VENDIM
Nr. 48, datë 31.7.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT"

(ndryshuar me vendimet: nr. 43, datë 30.7.2014, nr. 70, datë 18.12.2014, nr. 49, datë 1.7.2015, nr. 91, datë 2.12.2015, nr. 49, datë 30.3.2016, nr. 7, datë 5.2.2020)

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe neni 43 shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 58 shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", nenit 59 pikat 2 dhe 3 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit" dhe anekseve pjesë përbërëse të saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të rregullores, si dhe raportojnë në Bankën e Shqipërisë në lidhje me ecurinë e marrjes së masave dhe të kërkesave për kapital, sipas kërkesave të Departamentit të Mbikëqyrjes.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 58, datë 5.5.1999, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në buletinin zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 31 dhjetor 2014.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është:
a) përcaktimi i kritereve dhe rregullave për llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit; dhe
b) përcaktimi i nivelit minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Neni 2
Baza juridike

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12 shkronja “a” dhe neni 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) nenit 58 shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, nenit 59 pikat 2 dhe 3 dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji për bankat.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen “banka”).

Neni 4

Përkufizime

(ndryshuar nënpika 7 e shkronjës “a” të pikës 2, nënpika 11 e pikës 2 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat.

2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime dhe do të përdoren respektivisht:

a) Në kreun III, për llogaritjen e kërkesave për kapital të rrezikut të kredisë sipas metodës standarde:

1. “Institucion i jashtëm i vlerësimit të kredisë” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhet “ECAI”) është personi juridik, i cili kryen vlerësime dhe përcakton cilësinë e kredisë së një institucioni/subjekti tjetër.

2. “Institucion i jashtëm i vlerësimit të kredisë, i pranuar” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhet “ECAI” e pranuar) është institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë, i njohur nga Banka e Shqipërisë dhe i përfshirë në listën e ECAI-ve të pranuara, të publikuara në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë. Për qëllime të përllogaritjes së kërkesës për kapital, bankat mund të përdorin vetëm vlerësimet e kredisë së ECAI-ve të pranuara.

3. “Institucion i jashtëm i vlerësimit të kredisë, i emëruar” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhet “ECAI” e emëruar) është institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë i pranuar, vlerësimet e të cilit, banka ka vendosur t’i përdorë për qëllime të peshave të ponderimit me rrezikun.

4. “Agjencia e kreditimit të eksporteve” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhet “ECA”) është agjencia që mbështet aktivitetet e eksportit, të personave fizikë dhe juridikë, nga vendet në të cilat ECA-ja është e regjistruar. ECA-të ofrojnë kredi të garantuara nga qeveritë, garanci dhe sigurime, që mbulojnë si rrezikun politik, ashtu edhe atë tregtar, të vendit që merr hua. Bankat, në llogaritjen e kërkesës për kapital, mund të përdorin vlerësimet e kredisë, të publikuara nga ECA-ja, në rast se ato përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.

5. “Institucione të mbikëqyrura” janë bankat, shoqëritë e investimit dhe institucionet financiare.

6. “Shoqëritë e investimit” (shoqëritë komisionere) janë shoqëritë e përkufizuara sipas nenit 44 të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”.

7. “Institucionet financiare”[1] janë ndërmjetësit financiarë, subjekt i kërkesave

[1] Shfuqizuar.

mbikëqyrëse të barasvlershme me kërkesat mbikëqyrëse për bankat. Në rastin e institucioneve që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë do të përfshihen institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit e unionet e tyre, ndërsa nuk përfshihen zyrat e këmbimit valutor.

8. "Autoritete kompetente mbikëqyrëse" janë autoritetet vendase, kombëtare ose të huaja, të cilat janë të autorizuara me ligj apo rregullore, për mbikëqyrjen e bankave dhe/ose institucioneve të tjera financiare.

9. "Sipërmarrje investimesh kolektive" (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhet "SIK") janë sipërmarrjet e përkufizuara sipas nenit 2, pika 1 e ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

10. "Organe të qeverisjes lokale dhe rajonale" janë njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, siç përcaktohen nga autoritetet kompetente të çdo vendi.

11. 'Njësi të sektorit publik' janë organet administrative jotregtare, në varësi të qeverisë qendrore, qeverive rajonale apo autoriteteve lokale ose autoriteteve që ushtrojnë përgjegjësi të njëjta si qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale; ose ndërmarrjet/personat juridikë jotregtarë që zotërohen ose krijohen dhe financohen nga qeveria qendrore, qeveritë rajonale ose autoritetet lokale dhe garantohen prej tyre, të cilat përfshijnë organizmat që vetadministrohen dhe funksionojnë në bazë të një ligji të veçantë dhe janë nën mbikëqyrjen shtetërore.

12. "Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen "SME") për qëllime të kësaj rregulloreje janë respektivisht kategoritë, të cilat plotësojnë nivelet e mëposhtme të xhiros vjetore:

Kategoria	**Xhiro vjetore**
Mikrondërmarrje	më pak se 10 milionë lekë;
Ndërmarrje të vogla	10-50 milionë lekë;
Ndërmarrje të mesme	më pak se 250 milionë lekë.

13. "Ekspozime (kredi) me probleme" janë ekspozimet (kreditë), të cilat sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë", klasifikohen në një nga kategoritë: nënstandarde të dyshimta dhe të humbura.

14. "Ekspozime, të cilat u përkasin kategorive me rrezik të lartë" janë investimet në shoqëritë e kapitalit sipërmarrës dhe investimet në shoqëritë e kapitalit privat, të lidhura respektivisht me aktivitetet e mëposhtme:

i) investimet e bankave në shoqëritë e kapitalit sipërmarrës, më së shumti nënkuptojnë investimet në kapitalin fillestar të SME-ve dhe kapitalin e sipërmarrjeve te reja, të cilat nuk mund të rrisin kapital në treg;

ii) investimet në shoqëritë e kapitalit privat të një banke, u referohen zhvillimit të produkteve dhe teknologjive të reja, rritjeve të shpejta, kostove të shkrirjes dhe blerjeve, forcimit të bilancit të sipërmarrjes, në të cilën investohet etj.

15. "Obligacione të garantuara" janë ato obligacione, emetimi i të cilave rregullohet nga një ligj i veçantë i vendit ku emetuesi është i regjistruar, dhe është subjekt i mbikëqyrjes së autoriteteve kompetente mbikëqyrëse, si dhe plotësojnë njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

i) fondet e përfituara nga shitja e obligacioneve të garantuara duhet të investohen në mjete, të cilat sigurojnë mbulim të mjaftueshëm për detyrimet që rrjedhin nga këto obligacione, deri në maturimin e tyre; dhe

ii) në rast falimentimi të emetuesit, këto obligacione mundësojnë një trajtim preferencial të mbajtësit të tyre (obligacioneve të garantuara), duke i dhënë atij prioritet në terma të pagesave të principalit dhe të interesit.

16. "*Cash*-i në proces arkëtimi" janë fonde në proces transferimi midis bankave, të cilat përfshijnë fonde në llogaritë e transfertave, të çeqeve dhe të tjera forma pagesash, të cilat janë dërguar për arkëtim[2].

---

[2] Për shembull "llogaritë pezull" siç përcaktohet në metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve

17. “Pagesat minimale të qirasë financiare” janë pagesat dhe ndonjë opsion blerjeje që qiramarrësi është ose mund të jetë e nevojshme të kryejë, gjatë kohëzgjatjes së qirasë (domethënë opsion, ushtrimi i të cilit është, në mënyrë të arsyeshme, i sigurt).

18. “Vlerësim i kërkuar” (*solicite drating*) është një vlerësim i lëshuar nga një ECAI e pranuar, me kërkesën e institucionit/subjektit që vlerësohet, kundrejt pagesës së një tarife. Do të konsiderohen të tilla edhe vlerësimet e lëshuara në mungesë të kërkesës, nëse institucioni/subjekti ka marrë më parë një vlerësim të kërkuar nga e njëjta ECAI.

19. “Vlerësimi i dhënë” (*unsolicited rating*) është një vlerësim i lëshuar nga një ECAI e pranuar, pa kërkesën e institucionit/subjektit që vlerësohet dhe pa pagesë të ndonjë tarifë.

b) Në kreun IV, për zbatimin e teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë:

20. “Zbutja e rrezikut të kredisë” është teknika e përdorur nga një bankë, për të zvogëluar rrezikun e kredisë të lidhur me një ekspozim ose ekspozime të saj.

21. “Mbrojtja e kredisë” është çdo metodë kontraktuale, sipas së cilës ofruesi i mbrojtjes shet dhe blerësi i mbrojtjes përfiton mbrojtje, me qëllim zbutjen e rrezikut të kredisë.

22. “Aktiv bazë” është aktivi, i regjistruar në bilancin e blerësit të mbrojtjes së kredisë, për të cilin blihet mbrojtja.

23. “Blerës i mbrojtjes” është subjekti, që blen mbrojtje kundrejt rrezikut të kredisë, (domethënë shet rrezikun e kredisë).

24. “Ofrues i mbrojtjes” është subjekti që shet mbrojtje kundrejt rrezikut të kredisë, (domethënë blen rrezikun e kredisë).

25. “Mbrojtje e financuar e kredisë” janë teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë, që i japin blerësit të mbrojtjes të drejtën, që në rast dështimi të subjektit huamarrës në shlyerjen e detyrimit, të rimbursojë vlerën e kredisë së dhënë nëpërmjet aktiveve ose vlerave monetare të përcaktuara paraprakisht.

26. “Mbrojtje e pafinancuar e kredisë” janë teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë që bazohen në angazhimin e një pale të tretë për t’i paguar bankës një shumë të caktuar në rast paaftësie paguese të huamarrësit ose me materializimin e ngjarjeve të përcaktuara lidhur me kredinë.

27. “Transaksion huadhënieje i kolateralizuar” është çdo transaksion nga i cili buron një ekspozim i siguruar me kolateral, që nuk përfshin ndonjë klauzolë që i jep bankës të drejtën të përftojë shpesh marzh nga huamarrësi, pengdhënësi ose ofruesi i kolateralit.

28. “Transaksion i bazuar në tregun e kapitalit” është çdo transaksion nga i cili buron një ekspozim i siguruar me kolateral, që përfshin një klauzolë, e cila i jep bankës të drejtën të përftojë shpesh marzh nga huamarrësi, pengdhënësi ose ofruesi i kolateralit.

29. “Ngjarje kredie” është ngjarja që në përputhje me përcaktimet kontraktuale midis palëve (ofruesit dhe blerësit të mbrojtjes), detyron ofruesin e mbrojtjes t’i paguajë blerësit të mbrojtjes shumën e parashikuar në kontratë.

30. “Marrëveshjet tip të netimit (kompensimit)” janë marrëveshje që lejojnë netimin (kompensimin) e ekspozimeve përkatëse të dy palëve të përfshira, bazuar në transaksione ligjore individuale. Në rast të zgjidhjes së marrëveshjeve, ato (marrëveshjet tip) lejojnë shlyerjen e shumave përkatëse të lidhura me të gjitha transaksionet. Marrëveshjet tip të netimit (kompensimit) përcaktojnë termat dhe kushtet e netimit kur palët kryejnë transaksione të lidhura me produkte të ndryshme, të rregulluara nga marrëveshje individuale. Në këtë kuadër, marrëveshjet tip të netimit (kompensimit) rregullojnë marrëdhënien e përgjithshme midis palëve, duke i dhënë palës që nuk ka dështuar, të drejtën për të mbyllur të gjitha transaksionet e përfshira në marrëveshje në momentin që kundërpartia dështon të respektojë detyrimin e saj qoftë edhe për një transaksion të vetëm.

---

financiare.

31. “Derivativët e kredisë” janë kontrata që përcaktojnë detyrimin e ofruesit të mbrojtjes për t’i paguar blerësit të mbrojtjes detyrimin e parashikuar kontraktualisht në rast të materializimit të një ngjarjeje kredie të paracaktuar. Ky detyrim do të konsistojë në njërën nga vlerat e mëposhtme:

i) masën e rënies së vlerës së detyrimit referencë në raport me vlerën fillestare (*cash settlement variable*);

ii) vlerën e plotë nominale (*notional*) të detyrimit referencë në këmbim të dorëzimit (*physical delivery*) të detyrimit referencë ose të një instrumenti financiar ekuivalent (*deliverable obligation*) të specifikuar në kontratë;

iii) një shumë fikse të paracaktuar (*binary payout*).

32. “Detyrimi referencë” është detyrimi që përdoret për qëllime të përcaktimit të vlerës së shlyerjes *cash*, ose të detyrimit të dorëzueshëm, në rastin e derivativëve të kredisë.

33. “*Credit Default Swap*” është një lloj derivativi kredie, sipas të cilit blerësi i mbrojtjes ia transferon ofruesit të mbrojtjes rrezikun e kredisë të detyrimit referencë. Ofruesi i mbrojtjes merr përsipër të kompensojë blerësin e mbrojtjes në rast se materializohen ngjarjet e kredisë të specifikuara në kontratë. Për këtë shërbim, blerësi i mbrojtjes i paguan ofruesit të mbrojtjes një prim periodik.

34. “*Total Return Swap*” janë kontrata, nëpërmjet të cilave blerësi i mbrojtjes angazhohet t’i transferojë ofruesit të mbrojtjes të gjitha flukset e parasë që burojnë nga detyrimi referencë. Ofruesi i mbrojtjes nga ana e tij, i transferon blerësit flukset e parasë që lidhen me një normë referencë. Në datat e pagimit të flukseve të parasë (ose në datën e përfundimit të kontratës), blerësi i mbrojtjes i transferon ofruesit shumën e rivlerësimit të mundshëm të detyrimit referencë (domethënë një shumë të barabartë me diferencën pozitive midis vlerës së tregut dhe vlerës fillestare të detyrimit referencë). Në rast të rënies së vlerës së detyrimit referencë, ofruesi i mbrojtjes i transferon blerësit shumën përkatëse që kompenson këtë rënie.

35. “*Credit Linked Notes*” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen “CLN”) janë instrumente derivative me një *Embedded Credit Default Swap*, të cilat i lejojnë blerësit të mbrojtjes t’i transferojë ofruesit rrezikun që buron nga aktivi mbi të cilin bazohet CLN. Ofruesi i mbrojtjes merr nga blerësi një pagesë periodike (kupon) dhe vlerën e aktivit, kur ky maturohet, përveç rastit kur ndodh një ngjarje kredie përpara maturimit të aktivit, mbi të cilin bazohet CLN.

36. “Teknikat e zbutjes shportë (*basket*)” janë teknika që bazohen në derivativë kredie shportë, ku blerësi i mbrojtjes i transferon ofruesit rrezikun e kredisë të më shumë se një ekspozimi (disa ekspozimeve). Format e zakonshme të derivativëve të kredisë shportë janë *first-to-default* dhe *nth-to-default*.

37. “Derivativ kredie *first-to-default*” është një kontratë që lidhet me një numër të caktuar (shportë) ekspozimesh, sipas termave të së cilës dështimi i parë ndër ekspozimet do të shkaktojë pagesën e detyrimit nga ofruesi i mbrojtjes.

38. “Derivativ kredie *nth-to-default*” është një kontratë që lidhet me një numër të caktuar (shportë) ekspozimesh sipas termave të së cilës, dështimi i n-të ndër ekspozimet do të shkaktojë pagesën e detyrimit nga ofruesi i mbrojtjes.

39. “Instrumente të ngjashme me *cash*-in” janë certifikatat e depozitës ose instrumente të tjera të ngjashme të lëshuara nga banka, të cilat përfshijnë detyrimin për t’u rimbursuar me vlerë nominale.

40. “Vlera e dorëzimit” është shuma monetare që një shoqëri sigurimi i paguan një të siguruari që ka anuluar një policë sigurimi jete (domethënë vlera në *cash* e akumuluar nga primet dhe interesat për çdo vlerë monetare të mëparshme, në rastet që këto të fundit tejkalojnë koston e sigurimit).

41. “*Cross-Default*” është një klauzolë në një marrëveshje kredie apo instrumenti, që sjell shpalljen e dështimit të huamarrësit, nëse ky i fundit ka dështuar në shlyerjen e një

detyrim tjetër (njihet ndryshe edhe si *cross-acceleration*).

42. “Rivendosja e marzhit” është vendosja e *cash*-it ose letrave me vlerë shtesë me kundërpartinë në përgjigje të thirrjes për marzh. Në rastet kur vlera e tregut e kolateralit të lënë peng bie, mbajtësi i kolateralit i kërkon kundërpartisë të rivendosë marzhin për të respektuar kërkesat e përcaktuara.

c) Në kreun V, për llogaritjen e kërkesave për kapital të rrezikut në pozicionet e krijuara në procesin e titullzimit:

43. “Titullzimi” është një operacion apo një praktikë financiare, ku rreziku i kredisë i një ekspozimi ose ekspozimi të mundshëm, apo një portofoli ekspozimesh ose ekspozimesh të mundshme, ndahet në një ose disa segmente rreziku (transhe), në të cilin/ët:

i) pagesat e kryera varen nga ecuria e ekspozimit apo e grupit të ekspozimeve, në të cilën mbështetet ky operacion;

ii) segmentet e rrezikut (*transche*-et) kanë prioritete të ndryshme në mbulimin e humbjeve të ekspozimeve apo të grupit të ekspozimeve të titullzuara.

44. “Titullzimi tradicional” është operacion titullzimi, në të cilin transferimi i rrezikut të kredisë në dy ose më shumë segmente (transhe) realizohet nëpërmjet transferimit të ekspozimeve ose ekspozimeve të mundshme të titullzuara në një entitet me qëllim të posaçëm (*Special Purpose Vehicle* - SPV), i cili përkundrejt ekspozimeve të tilla, emeton tituj (*asset-backed securities*). Titujt e emetuar nuk përfaqësojnë detyrim për t’u paguar nga banka origjinuese. Konsiderohet titullzim tradicional edhe transferimi i rrezikut të kredisë nëpërmjet dhënies së financimeve bankës origjinuese nga ana e entit të posaçëm (*sub-participation*).

45. “Titullzimi sintetik” është operacion titullzimi, në të cilin transferimi i rrezikut të kredisë në një ose dy segmente realizohet nëpërmjet përdorimit të derivativëve të kredisë ose garancive, dhe aktivet ose portofoli i aktiveve të titullzuara nuk janë objekt transferimi. Konsiderohen titullzim sintetik edhe operacionet, me anë të të cilëve është e mundur që në kuadër të një portofoli të përbërë nga një ose disa lloj aktivesh, të izolohet një komponent rreziku që mbulon humbjet e para (*first loss*) të vetë portofolit, nëpërmjet teknikave të zbutjes së kredisë (të financuar dhe të pafinancuar).

46. “Ekspozime të titullzuara” janë një ose disa ekspozime ose ekspozime të mundshme të bankës, të cilat janë subjekt i titullzimit. Këtu përfshihen kreditë: titujt e borxhit, titujt e kapitalit, *asset-backed securities*[3], angazhime për dhënie fondesh etj.

47. “Pozicion titullzimi” është çdo lloj pozicioni që rrjedh nga titullzimi, të tilla si: titujt e emetuar nga entitetet me qëllim të posaçëm (SPV), lehtësirat e likuiditetit, huat e varura, kontratat derivative të normave të interesit ose monedha të shkëmbyera gjatë një operacioni titullzimi.

48. “Origjinuesi” është subjekti, i cili:

i) origjinon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi aktivet e bilancit ose jashtë bilancit, të cilat janë objekt titullzimi;

ii) titullzon aktivet e blera nga një palë e tretë, të regjistruara në bilancin e tij.

49. “Promotori” është subjekti i ndryshëm nga origjinuesi, që themelon dhe menaxhon një program ABCP apo skema të tjera titullzimesh, ku ekspozimet e titullzuara blihen nga subjekte palë e tretë.

50. “Programi ABCP (*Asset-Backed Commercial Paper*)” është një program titullzimi, në të cilin titujt e emetuar nga entiteti me qëllim të posaçëm (SPV) marrin kryesisht formën e letrave tregtare[4] me një maturitet fillestar prej një ose më pak se një viti.

---

[3] “*Assets back securities*” është një instrument financiar i siguruar me një kredi, qira apo një llogari të arkëtueshme, përkundrejt një apo disa aktiveve (duke përjashtuar pasuritë e paluajtshme dhe instrumentet e siguruara me pasuri të paluajtshme).

[4] “*Commercial Paper*” është një instrument afatshkurtër i pasiguruar borxhi, i emetuar nga një shoqëri me qëllim

51. “Entitet me qëllim të posaçëm” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen “SPV”) është shoqëria ose një subjekt tjetër juridik, i ndryshëm nga banka, i krijuar me qëllim kryerjen e një ose më shumë titullzimeve, dhe që ka karakteristikat e mëposhtme:

i) aktiviteti i saj është i lidhur ekskluzivisht me realizimin e operacioneve të titullzimit;

ii) struktura e entitetit ka për qëllim të izolojë detyrimet e saj nga ato të bankave origjinuese;

iii) zotëruesit e interesave ekonomike mund të përfitojnë apo këmbejnë lirisht këto interesa.

52. “Përmirësimi i cilësisë së kredisë” (*credit enhancement*) është një mekanizëm kontraktual, ku cilësia e kredisë së një pozicioni titullzimi përmirësohet në raport me cilësinë që do të evidentohej në rast të mungesës së një mekanizmi të tillë, duke përfshirë dhe rastin e përmirësimit të siguruar nga segmente me prioritet më të ulët në titullzim apo nga lloje të tjera të mbrojtjes së kredisë.

53. “Segment” (*tranche*) janë pozicione (kuota) të rrezikut të kredisë, të lidhura me një ekspozim apo një numër ekspozimesh, të përcaktuara kontraktualisht, ku çdo pozicion (kuotë) është i lidhur me një shkallë prioriteti (*subordination*) të lartë apo të ulët në mbulimin e humbjeve, krahasuar me një pozicion tjetër të tillë, duke mos marrë parasysh mbrojtjen e kredisë, të siguruar nga palët e treta direkt për mbajtësit e pozicioneve në këtë segment apo në segmente të tjera. Sipas prioritetit të mbulimit të humbjeve, pozicionet e titullzimit ndahen në: *senior*, *mezzanine* dhe *junior*.

54. “Marzhi i tejkaluar” (*Excess spread*) është diferenca midis flukseve të të ardhurave nga ekspozimet ose ekspozimet e mundshme të titullzuara dhe detyrimeve dhe shpenzimeve të lidhura me titullzimin.

55. “Investues” është subjekti, i cili gjatë një operacioni titullzimi, mban pozicione rreziku përkundrejt titullzimit.

56. “*Opsioni clean-up call*” është marrëveshja kontraktuale, që i lejon origjinuesit ushtrimin e opsionit të riblerjes ose mbylljes së pozicionit të titullzimit, përpara se të jenë ripaguar të gjitha ekspozimet e titullzuara përkatëse, kur shuma e ekspozimeve të tilla bie nën një nivel të caktuar.

57. “Lehtësira likuiditeti” janë pozicionet e titullzimit, që rezultojnë nga një marrëveshje kontraktuale, me qëllim sigurimin në kohën e duhur të financimit të flukseve të parasë për investitorët.

58. “Pozicionet e pavlerësuara” janë pozicionet e titullzimit që nuk kanë një vlerësim të vlefshëm kredie nga një ECAI e pranuar nga Banka e Shqipërisë.

59. “Pozicionet e vlerësuara” janë pozicionet e titullzimit që kanë një vlerësim të vlefshëm kredie nga një ECAI e pranuar nga Banka e Shqipërisë.

60. “Pozicion që mbart me përparësi humbjen” (*first loss tranche*) është pozicioni (segmenti/transhi) në një titull që përballon humbjen e parë, nëse bie vlera e ekspozimeve të titullzuara ose kanë nisur procedurat e ekzekutimit. Pozicionet që mbartin me përparësi humbjen kanë rrezik dhe kthim më të lartë.

61. “Ndarje përpjesëtimore (*pro-rata*)” është ndarja e pagesave, ndërmjet bankës origjinuese dhe investitorëve të pagesave të interesit, principalit, shpenzimeve, humbjeve, rimarrjeve (nëse aplikohen), bazuar në peshën në përqindje të bankës origjinuese dhe investitorit, në balancën e përdorur të ekspozimeve që janë në bazë të titullzimit, në fillim të çdo muaji.

62. “Ekspozim qarkullues” është një ekspozim ku bilancet e llogarive të klientëve lejohen të luhaten deri në një kufi të miratuar.

63. “Klauzolë e amortizimit të hershëm” është një klauzolë kontraktuale që në rast materializimi të ngjarjeve të përcaktuara, kërkon që pozicionet e investitorëve të shlyhen

---

financimin e detyrimeve afatshkurtra.

përpara maturitetit origjinal të titujve të emetuar.

d) Në kreun VI, për llogaritjen e kërkesave për kapital të rrezikut të kredisë së kundërpartisë:

64. “Rreziku i kredisë së kundërpartisë” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen “CCR”) është rreziku i dështimit të një kundërpartie në një transaksion, para se të bëhet pagesa finale e flukseve të parasë së transaksionit.

65. “Kundërpartia qendrore” është çdo njësi, e cila ligjërisht qëndron midis kundërpartive të kontratave të tregtuara në një ose më shumë tregje financiare, duke qenë në rolin e blerësit për çdo shitës dhe të shitësit për çdo blerës.

66. “Transaksione me afat të gjatë shlyerje” janë transaksionet në të cilat një kundërparti merr përsipër të dorëzojë një titull, një mall (*commodity*) ose një shumë në monedhë të huaj përkundrejt *cash*-it, instrumenteve të tjera financuara, ose malli (*commodity*), apo anasjellas, në një afat shlyerje ose dorëzimi, që është i specifikuar në kontratë, si më i shkurtri midis standardeve të tregut për këtë transaksion konkret dhe pesë ditë pune pas datës në të cilën bankat hyjnë në transaksion.

67. “Transaksionet e huadhënies me marzhe” janë transaksionet, në të cilat një bankë akordon një kredi, e cila lidhet me blerjen, shitjen, mbajtjen ose tregtimin e titujve. Transaksione të tilla nuk përfshijnë kreditë e tjera që mund të sigurohen me tituj si kolateral.

68. “Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes” janë të gjitha llojet e marrëveshje që përmbushin kriteret e mëposhtme:

i) sipas kësaj marrëveshjeje banka ose kundërpartia transferojnë pronësinë mbi titujt ose mallrat (*commodities*) ose të drejta të garantuara të lidhura me titujt dhe mallrat (*commodities*) (ku garancia është e lëshuar nga një bursë e njohur, e cila mban të drejtat për këtë titull ose mall (*commodities*); dhe

ii) kjo marrëveshje nuk i lejon një banke të transferojë ose të lerë peng (ose të shkëmbejë për tituj ose mallra (*commodities*) të njëjtë) një titull të caktuar ose një mall (*commodity*);

iii) te më shumë se një kundërparti njëkohësisht, e cila ka marrë përsipër t’i riblejë ato (ose tituj të ngjashëm ose mallra (*commodities*) që zëvendësojnë njëri-tjetrin), në një datë të ardhme të përcaktuar ose që mund të caktohet nga transferuesi.

Në rastin e bankave, një marrëveshje riblerje përfaqëson një marrëveshje, e cila përmbush kriteret e mësipërme dhe sipas së cilës banka shet titujt ose mallrat (*commodities*), ndërsa një marrëveshje e anasjellë e riblerjes përfaqëson një marrëveshje që përmbush kriteret e mësipërme dhe sipas së cilës banka blen titujt ose mallrat (*commodities*).

69. “Grup netimi (kompensimi)” është një marrëveshje që përfshin një grup transaksionesh me një kundërparti të vetme, të cilat janë subjekt i netimit (kompensimit) të dyanshëm, dhe për të cilat njihet netimi (kompensimi) në nënkreun II të kreut VI të kësaj rregulloreje. Çdo transaksion që nuk është subjekt i një marrëveshje netimi (kompensimi) ligjërisht të detyrueshme, dhe që njihet në nënkreun II të kreut VI, duhet të interpretohet si netim i veçantë për qëllime të këtij kreu.

70. “Marrëveshje e huadhënies së titujve e të mallrave (*commodities*) dhe marrëveshje e huamarrjes së titujve dhe të mallrave (*commodities*)” është çdo marrëveshje, sipas së cilës një bankë apo kundërpartia e saj, transferon tituj dhe mallra (*comimodities*) përkundrejt një kolaterali të përshtatshëm, kundrejt detyrimit që huamarrësi të kthejë të njëjtët titujt ose mallrat (*commodities*), në një datë të ardhme ose kur i kërkohet nga transferuesi. Tituj të njëjtë konsiderohen titujt e emetuar nga i njëjti emetues, me të njëjtën normë interesi, me të njëjtin maturitet, të denominuar në të njëjtën monedhë dhe që kanë të njëjtin trajtim në rast falimentimi.

71. “Pozicioni i rrezikut” është një numër që i jepet një transaksioni sipas metodës standarde, të përcaktuar sipas një algoritmi të paracaktuar në kreun VI.

72. “Grup mbrojtës” është një marrëveshje që synon mbrojtjen e grupeve të pozicioneve të rrezikut, që rrjedhin nga transaksionet brenda një marrëveshje të vetme netimi (kompensimi) për të cilën, vetëm balanca e tyre është e rëndësishme për të përcaktuar vlerën e ekspozimit sipas metodës standarde, të përcaktuar në kreun VI.

73. “Vlera aktuale e tregut” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen “CMV”) është vlera neto e tregut të portofolit të transaksioneve brenda marrëveshjes së netimit me kundërpartinë. Në llogaritjen e kësaj vlere përfshihen vlerat pozitive dhe negative të tregut, siç përcaktohen me metodën standarde të rrezikut të kundërpartisë.

74. “Kontratat plotësisht të ngjashme” janë kontrata *forward* mbi monedhat ose kontrata të ngjashme, në të cilat vlera nominale është ekuivalente me flukset e parasë, nëse flukset e parasë duhet të shlyhen në të njëjtën datë dhe janë plotësisht apo pjesërisht në të njëjtën monedhë.

e) Në kreun VII, për llogaritjen e kërkesave për kapital të rrezikut të tregut:

75. “Instrumente derivative të tregut mbi banak” (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen “OTC”) janë instrumentet e përcaktuar sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje, të cilat nuk tregtohen me ndërmjetësimin e një kundërpartie qendrore.

76. “Titull i konvertueshëm” është një titull, mbajtësi i të cilit ka opsionin ta këmbejë atë për një titull tjetër.

77. “Garancia” (*Warrant*) është një titull, i cili i jep të drejtë mbajtësit të blejë një aset bazë të caktuar, me një çmim të përcaktuar, brenda datës së skadencës ose në këtë datë, dhe që mund të shlyhet me anë të dorëzimit të vetë aktivit bazë[5] ose nëpërmjet shlyerjes *cash*.

78. “Financime të stokut” janë pozicione të krijuara nga shitja *forward* e stokut fizik të mallrave (*commodities*), dhe mbajtjes së pandryshueshme të kostos së financimit, deri në datën e shitjes *forward*.

79. “Bursë e njohur” është bursa që plotëson kriteret e mëposhtme:

i) funksionon normalisht;

ii) ekzistojnë rregulla të miratuara nga autoritetet kompetente të vendit ku ndodhet bursa, të cilat përcaktojnë kriteret për veprimtarinë e saj, kushtet për të pasur akses në këtë bursë, si dhe kushtet që duhet të plotësojnë kontratat, përpara se të tregtohen në bursë;

iii) bursa ka një mekanizëm *clearing*-u, përmes të cilit kontratat e listuara janë subjekte të një kërkese për marzh ditor, i cili, sipas opinionit të Bankës së Shqipërisë, siguron mbrojtjen e duhur.

80. “Koeficienti *delta*” është koeficienti që përfaqëson ndryshimin e pritshëm në çmimin e një opsioni, si rezultat i ndryshimit në çmimin e instrumentit bazë të tij.

81. “Koeficienti *gama*” është koeficienti që përfaqëson ndryshimin relativ të vlerës së koeficientit delta, të shkaktuar nga ndryshime të vogla në çmimin e instrumentit bazë të opsionit;

82. “Koeficienti *vega*” është koeficienti që përfaqëson ndryshimin në çmimin e një opsioni, të shkaktuar nga ndryshime të vogla në luhatshmërinë e instrumentit bazë të tij.

f) Në kreun VIII, për llogaritjen e kërkesave për kapital të rrezikut operacional.

83. “Rrezik operacional” është rreziku që subjekti të pësojë humbje, si rezultat i papërshtatshmërisë ose dështimit të proceseve të brendshme dhe të sistemeve, gabimeve njerëzore, apo i ngjarjeve të jashtme. Rreziku operacional përfshin dhe rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun reputacional dhe strategjik.

84. “Sistemi i administrimit të rrezikut operacional” është tërësia e rregullave,

---

[5] “*Underlying asset*” është një instrument financiar (për shembull aksionet, kontratat e së ardhmes, mallrat (*commodities*), monedhat, indekset etj.) mbi të cilat bazohet (derivon) çmimi i një derivativi (“derivativ” - është një instrument financiar çmimi i të cilit bazohet (derivon) nga një aset i ndryshëm).

proceseve, procedurave, strukturave dhe burimeve të krijuara nga banka për identifikimin, monitorimin, kontrollin, parandalimin dhe zbutjen e ekspozimeve ndaj rreziqeve operacionale. Ky sistem përfshin edhe sistemin e matjes së rrezikut operacional.

85. "Sistemi i matjes së rrezikut operacional" është tërësia e rregullave, proceseve, procedurave dhe kontrolleve për mbledhjen, trajtimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave mbi rreziqet operacionale dhe për përcaktimin e kërkesave për kapital, për rrezikun operacional.

KREU II
MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

Neni 5
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

1. Bankat llogarisin mjaftueshmërinë e kapitalit si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, e shprehur në përqindje, në baza individuale dhe të konsoliduara.

2. Bankat sigurojnë që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, i llogaritur sipas paragrafit 1 të këtij neni, të jetë jo më i vogël se 12%.

Neni 6
Ekspozimet e ponderuara me rrezikun

(shtuar paragrafët 2, 3, 4, 5, me vendimin nr. 70, datë 18.12.2014, ndryshuar paragrafi 4 me vendimin nr. 49, datë 1.7.2015, ndryshuar me vendimin nr. 91, datë 2.12.2015)

1. Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementeve të mëposhtme:

a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuar me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas metodës standarde, të përcaktuar respektivisht në kreun III dhe në kreun VI të kësaj rregulloreje;

b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5;

c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas metodës së treguesit të thjeshtë ose sipas metodës standarde, të përcaktuara në kreun VIII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5.

2. Pavarësisht përcaktimeve në paragrafin 1 të këtij neni, banka rregullon totalin e aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun, siç përcaktohet më poshtë:

a) duke e shtuar me vlerën e rritjes që rezulton në krahasim me muajin mars 2013, të klasave në aktiv të bilancit "veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "veprime në valutë me tituj" me jorezidentët, pasi të jetë zbritur vlera e shtuar e detyrimeve ndaj jorezidentëve në valutë, që i përkasin të njëjtave klasa në atë periudhë raportuese;

b) për vitin 2016:

i) për periudhën 1 janar – 30 qershor 2016, duke e pakësuar me vlerën që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

1) vlerën e rritjes së tepricës bruto të kredisë për klientët , të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) % dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) %;

2) vlerën 10 (dhjetë) % të tepricës bruto të kredisë për klientët të akorduar brenda vendit, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e

kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) %;

ii) për periudhën 1 korrik – 31 dhjetor 2016, duke e pakësuar me gjysmën e vlerës që rezulton nga një prej dy llogaritjeve të mëposhtme:

1) vlerën e rritjes së tepricës bruto të kredisë për klientët , të akorduar brenda vendit, në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se kjo rritje është më e madhe se 4 (katër) % dhe më e vogël ose e barabartë me 10 (dhjetë) %;

2) vlerën 10 (dhjetë) % të tepricës bruto të kredisë për klientët të akorduar brenda vendit, në krahasim me muajin dhjetor 2015, në rast se rritja në periudhën e raportimit, e kthyer në bazë vjetore, është më e madhe se 10 (dhjetë) %.

3. Përllogaritjet sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të paragrafit 2, bëhen sipas formularit 1 dhe 2, aneksi 8.

4. Shkronjat “a” dhe “b”, të paragrafit 2, të këtij neni, janë në fuqi deri në fund të vitit kalendarik 2016.

5. Në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, banka respekton nivelin minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje ose përcaktimeve të tjera të Bankës së Shqipërisë.

Neni 7

Kapitali rregullator

1. Bankat llogarisin kapitalin rregullator sipas udhëzimit të Bankës së Shqipërisë “Për kapitalin rregullator të bankës”.

2. Bankat sigurojnë që kapitali rregullator të jetë në çdo kohë më shumë se totali i:

a) kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritur si totali i ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me rrezikun, të shumëzuara me 12%;

b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 1.5;

c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas metodës së treguesit të thjeshtë ose sipas metodës standarde, të përcaktuara në kreun VIII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 1.5.

KREU III

RREZIKU I KREDISË

NËNKREU I

METODA STANDARDE

Neni 8

Të përgjithshme

1. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas metodës standarde.

2. Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas metodës standarde, është e barabartë me 12% të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me peshat e rrezikut, në përputhje me përcaktimet e këtij kreu të rregullores.

Neni 9

Përcaktimi i vlerës së ekspozimit

1. Vlera e ekspozimit është vlera e tij në bilanc, ndërsa vlera e ekspozimit të

mundshëm, siç përcaktohet në aneksin 2 të kësaj rregulloreje, do të jetë një përqindje e vlerës së tij, sipas klasifikimit në kategoritë e rrezikut[6], si më poshtë:

a) 100% e vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të lartë;

b) 50% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të mesëm;

c) 20% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të ulët;

d) 0% të vlerës së tij, për kategorinë pa rrezik.

2. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit përkatës, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve.

3. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit, në rastet kur ky ekspozim është subjekt i mbrojtjes së financuar të kredisë, duke konsideruar teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë, në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje.

4. Bankat, në rastet kur përdorin metodën gjithëpërfshirëse për njohjen e kolateralit financiar, si teknikë për zbutjen e rrezikut të kredisë, kur ekspozimi është në formën e titujve ose të mallrave (*commodities*) të shitura, të vendosura ose të huazuara në një transaksion riblerje ose në një transaksion të dhënies ose marrjes hua të titujve ose të mallrave (*commodities*) dhe transaksioneve të kreditimit me marzhe, do të rregullojnë vlerën e ekspozimit, me efektet në rritje të kësaj vlere, si rezultat i ndikimit të luhatshmërisë, siç përcaktohet në kreun IV të kësaj rregulloreje.

5. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të një instrumenti derivativ, të listuar në aneksin 4 të kësaj rregulloreje, në përputhje me kreun VI të saj.

6. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të transaksioneve të riblerjes, të transaksioneve të dhënies ose marrjes hua të titujve ose të mallrave (*commodities*), të transaksioneve me afat të gjatë shlyerje (*long settlement*) dhe transaksioneve të kreditimit me marzhe, në përputhje me kreun VI ose kreun IV të kësaj rregulloreje.

7. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të rrezikut të kredisë ndaj një kundërpartie qendrore, në përputhje me kreun VI të kësaj rregulloreje, me kusht që ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë të kundrëpartisë qendrore, ndaj të gjithë pjesëmarrësve në marrëveshjet e saj, të jetë plotësisht i kolateralizuar në baza ditore.

Neni 10

Klasat e ekspozimit

(Ndryshuar shkronja "c" e pikës 1 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat klasifikojnë çdo ekspozim të zërave, brenda dhe jashtë bilancit, në një nga klasat e ekspozimit në vijim:

a) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;

b) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;

c) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj njësive të sektorit publik;

d) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;

e) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;

f) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;

g) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);

h) ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofolave me pakicë (*retail*);

i) ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;

j) ekspozime (kredi) me probleme;

k) ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;

---

[6] *Përpara ponderimit me peshat e rrezikut.*

l) ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;

m) ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (*securitization*);

n) ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK; dhe/ose

o) zëra të tjerë.

2. Bankat klasifikojnë ekspozimin/et në klasën e ekspozimit me pakicë, të përmendur në shkronjën "h" të paragrafit 1 të këtij neni, nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) ekspozimi është ndaj një ose disa individëve, ose ndërmarrjeve të vogla apo të mesme;

b) ekspozimi merr një nga format e kredisë dhe linjave të kredisë së rinovueshme (*revolving*) (p.sh. për karta krediti, kreditë kufi/*overdraft*-et etj.), kreditë konsumatore dhe qiratë financiare personale (p.sh. kreditë me këste, kreditë dhe qiratë financiare për automjete, kreditë për shkollim etj.) dhe linjat ose angazhimet e kredisë për ndërmarrjet e vogla apo të mesme;

c) ekspozimi është pjesë e një portofoli të diversifikuar mjaftueshëm për nga niveli i rrezikut;

d) ekspozimi agregat me pakicë ndaj një individi ose ndërmarrjeje të vogël apo të mesme dhe palëve të lidhura, i cili llogaritet si shumë bruto e të gjitha ekspozimeve (përpara zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve dhe teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë) dhe ekspozimeve të mundshme (duke konsideruar vlerën e tyre, siç përcaktohet në nenin 9 të kësaj rregulloreje), nuk tejkalon shumën 50 milionë lekë[7].

3. Bankat nuk trajtojnë/kualifikojnë ekspozimet në tituj, në klasën e ekspozimit/eve ndaj portofolave me pakicë.

4. Bankat trajtojnë vlerën e aktualizuar të pagesave minimale për marrëveshjet e qirasë financiare[8], në klasën e ekspozimit/eve ndaj portofolave me pakicë.

Neni 11

Kërkesa të përgjithshme për përcaktimin e vlerës së ekspozimeve të ponderuara me rrezikun dhe përcaktimi i peshave të rrezikut sipas klasave të ekspozimit

1. Bankat, për llogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, do të zbatojnë peshat e rrezikut për të gjitha ekspozimet, përveç rasteve kur këto ekspozime janë elemente zbritëse të kapitalit rregullator, siç përcaktohet në këtë nënkre.

2. Bankat zbatojnë peshat e rrezikut duke u bazuar në klasën e ekspozimit, në të cilën është klasifikuar ky ekspozim dhe në cilësinë e kredisë.

3. Cilësia e kredisë mund të përcaktohet duke iu referuar vlerësimeve të kredisë nga ana e ECAI-ve ose vlerësimeve të kreditit nga ECA, në përputhje me nënkreun II të këtij kreu.

4. Bankat, për qëllime të zbatimit të një peshe rreziku, shumëzojnë vlerën e ekspozimit me peshat e rrezikut, të specifikuara apo të përcaktuara, në përputhje me këtë nënkre.

5. Bankat, në rastet kur një ekspozim është subjekt i mbrojtjes së kredisë, mund të ndryshojnë peshën e rrezikut të zbatueshme për këtë ekspozim, duke përdorur teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë, siç përcaktohet në kreun IV të kësaj rregulloreje.

6. Bankat llogarisin shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për ekspozimet në pozicionet nga titullzimi, në përputhje me kërkesat e kreut V të kësaj rregulloreje.

---

[7] Bankat, në llogaritjen e portofolit me pakicë, përjashtojnë ekspozimet apo ekspozimet e mundshme, të siguruara me kolateral, pasuri të paluajtshme rezidenciale, të cilat përfitojnë ponderimin me 35%.

[8] *Outstanding balance*.

7. Bankat, për ekspozime, të cilat nuk janë parashikuar në këtë rregullore, llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezikun, duke u caktuar një peshë rreziku prej 100%.

Neni 12

Ekspozimet ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore

(ndryshuar paragrafi 4 me vendimin nr. 49, datë 1.7.2015)

1. Bankat, pa rënë ndesh me përcaktimet në paragrafët 2 deri 7 të këtij neni, ponderojnë ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore me 100%.

2. Bankat, bazuar në vlerësimin e përcaktuar nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore me peshat e rrezikut sipas tabelës 1.

Tabela 1

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	0%	20%	50%	100%	100%	150%

3. Bankat ponderojnë me 0% ekspozimet ndaj Bankës Qendrore Europiane.

4) Bankat ponderojnë me 0% ekspozimet ndaj qeverisë shqiptare, të emetuara dhe financuara në monedhë kombëtare dhe me 50% titujt e borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj.[9]

5. Bankat ponderojnë me 0% ekspozimet ndaj Bankës së Shqipërisë, të emetuara dhe financuara në monedhë kombëtare dhe në monedhë të huaj.

6. Bankat ponderojnë me 0% ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore të vendeve anëtare të Bashkimi Europian, të emetuara dhe të financuara në monedhën e tyre kombëtare.

7. Bankat, në rastin kur autoritetet kompetente të një vendi të tretë (përjashtimisht vendeve të BE-së), me kritere rregullatore dhe mbikëqyrëse, të paktën të barasvlershme me ato të Bankës së Shqipërisë, zbatojnë pesha rreziku më të vogla për ekspozimet ndaj qeverive qendrore ose bankave të tyre qendrore, të emetuara dhe financuara në monedhën e tyre kombëtare, krahasuar me ato të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, zbatojnë këto pesha rreziku vetëm me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

8. Bankat, në rastin kur nuk përdorin vlerësimin e një ECAI-je ose kur një ECAI e njohur nuk ka bërë vlerësim, ponderojnë ekspozimet ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore, me peshat e rrezikut të parashikuara në tabelën 2, sipas vlerësimit të rrezikut të mundësuar nga ECA, të njohura nga Banka e Shqipërisë dhe për të cilat banka ka për qëllim përdorimin e tyre.

Tabela 2

Primet minimale të sigurimit të eksportit (MEIP)	0	1	2	3	4	5	6	7
Pesha e rrezikut	0%	0%	20%	50%	100%	100%	100%	150%

Neni 13

Ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale

1. Bankat, pa rënë ndesh me përcaktimet në paragrafët 2 deri në 5 të këtij neni,

[9] Ndryshimet e vendosura në këtë nen me vendimin nr. 49, datë 1.7.2015 janë të vlefshme për një periudhë kohore deri në datën 1 janar 2021.

ponderojnë ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale, me të njëjtat pesha rreziku, siç ponderojnë ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura (trajtimi për ekspozimet afatshkurtra të institucioneve, siç përcaktohet në këtë nënkre, nuk është i zbatueshëm).

2. Banka e Shqipërisë, në rastet kur nuk ka diferenca në rrezikun që rrjedh nga të tilla ekspozime me ato ndaj qeverisë qendrore, për arsye të kompetencave të veçanta në realizimin e të ardhurave ose të ekzistencës së një marrëveshjeje institucionale, e cila zvogëlon rrezikun e humbjes deri në nivelin e rrezikut të qeverisë qendrore, mund të lejojë bankat të ponderojnë ekspozimet ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale, me të njëjtën peshë rreziku si ekspozimet ndaj qeverive qendrore, në juridiksionin e të cilave ato veprojnë.

3. Trajtimi që përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni zbatohet vetëm për ekspozimet ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale në Shqipëri dhe në shtetet anëtare të Bashkimit Europian, të përcaktuara në listën e përgatitur dhe të botuar për këtë qëllim, nga autoritetet kompetente të çdo vendi.

4. Ekspozimet ndaj komuniteteve fetare të krijuara si persona juridikë në bazë të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe që krijojnë të ardhura dhe janë subjekt i taksimit, sipas legjislacionit shqiptar që u referohet këtyre institucioneve, do të trajtohen si ekspozimet ndaj qeverive rajonale dhe autoriteteve lokale, me përjashtim të trajtimit të paragrafit 2 të këtij neni, i cili nuk gjen zbatim në këtë rast.

5. Bankat, në rastin kur autoritetet kompetente të një vendi të tretë (përjashtimisht vendeve të BE-së), me kritere rregullatore dhe mbikëqyrjeje, të paktën të barasvlershme me ato të Bankës së Shqipërisë, zbatojnë pesha rreziku të njëjta për ekspozimet ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale, me ato të përdorura për qeveritë e tyre qendrore, mund të zbatojnë këto pesha rreziku vetëm me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

Neni 14

Ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik

(Ndryshuar me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik, për të cilat nuk ekziston vlerësim nga një ECAI, bazuar në nivelin e cilësisë së kredisë, të caktuar për ekspozimet ndaj qeverisë qendrore, në juridiksionin e të cilave janë krijuar/veprojnë këto njësi të sektorit publik, me peshat e rrezikut, sipas tabelës 2.1.

Tabela 2.1

Cilësia e kredisë për qeverinë qendrore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	100%	150%

2. Bankat ponderojnë me 100% ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik të pavlerësuara, që janë krijuar/veprojnë në vendet, qeveria qendrore e të cilave është e pavlerësuar.

3. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik, për të cilat ekziston vlerësimi nga një ECAI, në përputhje me peshat e rrezikut për ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura, të përcaktuara në nenin 17/1 të kësaj rregulloreje. Trajtimi preferencial për ekspozimet afatshkurtra, i parashikuar në nenin 17, paragrafi 2, dhe në nenin 17/1, paragrafi 2, nuk është i zbatueshëm për njësitë e sektorit publik.

4. Pavarësisht sa përcaktohet më sipër, bankat ponderojnë me 20% ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik, me një maturim fillestar prej 3 (tre) muajsh ose më pak se 3 (tre) muajsh.

5. Bankat, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të trajtojnë ekspozimet ndaj

njësive të sektorit publik, si ekspozimet ndaj qeverisë qendrore, në juridiksionin e të cilave ato janë krijuar/veprojnë, në rastin kur nuk ka asnjë ndryshim në rrezikun që rrjedh nga ekspozime të tilla, në bazë të ekzistencës së një garancie të përshtatshme nga ana e qeverisë qendrore.

6. Bankat, në rastet kur autoritetet kompetente të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian i trajtojnë ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik, si ekspozime ndaj institucioneve apo si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, në juridiksionin e të cilave ato janë krijuar/veprojnë, mund të ponderojnë në mënyrë të ngjashme ekspozimet ndaj entiteteve të tilla.

7. Në rastet kur autoritetet kompetente të një vendi të tretë (përjashtimisht vendeve të BE-së) kanë kritere rregullatore dhe mbikëqyrjeje, të paktën të barasvlershme me ato të Bankës së Shqipërisë dhe që i trajtojnë ekspozimet ndaj njësive të sektorit publik, në përputhje me paragrafët 1 deri në 3 të këtij neni, atëherë bankat mund të ponderojnë në mënyrë të ngjashme këto ekspozime, vetëm me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë. Nëse nuk plotësohen kushtet e parashikuara në këtë paragraf, bankat zbatojnë një peshë rreziku 100%.

Neni 15
Ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit

1. Bankat, bazuar në vlerësimin e përcaktuar nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit, me peshat e rrezikut, sipas tabelës 3. Për qëllime të këtij neni, Korporata Ndëramerikane e Investimeve, Banka e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim dhe Banka e Amerikës Qendrore për Integrimin Ekonomik, do të konsiderohen si banka shumëpalëshe të zhvillimit.

Tabela 3

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	50%	100%	100%	150%

2. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit të pavlerësuara, me një peshë rreziku 50%.

3. Bankat ponderojnë me një peshë rreziku 0%, ekspozimet ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit, të listuara më poshtë:

a) Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (*International Bank For Reconstruction And Development*);

b) Korporatës Ndërkombëtare për Financa (*International Finance Corporation*);

c) Bankës Ndëramerikane për Zhvillim (*Inter-American Development Bank*);

d) Bankës Aziatike e Zhvillimit (*Asian Development Bank*);

e) Bankës Afrikane për Zhvillim (*African Development Bank*);

f) Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim (*Council of Europe Development Bank*);

g) Bankës Nordike të Investimeve (*Nordic Investment Bank*);

h) Bankës së Karaibeve për Zhvillim (*Caribbean Development Bank*);

i) Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (*European Bank for Reconstruction and Development*);

j) Bankës Europiane të Investimeve (*European Investment Bank*);

k) Fondit Europian të Investimeve (*European Investment Fund*);

l) Agjencisë Shumëpalëshe për Garantimin e Investimeve (*Multilateral Investment Guarantee Agency*);

m) Qendrës Ndërkombëtare Financiare për Mbrojtje (*International Finance Facility for Immunisation*); dhe

n) Bankës Islamike e Zhvillimit (*Islamic Development Bank*).

4. Bankat ponderojnë me 20% pjesën e kapitalit të papaguar, të regjistruar në Fondin Europian të Investimeve.

Neni 16

Ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare

1. Bankat ponderojnë me një peshë rreziku 0%, ekspozimet ndaj organizatave ndërkombëtare të mëposhtme:

a) Bashkimit Europian (*European Union*);

b) Fondit Monetar Ndërkombëtar (*International Monetary Fund*);

c) Bankës për Shlyerje Ndërkombëtare (*Bank for International Settlements*);

d) Qendrës së Stabilitetit Financiar Europian (*European Financial Stability Facility*);

e) Çdo institucioni financiar ndërkombëtar, të krijuar nga dy ose më shumë shtete anëtare të Bashkimit Europian, i cili ka për qëllim të sigurojë financimin dhe të mundësojë ndihmë financiare në favor të anëtarëve të tij, të cilët janë ekspozuar ose mund të ekspozohen ndaj situatave të rënda financiare.

Neni 17

Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura

(Ndryshuar me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura, për të cilat ekziston vlerësimi nga një ECAI, sipas përcaktimeve në nenin 17/1 të kësaj rregulloreje. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura, për të cilat nuk ekziston vlerësimi nga një ECAI, sipas përcaktimeve në nenin 17/2 të kësaj rregulloreje.

2. Bankat, për ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura që kanë një maturitet të mbetur 3 (tre) ose më pak se 3 (tre) muaj dhe që janë të shprehura dhe të financuara në monedhën kombëtare të huamarrësit, zbatojnë një peshë rreziku që është një kategori më pak e favorshme se pesha preferenciale e rrezikut, e zbatuar ndaj qeverisë qendrore (siç përcaktohet në paragrafët 4, 6 dhe 7, të nenit 12 të kësaj rregulloreje). Kjo peshë rreziku, në çdo rast, nuk mund të jetë më pak se 20%.”.

Neni 17/1

Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura të vlerësuara

(shtuar me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura me një maturitet të mbetur prej më shumë se 3 (tre) muajsh, për të cilat ekziston vlerësimi nga një ECAI, sipas peshave të rrezikut të përcaktuara në tabelën 4.

Tabela 4

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	50%	100%	100%	150%

2. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura me një maturitet të mbetur deri në 3 (tre) muaj, për të cilat ekziston vlerësimi nga një ECAI, sipas peshave të rrezikut të përcaktuara në tabelën 4.1.

Tabela 4.1

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	20%	20%	50%	50%	150%

3. Bankat, bazuar në vlerësimin/et afatshkurtër/ra nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura, sipas tabelës 4.2.

Tabela 4.2

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	150%	150%	150%

4. Bankat, për përzgjedhjen midis trajtimit të vlerësimit afatshkurtër të kredisë nga një ECAI, sipas pikës 3 të këtij neni dhe trajtimit preferencial për ekspozimet afatshkurtra (me maturitet të mbetur deri në 3 (tre) muaj), të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, veprojnë si vijon:

a) nëse nuk ekziston një vlerësim afatshkurtër i ekspozimit, trajtimi i përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtra (me maturitet të mbetur deri në 3 (tre) muaj), siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, do të zbatohet për të gjitha ekspozimet ndaj institucioneve me maturitet të mbetur deri në 3 (tre) muaj;

b) nëse ekziston një vlerësim afatshkurtër, i cili përcakton një peshë rreziku më të favorshme ose të njëjtë me trajtimin e përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtra (me maturitet të mbetur deri në 3 (tre) muaj), siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, atëherë vlerësimi afatshkurtër do të përdoret vetëm për atë ekspozim specifik. Ekspozimet e tjera afatshkurtra do të ndjekin trajtimin e përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtra (me maturitet të mbetur deri në 3 (tre) muaj), siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni;

c) nëse ekziston një vlerësim afatshkurtër, i cili përcakton një peshë rreziku më pak të favorshëm se sa trajtimi i përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtra (me maturitet të mbetur deri në 3 (tre) muaj), siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, atëherë nuk do të përdoret trajtimi i përgjithshëm preferencial për ekspozimet afatshkurtra dhe të gjitha pretendimeve afatshkurtra të pavlerësuara, do t'u caktohet e njëjta peshë rreziku e përcaktuar nga vlerësimi specifik afatshkurtër.

Neni 17/2
Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura të pavlerësuara
(shtuar me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura, për të cilat nuk ekziston vlerësim nga një ECAI, bazuar në nivelin e cilësisë së kredisë të caktuar për ekspozimet ndaj qeverisë qendrore, në juridiksionin e të cilave janë krijuar/veprojnë këto institucione, me peshat e rrezikut, sipas tabelës 4.3.

Tabela 4.3

Cilësia e kredisë për qeverinë qendrore	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	100%	150%

2. Bankat ponderojnë me 100% ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura të pavlerësuara, që veprojnë në vendet, qeveria qendrore e të cilave është e pavlerësuar.

3. Bankat ponderojnë me 20% ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura të pavlerësuara, me një maturim fillestar efektiv prej 3 muajsh ose më pak se 3 muajsh. Për qëllime të këtij paragrafi, ekspozimet me maturim fillestar (kontraktual) prej 3 muajsh ose më pak se 3 muajsh, të cilat pritet të rinovohen (roll over), nuk kualifikohen për këtë trajtim preferencial.

4. Bankat ponderojnë me 50% ekspozimet e financimit tregtar (trade finance)[10] ndaj institucioneve të mbikëqyrura të pavlerësuara, me maturitet të mbetur deri në një vit, të cilat janë transaksione të vetëlikuidueshme dhe lidhen me këmbimin e mallrave dhe të shërbimeve, dhe me 20% ekspozimet e financimit tregtar (trade finance) ndaj institucioneve të mbikëqyrura të pavlerësuara, me maturitet të mbetur prej 3 (tre) muajsh ose më pak se 3 (tre) muajsh.

Neni 18
Investimet në instrumentet e kapitalit rregullator

Bankat ponderojnë investimet në kapital ose instrumente të kapitalit rregullator, të emetuar nga institucionet e mbikëqyrura me peshën e rrezikut prej 100%, përveç rasteve kur këto zbriten nga kapitali rregullator.

Neni 19
Ekspozimet ndaj shoqërive tregtare

1. Bankat, bazuar në vlerësimin e përcaktuar nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet ndaj shoqërive tregtare me peshat e rrezikut sipas tabelës 5.

Tabela 5

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	150%	150%

2. Bankat, në rastin kur nuk përdorin vlerësimin e një ECAI ose kur nuk ekziston vlerësimi nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet ndaj shoqërive tregtare me 100%. Ky ponderim nuk mund të jetë më i vogël (më i favorshëm) se pesha e rrezikut, me të cilën ponderohen ekspozimet ndaj qeverisë qendrore, në juridiksionin e së cilës është krijuar dhe vepron shoqëria tregtare.

3. Bankat, bazuar në vlerësimin/et afatshkurtra nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet ndaj shoqërive tregtare sipas tabelës 6.

Tabela 6

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	150%	150%	150%

Neni 20
Ekspozimet ndaj portofolave me pakicë (*retail*)

Bankat ponderojnë ekspozimet ndaj portofolave me pakicë (*retail*), me peshën e rrezikut 75%.

Neni 21
Ekspozimet e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme

Bankat, pa rënë ndesh me përcaktimet në nenet 22 dhe 23 të këtij kreu, ponderojnë ekspozimet e siguruara plotësisht me kolateral pasuri të paluajtshme, me peshën e rrezikut 100%.

Neni 22

---

[10] *Sipas përkufizimit për "financimin tregtar (trade finance)" të parashikuar në rregulloren nr. 27, datë 28.3.2019, "Për raportin e mbulimit me likuiditet".*

Ekspozimet e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale
(ndryshuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 1 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat ponderojnë me 35%, ekspozimet e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të Bashkimit Europian, të cilat plotësojnë, njëkohësisht, karakteristikat e mëposhtme:

a) kanë si objekt blerjen/ndërtimin/rikonstruksionin e një pasurie të paluajtshme rezidenciale (shtëpi, apartament);

b) kredimarrësi është blerësi/pronari i kësaj pasurie të paluajtshme rezidenciale;

c) janë të kolaterizuara me anë të një hipoteke mbi një pasuri të paluajtshme rezidenciale, e cila është në pronësi të kredimarrësit dhe është në përdorim ose jepet me qira prej tij;

d) janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje;

e) vlera e ekspozimit nuk e tejkalon 75% të vlerës së pasurisë së paluajtshme rezidenciale.

2. Bankat ponderojnë me 35% ekspozimet në qira financiare, ndaj një qiramarrësi, të lidhura me një pasuri të paluajtshme rezidenciale, ekspozime në të cilat banka është qiradhënësi dhe qiramarrësi ka një mundësi për të blerë pasurinë, me kusht që, ekspozimi i bankës të jetë plotësisht dhe tërësisht i siguruar nga pronësia e tij mbi objektin.

Neni 23
Ekspozimet e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme tregtare
(shtuar fjalë në shkronjën "a", të pikës 1, ndryshuar fjalë në shkronjën "a" të pikës 3 dhe shtuar pika 6 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat ponderojnë me 50%, ekspozimet ose pjesë të ekspozimit, të cilat janë të siguruara në mënyrë të plotë me kolateral pasuri të paluajtshme tregtare (të tilla si: zyra, qendra tregtare ose ambiente të tjera tregtare, për qëllime ose funksione tregtare etj.), që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Bankat ponderojnë me 50%, ekspozimet në qira financiare ndaj një qiramarrësi të lidhur me një pasuri tregtare, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, ekspozime në të cilat banka është qiradhënësi, dhe qiramarrësi ka një opsion për të blerë pronën, me kusht që ekspozimi i bankës të jetë plotësisht dhe tërësisht i siguruar nga pronësia e tij mbi pasurinë.

3. Bankat, për zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, sigurohen se janë plotësuar kriteret e mëposhtme:

a) vlera e pasurisë së paluajtshme nuk varet në mënyrë materiale nga ecuria financiare e kredimarrësit (banka mund të përjashtojë situatat, ku faktorë të thjeshtë makroekonomikë ndikojnë si në vlerën e pasurisë së paluajtshme, ashtu edhe në performancën e kredimarrësit, nga përcaktimi i materialitetit të një varësie të tillë);

b) rreziku i kredimarrësit nuk varet materialisht nga ecuria e pasurisë ose projektit, por më tepër nga burime të tjera të kredimarrësit për të shlyer kredinë (domethënë, shlyerja e kredisë nuk varet materialisht nga asnjë fluks i parasë i krijuar nga prona që shërben si kolateral);

c) janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje;

d) vlera e ekspozimit nuk e tejkalon 50% të vlerës së tregut të pasurisë së paluajtshme tregtare.

4. Pjesa që e tejkalon kufirin e përcaktuar në shkronjën "d" të paragrafit 3 të këtij neni, ponderohet me 100%.

5. Bankat, në rastin kur një shtet anëtar i Bashkimit Europian ponderon ekspozimet e siguruara me pronë tregtare, siç përcaktohet në paragrafët e mësipërm të këtij neni, ponderojnë me 50% ekspozimet e siguruara me pasuri të paluajtshme tregtare, të ndodhura

në territorin e atij shteti.

6. Për qëllime të këtij neni, toka nuk konsiderohet kolateral pasuri e paluajtshme tregtare.

Neni 24

Ekspozime (kredi) me probleme

(shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 3 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat, pa rënë ndesh me përcaktimet në paragrafët 2 deri 4 të këtij neni, ponderojnë pjesën e pagarantuar (pasiguruar) të ekspozimit (kredisë) me një kolateral ose garanci, për ekspozimet (kreditë) me probleme, si më poshtë:

a) me 150%, nëse fondet rezervë të krijuara për mbulimin e humbjeve janë më pak se 20% e vlerës së ekspozimit bruto të pasiguruar;

b) me 100%, nëse fondet rezervë të krijuara për mbulimin e humbjeve janë jo më pak se 20% e vlerës së ekspozimit bruto të pasiguruar.

2. Për qëllime të përcaktimit të pjesës së garantuar të kredisë me probleme, do të merren në konsideratë vetëm garancitë dhe kolateralët e pranuar për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë.

3. Bankat, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve, ponderojnë me 100% ekspozimet e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale, të cilat klasifikohen si ekspozime (kredi) me probleme.

4. Bankat, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve, ponderojnë me 100% ekspozimet e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme tregtare, të cilat klasifikohen si ekspozime (kredi) me probleme.

Neni 25

Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë

(shtuar shkronja "b" e pikës 1 dhe ndryshuar shkronjëzimi me vendimin nr. 49, datë 30.3.2016, ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe shfuqizuar shënimi sqarues i pikës 2 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat ponderojnë me peshën e rrezikut 150%, ekspozimet të cilat u përkasin kategorive me rrezik të lartë siç përcaktohen në nenin 4 të kësaj rregulloreje, si dhe kategoritë e mëposhtme:

a) vlerën e kredisë së akorduar jashtë territorit ku banka ushtron veprimtarinë nëpërmjet filialeve, degëve ose agjencive të saj;

b) vlerën e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara kundrejt shlyerjes së kredive.

c) të tjera ekspozime, për të cilat Banka e Shqipërisë konsideron se përfaqësojnë një rrezik të lartë.

2. Bankat ponderojnë me një peshë rreziku 50% më të lartë[11] vlerën e kredisë, në valutë dhe/ose të indeksuar në valutë, për kredimarrësin, që plotëson njëkohësisht kushtet e përcaktuara në nenin 4 pika 2 shkronja "c" të rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë".

Neni 26

Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara

(ndryshuar fjalë në pikën 1, 2, ndryshuar pika 3 dhe shtuar pika 4 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

---

[11] Shfuqizuar.

1. Obligacionet e garantuara, sipas përcaktimit në nenin 4 të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të trajtohen me pesha preferenciale rreziku, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe garantohen me njërin prej aktiveve të mëposhtme:

a) ekspozimet ndaj ose të garantuara nga qeveritë qendrore, bankat qendrore, njësitë e sektorit publik, qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale në Bashkimin Europian (BE);

b) ekspozimet ndaj ose të garantuara:

i) nga qeveri qendrore dhe banka qendrore jashtë BE-së, banka shumëpalëshe të zhvillimit, organizata ndërkombëtare që kualifikohen për shkallën 1 të cilësisë së kredisë, siç përcaktohet në këtë kre; dhe

ii) nga njësi të sektorit publik jashtë BE-së, qeveri rajonale dhe autoritete lokale jashtë BE-së, që ponderohen me rrezik, si ekspozimet ndaj institucioneve ose qeverive dhe bankave qendrore, respektivisht sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 13 dhe paragrafëve 1, 2, 3 dhe 5 të nenit 14, dhe që kualifikohen për shkallën 1 të cilësisë së kredisë, siç përcaktohet në këtë kre; dhe

iii) ekspozimet në kuptimin e kësaj pike, që kualifikohen, minimalisht, për të përftuar shkallën 2 të cilësisë së kredisë, siç përcaktohet në këtë kre, me kushtin që të mos tejkalojnë 20% të shumës nominale të tepricës së obligacioneve të garantuara të institucioneve emetuese;

c) ekspozimet ndaj institucioneve, që kualifikohen për shkallën 1 të cilësisë së kredisë, siç përcaktohet në këtë kre. Totali i këtyre ekspozimeve nuk duhet të tejkalojë 15% të shumës nominale të tepricës së obligacioneve të garantuara të bankës emetuese. Ekspozimet që shkaktohen nga transmetimi dhe administrimi i pagesave të debitorëve ose fondeve që rrjedhin nga likuidimet në lidhje me kreditë e siguruara nga pasuri të paluajtshme, te mbajtësit e obligacioneve të garantuara, nuk janë subjekt i kufirit/limitit prej 15%. Ekspozimet në institucione të BE-së me maturitet më pak se 100 ditë, nuk janë subjekt i shkallës 1 të cilësisë, por këto institucione duhet, minimalisht, të kualifikohen për shkallën 2 të cilësisë;

d) kreditë e siguruara me pasuri të paluajtshme rezidenciale, deri në nivelin minimal, ndërmjet vlerës së hipotekave (të kombinuara me ndonjë hipotekë të mëparshme) dhe 80% të vlerës së tregut të pronave të vendosura si garanci ose me tituj me "prioritet *senior*"[12], të emetuar nga subjekte titullzimi, që i nënshtrohen ligjit shqiptar ose ligjit të një shteti anëtar të Bashkimit Europian, të cilat titullzojnë ekspozimet në pasuri të paluajtshme rezidenciale, me kusht që të paktën 90%[13] e aktiveve të fondeve respektive të subjekteve të tilla (të titullzimit) të jenë të siguruara me pasuri të paluajtshme rezidenciale, të kombinuar me çdo barrë të mëparshme, deri në nivelin minimal ndërmjet vlerës së shumave të detyrimit të lidhur me titujt, vlerës së hipotekave dhe 80% të vlerës së pronave të vendosura si garanci;

e) kreditë e siguruara me pasuri të paluajtshme tregtare, deri në nivelin minimal ndërmjet vlerës së hipotekave, që janë të kombinuara me ndonjë hipotekë të mëparshme dhe 60% të vlerës së pronave të vendosura si garanci ose tituj me "prioritet senior", të emetuara nga subjekte titullzimi që i nënshtrohen ligjit shqiptar ose ligjit të një shteti anëtar të Bashkimit Europian, të cilat titullzojnë ekspozimet në pasuri të paluajtshme tregtare, me kusht që të paktën 90% e aktiveve të fondeve respektive ose të subjekteve ekuivalente të titullzimit të jenë të përbëra nga hipoteka, që janë të kombinuara me çdo barrë të

---

[12] Titujt me "prioritet *senior*" duhet të kualifikohen për shkallën 1 të cilësisë së kredisë, siç përcaktohet në këtë kre, dhe nuk duhet të tejkalojnë 20% të shumës nominale (të mbetur) të emetimit.

[13] Ekspozimet e shkaktuara nga transmetimi dhe administrimi i pagesave të debitorëve, apo të të ardhurave nga likuidimi në lidhje me kreditë e siguruara nga prona e vendosur garanci e njësive senior ose letrave me vlerë të borxhit, nuk do të përfshihen në llogaritjen e kufirit 90%.

mëparshme deri në nivelin minimal ndërmjet vlerës së shumave të detyrimit të lidhur me titujt, vlerës së hipotekave dhe 60% të vlerës së pronave të vendosura si garanci, ndërsa njësitë respektive kualifikohen për shkallen 1 të cilësisë së kredisë, siç përcaktohet në këtë kre, dhe njësi të tilla nuk tejkalojnë 20% të shumës nominale të emetimit.

Banka e Shqipërisë mund të njohë si të pranuara kreditë e siguruara nga pasuri të paluajtshme tregtare, kur vlera e kredisë tejkalon 60% të vlerës së pronës, deri në një nivel maksimal prej 70%, në qoftë se vlera e totalit të aktiveve të vendosura si kolateral për obligacionet e garantuara, e tejkalon me të paktën 10% shumën nominale të mbetur të obligacioneve të garantuara dhe pretendimet e mbajtësve të obligacioneve përmbushin kërkesat ligjore të sigurisë, të përcaktuara në kreun IV të kësaj rregulloreje. Pretendimet e mbajtësve të obligacioneve duhet të kenë përparësi mbi të gjitha pretendimet e tjera mbi kolateralin. Ekspozimet që shkaktohen nga transmetimi dhe administrimi i pagesave të debitorëve, apo të të ardhurave nga likuidimi, në lidhje me kreditë e siguruara nga prona e vendosur si garanci e njësive *senior* ose titujve të borxhit, nuk janë subjekt i kufirit/limitit 90%; ose

f) për qëllime të zbatimit të këtij paragrafi, termi 'të garantuara'përfshin rastet kur aktivet, të cilat përshkruhen në shkronjat 'a' deri në 'e' të kësaj pike, përcaktohen në mënyrë eksplicite në një ligj të veçantë, që siguron mbrojtjen e mbajtësit të obligacionit, përkundrejt humbjeve.

2. Bankat, për obligacionet e garantuara, të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, duhet të përmbushin kërkesat minimale, të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

3. Bankat ponderojnë ekspozimet në formën e obligacioneve të garantuara, për të cilat nuk ekziston një vlerësim nga një ECAI, bazuar në peshën e rrezikut të kredisë, të caktuar për ekspozimet e pagarantuara senior ndaj emetuesit, siç përcaktohet në tabelën 7:

a) nëse ekspozimit ndaj bankës emetuese i caktohet një peshë rreziku 20%, ekspozimit ndaj obligacioneve të garantuara i caktohet një peshë rreziku 10%;

b) nëse ekspozimit ndaj bankës emetuese i caktohet një peshë rreziku 50%, ekspozimit ndaj obligacioneve të garantuara i caktohet një peshë rreziku 20%;

c) nëse ekspozimit ndaj bankës emetuese i caktohet një peshë rreziku 100%, ekspozimit ndaj obligacioneve të garantuara i caktohet një peshë rreziku 50%; dhe

d) nëse ekspozimit ndaj bankës emetuese i caktohet një peshë rreziku 150%, ekspozimit ndaj obligacioneve të garantuara i caktohet një peshë rreziku 100%.

Tabela 7

Pesha e rrezikut për ekspozimet e pagarantuara senior ndaj bankës emetuese	*20%*	*50%*	*100%*	*150%*
Pesha e rrezikut për ekspozimet në formën e obligacioneve të garantuara	*10%*	*20%*	*50%*	*100%*

4. Bankat, për obligacionet e garantuara për të cilat ekziston një vlerësim nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet me peshat e rrezikut, sipas tabelës 7.1.

Tabela 7.1

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	10%	20%	20%	50%	50%	100%

5. Bankat trajtojnë me pesha preferenciale rreziku, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, ekspozimet në formën e obligacioneve të garantuara, të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) banka investuese merr/siguron minimalisht informacionin e mëposhtëm, mbi portofolin e investimit:

i. vlerën e fondit garantues (cover pool) dhe tepricën (outstanding) e obligacioneve të garantuara;

ii. shpërndarjen gjeografike dhe llojet e aktiveve që garantojnë obligacionet e garantuara,

madhësinë e kredisë, normën e interesit dhe rrezikun e kursit të këmbimit;

iii. strukturën e maturitetit të obligacioneve të garantuara dhe të aktiveve që i garantojnë këto obligacione; dhe

iv. përqindjen e kredive të cilat janë më shumë se 90 ditë në vonesë.

b) emetuesi i vë në dispozicion bankës investuese, të paktën çdo gjashtë muaj, informacionin e përcaktuar në shkronjën "a" të këtij paragrafi.

Neni 27

Ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (*securitization*)

Bankat ponderojnë ekspozimet në pozicionet e krijuara nga titullzimi, sipas përcaktimeve në kreun V të kësaj rregulloreje.

Neni 28

Ekspozime në formën e sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK)

1. Bankat, pa rënë ndesh me përcaktimet në paragrafët 2 deri në 8 të këtij neni, ponderojnë ekspozimet në formën e sipërmarrjeve të investimit kolektiv (SIK), me peshën e rrezikut 100%.

2. Bankat, bazuar në vlerësimin nga një ECAI, ponderojnë ekspozimet në formën e SIK-ve, me peshat e rrezikut, sipas tabelës 8.

Tabela 8

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5	6
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	100%	150%	150%

3. Banka e Shqipërisë, në rastin kur gjykon se ekspozimi në SIK shoqërohet me një rrezik veçanërisht të lartë, mund të kërkojë ponderimin me 150% të ekspozimit.

4. Bankat mund të përcaktojnë peshën e rrezikut për SIK-të, sipas paragrafëve 6 deri në 8 të këtij neni, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) SIK-ja administrohet nga një shoqëri që i nënshtrohet mbikëqyrjes në një shtet anëtar të BE-së ose bazuar në miratimin e Bankës së Shqipërisë, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

i) SIK-ja administrohet nga një shoqëri, mbikëqyrja e së cilës është e barasvlershme me atë në Shqipëri;

ii) është siguruar, në mënyrë të përshtatshme, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente në Shqipëri me autoritetin kompetent për mbikëqyrjen e SIK-së në vendin tjetër;

b) prospekti i emetimit të SIK-së ose dokumente të barasvlershme me të, përfshijnë informacione për sa u përket:

i) kategorive të aktiveve, në të cilat SIK-ja është e autorizuar të investojë;

ii) limite/kufij në përqindje dhe metodologji për llogaritjen e tyre, nëse aplikon të tilla (limite/kufij investimi);

c) veprimtaria e SIK-së raportohet, të paktën çdo vit, për të mundësuar vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve, rezultatin financiar dhe transaksionet në periudhën raportuese.

5. Banka e Shqipërisë mund të miratojë një SIK, për qëllime të përcaktimit të peshave të rrezikut nga banka, pa kryer procesin e saj të vlerësimit, në rastin kur autoritetet kompetente të një vendi të tretë, i cili zbaton kritere rregullatore dhe mbikëqyrëse, të paktën, të barasvlershme me ato në Shqipëri, vlerësojnë/konfirmojnë se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në paragrafin 4, shkronja "a".

6. Bankat, në rastet kur njohin aktivet e SIK-së, mund të llogarisin një peshë mesatare të rrezikut për ekspozimin ndaj SIK-së, duke marrë parasysh peshat e rrezikut të caktuara, për klasat respektive të aktiveve përkatëse (siç përcaktohet në nenet e klasave të ekspozimit më sipër, në këtë nënkre).

7. Bankat, në rastet që nuk i njohin aktivet e SIK-së, mund të llogarisin një peshë mesatare të rrezikut për SIK, duke konsideruar që SIK-ja investon fillimisht (kryesisht), në aktive që u përkasin klasave të ekspozimit me kërkesën më të lartë për kapital, deri në masën maksimale të lejuar sipas mandatit të saj, dhe më pas vazhdon të investojë në rendin zbritës, sipas kërkesave për kapital, deri në kufirin total të lejuar për investime.

8. Bankat, për qëllime të zbatimit të paragrafëve 6 dhe 7 të këtij neni, mund të përdorin një palë të tretë, të specializuar, për të llogaritur dhe raportuar peshat e rrezikut për SIK-në, me kusht që të sigurohet saktësia në llogaritje dhe raportim.

Neni 29

Ekspozime të tjera

1. Bankat ponderojnë me peshën e rrezikut 100%, aktivet e mëposhtme:

a) aktivet e qëndrueshme të trupëzuara;

b) shpenzimet/pagesat dhe të ardhurat e përllogaritura, për të cilat nuk mund të përcaktohet kundërpartia;

c) investimet në aksione, instrumente të reja të kapitalit, instrumente hibride të kapitalit dhe tipa të tjerë të pjesëmarrjeve, me përjashtim të rasteve kur këto janë të zbritshme nga kapitali rregullator;

d) instrumentet e varura, të emetuara nga organet e tjera, të ndryshme nga institucionet e mbikëqyrura.

2. Bankat ponderojnë me një peshë rreziku 20%, *cash*-in në procesin e mbledhjes.

3. Bankat ponderojnë me një peshë rreziku 0%, *cash*-in ose aktivet ekuivalente me *cash*-in.

4. Bankat ponderojnë me një peshe rreziku 0%, arin ose argjendin e mbajtur në kasat e veta të sigurisë ose gjendjen/tepricën e tyre, deri në kufirin e shumave të mbuluara me pasive në ar ose argjend.

5. Në rastin e transaksioneve të riblerjes dhe angazhimeve të pakthyeshme të blerjes në të ardhmen, do të konsiderohet pesha e rrezikut që lidhet me aktivin dhe jo pesha e rrezikut që shoqëron kundërpartinë.

6. Në rastin kur një bankë siguron mbrojtje të kreditit, që mbulon një numër të caktuar ekspozimesh (shportë ekspozimesh), me kushtin që, ngjarja e n-të e dështimit (*default*) lidhur me ekspozimet, do të shkaktojë pagesë dhe që kjo ngjarje kredie do të çojë në përfundimin e kontratës, dhe kur produkti ka një vlerësim të siguruar nga një ECAI, peshat e rrezikut do të caktohen sipas kreut V të kësaj rregulloreje, për trajtimin e rrezikut të kredisë në lidhje me ekspozimet në titullzim. Në qoftë se produkti nuk ka një vlerësim nga një ECAI, peshat e rrezikut që i korrespondojnë ekspozimeve të përfshira në shportë, do të mblidhen (agregohen), duke përjashtuar n-1 ekspozime, deri në një maksimum prej 1250% dhe do të shumëzohen me shumën nominale të mbrojtjes të siguruar me derivativë kredie, për të përftuar vlerën e aktiveve të ponderuara me rrezikun. N-1 ekspozimet, të cilat do të përjashtohen nga mbledhja (agregimi), do të përfshijnë ato ekspozime, të cilat, në veçanti, prodhojnë një vlerë të ponderuar me rrezikun, më të ulët se vlera e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun e secilës prej aktiveve të përfshira në shumë (shumën e agreguar).

7. Vlera e ekspozimit për qiranë financiare do të jetë vlera e skontuar e pagesave minimale të qirasë financiare. Pagesat minimale të qirasë financiare janë pagesat që qiramarrësi është ose mund të jetë e nevojshme të kryejë gjatë kohëzgjatjes së qirasë dhe ndonjë opsion blerje, (opsion, ushtrimi i të cilit është në mënyrë të arsyeshme, i sigurt). Çdo vlerë e mbetur e garantuar, e cila përmbush kushtet e vendosura në nënkreun III të kreut IV, në lidhje me pranueshmërinë e ofruesit të mbrojtjes (nenet 82, 83), si dhe kërkesat minimale për njohjen e llojeve të tjera të garancive të parashikuara në po këtë kre (neni 77), do të përfshihet në pagesat minimale të qirasë. Këto ekspozime duhet të caktohen në klasën

përkatëse të ekspozimit, në përputhje me nenin 10 të rregullores. Kur ekspozimi është një vlerë e mbetur e pasurive me qira financiare, shuma e ponderuar e ekspozimit të rrezikut do të llogaritet si vijon:

1/t * 100% * vlera e ekspozimit,

ku: "t" është vlera më e madhe ndërmjet 1 dhe numrit më të afërt të të gjitha viteve të mbetura të qirasë financiare.

8. Banka e Shqipërisë mund të lejojë një peshë rreziku prej 10%, për ekspozimet ndaj institucioneve të specializuara në tregjet ndërbankare dhe të borxhit publik në vendet e tyre të origjinës, dhe subjekt i mbikëqyrjes së kujdesshme nga ana e autoriteteve kompetente, kur aktivet e tyre janë plotësisht të siguruara, me miratimin paraprak të autoriteteve kompetente të vendeve të tyre të origjinës, për zëra që kanë një ponderim të rrezikut 0% ose 20%, dhe të njohura nga këto të fundit si kolateralë të përshtatshëm.

NËNKREU II
NJOHJA E ECAI-VE DHE *MAPPING* I VLERËSIMIT TË KREDISË NGA ECAI

Neni 30
Njohja e vlerësimeve (*rating*) të jashtme të kredisë

1. Bankat përdorin vlerësimet e ECAI-ve për të përcaktuar peshën e rrezikut të një ose disa ekspozimeve, vetëm nëse ECAI-të njihen nga Banka e Shqipërisë si të pranueshëm (të ligjshëm) për ta mundësuar këtë vlerësim.

2. Banka e Shqipërisë do të njohë një ECAI si të pranuar (ligjshëm) për qëllime të zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, vetëm nëse krijon bindjen se metodologjia e vlerësimit të saj është në përputhje me kërkesat e objektivitetit, pavarësisë, rishikimit të vazhdueshëm, dhe se vlerësimet e saj përmbushin kërkesat e besueshmërisë, si dhe të transparencës dhe plotësohen kriteret teknike të përcaktuara në nenin 31 të këtij nënkreu.

3. Banka e Shqipërisë, në rastin kur një ECAI është njohur si e pranuar (e ligjshme) nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar të Bashkimit Europian, mund ta njohë atë si të pranueshëm, pa kryerjen e procesit të vlerësimit nga vetë ajo.

4. Banka e Shqipërisë bën publik një shpjegim mbi procesin e njohjes së ECAI-së/ve dhe një listë të ECAI-ve të pranuara.

Neni 31
Kriteret teknike për njohjen e ECAI-ve

1. ECAI, për qëllime të njohjes nga Banka e Shqipërisë, duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) Objektiviteti. Metodologjia që përdor ECAI-ja për caktimin e vlerësimeve të kredisë është rigoroze, sistematike, e vazhdueshme dhe i nënshtrohet vlefshmërisë, bazuar në përvojën historike. Banka e Shqipërisë, për të vërtetuar plotësimin e kësaj kërkese, kërkon për ECAI-në që do të njohë, plotësimin e kushteve të mëposhtme:

i) metodologjia e përdorur duhet të marrë në konsideratë faktorët që bëjnë diferencimin e karakteristikave specifike të pozicioneve të ndryshme të vlerësuara sipas kësaj metodologjie (procesi i njohjes nuk ka për qëllim të verifikojë saktësinë e metodologjisë, por kjo e fundit duhet të mbështetet në evidenca statistikore nga përdorimi i saj në të kaluarën);

ii) aftësia shpjeguese e metodologjisë duhet të mbështetet në të dhëna të disponueshme mbi normat e dështimit, të regjistruara për shkallët e vlerësimit individual dhe normat e migrimit, ndërmjet shkallëve të ndryshme të vlerësimit;

iii) metodologjia duhet të zbatohet në mënyrë konsistente ndaj të gjitha ekspozimeve në një klasë të caktuar, dhe duhet të bëjë diferencimet e duhura, ndërmjet ekspozimeve në

klasa të ndryshme;

iv) metodologjia duhet të vlerësohet (*validated*) brenda institucionit (ECAI-së), në bazë të eksperiencës historike; dhe

v) metodologjia duhet të korrigjohet në kuadrin e gabimeve sistematike, të dala gjatë *back-testing*.

b) Pavarësia. Metodologjia është e pavarur nga ndikimet ose kufizimet e jashtme politike dhe nga konfliktet e interesit ose presionet ekonomike, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kredisë. Banka e Shqipërisë, për të verifikuar plotësimin e kësaj kërkese, kërkon nga ECAI-ja që do të njohë, të vërtetojë se:

i) janë marrë masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë nga pronësia (aksionarët) dhe për të parandaluar presionet ose kufizimet e jashtme politike apo ekonomike, të cilat mund të rrezikojnë objektivitetin e vlerësimit të kredisë;

ii) struktura organizative siguron, nga pikëpamja operative, e burimeve njerëzore dhe mundësisht ligjore, ndarjen e veprimtarisë së vlerësimit të kredisë nga veprimtaritë e tjera, të tilla si: këshillimi dhe marketingu, të cilat mund të ndikojnë në objektivitetin e vlerësimit;

iii) janë miratuar rregulla të brendshme për të parandaluar konfliktet e interesit në lidhje me personat e përfshirë në caktimin e vlerësimeve (*ratings*);

iv) veprimtaria e vlerësimit është fitimprurëse dhe subjekti ka burime financiare të mjaftueshme në dispozicion;

v) struktura e tarifave në ngarkim të subjekteve të vlerësuara dhe kompensimi i personelit përgjegjës për caktimin e vlerësimeve (*ratings*) nuk ndikohen nga rezultati i vlerësimit dhe anasjelltas;

vi) janë marrë masat e nevojshme për të siguruar pavarësinë në dhënien e vlerësimeve nga klientët kryesorë, që gjenerojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave (më të madhe se 5%);

vii) ka staf të mjaftueshëm, me një nivel të duhur të ekspertizës dhe përvojës profesionale në kryerjen e vlerësimeve të kredisë (për shembull, të paktën një nga personat që marrin pjesë në një vendim vlerësimi, duhet të ketë të paktën tre vjet eksperiencë). Numri i personelit duhet të jetë i përshtatshëm për vëllimin e biznesit të kryer, duke pasur parasysh, gjithashtu, nevojën për të mbajtur kontakte të vazhdueshme me subjektet e vlerësuara, atje ku kjo është pjesë e metodologjisë së përdorur;

viii) rregullat e brendshme të qeverisjes janë formalizuar në mënyrë të qartë;

ix) bën publike në mënyrën e duhur çfarëdo konflikti interesash;

x) ka një funksion të kontrollit (auditit) të brendshëm (ose funksione të tjera të ngjashme), që është i pavarur nga personat përgjegjës për caktimin e vlerësimeve (*ratings*) dhe që është ngarkuar me verifikimin e zbatimit efektiv të kushteve të pavarësisë.

c) Rishikimi në vazhdimësi. Vlerësimet e kreditit të ECAI-së janë subjekt i rishikimit të vazhdueshëm dhe u përgjigjen ndryshimeve në kushtet financiare. Banka e Shqipërisë, për të vërtetuar plotësimin e kësaj kërkese, kërkon për ECAI-në që do të njohë, plotësimin e kushteve të mëposhtme:

i) ECAI-ja disponon procedura për të monitoruar çdo ndryshim në njësitë ekonomike të vlerësuara, gjë që mund të çojë në ndryshime të rëndësishme të vlerësimit dhe, nëse është e nevojshme, të mund të ndryshojë në mënyrë të menjëhershme vlerësimin/et;

ii) ECAI-ja disponon një procedurë të kolauduar të *back-testing*;

iii) vlerësimet e kredisë shqyrtohen, së paku një herë në vit.

d) Besueshmëria e tregut. Vlerësimet individuale të kredisë, nga ana e ECAI-së, janë të njohura në treg si të besueshme nga përdoruesit e vlerësimeve të tilla. Banka e Shqipërisë vlerëson kriterin e besueshmërisë, duke u mbështetur në faktorë të tillë si:

i) pjesa e tregut që mbulon ECAI-ja;

ii) të ardhurat e krijuara nga ECAI-ja dhe në përgjithësi, burimet financiare të saj (ECAI-së);

iii) nëse vendosja/përcaktimi i çmimeve/tarifave bëhet në bazë të vlerësimeve; dhe

iv) të paktën dy banka përdorin vlerësimin individual të saj (ECAI-së) për emetimin e obligacioneve dhe/ose vlerësimin e rrezikut të kreditit.

e) Transparenca e metodologjive dhe vlerësimeve. Banka e Shqipërisë, në procesin e njohjes së një ECAI-e, kërkon që:

i) ECAI-ja të bëjë publike parimet e metodologjisë së vlerësimit dhe çdo ndryshim në metodologji, në një mënyrë që të jetë e kuptueshme për përdoruesit e vlerësimeve të kredisë;

ii) vlerësimet individuale të kredisë të jenë të aksesueshme në kohën e duhur dhe për të gjitha bankat që kanë interesa legjitime për këto vlerësime kredie; dhe

iii) në veçanti, vlerësimet individuale të kredisë të jenë të disponueshme për bankat e huaja (jovendase), në mënyrë të barabartë me bankat vendase, që kanë interesa legjitime për këto vlerësime kredie.

Neni 32

Kërkesa për dokumentacionin në lidhje me njohjen e ECAI-ve

Banka e Shqipërisë, me paraqitjen e kërkesës së aplikimit për njohje nga një ECAI, bën njohjen e saj (ECAI-së), bazuar në plotësimin e kritereve të përcaktuara në nenin 31.

1. ECAI-ja përgatit aplikimin për njohje, në bashkëpunim me bankat që kanë interes për këtë njohje. Aplikimi për njohje shoqërohet nga dokumentacioni i nevojshëm, siç përcaktohet në aneksin 6, që vërteton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në nenin 31 të këtij nënkreu.

2. Përjashtimisht, çfarë përcaktohet në paragrafin 3 të nenit 30, një ECAI e njohur nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare të BE-së, paraqet bashkë me aplikimin, dokumentacionin që vërteton njohjen e saj nga këto autoritete, si dhe dokumentacionin siç përcaktohet në aneksin 6 (informacion i përgjithshëm dhe *mappingi* vlerësimit afatgjatë dhe afatshkurtër të kredisë).

3. Banka e Shqipërisë, në procesin e shqyrtimit të aplikimit, mund të kërkojë dokumentacion shtesë, në rastet që gjykohet e arsyeshme.

Neni 33

***Mapping* i vlerësimeve (*rating*) të jashtme të kredisë**

1. Banka e Shqipërisë, duke marrë parasysh kriteret teknike të përcaktuara në këtë nënkre për njohjen e ECAI-ve, përcakton lidhjen (korrespondencën, *mapping*) ndërmjet shkallës (kategorisë, klasës) së cilësisë së kredisë, të përcaktuar në nënkreun I të këtij kreu dhe vlerësimeve përkatëse të kredisë, të një ECAI-e të njohur. Këto përcaktime duhet të jenë objektive dhe konsekuente (të qëndrueshme).

2. Në rastin kur autoritetet kompetente të një shteti anëtar të Bashkimit Europian kanë bërë një përcaktim në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, Banka e Shqipërisë mund të pranojë përcaktimin, pa realizuar procesin e saj të përcaktimit të varësisë ndërmjet shkallës së cilësisë së kredisë dhe vlerësimeve përkatëse të kredisë.

3. Banka e Shqipërisë përcakton lidhjen mes vlerësimeve të kredisë, të realizuara nga ECAI-ja dhe klasave të rrezikut, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

a) faktorët sasiorë, të tillë si: normat e dështimit (*default*) afatgjatë, të lidhur me të gjithë aktivet me të njëjtin vlerësim të rrezikut të kredisë. Banka e Shqipërisë, për ECAI të krijuara kohët e fundit dhe për ato që kanë regjistruar vetëm një seri të shkurtër të të dhënave të dështimit (*default*), kërkon prej tyre (ECAI-ve) një vlerësim të normës së dështimit (*default*) afatgjatë për të gjitha aktivet e caktuara në të njëjtin vlerësim të kredisë;

b) faktorët cilësorë, të tillë si: kategoria/niveli i emetuesve që mbulon/vlerëson ECAI-ja, gama e vlerësimeve të kredisë, kuptimi i secilës kategori të vlerësimit, si dhe përkufizimi

për *default* që ECAI-ja përdor.

4. Banka e Shqipërisë krahason normat e dështimit (*default*), për çdo vlerësim të rrezikut të kredisë, të realizuar nga një ECAI, me një standard, të ndërtuar mbi bazën e përvojës së normave të dështimit (*default*), nga ECAI të tjera, për një kategori të emetuesve me një nivel të barasvlershëm të rrezikut të kredisë.

5. Banka e Shqipërisë, në rastet kur konsideron se normat e dështimit (*default*) për vlerësimin e kreditit të një ECAI-e, janë materialisht dhe sistematikisht më të larta se standardi i ndërtuar, ajo (Banka e Shqipërisë) cakton një nivel/shkallë më të lartë të cilësisë së kredisë (më pak të favorshme) për vlerësimin e rrezikut të kredisë së ECAI-së.

6. Banka e Shqipërisë, në rastet kur ka rritur peshën e rrezikut, të lidhur me vlerësimin e rrezikut të kreditit nga një ECAI e veçantë, dhe në qoftë se ECAI-ja provon se normat e dështimit (*default*), bazuar në përvojën e saj për vlerësimin e kredisë, nuk janë materialisht dhe sistematikisht më të larta se standardi, ajo (Banka e Shqipërisë) mund të vendosë të rikthejë cilësinë e kredisë fillestare, në shkallën e vlerësimit të cilësisë së kredisë të dhënë nga ECAI-ja.

NËNKREU III
PËRDORIMI I VLERËSIMEVE TË KREDISË NGA ECAI, PËR PËRCAKTIMIN E PESHAVE TË RREZIKUT

Neni 34
Përdorimi i vlerësimeve (*rating*) të jashtme të kredisë

1. Përdorimi i vlerësimeve të kredisë të realizuara nga ECAI-ja, për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, duhet të jetë konsekuent dhe në përputhje me kërkesat e këtij nënkreu. Vlerësimet e kredisë nuk do të përdoren në mënyrë të përzgjedhur (*selektive*).

2. Bankat përdorin vlerësimet e kërkuara (*solicite drating*). Vlerësimet e dhëna (*unsolicite drating*) do të përdoren vetëm për ekspozimet ose ekspozimet e mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore.

Neni 35
Përdorimi i vlerësimeve të kredisë nga ECA-të
(shtuar pika 2 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Banka e Shqipërisë njeh vlerësimet e një agjencie të kreditimit të eksporteve (ECA), në rast se plotësohet, të paktën, një prej kushteve të mëposhtme:

a) ECA-ja përdor një nga format e pikëzimit të rrezikut, të pranuar nga të gjitha ECA-të, pjesëmarrëse në marrëveshjen e OECD-së “Mbi parimet për mbështetjen publike (me fonde publike) të kredive për eksporte”; ose

b) ECA-ja boton/publikon vlerësimet e saj të kredisë dhe ky vlerësim i kredisë është i lidhur me një nga tetë primet minimale të sigurimit të eksportit (MEIP), sipas metodologjisë së pranuar (rënë dakord) nga OECD-ja dhe të nënshkruar nga ECA-ja.

2. Lista zyrtare e ECA-ve publikohet dhe përditësohet nga OECD në linkun: http://www.oecd.org/trade/topics/export-credits/documents/links-of-official-export-credit-agencies.pdf

Neni 36
Kërkesa të përgjithshme për përdorimin e vlerësimeve

1. Banka mund të emërojë një ose më shumë ECAI dhe/ose ECA, të pranuar/njohur nga Banka e Shqipërisë, vlerësimet e të cilëve do të përdoren për përcaktimin e peshave të

rrezikut për ekspozime dhe ekspozime të mundshme.

2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, përdorimi i vlerësimeve të kredisë së ECA-ve do të lejohet vetëm për ekspozimet ndaj qeverive dhe bankave qendrore.

3. Banka, e cila për një klasë të caktuar të aktiveve, vendos të përdorë vlerësimet e kredisë të realizuara nga një ECAI dhe/ose ECA, duhet të përdorë këto vlerësime krediti, në mënyrë konsekuente, për të gjitha ekspozimet që përfshihen në atë klasë.

4. Banka, e cila vendos të përdorë vlerësimet e kredisë të realizuara nga një ECAI e njohur, duhet t'i përdorë ato në një mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme në kohë.

5. Banka mund të përdorë vetëm vlerësimet e kreditit të ECAI-së dhe/ose ECA-së, që marrin parasysh, si kryegjënë ashtu edhe interesin.

6. Banka, në qoftë se ekziston vetëm një vlerësim i kredisë nga një ECAI e emëruar, do të përdorë këtë vlerësim të rrezikut të kredisë, për të përcaktuar peshën e rrezikut për këtë element.

7. Banka, në qoftë se për një element të vlerësuar ekzistojnë dy vlerësime të kredisë nga ECAI dhe dy vlerësimet u korrespondojnë peshave të ndryshme të rrezikut, do të përdorë peshën më të madhe të rrezikut për atë element.

8. Banka, në qoftë se për një element të vlerësuar ekzistojnë më shumë se dy vlerësime të kredisë nga ECAI-të, do të konsiderojë dy vlerësimet që gjenerojnë dy peshat më të ulëta të rrezikut. Nëse dy peshat më të ulëta të rrezikut janë të ndryshme, atëherë do të përdoret pesha më e lartë e rrezikut dhe nëse dy peshat më të ulëta të rrezikut janë të njëjta, banka do të përdorë atë peshë rreziku.

Neni 37

Kërkesa për përdorimin e vlerësimeve të kredisë për emetuesin dhe për emetimin

1. Banka, në rastet kur ekziston një vlerësim i rrezikut të kredisë për një program ose lehtësi të veçantë emetimi, në të cilën bën pjesë elementi që përbën ekspozimin, do të përdorë këtë vlerësim të rrezikut të kredisë, për të përcaktuar peshën e rrezikut për këtë element.

2. Banka, në rastet kur nuk ka një vlerësim të drejtpërdrejtë të zbatueshëm të rrezikut të kredisë për një element të caktuar, por ekziston një vlerësim i rrezikut të kredisë për një program ose lehtësi të veçantë, të cilës nuk i përket elementi që përbën ekspozimin, ose ekziston një vlerësim i përgjithshëm për emetuesin, do të përdorë këtë vlerësim të rrezikut të kredisë, në qoftë se ky vlerësim prodhon:

a) një peshë më të lartë rreziku; ose

b) një peshë rreziku më të ulët, por ekspozimi në fjalë renditet, të paktën, në të njëjtën shkallë (*pari passu*):

i) me programin specifik të emetimit ose lehtësinë; ose

ii) me ekspozimet *senior* të pasiguruara të emetuesit.

3. Banka, në rastet kur nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, përdor, për të gjitha ekspozimet ndaj këtij emetuesi (debitori), për të cilin nuk ekzistojnë vlerësime kredie të aplikueshme në mënyre direkte, peshat e aplikuara për ekspozimet, për të cilat nuk ka klasifikim (*rating*).

4. Banka nuk mund të përdorë vlerësimin/et e rrezikut të kredisë së një emetuesi, që i përket një grupi të përbashkët, si vlerësim të rrezikut të kredisë për një emetues tjetër, brenda të njëjtit grup.

Neni 38

Kërkesa për përdorimin e vlerësimeve afatgjata dhe afatshkurtra të kredisë

(shtuar fjalë në pikën 1 me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

1. Bankat përdorin vlerësimet afatshkurtra të kredisë vetëm për aktivet dhe zërat jashtë bilancit afatshkurtër, që përbëjnë ekspozime ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare (korporatave).

2. Çdo vlerësim afatshkurtër i kredisë do të zbatohet vetëm për zërin, të cilit i referohet dhe nuk do të përdoret për të nxjerrë peshat e rrezikut për ndonjë zë tjetër, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) nëse një lehtësie afatshkurtër të vlerësuar, i është caktuar një peshë rreziku 150%, atëherë për të gjitha ekspozimet e pasiguruara dhe të pavlerësuara, afatshkurtra apo afatgjata ndaj një kundërpartie, do të përdoret një peshë rreziku 150%;

b) nëse një lehtësie afatshkurtër të vlerësuar i është caktuar një peshë rreziku 50%, atëherë për çdo ekspozim afatshkurtër të pavlerësuar, do të përdoret një peshë rreziku jo më e ulët se 100%.

Neni 39

Kërkesa për përdorimin e vlerësimeve për zërat në monedhën vendase ose të huaj

1. Një vlerësim kredie që i referohet një zëri në monedhën vendase të debitorit, nuk mund të përdoret për të nxjerrë peshën e rrezikut për një tjetër ekspozim ndaj të njëjtit debitor, e cila është shprehur në një monedhë të huaj.

2. Banka e Shqipërisë, pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur lind një ekspozim si rrjedhojë e pjesëmarrjes së një banke në një kredi të një banke shumëpalëshe për zhvillim, së cilës i është njohur në treg statusi si kreditor i preferuar, mund të lejojë bankën/at të përdorin, për qëllime të peshave të rrezikut, vlerësimin e kredisë së zërave në monedhën vendase të debitorit.

KREU IV
TEKNIKAT E ZBUTJES SË RREZIKUT TË KREDISË

NËNKREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 40

Parime të përgjithshme mbi teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë

1. Bankat përdorin teknika të mbrojtjes së kredisë, të cilat së bashku me masat e ndërmarra prej tyre, procedurat dhe politikat që zbatojnë, rezultojnë në marrëveshje të mbrojtjes së kredisë, që janë ligjërisht efektive dhe të zbatueshme në të gjitha juridiksionet përkatëse.

2. Bankat ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të siguruar efektivitetin e marrëveshjeve të mbrojtjes së kredisë dhe për të adresuar rreziqet e lidhura me to.

Neni 41

Mënyra e zbatimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë

1. Bankat modifikojnë llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, duke zbatuar format e pranueshme të mbrojtjes së kredisë, vetëm nëse plotësohen kërkesat e këtij kreu.

2. Shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, të modifikuara nëpërmjet përdorimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, nuk mund të tejkalojnë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, që do të përllogariteshin për të njëjtat ekspozime, në mungesë të zbutjes së rrezikut të kredisë.

3. Bankat, në rastet kur mbrojtja e kredisë është marrë në konsideratë në llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, sipas metodës standarde të përcaktuar në kreun III të kësaj rregulloreje, nuk mund të përdorin përsëri këtë teknikë për të modifikuar shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun për rrezikun e kredisë, sipas këtij kreu.

Neni 42

Zbatimi i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë në rastin e llojeve të ndryshme të mbrojtjes së kredisë

1. Bankat, për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, mund të përdorin më shumë se një lloj mbrojtje kredie për të mbuluar një ekspozim.

2. Bankat, në rastin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për rrezikun e kredisë, do të ndajnë ekspozimin në pjesë të veçanta, ku secila mbulohet nga një lloj mbrojtje kredie, dhe do të llogarisin shumën e ekspozimit të ponderuar me rrezikun për secilën pjesë në mënyrë të veçantë, siç përcaktohet në këtë kre.

Neni 43

Llojet e mbrojtjes së kredisë

1. Bankat, për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, përdorin llojet e mëposhtme të mbrojtjes së kredisë:

a) mbrojtjen e financuar të kredisë, të përcaktuar në nënkreun 2 të këtij kreu;

b) mbrojtjen e pafinancuar të kredisë, të përcaktuar në nënkreun 3 të këtij kreu.

Neni 44

Mospërputhja e maturiteteve midis ekspozimit dhe mbrojtjes së kredisë

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për rrezikun e kredisë, marrin në konsideratë mospërputhjet e maturiteteve që ndodhin kur maturiteti i mbetur i mbrojtjes së kredisë është më i vogël se ai i ekspozimit të mbrojtur.

2. Bankat nuk mund të përdorin mbrojtjen e kredisë, në rastet kur maturiteti i mbetur i saj (i mbrojtjes së kredisë) është më i vogël se 3 (tre) muaj dhe ekspozimi ka një maturitet të mbetur më të madh se maturiteti i mbetur i mbrojtjes.

3. Bankat nuk mund të përdorin mbrojtjen e kredisë, në rastet kur maturiteti fillestar i saj është më i vogël se një vit dhe maturiteti i mbetur i kredisë është më i madh se maturiteti fillestar i mbrojtjes.

4. Bankat, duke bërë përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur përdorin metodën e thjeshtë të kolateralit financiar për të llogaritur shumat e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, të specifikuar në nenet 53 deri në 57, nuk do të njohin mbrojtjen e financuar të kredisë, nëse ka mospërputhje midis maturitetit të mbrojtjes së financuar të kredisë dhe ekspozimit të mbrojtur.

5. Maturiteti efektiv i ekspozimit është koha më e gjatë e mundshme, maksimalisht prej 5 vitesh, e mbetur para se debitori të jetë i detyruar të përmbushë detyrimet e tij sipas planit të shlyerjes. Maturiteti i mbrojtjes së kredisë do të jetë koha deri në datën më të hershme, në të cilën mbrojtja mund të përfundojë ose të ndërpritet.

6. Bankat, në rastet kur ka një mundësi për ndërprerjen e mbrojtjes së pafinancuar, e cila është në diskrecionin e shitësit të mbrojtjes, do të konsiderojnë si maturitet të mbrojtjes, kohën deri në datën më të hershme në të cilën mund të ushtrohet kjo e drejtë (ndërprerja). Ndërsa, në rastet kur ka një mundësi për ndërprerjen e mbrojtjes, e cila është në diskrecionin

e blerësit të mbrojtjes dhe kushtet e marrëveshjes së mbrojtjes përmbajnë stimuj që i japin shtysë bankës për ta mbyllur transaksionin përpara maturimit kontraktual, do të konsiderohet si maturitet i mbrojtjes koha deri në datën më të hershme, në të cilën mund të ushtrohet kjo e drejtë.

7. Bankat, në rastet kur përdorin si teknikë zbutjeje një derivativ kredie, që mund (lejohet) të mbyllet përpara skadimit të ndonjë periudhe të mundshme "*grace period*", kur ky skadim përbën kusht për shpalljen dështimit (*default*) të detyrimit referencë si rezultat i pamundësisë për të paguar, do të reduktojnë maturitetin e mbrojtjes së kredisë me afatin/periudhën e "*grace period*".

8. Bankat, në rastin e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, kur mbrojtjet e kredisë që burojnë nga një ofrues i vetëm mbrojtjeje, kanë maturitete të ndryshme, do të ndjekin të njëjtën trajtim (qasje) me atë të specifikuar në paragrafin 2 të nenit 42.

Neni 45

Kërkesat për sistemet dhe proceset e brendshme për administrimin e rreziqeve që shoqërojnë zbatimin e teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë

1. Bankat disponojnë/zhvillojnë sistemet dhe proceset e duhura për administrimin e rrezikut/qeve, që shoqërojnë teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë, të përdorura prej tyre, duke siguruar efektivitetin e kuadrit të mbrojtjes së kredisë.

2. Bankat, pavarësisht marrjes në konsideratë të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, për qëllime të llogaritjes së shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun dhe humbjeve të rëndësishme të pritshme, kryejnë vlerësimin e plotë të rrezikut të kredisë për ekspozimin/et respektive. Në rastin e transaksioneve të riblerjes dhe atyre të anasjella të riblerjes dhe/ose të transaksioneve të huadhënies ose huamarrjes së titujve ose të mallrave (*commodities*), si ekspozim, do të konsiderohet vlera neto e tyre.

NËNKREU II

MBROJTJA E FINANCUAR E KREDISË

Neni 46

Kritere të përgjithshme mbi njohjen e mbrojtjes së financuar të kredisë

1. Bankat njohin si mbrojtje të financuar kredie vetëm aktivet që plotësojnë kriteret/kushtet e përcaktuara në këtë nënkre.

2. Bankat, në rastin e mbrojtjes së financuar të kredisë, sigurojnë që aktivet e përdorura të jenë mjaftueshëm likuide dhe vlera e tyre në kohë të jetë mjaftueshëm e qëndrueshme, për të dhënë sigurinë e nevojshme, për mbrojtjen e kredisë, që arrihet nëpërmjet tyre, në përputhje me metodën e përdorur për të llogaritur shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun dhe në masën e njohjes së lejuar.

3. Bankat, në rastin e mbrojtjes së financuar të kredisë, sigurojnë me anë të një kontrate, të drejtën për të likuiduar ose zotëruar, në kohën e duhur, aktivet prej të cilave buron mbrojtja, në rast dështimi, paaftësie paguese ose falimentimi të debitorit, ose në rast të materializimit të ndonjë ngjarjeje tjetër kredie, të specifikuar në kontratë dhe aty ku është e aplikueshme, të institucionit kujdestar, që mban kolateralin.

4. Bankat sigurojnë që shkalla e korrelacionit midis vlerës së aktiveve prej të cilave buron mbrojtja dhe cilësisë së kredisë së debitorit, të jetë e përshtatshme (për shembull në rast se banka përdor si mbrojtje, aksione të një kompanie që operon në të njëjtin segment tregu me debitorin, pra ecuria e së cilës ndikohet nga të njëjtët faktorë specifikë që ndikojnë ecurinë e biznesit të debitorit të bankës, atëherë kjo mbrojtje konsiderohet e pavlefshme, për shkak të korrelacionit të fortë midis vlerës së mbrojtjes dhe cilësisë së kredisë së debitorit).

Neni 47
Llojet e mbrojtjes së financuar të kredisë

1. Bankat, për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, përdorin format e mëposhtme të mbrojtjes së financuar të kredisë:

a) kolaterali financiar;

b) netimi në bilanc;

c) marrëveshjet tip të netimit (kompensimit);

d) mbrojtje të tjera:

i) depozita me institucione palë të treta;

ii) polica të sigurimit të jetës;

iii) instrumente të riblerë sipas kërkesës.

2. Bankat, për qëllime të llogaritjes së efekteve të zbutjes së rrezikut të kredisë, trajtojnë si kolateral financiar sipas përcaktimit të paragrafit 1 shkronja "a" të këtij neni, *cash*-in, titujt ose mallrat (*commodities*) e blera, përftuara ose të marra hua nën një transaksion riblerjeje, transaksion të anasjellë riblerjeje ose nën një transaksion të huadhënies ose huamarrjes së titujve ose mallrave (*commodities*).

Neni 48
Pranueshmëria e kolateralit financiar

1. Banka, në rastet kur teknika e zbutjes së rrezikut të kredisë e përdorur prej saj mbështetet në mbrojtjen e financuar të kredisë, e përcakton pranueshmërinë e kolateralit financiar, në varësi të metodës së përdorur prej saj: metoda e thjeshtë e kolateralit financiar apo metoda gjithëpërfshirëse e kolateralit financiar.

2. Banka, përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në rastin e transaksioneve të riblerjes, transaksioneve të anasjella të riblerjes dhe të transaksioneve të huadhënies ose huamarrjes së titujve ose mallrave (*commodities*), do të konsiderojë në procesin e pranueshmërisë së teknikës për zbutjen e rrezikut të kredisë edhe faktin nëse transaksioni është kontabilizuar në librin e bankës apo në librin e tregtueshëm.

Neni 49
Pranueshmëria e kolateralit financiar sipas të gjitha metodave
(ndryshuar fjalë në shkronjat "b" të pikës 3 dhe 4 me vendimin nr.7, datë 5.2.2020)

1. Bankat njohin instrumentet e mëposhtëm si kolateralë financiarë të pranueshëm sipas të gjitha metodave, për njohjen e zbutjes së rrezikut të kredisë:

a) depozitë/a në *cash* ose certifikata të depozitave apo instrumente të ngjashme me to, të mbajtur pranë bankës huadhënëse;

b) titujt e borxhit të emetuar nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore, të cilat sipas përcaktimeve për ponderimin me rrezikun të ekspozimeve ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore në zbatim të kreut III, kanë një vlerësim të jashtëm të rrezikut të kredisë, që korrespondon me cilësinë e kredisë "shkalla 4" ose më lart;

c) titujt e borxhit të emetuar nga institucionet, të cilat sipas përcaktimeve për ponderimin me rrezikun, të ekspozimeve ndaj institucioneve në zbatim të kreut III, kanë një vlerësim të jashtëm të rrezikut të kredisë, që korrespondon me cilësinë e kredisë shkalla 3 ose më lart;

d) titujt e borxhit të emetuar nga subjekte të tjera, të cilat sipas përcaktimeve për ponderimin me rrezikun të ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare në zbatim të kreut III, kanë një vlerësim të jashtëm të rrezikut të kredisë, që korrespondon me cilësinë e kredisë shkalla

3 ose më lart;

e) titujt e borxhit me një vlerësim afatshkurtër të rrezikut të kredisë, që sipas përcaktimeve për ponderimin me rrezikun të ekspozimeve afatshkurtra në zbatim të kreut III, korrespondon me cilësinë e kredisë shkalla 3 ose më lart;

f) aksione ose obligacione të konvertueshme, që janë të përfshira në një indeks kryesor; dhe

g) ari.

2. Bankat, në rastin kur një titull i borxhit i listuar në shkronjat "b" deri në "e" të paragrafit 1 të këtij neni, ka dy vlerësime krediti nga ECAI të njohura, do të përdorin vlerësimin më pak të favorshëm. Ndërsa, në rastet kur një titull i borxhit ka më shumë se dy vlerësime të kreditit nga këto ECAI të njohura, do të përdorin dy vlerësimet më të favorshme dhe nëse dy vlerësimet më të favorshme janë të ndryshme, do të përdorin vlerësimin më pak të favorshëm.

3. Për qëllime të shkronjës "b" të paragrafit 1 të këtij neni, "titujt e borxhit të emetuar nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore" do të përfshijnë:

a) titujt e borxhit të emetuar nga qeveritë rajonale ose autoritetet vendore, ekspozimet e të cilave janë trajtuar sipas kreut III të rregullores si ekspozime ndaj qeverisë qendrore në juridiksionin e të cilave ata janë vendosur;

b) titujt e borxhit të emetuar nga njësitë e sektorit publik, të cilët trajtohen sipas nenit 14, si ekspozime ndaj qeverive qendrore;

c) titujt e borxhit të emetuar nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, të cilave, sipas kreut III të rregullores, u është dhënë një peshë rreziku prej 0%; dhe

d) titujt e borxhit të emetuar nga organizatat ndërkombëtare, të cilave, sipas kreut III të rregullores, u është dhënë një peshë rreziku prej 0%.

4. Për qëllime të shkronjës "c" të paragrafit 1 të këtij neni "titujt e borxhit të emetuar nga institucionet" përfshijnë:

a) titujt e borxhit të emetuar nga qeveritë rajonale ose autoritetet vendore, përveç atyre të cilët janë trajtuar sipas kreut III të rregullores, si ekspozime ndaj qeverive qendrore, në juridiksionin e të cilave ato janë vendosur;

b) titujt e borxhit të emetuar nga njësitë e sektorit publik, ekspozimet, ndaj të cilave janë trajtuar sipas kreut III të rregullores, si ekspozime ndaj institucioneve; dhe

c) titujt e borxhit të emetuar nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, të ndryshme nga ata të cilat sipas kreut III të rregullores, ponderohen me 0% rrezik.

5. Bankat njohin si kolateral financiar të pranueshëm letrat me vlerë, të emetuara nga institucionet, të cilat nuk kanë një vlerësim të jashtëm të rrezikut të kredisë, vetëm nëse këto letra plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) janë të listuara në një treg/bursë të njohur;

b) kualifikohen si borxh (senior) me përparësi të lartë;

c) të gjitha emetimet e tjera të institucionit emetues me prioritet të njëjtë në pagesë (borxh *senior*), të cilat sipas përcaktimeve për ponderimin me rrezikun të ekspozimeve ndaj institucioneve apo ekspozimeve afatshkurtra, të cilat sipas kreut III të kësaj rregulloreje, kanë një vlerësim të jashtëm të rrezikut të kredisë, që korrespondon me një cilësi kredie shkalla 3 ose më lart;

d) banka huadhënëse nuk ka ndonjë informacion që sugjeron se emetimi do të justifikonte një vlerësim kredie më poshtë se ai i treguar në shkronjën "c"; dhe

e) banka mund t'i provojë Bankës së Shqipërisë se likuiditeti i tregut për instrumentin është i mjaftueshëm për këto qëllime.

6. Bankat njohin si kolateral financiar të pranueshëm kuotat e pjesëmarrjes/njësitë në sipërmarrjet kolektive të investimit (SIK), vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ato kanë një çmim të kuotuar publikisht mbi baza ditore; dhe

b) sipërmarrja kolektive e investimit është e kufizuar në investimin/et vetëm në

instrumentet, të cilat njihen si të pranueshme sipas këtij neni.

7. Bankat, nëse sipërmarrja kolektive e investimit nuk është kufizuar vetëm në investimin në instrumente, që janë të pranueshme për njohje sipas këtij neni, mund të njohin njësitë e SIK-së me vlerën e aktiveve të pranueshme si kolateral, me supozimin që SIK-ja ka investuar në masën maksimale të lejuar në bazë të mandatit të saj, në aktive të papranueshme, si teknikë zbutjeje të rrezikut të kredisë.

8. Bankat, në rastet kur aktivet e papranueshme mund të kenë një vlerë negative për shkak të detyrimeve ose detyrimeve të kushtëzuara që rrjedhin nga pronësia, do të llogarisin vlerën totale të aktiveve të papranueshme dhe do të zvogëlojnë vlerën e aktiveve të pranueshme me atë të aktiveve të papranueshme, në rast se kjo e fundit është negative në total.

9. Përdorimi ose përdorimi i mundshëm, nga ana e një sipërmarrje të investimit kolektiv, i instrumenteve derivative për të mbrojtur investimet e lejuara, nuk i pengon njësitë në këto sipërmarrje të jenë të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë.

Neni 50

Instrumente të tjera të pranueshme si kolateral sipas metodës gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar

1. Bankat, përveç kolateralit të përcaktuar në nenin 49, në rastin kur përdorin metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar, sipas këtij nënkreu, njohin si kolateral të pranueshëm edhe instrumentet financiare të mëposhtme:

a) aksione ose obligacione të konvertueshme që nuk përfshihen në një indeks kryesor, por tregtohen në një bursë të njohur; dhe

b) njësitë në sipërmarrjet kolektive të investimit, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) ato kanë një kuotim publik ditor të çmimeve; dhe

ii) sipërmarrja kolektive e investimit është e kufizuar për të investuar në instrumentet që janë të pranueshme për njohje, sipas paragrafëve 1-5 të nenit 49, dhe në elementet e përcaktuara në shkronjën “a” të këtij paragrafi;

iii) respektohen kërkesat e paragrafit 7 dhe 8 të nenit 49.

Përdorimi (ose përdorimi i mundshëm) nga ana e një sipërmarrje kolektive, të investimit të instrumenteve derivative për të mbrojtur investimet e lejuara, nuk i pengon njësitë në këto sipërmarrje të jenë të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë.

2. Bankat, për qëllime të përllogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e kundërpartisë në lidhje me transaksionet e riblerjes, transaksionet e anasjella të riblerjes dhe transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së titujve dhe mallrave (*commodities*) të kontabilizuara në librin e tregtueshëm, mund të njohin si kolateral të pranueshëm të gjitha instrumentet financiare dhe mallrat (*commodities*) që janë të pranueshme për t’u përfshirë në librin e tregtueshëm.

3. Bankat, për ekspozimet që rrjedhin nga instrumentet derivativë OTC, të kontabilizuar në librin e tregtueshëm, mund të njohin si kolateral të pranueshëm mallrat (*commodities*) që janë të pranueshme për t’u përfshirë në librin e tregtueshëm.

Neni 51

Kërkesat minimale për njohjen e kolateralit financiar sipas të gjitha metodave

1. Bankat njohin kolateralin financiar dhe arin, si elemente të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë, sipas të dyja metodave, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ekziston një lidhje/korrelacion i ulët, pra gjendja financiare e kredimarrësit dhe vlera e kolateralit nuk duhet të kenë një korrelacion pozitiv material (domethënë titujt e

emetuar nga kredimarrësi ose persona të lidhur me të, nuk do të konsiderohen si kolateralë të pranueshëm për zbutjen e rrezikut të kredisë). Pavarësisht këtij kushti, obligacionet e garantuara të emetuara nga kredimarrësi që plotësojnë kushtet e paragrafit 1 të nenit 26, mund të njihen si kolateral i pranueshëm, kur ato janë të vendosura si kolateral për transaksionet e riblerjes, me kusht që të plotësohen kërkesat e shkronjës “a” të këtij neni (nenit 51);

b) bankat plotësojnë kërkesat kontraktuale e ligjore dhe ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar zbatueshmërinë e marrëveshjeve të kolateralit, sipas ligjit në fuqi, të zbatueshëm për të drejtat/pretendimet e tyre ndaj kolateralit. Bankat kryejnë shqyrtime të mjaftueshme ligjore, me qëllim sigurimin e ekzekutimit të kolateralit/zbatueshmërisë së marrëveshjeve të tij (kolateralit) në të gjitha juridiksionet përkatëse, si dhe i rikonsiderojnë të tilla shqyrtime sipas nevojave për të siguruar vazhdimësi në zbatueshmërinë e këtyre kontratave;

c) bankat plotësojnë kërkesat e mëposhtme operacionale:

i) hartojnë dhe miratojnë procedurat e duhura për dokumentimin e marrëveshjeve të kolateralit, me qëllim likuidimin në kohë të tij (kolateralit);

ii) përdorin procedura dhe procese rigoroze të kontrollit të rreziqeve që vijnë nga përdorimi i kolateralit (duke përfshirë rrezikun e dështimit ose reduktimit të mbrojtjes së kredisë, rrezikun e vlerësimit, rreziqet që lidhen me ndërprerjen e mbrojtjes së kredisë, rrezikun e përqendrimit që rrjedh nga përdorimi i kolateralit dhe ndërveprimi me profilin e përgjithshëm të rrezikut të bankës);

iii) hartojnë dhe miratojnë politika dhe disponojnë praktika të dokumentuara në lidhje me llojet dhe sasitë e kolateralit të pranuar si teknikë zbutjeje;

iv) llogarisin vlerën e tregut të kolateralit dhe bëjnë rivlerësime të tij (kolateralit) në përputhje me rrethanat, minimalisht të paktën një herë në gjashtë muaj dhe sa herë që banka gjykon që ka ndodhur një rënie e konsiderueshme në vlerën e tregut të këtij kolaterali;

v) në rastin kur kolaterali është mbajtur/mbahet nga një palë e tretë, bankat duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të siguruar që pala e tretë dallon (veçon) kolateralin nga aktivet e saj.

Neni 52

Kolaterali financiar - Llogaritja e vlerës së ekspozimit plotësisht të rregulluar

1. Bankat, për qëllime të përllogaritjes së efekteve të kolateralit financiar, mund të përdorin njërën nga metodat e mëposhtme:

a) metodën e thjeshtë të kolateralit financiar;

b) metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar.

2. Bankat, për qëllime të llogaritjes së efekteve të zbutjes së rrezikut të kredisë, nuk mund të përdorin njëkohësisht metodën e thjeshtë të kolateralit financiar dhe metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar.

Neni 53

Metoda e thjeshtë për kolateralin financiar - Vlerësimi i kolateralit

Sipas kësaj metode, kolateralit financiar të njohur si teknikë zbutjeje, i jepet një vlerë e barabartë me vlerën e tij në treg, të përcaktuar në përputhje me nenin 51 paragrafi 1 shkronja “c”.

Neni 54

Metoda e thjeshtë për kolateralin financiar - Llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuar me rrezikun, për rrezikun e kredisë

1. Banka i cakton proporcionalisht asaj pjese të shumës së ekspozimit që mbulohet me vlerën e tregut të kolateralit të njohur, peshën e rrezikut që do t'u caktohej ekspozimeve në bazë të kreut III të rregullores, nëse huadhënësi do të kishte një ekspozim të drejtpërdrejtë ndaj instrumentit të kolateralit.

2. Banka, për këtë qëllim, konsideron si vlerë ekspozimi të një zëri jashtë bilanci të listuar në aneksin 2, 100% të vlerës së tij, në vend të vlerës së ekspozimit të përcaktuar në aneksin 2 (klasifikimi i zërave jashtë bilancit).

3. Banka do të aplikojë një peshë rreziku të paktën 20%, për shumën e mbuluar me kolateral, përveç rasteve të specifikuara në nenet 55, 56, 57. Pjesa e mbetur e shumës së ekspozimit do të ponderohet me nivelin e rrezikut, që sipas kreut III të rregullores, do të caktohet për ekspozimet e pasiguruara me kolateral.

Neni 55

Metoda e thjeshtë për kolateralin financiar - Transaksionet e riblerjes dhe transaksionet e huadhënies apo të huamarrjes së titujve

Bankat ponderojnë me peshën e rrezikut 0%, pjesën e mbuluar me kolateral/e të ekspozimeve që rrjedhin nga transaksionet, të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 66. Në rastet kur kundërpartia e transaksionit nuk është pjesëmarrës i rëndësishëm në treg, bankat ponderojnë ekspozimin me një peshë rreziku prej 10%.

Neni 56

Metoda e thjeshtë për kolateralin financiar - Transaksionet derivativë mbi banak (OTC) që janë subjekt i kontabilizimit të përditshëm me metodën *mark-to-market*

1. Bankat ponderojnë me një peshë rreziku 0%, deri në masën e mbuluar me kolateral, vlerat e ekspozimit të përcaktuara në kreun VI të kësaj rregulloreje, për instrumentet derivative të listuara në aneksin 4, dhe që i nënshtrohen kontabilizimit të përditshëm sipas metodës *mark-to-market*, të mbuluara me kolateral *cash* ose me instrumente të ngjashme me *cash*-in kur nuk ka mospërputhje të monedhave.

2. Bankat ponderojnë me një peshë rreziku prej 10%, pjesën e mbuluar me kolateral të ekspozimit të atyre transaksioneve që mbulohen me kolateral të llojit të titujve të borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore, të cilave, në kreun III të rregullores, u është caktuar një peshë rreziku prej 0%.

3. Për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, titujt e emetuar nga qeveritë qendrore ose nga bankat qendrore do të përfshijnë:

a) tituj të borxhit të emetuar nga qeveritë rajonale ose autoritetet vendore, ekspozimet ndaj të cilave sipas kreut III të rregullores, janë trajtuar si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, në juridiksionin e të cilave ato janë krijuar;

b) tituj të borxhit të emetuar nga bankat e zhvillimit shumëpalëshe, të cilave në bazë të kreut III të rregullores, u është caktuar një peshë rreziku prej 0%; dhe

c) tituj të borxhit të emetuar nga organizatat ndërkombëtare, të cilave sipas kreut III të rregullores, u është caktuar një peshë rreziku prej 0%.

Neni 57

Metoda e thjeshtë për kolateralin financiar -Transaksionet e tjera

1. Bankat ponderojnë ekspozimet me një peshë rreziku prej 0%, në rastet kur vlera e ekspozimit dhe ajo e kolateralit janë të shprehura në të njëjtën monedhë, si dhe kolaterali

është në formën e:

a) depozitës në *cash* ose certifikatave te depozitave apo instrumenteve të ngjashme me to; ose

b) titujve të borxhit të emetuar nga qeveritë qendrore ose bankat qendrore, që sipas kreut III të rregullores, ponderohen me një peshë rreziku prej 0% dhe vlera e tyre e tregut është reduktuar/skontuar me 20%. Për qëllime të kësaj pike "titujt e borxhit të emetuara nga qeveritë qendrore ose nga bankat qendrore" , do të përfshijnë ato të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 56.

Neni 58

Metoda gjithëpërfshirëse e kolateralit financiar - Vlerësimi i kolateralit financiar

1. Bankat, në vlerësimin e kolateralit financiar sipas metodës gjithëpërfshirëse për kolateralin financiar, zbatojnë rregullimet e luhatshmërisë për vlerën e tregut të kolateralit/eve, siç përcaktohet në nenet 60-66 më poshtë.

2. Bankat, në përputhje me kërkesat për trajtimin e mospërputhjeve midis monedhave, në rastin e transaksioneve të derivativëve mbi banak (OTC), siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni, në rastet kur kolaterali është i denominuar në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën është denominuar aktivi bazë, përveç rregullimit për luhatshmërinë që zbatohet për kolateralin, do të zbatojnë edhe një rregullim tjetër që pasqyron luhatshmërinë e monedhave, siç përcaktohet në nenet 60-66 në vijim.

3. Bankat, në rastin e transaksioneve derivative mbi banak (OTC) të mbuluara nga marrëveshjet tip të netimit, të njohura nga Banka e Shqipërisë sipas kreut VI, zbatojnë një rregullim luhatshmërie që pasqyron luhatshmërinë e monedhave kur ka mospërputhje midis monedhës së kolateralit dhe monedhës së shlyerjes.

4. Bankat, edhe në rastin kur ka shumë monedha të përfshira në transaksionet e mbuluara nga marrëveshja tip e netimit, zbatojnë vetëm një rregullim luhatshmërie (për shportën e monedhave dhe jo për çdo monedhë).

Neni 59

Metoda gjithëpërfshirëse për kolateralin financiar – Llogaritja e vlerave të rregulluara

1. Bankat llogarisin vlerën e kolateralit të rregulluar me efektet e luhatshmërisë, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme, për të gjitha transaksionet, përveç atyre transaksioneve që janë subjekt i marrëveshjeve tip të netimit të njohura, për të cilat zbatohen dispozitat e parashikuara në nenet 74 deri në 76:

$$C_{VA} = C \times (1-H_C-H_{FX}),$$

ku:

C_{VA} - është vlera e kolateralit e rregulluar për luhatshmërinë;

C – është vlera e tregut të kolateralit, përpara aplikimit të rregullimeve të luhatshmërisë;

H_C - është rregullimi i luhatshmërisë për kolateralin, i llogaritur sipas neneve 60 deri 65, në vijim;

H_{FX} - është rregullimi i luhatshmërisë për mospërputhjen e monedhave, i llogaritur sipas neneve 60 deri 65, në vijim.

2. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të rregulluar ndaj luhatshmërisë siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$E_{VA} = E \times (1 + HE)$ dhe në rastin e transaksioneve derivative mbi banak, EVA = E,

ku:

E_{VA} - është shuma e ekspozimit, e rregulluar për luhatshmërinë;

E - është vlera e ekspozimit, ashtu siç do të përcaktohej në bazë të kreut III të rregullores, nëse ekspozimi nuk do të ishte i mbuluar me kolateral. Për këtë qëllim, vlera e ekspozimit të zërave jashtë bilancit të përcaktuara në aneksin 2 të rregullores, do të jetë 100% e vlerës së tyre;

HE - është rregullimi i luhatshmërisë për ekspozimin (E), i llogaritur sipas neneve 60 deri 65, në vijim.

3. Bankat pasqyrojnë maturitetin e mbrojtjes së kredisë dhe maturitetin e ekspozimit në vlerën e rregulluar të kolateralit (domethënë reflektojnë mospërputhjet e maturitetit midis ekspozimit dhe kolateralit), siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$C_{VAM} = C_{VA} \times (t-t^*) / (T-t^*),$$

ku:

C_{VAM} - do të merret si CVA e korrektuar për mospërputhjen e maturiteteve, për t'u përfshirë në formulën për llogaritjen e vlerës plotësisht të rregulluar të ekspozimit (E*);

C_{VA} - është vlera më e ulët midis vlerës së kolateralit të rregulluar për luhatshmërinë, siç specifikohet në këtë nen, dhe shumës së ekspozimit;

t - është vlera më e ulët midis numrit të viteve të mbetura deri në datën e maturimit të mbrojtjes së kredisë, e llogaritur në përputhje me nenin 44, paragrafët 5-7 dhe vlerës së T;

T - është vlera më e ulët midis numrit të viteve të mbetura deri në datën e maturimit të ekspozimit, të llogaritur në përputhje me nenin44, paragrafët 5-7, dhe 5 vjet; dhe

t* - është 0,25.

4. Bankat llogarisin vlerën plotësisht të rregulluar të ekspozimit, duke marrë parasysh efektet e luhatshmërisë dhe efektet e zbutjes së rrezikut nga kolaterali, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$E^* = \max \{0, [E_{VA} - C_{VAM}]\},$$

ku:

E* - është vlera plotësisht e rregulluar e ekspozimit, duke marrë parasysh luhatshmërinë dhe efektet zbutëse të rrezikut nga kolaterali;

E_{VA} - është shuma e ekspozimit, e rregulluar për luhatshmërinë;

C_{VAM} - është C_{VA} e rregulluar edhe me mospërputhjen e maturiteteve, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 60

Metoda gjithëpërfshirëse për kolateralin financiar - Llogaritjet e rregullimeve të luhatshmërisë

1. Bankat llogarisin rregullimet e luhatshmërisë, sipas njërës prej metodave të mëposhtme:

a) metodës mbikëqyrëse të rregullimeve të luhatshmërisë;

b) metodës së vlerësimeve të veta (të bankës) për rregullimet e luhatshmërisë (metoda e vlerësimeve të veta).

2. Bankat nuk mund të përdorin metodën e vlerësimeve të veta pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

3. Bankat që marrin miratimin për të përdorur metodën e vlerësimeve të veta duhet ta përdorin këtë metodë për të gjithë llojet e instrumenteve.

4. Bankat, duke bërë përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, mund të përdorin metodën mbikëqyrëse të rregullimeve të luhatshmërisë për portofolat jomateriale.

5. Bankat, në rastet kur kolaterali përbëhet nga një numër zërash të njohur, bëjnë rregullimin e luhatshmërisë, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$H = \sum_{ii} H_i,$$

ku:

$_i$ - është pjesa që zë secili artikull/zë ndaj të gjithë kolateralit;

H_i - është rregullimi i luhatshmërisë që zbatohet për atë artikull/zë.

Neni 61

Metoda gjithëpërfshirëse për kolateralin financiar - Rregullimet mbikëqyrëse të luhatshmërisë

Bankat përdorin rregullimet e luhatshmërisë sipas metodës mbikëqyrëse të rregullimit të luhatshmërisë (me kusht që të kryhet rivlerësim ditor i instrumenteve), siç përcaktohen në tabelat e mëposhtme (9-12).

Tabela 9. Rregullimet e luhatshmërisë për titujt e borxhit të listuara në nenin 49, paragrafi 1 shkronjat “b”, “c” dhe “d”

Shkalla e cilësisë së kredisë që i korrespondon vlerësimit të titullit të borxhit	**Maturiteti i mbetur**	**Rregullimi i luhatshmërisë për titujt e borxhit të emetuar nga entitetet e përshkruara në nenin 49, paragrafi 1, shkronja “b”**			**Rregullimi i luhatshmërisë për titujt e borxhit të emetuar nga entitetet e përshkruara në nenin 49, paragrafi 1, shkronjat “c” dhe “d”**		
		Periudha e likuidimit 20 ditë (%)	**Periudha e likuidimit 10 ditë (%)**	**Periudha e likuidimit 5 ditë (%)**	**Periudha e likuidimit 20 ditë (%)**	**Periudha e likuidimit 10 ditë (%)**	**Periudha e likuidimit 5 ditë (%)**
1	≤ 1 vit	0,707	0,5	0,354	1,414	1	0,707
	>1 ≤ 5 vjet	2,828	2	1,414	5,657	4	2,828
	> 5 vjet	5,657	4	2,828	11,314	8	5,657
2-3	≤ 1 vit	1,414	1	0,707	2,828	2	1,414
	>1 ≤ 5 vjet	4,243	3	2,121	8,485	6	4,243
	> 5 vjet	8,485	6	4,243	16,971	12	8,485
4	≤ 1 vit	21,213	15	10,607	N/A	N/A	N/A
	>1 ≤ 5 vjet	21,213	15	10,607	N/A	N/A	N/A
	> 5 vjet	21,213	15	10,607	N/A	N/A	N/A

Tabela 10. Rregullimet e luhatshmërisë për titujt e listuar në nenin 49, paragrafi 1, pikat “b”, “c” dhe “d” me vlerësime afatshkurtra të cilësisë së kredisë

Shkalla e cilësisë së kredisë me të cilën korrespondon vlerësimi i titullit të borxhit afatshkurtër	**Rregullimet e luhatshmërisë për titujt e borxhit të emetuar nga entitetet e përshkruara në nenin 49, paragrafi 1, pika “b”, me vlerësim afatshkurtër të cilësisë së kredisë**			**Rregullimet e luhatshmërisë për titujt e borxhit të emetuar nga entitetet e përshkruara në nenin 49, paragrafi 1, pikat “c” dhe “d”, me vlerësim afatshkurtër të cilësisë së kredisë**		
	Periudha e likuidimit 20 ditë (%)	Periudha e likuidimit 10 ditë (%)	Periudha e likuidimit 5 ditë (%)	Periudha e likuidimit 20 ditë (%)	Periudha e likuidimit 10 ditë (%)	Periudha e likuidimit 5 ditë (%)
1	0,707	0,5	0,354	1,414	1	0,0707
2-3	1,414	1	0,707	2,828	2	1,414

Tabela 11. Rregullimet e luhatshmërisë për lloje të tjera kolaterali ose ekspozimi

Lloje të tjera kolaterali			
Llojet e tjera të kolateralit	**Periudha e likuidimit 20 ditë (%)**	**Periudha e likuidimit 10 ditë (%)**	**Periudha e likuidimit 5 ditë (%)**
Aksione të përfshira në një indeks kryesor, obligacione të konvertueshme të përfshira në një indeks kryesor	21,213	15	10,607
Aksione të tjera të papërfshira në një indeks kryesor ose obligacione të konvertueshme të papërfshira në një indeks kryesor, të listuara në një bursë të njohur	35,355	25	17,678
Depozita në *cash*, ose instrumente të ngjashme me to	0	0	0
Ar	21,213	15	10,607

Tabela 12. Rregullimet e luhatshmërisë për mospërputhjet e monedhave

Rregullimi i luhatshmërisë për mospërputhjet e monedhave		
Periudha e likuidimit 20 ditë (%)	**Periudha e likuidimit 10 ditë (%)**	**Periudha e likuidimit 5 ditë (%)**
11,314	8	5,657

1. Për qëllime të zbatimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, periudhat e likuidimit do të jenë si më poshtë:

a) 20 ditë pune për transaksionet e huadhënies të kolateralizuara;

b) 5 ditë pune për transaksionet e riblerjes (me përjashtim të rasteve kur këto transaksione përfshijnë transferimin e mallrave (*commodities*) apo të të drejtave të garantuara, të lidhura me titullin e këtyre mallrave (*commodities*);

c) 5 ditë pune për transaksionet e huadhënies apo huamarrjes së titujve;

d) 10 ditë pune për transaksionet e tjera të bazuara në tregun e kapitaleve.

2. Në tabelat 9 deri në 12 dhe në paragrafët 4 deri në 6 të këtij neni, shkalla e cilësisë së kredisë, të cilës i korrespondon vlerësimi i titullit të borxhit, është shkalla e cilësisë së kredisë e përcaktuar sipas kreut III të rregullores. Për qëllime të këtij paragrafi, kur titujt e sipërpërmendur kanë më shumë se një vlerësim kredie, bankat përdorin vlerësimin e kredisë në përputhje me nenin 49, paragrafi 2.

3. Bankat, për tituj të cilët nuk njihen si të pranueshëm në teknikat e zbutjes se rrezikut ose për mallrat (*commodities*) e dhëna hua apo të shitura me marrëveshje riblerje, ose për transaksionet e huadhënies apo huamarrjes së titujve apo mallrave (*commodities*), llogarisin rregullimin e luhatshmërisë njëlloj si për titujt e listuar në një bursë të njohur, të cilët nuk përfshihen në një indeks kryesor.

4. Bankat, për njësitë e sipërmarrjeve të investimit kolektiv të njohura për qëllime të teknikave të zbutjes, llogarisin rregullimin e luhatshmërisë, si mesatare e ponderuar e rregullimeve të luhatshmërisë që do të përdoreshin ndaj aktiveve, në të cilat ka investuar SIK-ja, duke marrë në konsideratë periudhën e likuidimit të transaksionit, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. Në rast se aktivet në të cilat ka investuar SIK-ja nuk njihen nga banka, rregullimi i luhatshmërisë është rregullimi më i lartë që do të zbatohej për çdo aktiv në të cilin SIK-ja ka të drejtë të investojë.

5. Bankat, për titujt e borxhit të emetuar nga institucione, për të cilat nuk ka një vlerësim të jashtëm të kredisë dhe që plotësojnë kriteret për njohje në nenin 49, paragrafi 5, llogarisin rregullimin e luhatshmërisë njëlloj si për titujt e emetuar nga institucione apo shoqëri me një vlerësim të jashtëm të kredisë, që korrespondon me shkallët 2 ose 3 të cilësisë së kredisë.

Neni 62

Metoda e vlerësimeve të veta për rregullimet e luhatshmërisë

1. Banka e Shqipërisë lejon bankat që përmbushin kërkesat e neneve 63 dhe 64, të përdorin vlerësimet e veta për përllogaritjen e rregullimeve të luhatshmërisë që aplikohen ndaj kolateralit dhe ekspozimeve.

2. Bankat, në rastet kur titujt kanë një vlerësim kredie nga një ECAI e njohur, ekuivalente me gradën e investimit ose më të lartë (të paktën BBB- ose shkalla 3 e cilësisë së kredisë), mund të llogarisin një vlerësim luhatshmërie për secilën kategori titujsh.

3. Bankat, në përcaktimin e kategorive të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, do të marrin në konsideratë llojin e emetuesit të titullit, vlerësimin e titujve nga një ECAI e njohur, maturitetin e mbetur, dhe kohëzgjatjen e modifikuar (*duration*).

4. Vlerësimet e luhatshmërisë duhet të jenë përfaqësuese për titujt e përfshirë në secilën nga kategoritë e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Bankat, për titujt e borxhit që kanë një vlerësim nga një ECAI e njohur në nivelin nën gradën e investimit (deri në BB+ ose shkalla 4 e cilësisë së kredisë), dhe për kolateralë të tjerë të pranueshëm, llogarisin rregullimet e luhatshmërisë për çdo element individual.

6. Bankat, të cilat përdorin metodën e vlerësimeve të veta, vlerësojnë luhatshmërinë e kolateralit ose mospërputhjen e monedhave, pa marrë në konsideratë korrelacionet e mundshme midis ekspozimit të pasiguruar, kolateralit dhe/ose kurseve të këmbimit.

7. Bankat, të cilat përdorin metodën e vlerësimeve të veta, për llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun e kundërpartisë, llogarisin rregullimet e luhatshmërisë për çdo element individual lidhur me instrumentet financiare dhe mallrat (*commodities*), e përmendur në nenin 50 paragrafi 2.

Neni 63

Kriteret sasiore - Metoda e vlerësimeve të veta për rregullimet e luhatshmërisë

1. Bankat, sipas metodës së vlerësimeve të veta për llogaritjen e rregullimeve të luhatshmërisë, përdorin një interval besimi 99% vetëm me kufi të sipërm besimi (*one-tailed*).

2. Bankat përdorin periudhat e likuidimit, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 61.

3. Bankat mund të përdorin vlera të rregullimit të luhatshmërisë të llogaritura sipas periudhave përkatëse të likuidimit më të shkurtra ose më të gjata (TM), të përshkallëzuara në rritje ose në zbritje, kundrejt periudhës së likuidimit (TN) të përcaktuar në nenin 61, për llojin e transaksionit në fjalë.

4. Bankat llogarisin rregullimin e luhatshmërisë në periudhën përkatëse të likuidimit (TM), kundrejt periudhës së likuidimit (TN), siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$H_M=H_N\sqrt{T_M}\sqrt{T_N},$$

ku:

H_M - është rregullimi i luhatshmërisë në periudhën përkatëse të likuidimit TM;

H_N - është rregullimi i luhatshmërisë bazuar në periudhën e likuidimit TN;

T_M - është periudha përkatëse e likuidimit;

T_N - është periudha e likuidimit e përcaktuar në nenin 61.

5. Bankat marrin në konsideratë shkallën e ulët të likuiditetit (ilikuiditetin) të aktiveve me cilësi të ulët dhe rregullojnë në mënyrë të përshtatshme periudhën e likuidimit.

6. Bankat identifikojnë rastet ku të dhënat historike mund të nënvlerësojnë luhatshmërinë potenciale dhe trajtojnë raste të tilla nëpërmjet skenarëve të *stress*-it.

7. Kohëzgjatja e periudhës së të dhënave historike për përllogaritjen e rregullimeve të luhatshmërisë do të jetë minimalisht një vit.

8. Bankat, të cilat përdorin një skemë ponderimi ose metoda të tjera për periudhën e të dhënave historike, duhet të sigurojnë që periudha efektive e të dhënave historike të jetë të paktën një vit.

9. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë që banka të llogarisë rregullimet e luhatshmërisë, duke përdorur një periudhë më të shkurtër të dhënash historike, nëse kjo justifikohet nga një rritje e rëndësishme e luhatshmërisë së çmimeve.

10. Bankat përditësojnë bazën e të dhënave të paktën një herë në tre muaj dhe i rivlerësojnë ato sa herë që çmimet e tregut pësojnë ndryshime materiale (domethënë rregullimet e luhatshmërisë do të përllogariten të paktën çdo tre muaj).

Neni 64

Kriteret cilësore - Metoda e vlerësimeve të veta për rregullimet e luhatshmërisë

1. Bankat përdorin vlerësimet e luhatshmërisë, në procesin e përditshëm të administrimit të bankës, edhe në lidhje me limitet/kufijtë e brendshëm të ekspozimit.

2. Bankat, nëse periudha e likuidimit e përdorur prej tyre është më e gjatë se ajo e përcaktuar në nenin 61 për llojin e transaksionit në fjalë, përshkallëzojnë rregullimet e luhatshmërisë, në përputhje me formulën e përcaktuar në nenin 63, paragrafi 4.

3. Bankat hartojnë dhe zbatojnë procedura për të monitoruar dhe siguruar përputhshmërinë me rregulloret dhe udhëzimet e brendshme për funksionimin e sistemeve të tyre, për llogaritjen e rregullimeve të luhatshmërisë dhe për integrimin e këtyre vlerësimeve në procesin e tyre të administrimit.

4. Bankat, gjatë procesit të kontrollit (auditimit) të brendshëm, kryejnë të paktën një herë në vit shqyrtime të pavarura të sistemeve të llogaritjes së rregullimeve të luhatshmërisë.

5. Bankat, në shqyrtimet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, konsiderojnë konkretisht:

a) integrimin e rregullimeve të vlerësuara të luhatshmërisë në administrimin e përditshëm të rrezikut;

b) vlerësimin (*validation*) e çdo ndryshimi të rëndësishëm në procesin e vlerësimit të rregullimeve të luhatshmërisë;

c) verifikimin e koherencës, përpikmërisë kohore dhe besueshmërisë së burimeve të të dhënave të përdorura për të administruar sistemin e vlerësimit të rregullimeve të luhatshmërisë, duke përfshirë pavarësinë e burimeve të të dhënave; si dhe

d) saktësinë dhe përshtatshmërinë e supozimeve mbi luhatshmërinë.

Neni 65

Përshkallëzimi i rregullimit të luhatshmërisë

1. Bankat zbatojnë rregullimet mbikëqyrëse të luhatshmërisë të përcaktuara në nenin 61, në rastet kur ka një rivlerësim ditor të ekspozimit dhe të kolateralit të pranuar. Në rastet kur bankat përdorin vlerësimet e veta të rregullimeve të luhatshmërisë, këto të fundit (vlerësimet e veta) duhet të llogariten në kohë reale, në bazë të rivlerësimit të përditshëm.

2. Bankat, në rastet kur frekuenca e rivlerësimit është më e vogël se ditore, zbatojnë rregullime më të mëdha të luhatshmërisë, të cilat llogariten duke përshkallëzuar rregullimet e luhatshmërisë të rivlerësimit ditor, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$H = H_M \sqrt{\frac{N_R + \left(T_M - 1\right)}{T_M}}$$

ku:

H - është rregullimi i luhatshmërisë i përdorur;

H_M - është rregullimi i luhatshmërisë kur ka rivlerësim ditor;

N_R - është numri aktual i ditëve të punës midis rivlerësimeve;

T_M - është periudha e likuidimit për llojin e transaksionit.

Neni 66

Kushtet për zbatimin e rregullimit të luhatshmërisë prej 0%

1. Bankat, në rastet e transaksioneve të riblerjes dhe transaksioneve të huamarrjes ose huadhënies së titujve, kur plotësohen njëkohësisht kushtet e përcaktuara në shkronjat “a” deri “h” të këtij paragrafi, mund të zbatojnë një rregullim luhatshmërie prej 0%:

a) ekspozimi dhe kolaterali janë në *cash* ose tituj borxhi të emetuar nga qeveritë qendrore apo bankat qendrore të përcaktuara në nenin 49, paragrafi 1, pika “b”, të kualifikuara për një peshë rreziku prej 0%, në përputhje me kreun III të rregullores;

b) ekspozimi dhe kolaterali janë në të njëjtën monedhë;

c) maturiteti i transaksionit është jo më shumë se një ditë ose ekspozimi së bashku me kolateralin janë subjekt i kontabilizimit të përditshëm, sipas metodës *mark-to-market* ose rivendosjes ditore të marzhit (*remargining*);

d) periudha kohore midis kontabilizimit të fundit me metodën mark-to-market, përpara një dështimi në rivendosjen e marzhit nga kundërpartia dhe likuidimit të kolateralit, do të jetë

jo më shumë se 4 ditë pune;

e) transaksioni shlyhet nëpërmjet një sistemi shlyerje të provuar/testuar për këtë lloj transaksioni;

f) dokumentacioni që mbulon marrëveshjen është dokumentacion standard i tregut për transaksionet e riblerjes, transaksionet e anasjella të riblerjes ose transaksionet e huamarrjes dhe huadhënies së titujve ose mallrave (*commodities*);

g) transaksioni rregullohet nga dokumentacioni përkatës që specifikon se, nëse kundërpartia nuk përmbush detyrimin për të dorëzuar *cash*-in ose titujt, ose për të plotësuar kërkesat lidhur me marzhet, apo dështon, atëherë transaksioni mund të ndërpritet menjëherë; dhe

h) kundërpartia konsiderohet "pjesëmarrës i rëndësishëm në treg".

Pjesëmarrësit e rëndësishëm të tregut përfshijnë entitetet e mëposhtme:

i) entitetet e përmendura në nenin 49 paragrafi 1 shkronja "b", ekspozimeve ndaj të cilave sipas kreut III të rregullores, u është caktuar një peshë rreziku 0%;

ii) institucionet e mbikëqyrura;

iii) shoqëri të tjera financiare (duke përfshirë shoqëritë e sigurimit) ekspozimeve ndaj të cilave sipas kreut III të rregullores, u është caktuar një peshë rreziku 20%;

iv) sipërmarrjet e investimit kolektiv të licencuara dhe të rregulluara, që janë subjekt i kërkesave për kapital ose kërkesave mbi levën financiare;

v) fonde pensioni të rregulluara; dhe

vi) organizata kleringu të njohura.

2. Banka e Shqipërisë, në rastet kur një autoritet përgjegjës i një vendi anëtar të Bashkimit Europian lejon trajtimin sipas paragrafit 1 të këtij neni të transaksioneve të riblerjes ose transaksioneve të huamarrjes dhe huadhënies për tituj të lëshuar nga qeveria e saj, mund të vendosë t'i lejojë bankat të zbatojnë të njëjtin trajtim për të njëjtat transaksione.

Neni 67

Llogaritja e shumave të ekspozimit, të ponderuara me rrezikun

1. Bankat konsiderojnë si vlerë ekspozimi për qëllime të llogaritjes së shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, në përputhje me kreun III të rregullores, treguesin E* të llogaritur sipas nenit 59.

2. Bankat, në rastin e zërave jashtë bilancit të listuara në aneksin 2 të kësaj rregulloreje, do të marrin E* si vlerën, ndaj së cilës do të aplikohen përqindjet e përcaktuara në nenin 9, dhe peshat e rrezikut të përcaktuara në kreun III të rregullores, për të llogaritur vlerën e ekspozimit.

Neni 68

Netimi në bilanc – Pranueshmëria

1. Bankat përdorin/njohin si teknikë zbutjeje netimin e të drejtave të ndërsjella ndërmjet bankës dhe kundërpartisë.

2. Bankat, pa rënë ndesh me nenin 72, përdorin/njohin netimin e zërave në bilanc vetëm për tepricat reciproke në *cash* midis bankës dhe kundërpartisë. Bankat kualifikojnë si të tilla (teprica reciproke në *cash*), vetëm kreditë dhe depozitat e bankës për modifikimin e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në rast të një marrëveshje netimi për zërat e bilancit.

Neni 69

Netimi në bilanc - Kërkesat minimale

1. Bankat njohin si teknikë të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë,

marrëveshjet e netimit në bilanc (përveç marrëveshjeve tip të netimit që mbulojnë transaksionet e riblerjes, transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së titujve ose të mallrave (*commodities*) dhe/ose transaksionet e tjera të tregut të kapitalit),vetëm nëse plotësohen kushtet/kriteret e mëposhtme:

a) të jenë ligjërisht efektive dhe të zbatueshme në të gjitha juridiksionet përkatëse, duke përfshirë edhe rastin e paaftësisë paguese ose falimentimit të kundërpartisë;

b) bankat të jenë në gjendje të përcaktojnë në çdo kohë ato aktive dhe pasive që janë subjekt i marrëveshjes së netimit në bilanc;

c) bankat të kryejnë monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve të lidhura me ndërprerjen e mbrojtjes së kredisë; dhe

d) bankat të monitorojnë dhe të kontrollojnë ekspozimet përkatëse në baza neto.

Neni 70

Netimi në bilanc - Llogaritja e vlerave plotësisht të rregulluara të ekspozimit

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së vlerave të ekspozimit plotësisht të rregulluara, trajtojnë si kolateral në *cash* kreditë dhe depozitat me bankën kredidhënëse, të cilat janë subjekt i netimit në bilanc.

2. Bankat, në rastet kur ka mospërputhje maturitetesh midis kredive dhe depozitave të përcaktuara në nenin 68, paragrafi 2, përdorin metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar, sipas neneve 58 deri në 67, për të llogaritur vlerën e ekspozimit plotësisht të rregulluar.

3. Bankat që përdorin vetëm metodën e thjeshtë të kolateralit financiar, për të llogaritur vlerën e ekspozimit plotësisht të rregulluar për të gjithë kolateralët e tjerë financiarë, në rastet kur nuk ka mospërputhje maturitetesh midis kredive dhe depozitave të përcaktuara në nenin 68, paragrafi 2, mund të përdorin këtë metodë sipas neneve 53 deri në 57, për të përllogaritur vlerën e ekspozimit plotësisht të rregulluar të kredive dhe depozitave që janë subjekt i netimit në bilanc.

Neni 71

Netimi në bilanc – Llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun

Bankat, në varësi të metodës së përdorur për përllogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, llogarisin vlerën e ekspozimit plotësisht të rregulluar, duke aplikuar peshat përkatëse të rrezikut të specifikuara në kreun III të kësaj rregulloreje.

Neni 72

Marrëveshjeve tip të netimit që mbulojnë transaksionet e riblerjes dhe/ose transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së mallrave (*commodities*) ose titujve dhe/ose transaksionet e bazuara në tregun e kapitaleve – Pranueshmëria

1. Bankat, për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, mund të përdorin marrëveshjet tip të netimit që mbulojnë transaksionet e riblerjes; dhe/ose transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së mallrave (*commodities*) ose titujve; dhe/ose transaksionet e bazuara në tregun e kapitaleve; vetëm nëse aplikojnë metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar.

2. Bankat njohin efektet e marrëveshjeve tip të netimit që mbulojnë transaksionet e riblerjes; dhe/ose transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së mallrave (*commodities*) ose të titujve; dhe/ose transaksionet e bazuara në tregun e kapitaleve; vetëm nëse kolaterali i marrë dhe titujt ose mallrat (*commodities*) e huazuara nëpërmjet këtyre marrëveshjeve, plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenet 49 dhe 50.

3. Kërkesat e paragrafit 2 të këtij neni nuk bien ndesh me detyrimin e bankës për të zbatuar kërkesat e kreut VI.

Neni 73

Marrëveshjeve tip të netimit - Kërkesat minimale

1. Bankat njohin si teknikë të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë marrëveshjet tip të netimit që mbulojnë transaksionet e riblerjes, transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së titujve ose të mallrave (*commodities*) dhe/ose transaksionet e tjera të bazuara në tregun e kapitalit, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) të jenë ligjërisht efektive dhe të zbatueshme në të gjitha juridiksionet përkatëse, duke përfshirë edhe rastin e paaftësisë paguese ose falimentimit të kundërpartisë;

b) t'i japin palës që nuk ka dështuar (*solvent*-e) të drejtën për të ndërprerë në kohën e duhur të gjitha transaksionet sipas marrëveshjes, në rastin e ndodhjes së dështimit (*default*), duke përfshirë rastin e falimentimit apo të paaftësisë paguese të kundërpartisë;

c) të mundësojë netimin e fitimeve dhe humbjeve në transaksionet e mbyllura/të përfunduara në bazë të një marrëveshjeje tip, në mënyrë që të përftohet një shumë e vetme neto, e cila të përfaqësojë detyrimin e njërës palë kundrejt tjetrës; si dhe

d) përveç sa përcaktohet në shkronjat "a" deri në "c" të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përmbushen dhe kërkesat minimale për njohjen e kolateralit financiar sipas metodës gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar të përcaktuara në nenin 49.

2. Marrëveshjet tip të netimit që mbulojnë transaksionet e riblerjes; dhe/ose transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së mallrave (*commodities*) ose titujve; dhe/ose transaksionet e bazuara në tregun e kapitaleve të cilat rregullojnë netimin midis pozicioneve në librin e bankës dhe pozicioneve në librin e tregtueshëm; mund të njihen për qëllime të llogaritjes së kërkesave për kapital për rrezikun e kundërpartisë, nëse transaksionet e netuara përmbushin kushtet e mëposhtme:

a) të gjitha transaksionet vlerësohen nëpërmjet metodës *mark-to-market* me frekuencë ditore;

b) të gjitha instrumentet e marra hua, blerë, ose të marrë në kuadrin e transaksioneve të mbuluara nga marrëveshja tip e netimit, njihen si kolateral i pranueshëm sipas përcaktimeve të këtij nënkreu, por pa aplikuar kërkesat e nenit 50, paragrafi 2 dhe 3, dhe nenit 62, paragrafi 7.

Neni 74

Marrëveshjet tip të netimit - Rregullimet mbikëqyrëse të luhatshmërisë/vlerësimet e veta të rregullimeve të luhatshmërisë

1. Bankat, në përllogaritjen e vlerës së ekspozimit plotësisht të rregulluar (E*), për ekspozimet që janë subjekt i një marrëveshjeje tip netimi të pranueshme, që mbulon transaksionet e riblerjes; dhe/ose transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së mallrave (*commodities*) ose titujve; dhe/ose transaksionet e bazuara në tregun e kapitaleve; aplikojnë rregullimet e luhatshmërisë sipas metodës mbikëqyrëse të rregullimeve të luhatshmërisë ose metodës së vlerësimeve të veta të rregullimeve të luhatshmërisë, siç përcaktohet në nenet 61 deri në 66.

2. Bankat, në rastin e përdorimit të metodës së vlerësimeve të veta të luhatshmërisë, zbatojnë të njëjtat kushte dhe kërkesa si ato që zbatohen në metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar.

Neni 75

Marrëveshjet tip të netimit - Llogaritja e vlerës plotësisht të rregulluar të ekspozimit

1. Bankat llogarisin pozicionin neto të çdo lloj titulli ose malli (*commodity*), duke zbritur nga vlera totale e titujve ose mallrave (*commodities*) të atij lloji, të dhëna hua, të shitura ose të dhëna nën marrëveshjen tip të netimit, vlerën totale të titujve ose mallrave (*commodities*) të atij lloji, të marra hua, të blera ose të marra sipas marrëveshjes.

2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni "lloje titujsh" do të konsiderohen titujt që janë emetuar nga i njëjti entitet, që kanë të njëjtën datë emetimi, të njëjtin maturitet dhe u nënshtrohen të njëjtave afate, kushte dhe periudha likuidimi, siç përcaktohet në nenet 61 deri në 66.

3. Bankat llogarisin pozicionin neto në çdo monedhë të ndryshme nga monedha e shlyerjes së marrëveshjes tip të netimit, duke zbritur nga shuma e vlerës totale të titujve të denominuar në atë monedhë të dhënë hua, të shitur ose të dhënë sipas marrëveshjes tip të netimit dhe vlerës së *cash*-it, në atë monedhë të dhënë ose të transferuara sipas marrëveshjes, shumën e vlerës totale të titujve të denominuar në atë monedhë, të marra hua, blerë ose përftuar sipas marrëveshjes dhe vlerës së *cash*-it në atë monedhë të marrë hua ose përftuar sipas marrëveshjes.

4. Bankat aplikojnë rregullimin e luhatshmërisë të përshtatshëm për një lloj të dhënë titulli ose pozicioni në *cash*, mbi vlerën absolute të pozicionit neto pozitiv ose negativ, në titujt e atij lloji.

5. Bankat aplikojnë rregullimin e luhatshmërisë për rrezikun e kursit të këmbimit (fx) mbi pozicionin neto pozitiv ose negativ, në çdo monedhë të ndryshme nga monedha e shlyerjes së marrëveshjes tip të netimit.

6. Bankat llogarisin vlerën plotësisht të rregulluar të ekspozimit (E*), siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$E^* = \max \{0, [(\sum(E) - \sum(C)) + \sum(|\text{pozicioni neto për çdo lloj titulli}| \times H_{sec}) + (\sum|E_{fx}| \times H_{fx})]\},$$

ku:

E* - është vlera e ekspozimit plotësisht e rregulluar;

E - është vlera e ekspozimit për çdo ekspozim të veçantë, sipas marrëveshjes që do të zbatohej në mungesë të mbrojtjes së kredisë;

C - është vlera e titujve ose mallrave (*commodities*) të marrë hua, blerë ose përftuar ose *cash*-it të marrë hua ose përftuar lidhur me çdo ekspozim të tillë;

$\sum(E)$ - është shuma e të gjitha E-ve, sipas marrëveshjes;

$\sum(C)$ - është shuma e të gjitha C-ve, sipas marrëveshjes;

H_{sec} - është rregullimi i luhatshmërisë, i përshtatshëm për një lloj të veçantë titulli;

E_{fx} - është pozicioni neto (pozitiv ose negativ) në një monedhë të dhënë, të ndryshme nga monedha e shlyerjes së marrëveshjes, të përllogaritur sipas paragrafit 3 të këtij neni;

H_{fx} - është rregullimi i luhatshmërisë së kursit të këmbimit.

Neni 76

Marrëveshjet tip të netimit - Llogaritja e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun

Bankat do të konsiderojnë si vlerë ekspozimi, të ekspozimit ndaj kundërpartisë që buron nga transaksionet që u nënshtrohen marrëveshjeve tip të netimit, vlerën plotësisht të rregulluar të ekspozimit (E*), të llogaritur sipas nenit 75.

Neni 77

Mbrojtje të tjera të financuara të kredisë – Pranueshmëria

1. Bankat njohin si kolateral të pranueshëm për zbutjen e rrezikut të kredisë, depozitën/at në *cash* ose certifikata të depozitave apo instrumente të ngjashme me to, e

mbajtur pranë një institucioni tjetër/palë e tretë sipas një marrëveshjeje depozituese jokujdestarie dhe të lënë peng në favor të institucionit që ka dhënë kredinë.

2. Bankat njohin si kolateral të pranueshëm për zbutjen e rrezikut të kredisë edhe policat e sigurimit të jetës, të lëna si garanci në favor të tyre (bankave).

3. Bankat njohin si kolateral të pranueshëm për zbutjen e rrezikut të kredisë edhe instrumentet e lëshuara nga një institucion tjetër/palë e tretë, të cilat do të riblihen nga po ky institucion, mbi bazën e një kërkese.

Neni 78

Mbrojtje të tjera të financuara të kredisë – Kërkesat minimale

1. Bankat njohin si kolateral të pranueshëm për zbutjen e rrezikut të kredisë (sipas trajtimit të parashtruar në nenin 77 paragrafi 1 depozitën/at në *cash* ose certifikata të depozitave apo instrumente të ngjashme me to, të mbajtura pranë një institucioni tjetër/palë e tretë, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) e drejta/pretendimi i kredimarrësit ndaj institucionit tjetër/palës së tretë duhet të jetë lënë peng në mënyrë të qartë në favor të bankës kredidhënëse ose t'i jetë transferuar bankës kredidhënëse, si dhe ky peng ose transferim duhet të jetë i vlefshëm nga pikëpamja ligjore dhe i zbatueshëm në të gjitha juridiksionet përkatëse;

b) institucioni tjetër/pala e tretë duhet të njoftohet mbi pengun ose transferimin;

c) si rezultat i njoftimit, institucioni tjetër/pala e tretë duhet të jetë në gjendje të kryejë pagesat vetëm ndaj bankës kredidhënëse ose palëve të tjera, me lejen e bankës kredidhënëse; dhe

d) pengu ose transferimi është i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

2. Bankat njohin si teknika të pranueshme për zbutjen e rrezikut të kredisë, policat e sigurimit të jetës të lëna peng në favor të tyre (bankave kredidhënëse), vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) polica e sigurimit të jetës duhet të jetë lënë peng ose të jetë transferuar në favor të bankës kredidhënëse;

b) shoqëria e sigurimit që ofron sigurimin e jetës, duhet të njoftohet lidhur me lënien peng ose transferimin e tij në favor të bankës, dhe si rezultat shoqëria e sigurimit nuk do të mund të paguajë shumat e pagueshme sipas kontratës, pa lejen e bankës kredidhënëse;

c) banka kredidhënëse ka të drejtë të anulojë policën dhe të marrë vlerën e dorëzimit në rast dështimi (default) të kredimarrësit;

d) banka kredidhënëse duhet të informohet nga mbajtësi i policës së sigurimit, mbi çdo moskryerje pagese sipas policës;

e) mbrojtja ndaj rrezikut të kredisë duhet të ofrohet për një periudhë kohore që përputhet me maturitetin e kredisë. Në rastet kur kjo nuk është e mundur sepse marrëdhënia siguruese përfundon përpara se të maturohet kredia, banka duhet të sigurojë se shuma që buron nga kontrata e sigurimit, i shërben bankës si mbrojtje, deri në fund të kohëzgjatjes së marrëveshjes së kredisë;

f) pengu ose transferimi i tij duhet të jenë ligjërisht të vlefshëm dhe të zbatueshëm në të gjitha juridiksionet që janë të lidhura me marrëveshjen e kredisë në momentin e lidhjes/nënshkrimit të saj;

g) vlera e dorëzimit deklarohet nga shoqëria që ofron sigurimin e jetës dhe, në çdo rast, nuk mund të pakësohet/zvogëlohet;

h) vlera e dorëzimit duhet të paguhet në kohën e duhur sipas kërkesës;

i) vlera e dorëzimit nuk mund të kërkohet pa lejen e bankës;

j) shoqëria që ofron sigurimin e jetës është subjekt i ligjit nr. 9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", i

ndryshuar, ose subjekt i mbikëqyrjes nga një autoritet kompetent i një vendi të tretë, që zbaton standarde mbikëqyrëse dhe rregullatore, të paktën ekuivalente me ato të zbatueshme në Shqipëri.

3. Bankat, për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, përdorin instrumentet e riblera sipas kërkesës, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) institucioni emetues ka një vlerësim kredie nga një ECAI, që sipas përcaktimeve të Bankës së Shqipërisë, është ekuivalent me shkallën 1 të cilësisë së kredisë, sipas kërkesave për ponderimin me rrezikun të ekspozimeve ndaj institucioneve, në kreun III të rregullores;

b) institucioni emetues duhet të provojë se instrumentet janë mjaftueshëm likuide.

Neni 79

Llogaritja e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun - Depozitat në *cash* ose certifikatat e depozitave apo instrumente të ngjashme me to të mbajtura pranë një institucioni tjetër/palë e tretë

Bankat trajtojnë si garanci nga një institucion tjetër/palë e tretë, rastet e teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, që përcaktohen në nenin 78 paragrafi 1 dhe që plotësojnë kushtet e vendosura në nënkreun III (mbrojtja e pafinancuar e kredisë).

Neni 80

Llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezik - Policat e sigurimit të jetës të lëna peng në favor të bankës huadhënëse

1. Bankat ponderojnë me peshat e rrezikut siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, pjesën e ekspozimit të kolateralizuar, me vlerën korente të dorëzimit të policave të sigurimit të jetës, të lëna peng në favor të bankës huadhënëse, në rast se plotësohen kushtet e vendosura në nenin 78 paragrafi 2.

2. Bankat, për qëllime të zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, duke u bazuar në peshën e rrezikut që i është vendosur një ekspozimi të pasiguruar *senior*, ndaj shoqërisë së sigurimit që ofron sigurimin e jetës, përcakton peshat e mëposhtme të ponderimit me rrezikun:

a) 20%, në rastin kur për ekspozimin e pasiguruar *senior* ndaj shoqërisë që ofron sigurimin e jetës është caktuar një peshë rreziku prej 20%;

b) 35%, në rastin kur për ekspozimin e pasiguruar *senior* ndaj shoqërisë që ofron sigurimin e jetës është caktuar një peshë rreziku prej 50%;

c) 70%, në rastin kur për ekspozimin e pasiguruar *senior* ndaj shoqërisë që ofron sigurimin e jetës është caktuar një peshë rreziku prej 100%;

d) 150%, në rastin kur për ekspozimin e pasiguruar *senior* ndaj shoqërisë që ofron sigurimin e jetës është caktuar një peshë rreziku prej 150%.

3. Bankat, për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, në rastin e mospërputhjes së monedhave midis ekspozimit dhe mbrojtjes së njohur të kredisë, reduktojnë vlerën korente të dorëzimit, siç përcaktohet në nenin 91.

Neni 81

Llogaritja e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun - Instrumente të institucioneve të riblera sipas kërkesës

1. Bankat trajtojnë si garanci nga institucioni emetues, sipas përcaktimeve të nënkreut III (Mbrojtja e pafinancuar e kredisë), instrumentet e pranuar në përputhje me kushtet e vendosura në nenin 78, paragrafi 3.

2. Bankat përcaktojnë vlerën e mbrojtjes së njohur të kredisë, si më poshtë:

a) në rastin kur instrumenti do të riblihet me vlerën e tij nominale, vlera e mbrojtjes do të jetë ekuivalente me këtë shumë (vlerën nominale);

b) në rastin kur instrumenti do të riblihet me çmimin e tregut, vlera e mbrojtjes do të jetë vlera e instrumentit, e vlerësuar në të njëjtën mënyrë si titujt e borxhit të specifikuar në nenin 49, paragrafi 5.

NËNKREU III
MBROJTJA E PAFINANCUAR E KREDISË

Neni 82
Të përgjithshme

1. Bankat njohin si mbrojtje të pafinancuar kredie vetëm ofruesit e mbrojtjes dhe llojet e marrëveshjeve të mbrojtjes së kredisë, të përcaktuara në këtë nënkre.

2. Bankat, në rastin e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, në mënyrë që ofruesi i mbrojtjes së kredisë të jetë i pranueshëm, sigurohen se ai (ofruesi i mbrojtjes) është i besueshëm, dhe marrëveshjet e mbrojtjes janë ligjërisht efektive dhe të zbatueshme në juridiksionet përkatëse, për të dhënë siguri të mjaftueshme mbi mbrojtjen e kredisë së arritur.

3. Bankat përdorin format e mëposhtme si teknika të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë:

a) garancinë;

b) kundërgarancinë ose marrëveshje të tjera ligjore, që kanë të njëjtat efekte ligjore si kundërgarancitë (të referuara më poshtë si kundërgaranci);

c) derivativët e kredisë.

Neni 83
Pranueshmëria e ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, sipas të gjitha metodave

1. Bankat njohin subjektet e mëposhtme, si ofrues të pranuar të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë:

a) qeveritë qendrore dhe bankat qendrore;

b) qeveritë rajonale dhe autoritetet lokale;

c) bankat shumëpalëshe të zhvillimit;

d) organizatat ndërkombëtare, ekspozimeve ndaj të cilave, sipas kreut III të rregullores, u përcaktohet një peshë rreziku prej 0%;

e) njësitë e sektorit publik, ekspozimet/të drejtat ndaj të cilave, sipas kreut III të rregullores, trajtohen nga Banka e Shqipërisë, si ekspozime/të drejta ndaj bankave dhe shoqërive të investimit ose qeverive qendrore;

f) institucionet e mbikëqyrura; dhe

g) shoqëritë e tjera tregtare, të cilat përfshijnë dhe mëmën, degët dhe shoqëri të lidhura me bankën (filialet), të cilat sipas përcaktimeve në kreun III të rregullores për ponderimin me rrezikun të ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare, kanë një vlerësim nga një ECAI e pranuar, i cili korrespondon me cilësinë e kredisë shkalla 2 ose më lart.

2. Banka e Shqipërisë, duke bërë përjashtim nga përcaktimet e paragrafit 1 të këtij neni, mund të njohë si ofrues të pranueshëm të mbrojtjes së pafinancuar edhe institucione të tjera financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura nga autoritetet e tjera kompetente përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe që u nënshtrohen kërkesave prudenciale, ekuivalente me ato, të cilave u nënshtrohen bankat dhe shoqëritë e investimit.

Neni 84
Pranueshmëria e derivativëve të kreditit

1. Bankat njohin për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë, llojet e mëposhtme të derivativëve të kredisë, si dhe instrumentet që mund të përbëhen nga derivativë të tillë ose që janë efektivisht të ngjashëm nga pikëpamja ekonomike me to:

a) *credit defaultswaps* (CDS);

b) *total returnswaps* (TRS); dhe

c) *credit linked notes* (CLN), në masën e financimit të tyre me *cash*.

2. Bankat, në rastin kur blejnë mbrojtje kredie nëpërmjet një TRS-je dhe i regjistrojnë pagesat neto të marra nga *swap*-i si të ardhura neto, por nuk regjistrojnë kompensimin për rënien e vlerës së aktivit bazë (ose nëpërmjet reduktimit të vlerës së tregut ose nëpërmjet shtimit të rezervave), nuk do të njohin mbrojtjen e kredisë si të pranueshme.

Neni 85

Mbrojtjet e brendshme (*Internal hedges*)

1. Bankat, në rastet kur kryejnë mbrojtje të brendshme kredie, duke përdorur derivativët e kredisë (domethënë mbulojnë rrezikun e kredisë së një ekspozimi në librat e bankës, me një derivativ të kontabilizuar në portofolin e tregtueshëm), në mënyrë që mbrojtja të njihet si e pranueshme për qëllimet e këtij kreu, rrezikun e kredisë të transferuar në portofolin e tregtueshëm duhet ta transferojnë te një ose disa palë të treta.

2. Bankat, në referencë të paragrafit 1 të këtij neni, me kusht që një transferim i tillë të përmbushë kërkesat për njohjen e zbutjes së rrezikut të kredisë të përcaktuara në këtë kre, zbatojnë rregullat për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun që aplikohen në rastin e përftimit të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë.

Neni 86

Kërkesat minimale të përbashkëta për garancitë dhe derivativët e kredisë

1. Bankat njohin si teknika të zbutjes së rrezikut të kredisë, një garanci ose një derivativ kredie, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) mbrojtja e kredisë të jetë e drejtpërdrejtë;

b) shkalla e mbrojtjes së kredisë duhet të përcaktohet qartë dhe në mënyrë të pakundërshtueshme (*non controvertible*);

c) kontrata e mbrojtjes së kredisë nuk duhet të përmbajë ndonjë dispozitë, përmbushja e të cilës është jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të kredidhënësit, dispozitë që:

i) do të lejonte që ofruesi i mbrojtjes të anulonte mbrojtjen në mënyrë të njëanshme;

ii) do të rriste koston efektive të mbrojtjes si rezultat i përkeqësimit të cilësisë së kredisë që i përgjigjet ekspozimit të mbrojtur;

iii) mund të pengojë ofruesin e mbrojtjes të përmbushë detyrimin për të paguar në kohën e duhur, në rast se debitori fillestar nuk arrin të kryejë pagesat e maturuara; ose

iv) mund të lejonte që maturiteti i mbrojtjes së kredisë të reduktohej nga ofruesi i mbrojtjes;

d) kontrata duhet të jetë ligjërisht efektive dhe e zbatueshme në të gjitha juridiksionet që janë të lidhura me marrëveshjen e kredisë në kohën e lidhjes/nënshkrimit të saj.

2. Bankat zhvillojnë sisteme për administrimin e rrezikut të mundshëm të përqendrimit, që lind nga përdorimi i garancive dhe derivativëve të kredive, si teknika për zbutjen e rrezikut të kredisë.

3. Bankat sigurojnë që strategjitë e tyre mbi përdorimin e derivativëve të kredisë dhe garancive, lidhen/ndërveprojnë efektivisht me administrimin e profilit të tyre të përgjithshëm të rrezikut.

Neni 87

Kërkesat minimale për kundërgarancitë e qeverive qendrore ose bankave qendrore dhe të tjera kundërgaranci të sektorit publik

(ndryshuar fjalë në pikat 1 dhe 2 me vendimin nr.7, datë 5.2.2020)

1. Bankat, në rastet kur një ekspozim është i mbrojtur nga një garanci, e cila është kundërgarantuar nga një qeveri qendrore apo bankë qendrore; nga një qeveri rajonale apo autoritet lokal; nga një njësi e sektorit publik, ekspozimet ndaj së cilës, sipas kreut III të rregullores, janë trajtuar si ekspozime ndaj qeverisë qendrore, në juridiksionin e të cilëve ato janë krijuar (themeluar); një bankë shumëpalëshe zhvillimi apo një organizatë ndërkombëtare, për të cilën sipas kreut III të rregullores, është caktuar një peshë rreziku 0%; ose një ekspozimet ndaj së cilës, sipas nenit 14, paragrafët 1, 2 dhe 3 të rregullores, ponderohen bazuar në cilësinë e kredisë së caktuar për ekspozimet ndaj qeverisë qendrore ose janë trajtuar si ekspozime ndaj institucioneve të mbikëqyrura; mund të trajtojnë ekspozimin si të mbrojtur nga një garanci e ofruar nga subjekti në fjalë, me kusht që të plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) kundërgarancia të mbulojë të gjitha elementet e rrezikut të kredisë të ekspozimit;

b) garancia origjinale dhe kundërgarancia të plotësojnë kërkesat për garancitë e përcaktuara në nenet 86 dhe 88, duke bërë përjashtim nga paragrafi 1 pika “a”, në nenin 86 (domethënë kundërgarancia nuk ka nevojë të jetë e drejtpërdrejtë); dhe

c) mbrojtja është rigoroze dhe të dhënat historike tregojnë se mbulimi i siguruar nga kundërgarancia është të paktën i barabartë me atë të një garancie të drejtpërdrejtë nga i njëjti subjekt.

2. Bankat zbatojnë trajtimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni edhe për një ekspozim i cili nuk është garantuar nga një kundërgaranci e subjekteve të listuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse vetë kundërgarancia e ofruar nga një subjekt tjetër për këtë ekspozim, është e garantuar drejtpërdrejt nga një prej subjekteve të listuara në këtë paragraf dhe janë plotësuar kushtet e përcaktuara aty.

Neni 88

Kërkesa të tjera për garancitë

(ndryshuar fjalë në pikën 2 me vendimin nr.7, datë 5.2.2020)

1. Bankat, përveç kërkesave të përcaktuara në nenin 86, njohin garancitë si teknika të pranueshme të zbutjes së rrezikut të kredisë, vetëm nëse plotësohen edhe kushtet e mëposhtme:

a) në rast të dështimit (*default*) ose të mospagesës nga ana e kundërpartisë, banka kredidhënëse, duhet të ketë të drejtën të kërkojë pagesën nga garantuesi, në kohën e duhur, për çdo shumë parash që i përgjigjet mbrojtjes së ofruar (pagesa nga garantuesi duhet të kryhet pa pasur nevojë që banka kredidhënëse të ndjekë fillimisht debitorin për kryerjen e pagesës sipas afatit të maturimit);

b) në rastin e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë që mbulon kreditë hipotekare rezidenciale, kërkesat në nenin 86, paragrafi 1, shkronja “c”, nënpika “iii”, dhe shkronjën “a” të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të plotësohen brenda 24 muajve (pra, në rast të dështimit dhe/ose mospagimit nga kundërpartia, banka kredidhënëse ka të drejtën të ekzekutojë kolateralin dhe, në rast se ky proces dështon, aktivizohet pagesa, në përputhje me garancinë dhe banka ndjek garantuesin, për shumat që ky i fundit i detyrohet brenda 24 muajve);

c) garancia duhet të dokumentojë në mënyrë të qartë detyrimin e marrë përsipër nga garantuesi; dhe

d) garancia duhet të mbulojë të gjitha llojet e pagesave që debitori pritet të bëjë në lidhje me detyrimin dhe në rastet kur lloje të caktuara të pagesave janë të përjashtuara nga garancia, vlera e njohur e garancisë duhet të korrektohet/rregullohet, me qëllim që të

pasqyrohet vlera e saktë e mbulimit.

2. Banka e Shqipërisë, në rastin e garancive të ofruara në kuadër të skemave të ndërsjella të garantimit, të njohura për këto qëllime nga Banka e Shqipërisë ose të ofruara apo kundërgarantuara nga subjektet e referuara në paragrafin 1 të nenit 87, i konsideron të plotësuara kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni (neni 88), shkronjat "a" dhe "b", nëse bankat plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

a) banka kredidhënëse, në proporcion me mbulimin e garancisë, ka të drejtën të marrë në kohën e duhur një pagesë të përkohshme nga garantuesi, që përfaqëson një vlerësim rigoroz të humbjes ekonomike, duke përfshirë humbjet që mund të pësojë banka kredidhënëse, si rezultat i mospagimit të interesit dhe llojeve të tjera të pagesës që kredimarrësi është i detyruar të kryejë;

b) banka kredidhënëse, mund të vërtetojë se efektet mbrojtëse të garancisë ndaj humbjeve, duke përfshirë humbjet që rezultojnë nga mospagimi i interesit dhe llojeve të tjera të pagesave që kredimarrësi është i detyruar të bëjë, justifikojnë një trajtim të tillë.

Neni 89

Kërkesa të tjera për derivativët e kredisë

1. Bankat njohin derivativët e kredisë si teknika të zbutjes së rrezikut të kredisë, vetëm nëse plotësohen, përveç kërkesave të nenit 86, edhe kushtet e mëposhtme:

a) ngjarjet e kredisë të specifikuara për derivativët e kredisë, duhet të përfshijnë minimalisht:

i) dështimin në pagimin e shumave të detyrimit, sipas kushteve në fuqi për detyrimin referencë në kohën e ndodhjes së dështimit (me një *grace period* të afërt ose më të shkurtër se *grace period* e aktivit bazë);

ii) falimentimin, paaftësinë paguese të debitorit për të paguar borxhet ose dështimin e tij, apo pranimin me shkrim të paaftësisë së tij për të paguar borxhet kur këto maturohen dhe/ose ngjarje analoge me to; dhe

iii) ristrukturimin e aktivit bazë, që përfshin faljen apo shtyrjen e kryegjësë, interesit apo komisioneve, të cilat rezultojnë në një ngjarje që shkakton humbje kredie (si për shembull krijimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve etj.);

b) në rastet kur ngjarjet e kredisë, të specifikuara për derivativët e kredisë në shkronjën "a" të paragrafit 1 të këtij neni, nuk përfshijnë ristrukturimin e aktiveve bazë, sipas nënpikës "iii", mbrojtja e kredisë njihet duke marrë në konsideratë një zvogëlim të vlerës së njohur, sipas përcaktimeve të paragrafit 3 të nenit 90;

c) në rastet kur derivativët e kredisë lejojnë shlyerjen në *cash*, bankat duhet të zhvillojnë një proces të kujdesshëm për vlerësimin e besueshëm të humbjeve, si dhe të përcaktojnë në mënyrë të qartë periudhën e kohës, për përftimin e vlerësimit të aktivit bazë, pas ndodhjes së ngjarjes së kredisë;

d) në rastet kur shlyerja kushtëzohet nga fakti që blerësi i mbrojtjes ka të drejtën dhe aftësinë për të transferuar aktivin bazë tek ofruesi i mbrojtjes, kushtet e aktivit bazë duhet të sigurojnë se miratimi i kërkuar, për një transferim të tillë, nuk duhet të refuzohet pa arsye;

e) duhet të identifikohen në mënyrë të qartë palët përgjegjëse për të vendosur nëse ka ndodhur një ngjarje kredie. Ky përcaktim (nëse ka ndodhur ose jo një ngjarje kredie) nuk duhet të jetë përgjegjësi e vetme e ofruesit të mbrojtjes. Blerësi i mbrojtjes duhet të ketë të drejtën/aftësinë për të informuar ofruesin e mbrojtjes për ndodhjen e një ngjarje kredie.

2. Mospërputhjet midis aktivit bazë dhe detyrimit referencë nën derivativin e kredisë (që do të thotë, detyrimi i përdorur për qëllime të përcaktimit të vlerës së shlyerjes *cash* ose të detyrimit që do të dorëzohet), ose ndërmjet aktivit bazë dhe detyrimit të përdorur për përcaktimin, nëse ka ndodhur një ngjarje kredie, janë të lejueshme vetëm në rast se

përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) detyrimi referencë ose detyrimi i përdorur për të përcaktuar nëse ka ndodhur një ngjarje kredie, sipas rastit, ka të njëjtën përparësi shlyerje ose një përparësi më të ulët shlyerje se aktivi bazë; dhe

b) aktivi bazë dhe detyrimi referencë ose sipas rastit, detyrimi i përdorur për të përcaktuar nëse një ngjarje kredie ka ndodhur, i referohen të njëjtit debitor (entitet ligjor) dhe ekzistojnë klauzola ndërfalimentuese (*cross-default*) dhe ndërshpejtuese (*cross-acceleration*), ligjërisht të zbatueshme.

Neni 90

Vlerësimi i mbrojtjes së pafinancuar të kredisë

1. Bankat përcaktojnë vlerën e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë (G), si shumë që ofruesi i mbrojtjes ka marrë përsipër të paguajë në rast dështimi ose mospagesë nga ana e huamarrësit ose në rast të materializimit të ngjarjeve të tjera të kredisë, të përcaktuara sipas kontratës.

2. Bankat trajtojnë *credit linked notes*, të emetuara prej tyre dhe të pranuara më tej si mbrojtje kredie, si kolateral në *cash*, dhe vlerësimi e llogaritja e efekteve të tyre kryhet në përputhje me nenin 52.

3. Bankat, në rastin e derivativëve të kredisë, të cilët nuk përfshijnë si ngjarje kredie ristrukturimin e aktivit bazë që përfshin faljen ose shtyrjen e kryegjësë, interesit apo komisioneve që rezultojnë në një ngjarje humbjeje të kredisë (për shembull rregullim vlere, krijimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga rreziku i kredisë ose debitime të tjera të ngjashme në llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve), bëjnë rregullimin e shumës së derivativëve, siç përcaktohet më poshtë:

a) nëse shuma që ofruesi i mbrojtjes ka marrë përsipër të paguajë nuk është më e lartë se vlera e ekspozimit, vlera e mbrojtjes së kredisë (G), do të reduktohet me 40%; ose

b) nëse shuma që ofruesi i mbrojtjes ka marrë përsipër të paguajë është më e lartë se vlera e ekspozimit, vlera e mbrojtjes së kredisë që do të njihet (G) nuk do të jetë më e lartë se 60% e vlerës së ekspozimit.

Neni 91

Mospërputhja e monedhave

1. Bankat, në rastin kur mbrojtja e pafinancuar e kredisë është denominuar në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën është denominuar ekspozimi (kur ka mospërputhje monedhash), reduktojnë vlerën e mbrojtjes së kredisë, nëpërmjet zbatimit të një rregullimi luhatshmërie HFX, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$G^* = G \times (1-H_{FX}),$$

ku:

G - është vlera nominale e mbrojtjes së kredisë;

G* - është G e rregulluar për rrezikun e këmbimit valutor; dhe

H_{FX} - është rregullimi i luhatshmërisë për mospërputhjet e monedhave, ndërmjet mbrojtjes së kredisë dhe aktivit bazë.

Në rastet kur nuk ka mospërputhje monedhash, G* = G.

2. Bankat llogarisin rregullimin e luhatshmërisë për mospërputhjet e monedhave sipas metodës mbikëqyrëse për rregullimet e luhatshmërisë ose metodës së vlerësime të veta, të përcaktuara në nenet 60 deri në 66.

Neni 92

Mospërputhja e maturiteteve

1. Bankat pasqyrojnë maturitetin e mbrojtjes së kredisë dhe maturitetin e ekspozimit në vlerën e rregulluar të mbrojtjes së kredisë, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$G_A = G^* \times (t-t^*) / (T-t^*),$$

ku:

G* - është shuma e mbrojtjes e rregulluar për mospërputhjet e monedhave;

G_A - është G* e rregulluar për mospërputhjet e maturitetit;

t - është vlera më e ulët midis numrit të viteve të mbetura deri në datën e maturimit të mbrojtjes së kredisë, e llogaritur në përputhje me nenin 44, paragrafi 5 deri në 7 dhe vlerës T;

T - është vlera më e ulët midis numrit të viteve të mbetura deri në datën e maturimit të ekspozimit, e llogaritur në përputhje me nenin 44 paragrafi 5 deri në 7 dhe 5 vjet; dhe

t* - është 0,25;

G_A- do të merret si vlera e mbrojtjes për qëllime të neneve 94 dhe 95.

Neni 93

Llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun - Mbrojtja e pjesshme (segmentimi)

1. Bankat, në rastin kur transferojnë një pjesë të rrezikut të një kredie në një ose më shumë transhe, zbatojnë kërkesat e përcaktuara në kreun V.

2. Kufijtë e materialitetit, nën të cilët nuk mund të kryhen pagesa në rast humbjeje, konsiderohen si ekuivalente me pozicionet që bartin me përparësi humbjen dhe sjellin për rrjedhojë transferimin e segmentuar të rrezikut.

Neni 94

Llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun - Mbrojtja e plotë

1. Bankat, për qëllime të nenit 11, do të konsiderojnë g peshën e rrezikut që i caktohet një ekspozimi, vlera e ekspozimit (E) e të cilit, është e mbrojtur plotësisht nga mbrojtja e pafinancuar (G_A), ku:

E - është vlera e ekspozimit në bazë të nenit 9 (për këtë qëllim, vlera e ekspozimit të një zëri jashtë bilancit, të renditur në aneksin 2, do të jetë 100% e vlerës së tij dhe jo vlera e ekspozimit e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 9;

g - është pesha e rrezikut të ekspozimit ndaj ofruesit të mbrojtjes, të përcaktuar sipas kreut III të rregullores; dhe

G_A - është vlera e G*, e llogaritur sipas nenit 91, e korrektuar për çdo mospërputhje maturiteti, siç përcaktohet në nenin 92.

Neni 95

Llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezik - Mbrojtja e pjesshme (përparësi e njëjtë në shlyerje)

1. Bankat, në rastin kur shuma e mbrojtur është më e vogël se vlera e ekspozimit, dhe pjesët e mbrojtura dhe të pambrojtura kanë të njëjtin senioritet (përparësi në shlyerje), domethënë banka dhe ofruesi i mbrojtjes ndajnë humbjet në mënyrë proporcionale, mund të zbatojnë një lehtësim proporcional lidhur me kapitalin rregullator.

2. Bankat, për qëllime të nenit 11, llogarisin shumat e ekspozimit të ponderuara me rrezikun, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

$$(E-G_A) \times r + G_A \times g$$

ku:

E - është vlera e ekspozimit në bazë të nenit 9 (për këtë qëllim, vlera e ekspozimit të

një zëri jashtë bilancit, të renditur në aneksin 2, do të jetë 100% e vlerës së tij dhe jo vlera e ekspozimit e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 9);

G_A - është vlera e G*, e llogaritur sipas nenit 9, e korrektuar për mospërputhjet e maturitetit, siç përcaktohet në nenin 92;

r - është pesha e rrezikut të ekspozimeve ndaj debitorit, ashtu siç është specifikuar në kreun III të rregullores; dhe

g - është pesha e rrezikut të ekspozimeve ndaj ofruesit të mbrojtjes, siç përcaktohet sipas kreut III të rregullores.

Neni 96

Llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun - Garanci të qeverive qendrore ose bankave qendrore

Bankat, për qëllime të llogaritjeve në nenet 94 dhe 95, për ekspozimet ose pjesët e ekspozimeve të garantuara nga qeveri qendrore apo banka qendrore, kur garancia është denominuar në monedhën vendase të huamarrësit dhe ekspozimi është financuar në po atë monedhë, konsiderojnë g = 0%.

Neni 97

Derivativë të kredisë *first-to-default*

Bankat, në rastet kur marrin mbrojtje kredie për një numër ekspozimesh sipas kushteve që dështimi i parë midis ekspozimeve do të shkaktojë pagesën dhe që kjo ngjarje kredie do të sjellë zgjidhjen e kontratës, modifikojnë llogaritjen e shumës së ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, të cilat në mungesë të mbrojtjes së kredisë, në bazë të kreut III të rregullores, do të rezultonin në nivelet më të ulëta të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në përputhje me këtë kre, vetëm në qoftë se vlera e ekspozimit është më e vogël ose e barabartë me vlerën e mbrojtjes së kredisë.

Neni 98

Derivativë të kredisë *nth-to-default* (dështimi i rendit "n")

Bankat, në rastet kur dështimi i n-të midis ekspozimeve nxit kryerjen e pagesës në kuadrin e mbrojtjes së kredisë, njohin mbrojtjen për llogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, vetëm nëse është marrë/blerë mbrojtje edhe për dështimet e mundshme nga 1 në n-1 ose kur kanë ndodhur tashmë n-1 dështime. Në raste të tilla, metodologjia do të ndjekë përcaktimet e nenit 97 për derivativët *first-to-default*, të modifikuara për produktet *nth-to-default*.

KREU V

TITULLZIMI

NËNKREU I

Neni 99

Të përgjithshme

Bankat llogarisin shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun në lidhje me ekspozimet e titulluara, sipas një titullzimi tradicional dhe sintetik ose sipas një strukture që përmban tipare/karakteristika nga të dyja llojet e titullzimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë kre.

Neni 100

Trajtimi i ekspozimeve të titullzuara

1. Bankat origjinuese, në rastet kur me anë të titullzimit realizojnë një transferim të konsiderueshëm të rrezikut të kredisë në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, mund:

a) në rastin e titullzimit tradicional, të përjashtojnë ekspozimet e titullzuara nga llogaritja e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun; dhe

b) në rastin e titullzimit sintetik, të përllogarisin shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në lidhje me ekspozimet e titullzuara në përputhje me nënkreun II të këtij kreu.

2. Bankat origjinuese, në rastin kur aplikohet paragrafi 1 i këtij neni, llogarisin shumat e ekspozimit të ponderuara me rrezikun siç parashikohet në këtë kre, për pozicionet e tjera që mund të mbajnë në titullzim.

3. Bankat origjinuese, kur nuk arrijnë të transferojnë një sasi të konsiderueshme të rrezikut të kredisë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, nuk llogarisin shuma të ekspozimeve të ponderuara me rrezik për pozicionet në titullzim sipas këtij kreu, por i trajtojnë këto pozicione si të mos ishin të titullzuar, duke zbatuar dispozitat e kreut III të kësaj rregulloreje.

Neni 101

Llogaritja e vlerës së ekspozimeve të pozicioneve në titullzim

1. Bankat, për të llogaritur shumën e ekspozimit të ponderuar me rrezikun, të një pozicioni në titullzim, do t'i caktojnë vlerës së ekspozimit të pozicionit, pesha rreziku bazuar në cilësinë e kredisë së pozicionit, e cila përcaktohet mbështetur në vlerësimin e kredisë së një ECAI-je të pranuar ose në rast të kundërt, siç përcaktohet në këtë kre.

2. Bankat, do të konsiderojnë:

a) vlerë të ekspozimit të një pozicioni në titullzim brenda bilancit, vlerën e tij në bilanc;

b) vlerë të ekspozimit të një pozicioni në titullzim jashtë bilancit, vlerën e tij nominale të shumëzuar me një faktor konvertimi. (Nëse nuk specifikohet ndryshe në këtë kre, ky faktor konvertimi do të jetë 100%.)

3. Përveçse sa përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, vlera e ekspozimit të një pozicioni në titullzim që rrjedh nga një derivativ kredie të listuar në aneksin 4, përcaktohet në përputhje me kreun VI të kësaj rregulloreje.

4. Bankat, në rastet kur kanë dy ose më shumë pozicione të mbivendosura në një titullzim, deri në masën që ato mbivendosen, përfshijnë në llogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, vetëm atë pozicion apo pjesë të tij që gjeneron shumën më të madhe të ekspozimit të ponderuar me rrezikun. Për qëllime të këtij paragrafi "mbivendosje" nënkupton që pozicionet, tërësisht ose pjesërisht, përfaqësojnë një ekspozim ndaj të njëjtit rrezik, të tillë që deri në masën e mbivendosjes, përfaqësojnë një ekspozim të vetëm.

5. Bankat, në rastin kur kanë ekspozime ndaj segmenteve (transheve) të ndryshme, në një titullzim, do ta konsiderojnë ekspozimin ndaj çdo segmenti si pozicion titullzimi të veçantë. Pozicionet e titulluar, do të përfshijnë edhe ofruesit e mbrojtjes së kredisë për pozicionet e titullzimit[14], si dhe ekspozimet ndaj titullzimit, që burojnë nga kontratat e derivativëve të normave të interesit ose të monedhave.

6. Bankat, në rastet kur një pozicion në titullzim është subjekt i mbrojtjes, modifikojnë peshën e rrezikut që zbatohet për atë pozicion, në përputhje me kreun IV dhe këtë kre.

7. Bankat, në rastet kur një pozicion në titullzim është subjekt i mbrojtjes së financuar,

---

[14]Bankat që ofrojnë, nëpërmjet metodave të zbutjes së kredisë, mbrojtje nga rreziku i kredisë për pozicionet e titullzuara, konsiderohen sikur të mbanin vetë direkt pozicione në këtë titullzim.

modifikojnë vlerën e ekspozimit në përputhje me kreun IV dhe këtë kre.

Neni 102
Trajtime të veçanta prudenciale

1. Bankat sponsorizuese ose bankat origjinuese, të cilat lidhur me një titullzim, kanë shfrytëzuar hapësirat e nenit 100 në llogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, nuk lejohen që për qëllime të zvogëlimit të humbjeve të mundshme dhe aktuale të investitorëve, të ofrojnë mbështetje për titullzimin përtej detyrimeve kontraktore (mbështetje jokontraktuale).

2. Bankat origjinuese ose sponsorizuese, të cilat nuk janë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni lidhur me një titullzim, duhet që:

a) të mbajnë nivele kapitali për të gjitha ekspozimet e titullzuara, sikur këto ekspozime të mos ishin titullzuar;

b) të publikojnë se kanë dhënë mbështetje jokontraktuale, si dhe efektin në kapital, të këtij veprimi.

3. Banka e Shqipërisë vendos masa të kujdesshme (prudenciale) mbi origjinuesin dhe/ose sponsorin, të cilët në mënyrë të vazhdueshme ofrojnë mbështetje jokontraktuale.

NËNKREU II
KËRKESAT MINIMALE PËR NJOHJEN E TRANSFERIMIT TË PJESËS SË KONSIDERUESHME TË RREZIKUT TË KREDISË DHE PËR LLOGARITJEN E SHUMAVE TË EKSPOZIMIT, TË PONDERUARA ME RREZIKUN

Neni 103
Kërkesa minimale për njohjen e transferimit të pjesës së konsiderueshme të rrezikut të kredisë, në një titullzim tradicional

1. Bankat origjinuese të një titullzimi tradicional, mund të përjashtojnë ekspozimet e titullzuara nga përllogaritja e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, nëse plotësohet një prej kushteve të mëposhtme:

a) një pjesë e rëndësishme e rrezikut të kredisë, e lidhur me ekspozimet e titullzuara, konsiderohet e transferuar në palë të treta;

b) banka origjinuese ponderon, me peshën e rrezikut 1250%, të gjitha pozicionet që ajo mban në këtë titullim ose i zbret këto pozicione përbërëse të titullzimit nga kapitali rregullator.

2. Bankat, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë konstaton se reduktimi i mundshëm i shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, të cilat banka origjinuese do t'i arrinte nëpërmjet këtij titullzimi, nuk justifikohet nga një transferim proporcional i rrezikut të kredisë drejt palëve të treta, konsiderojnë se pjesa e rëndësishme e rrezikut të kredisë është transferuar në palë të treta, nëse plotësohet njeri prej kushteve të mëposhtme:

a) shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për pozicionet e titullzimit *mezzanine*, të mbajtura nga banka origjinuese në këtë titullzim, janë më pak se 50% e

shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezik për të gjitha pozicionet *mezzanine* në këtë titullzim;

b) kur nuk ka pozicione *mezzanine* dhe banka origjinuese vërteton se vlera e ekspozimit të pozicioneve të titullzimit, që do të ishte subjekt i zbritjeve nga kapitali rregullator ose i një peshe rreziku prej 1250%, tejkalon me një marzh të konsiderueshëm, një vlerësim të arsyeshëm të humbjeve të pritshme ndaj ekspozimeve të titullzuara, banka origjinuese nuk mban më shumë se 20% të vlerave të ekspozimit të pozicioneve të titullzimit, që do të ishin subjekt i zbritjes nga kapitali rregullator ose i një peshe rreziku prej 1250%.

3. Banka e Shqipërisë, pa rënë në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, njeh/pranon transferimin e pjesës së konsiderueshme të rrezikut të kredisë në palë të treta, vetëm nëse krijon bindjen për cilësinë e politikave dhe metodologjive të bankës, të cilat sigurojnë se reduktimi i mundshëm i kërkesave për kapital që arrin origjinuesi nëpërmjet titullzimit, justifikohet nga një transferim proporcional i rrezikut të kredisë drejt palëve të treta. Banka e Shqipërisë krijon këtë bindje vetëm nëse banka origjinuese vërteton se një transferim i tillë i rrezikut të kredisë drejt palëve të treta, njihet, gjithashtu, për qëllime të administrimit të brendshëm të rrezikut të bankës dhe të shpërndarjes së brendshme të kapitalit.

4. Bankat, përveç sa përcaktohet në paragrafët 1 deri në 4 të këtij neni, që pjesa e konsiderueshme e rrezikut të kredisë të njihet si e transferuar në palë të treta, duhet të sigurojnë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) dokumentacioni i titullzimit të pasqyrojë qëllimin ekonomik të transaksionit;

b) banka origjinuese dhe kreditorët e saj të mos kenë të drejta mbi ekspozimet e titullzuara, përfshirë rastet e kujdestarisë ose likuidimit (origjinuesi duhet ta demonstrojë këtë me anë të një opinioni ligjor të kualifikuar);

c) titujt e emetuar të mos përfaqësojnë detyrime pagesash për bankën origjinuese;

d) shoqëria, drejt së cilës kryhet transferimi, të jetë një entitet me qëllim të posaçëm (SPV);

e) banka origjinuese të mos ushtrojë kontroll efektiv ose indirekt mbi ekspozimet e transferuara. Banka origjinuese do të konsiderohet se ushtron kontroll efektiv mbi ekspozimet e transferuara, nëse ajo ka të drejtë të riblejë nga shoqëria drejt së cilës është kryer transferimi, ekspozimet e transferuara më parë, në mënyrë që të marrë përfitimet e tyre ose nëse është e detyruar të rimarrë përsipër rrezikun e transferuar (mbajtja e të drejtave ose detyrimeve të shërbimit (*servicing*), lidhur me ekspozimet nga ana e bankës origjinuese, nuk përbën në vetvete kontroll indirekt të ekspozimeve);

f) në rastet kur ekziston një opsion *clean-up call*, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) opsioni të jetë i ushtrueshëm sipas gjykimit të bankës origjinuese;

ii) opsioni mund të ushtrohet vetëm kur 10% ose më pak, e vlerës origjinale të ekspozimeve të titullzuara mbetet e paamortizuar; dhe

iii) opsioni nuk është i strukturuar në mënyrë të tillë që të mund të shmangë shpërndarjen e humbjeve te pozicionet, të cilave u është siguruar një përmirësim i cilësisë së kredisë (*credit enhancement positions*) ose në pozicione të tjera të mbajtura nga investitorët dhe opsioni nuk është strukturuar me qëllim rritjen e cilësisë së kredisë; si dhe

g) dokumentacioni i titullzimit të mos përmbajë klauzola të cilat:

i) përveç rastit të kërkesave për amortizim të hershëm, kërkojnë që pozicionet në titullzim të përmirësohen nga banka origjinuese, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në ndryshimin e ekspozimeve përkatëse të kredisë ose rritjen e kthimit (*yield*-it) të pagueshëm investitorëve, në përgjigje të një përkeqësimi të cilësisë së kredisë së ekspozimeve të titullzuara; ose

ii) rrisin kthimin e pagueshëm ndaj mbajtësve të pozicioneve, në titullzim, në përgjigje të një përkeqësimi të cilësisë së kredisë të grupit të ekspozimeve në një titullzim (*underlying*

pool).

Neni 104

Kërkesa minimale për njohjen e transferimit të pjesës së konsiderueshme të rrezikut të kredisë në një titullzim sintetik

1. Bankat origjinuese të një titullzimi sintetik mund të llogarisin shumat e ekspozimit të ponderuar me rrezikun për ekspozimet e titulluara, në përputhje me nenin 124 të kësaj rregulloreje, vetëm nëse plotësohet njëri nga kushtet e mëposhtme:

a) pjesa e konsiderueshme e rrezikut të kredisë konsiderohet se i është transferuar palëve të treta, nëpërmjet mbrojtjes së kredisë;

b) banka origjinuese ponderon, me peshën e rrezikut prej 1250%, të gjitha pozicionet që ajo mban në këtë titullzim, ose i zbret këto pozicione të titullzuara nga kapitali rregullator.

2. Bankat, përveç rasteve kur Banka e Shqipërisë vendos se reduktimi i mundshëm i shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezik, të cilat bankat origjinuese do t'i arrinin nëpërmjet këtij titullzimi, nuk justifikohet nga një transferim proporcional i rrezikut të kredisë te palët e treta, vlerësojnë se pjesa e konsiderueshme e rrezikut të kredisë është transferuar, në rastet e mëposhtme:

a) shumat e ekspozimit të ponderuara me rrezikun, për pozicionet e titullzimit *mezzanine*, të mbajtura nga banka origjinuese në këtë titullzim, janë më pak se 50% e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, për të gjitha pozicionet e titullzimit *mezzanine* që ekzistojnë në këtë titullzim;

b) banka origjinuese vërteton se vlera e ekspozimit të pozicioneve të titullzimit (në rastin e një titullzimi pa pozicione titullzimi *mezzanine*), që do të ishte subjekt i zbritjes nga kapitali rregullator ose i një peshe rreziku prej 1250%, e tejkalon, me një marzh të konsiderueshëm, një vlerësim të arsyeshëm të humbjeve të pritshme ndaj ekspozimeve të titulluara, dhe ajo (banka origjinuese) nuk mban më shumë se 20% të vlerave të ekspozimit të pozicioneve të titullzimit, që do të ishin subjekt i zbritjes nga kapitali rregullator ose i një peshe rreziku prej 1250%.

3. Për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, pozicionet *mezzanine* të titullzimit, nënkuptojnë ato pozicionet të titullzimit, ndaj të cilave aplikohet një peshë rreziku më e ulët se 1250% dhe që janë me prioritet më të ulët se pozicioni senior në këtë titullzim, si dhe me prioritet më të ulët se çdo pozicion tjetër titullzimi në këtë titullzim, të cilit i caktohet cilësia e kredisë e shkallës 1.

4. Banka e Shqipërisë, pa rënë në kundërshtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, njeh/pranon transferimin e pjesës së konsiderueshme të rrezikut të kredisë në palë të treta, vetëm nëse krijon bindjen për cilësinë e politikave dhe metodologjive të bankës, të cilat sigurojnë se reduktimi i mundshëm i kërkesave për kapital, që arrin origjinuesi nëpërmjet titullzimit, justifikohet nga një transferim proporcional i rrezikut të kredisë drejt palëve të treta. Banka e Shqipërisë krijon këtë bindje vetëm nëse banka origjinuese vërteton se një transferim i tillë i rrezikut të kredisë drejt palëve të treta, njihet, gjithashtu, për qëllime të administrimit të brendshëm të rrezikut të bankës dhe shpërndarjes së brendshme të kapitalit.

5. Bankat, përveç këtyre kërkesave, duhet të sigurojnë se transferimi plotëson kushtet e mëposhtme:

a) dokumentacioni i titullzimit të pasqyrojë qëllimin ekonomik të transaksionit;

b) mbrojtja e kredisë, nëpërmjet së cilës është transferuar rreziku i kredisë, është në përputhje me pranueshmërinë dhe kërkesat e tjera për njohjen e mbrojtjes së kredisë, bazuar në kreun IV të kësaj rregulloreje. Për qëllime të kësaj pike, entitetet me qëllim të posaçëm (SPV) nuk do të njihen si ofrues të pranueshëm për mbrojtjen e pafinancuar;

c) instrumentet e mbrojtjes se kredisë që përdoren për transferimin e rrezikut të kredisë nuk duhet të përmbajnë afate ose kushte që:

i) diktojnë kufij/limite materiale, poshtë të cilave mbrojtja e kredisë konsiderohet jo e zbatueshme në kushtet e ndodhjes së ngjarjes së parapërcaktuar të kredisë;

ii) lejojnë ndërprerjen e mbrojtjes për shkak të përkeqësimit të cilësisë së kredisë së ekspozimeve bazë;

iii) kërkojnë përmirësimin e pozicioneve në titullzim nga banka origjinuese, përveç rastit të dispozitave të amortizimit të hershëm;

iv) rrisin koston e mbrojtjes së kredisë për bankën ose rrisin kthimin e pagueshëm ndaj mbajtësve të pozicioneve në titullzim, në përgjigje të një përkeqësimi të cilësisë së kredisë së grupit të ekspozimeve në titullzim; dhe

d) është marrë një opinion ligjor i kualifikuar, i cili konfirmon zbatueshmërinë e mbrojtjes së kredisë në të gjitha juridiksionet përkatëse.

NËNKREU III
VLERËSIMET E JASHTME TË KREDISË

Neni 105
Kërkesat për vlerësimet e kredisë nga institucionet e vlerësimit të jashtëm të kredisë

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, sipas nënkreut IV, përdorin vlerësimin e kredisë nga një ECAI e pranuar, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) llojet e pagesave të marra në konsideratë në vlerësimin e kredisë, nuk duhet të kenë mospërputhje me llojet e pagesave që i takojnë bankës, sipas kontratës që krijon pozicionin e titullzimit në fjalë;

b) vlerësimet e kredisë duhet të jenë publikisht të disponueshme nga tregu. (Vlerësimet e kredisë konsiderohen të tilla, nëse publikohen në një forum që ka akses publik dhe përfshihen në matricën e tranzicionit të ECAI-së, ndërsa vlerësimet e kredisë të bëra publike vetëm për një numër të kufizuar subjektesh, nuk do të konsiderohen si me akses publik.)

Neni 106
Përdorimi i vlerësimeve të kredisë

1. Bankat mund të caktojnë një ose më shumë ECAI të pranuara (ECAI e emëruar), vlerësimet e kredisë të së cilave, mund të përdoren për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderura me rrezikun, sipas këtij kreu.

2. Bankat përdorin vlerësimet e kredisë nga një ECAI e emëruar, në mënyrë konsekuente, për sa u përket pozicioneve të tyre të titullzimit.

3. Bankat nuk mund të përdorin vlerësimin e kredisë së një ECAI-je për pozicionet e tyre në disa segmente (transhe) dhe vlerësimin e kredisë nga një ECAI tjetër, për pozicionet e tyre në segmente (transhe) të tjera, të cilat janë pjesë e së njëjtës strukturë që mundet ose jo të jetë vlerësuar nga ECAI-ja e parë.

4. Bankat, në rastet kur një pozicion ka dy vlerësime kredie, nga ECAI të emëruara të ndryshme, përdorin vlerësimin më pak të favorshëm të kredisë.

5. Bankat, në rastet kur një pozicion ka më shumë se dy vlerësime kredie nga ECAI të caktuara, përdorin dy vlerësimet më të favorshme dhe nëse dy vlerësimet më të favorshme janë të ndryshme përdoret ai më pak i favorshëm.

6. Bankat, pa rënë në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni, në rastet kur mbrojtja e kredisë e njohur sipas kreut IV të rregullores, i ofrohet direkt SPV-së dhe kjo mbrojtje është

konsideruar në vlerësimin e kredisë së një pozicioni nga një ECAI, përdorin si peshë rreziku, peshën e rrezikut të lidhur me atë vlerësim kredie.

7. Bankat, në rastet kur mbrojtja e kredisë nuk njihet si teknikë zbutje sipas kërkesave të kreut IV të kësaj rregulloreje, nuk do të njohin as vlerësimin e kredisë nga ECAI-ja, dhe në rastet kur mbrojtja e kredisë nuk i ofrohet SPV-së, por direkt një pozicioni të titullzuar, nuk do të njohin as vlerësimin e kredisë.

8. Banka e Shqipërisë, merr masat e nevojshme për të siguruar se, për sa u përket vlerësimeve të kredisë për instrumentet e strukturuara financiare, ECAI-të angazhohen në publikimin e shpjegimeve mbi ndikimin e performancës së grupit të aktiveve në vlerësimet e kredisë.

Neni 107
***Mapping* i vlerësimit të ECAI-ve**

1. Banka e Shqipërisë përcakton lidhjen ndërmjet secilit prej vlerësimeve të kredisë, të një ECAI-je të pranuar, me cilësinë e kredisë, të përcaktuar në nënkreun IV të këtij kreu.

2. Banka e Shqipërisë, në përcaktimin e lidhjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, bën diferencimin ndërmjet shkallëve relative të rrezikut të shprehur në çdo vlerësim.

3. Banka e Shqipërisë, në këtë proces, konsideron faktorë sasiorë, të tillë si probabilitetet e dështimit dhe/ose të humbjes dhe faktorët cilësorë, të tillë si gama e transaksioneve të vlerësuara nga ECAI-të dhe kuptimi i vlerësimit të kredisë.

4. Pozicionet në titullzim, mbi të cilat në bazë të vlerësimeve të kredisë së ECAI-ve të pranuara aplikohet e njëjta peshë rreziku, duhet të përfaqësojnë të njëjtën shkallë të rrezikut të kredisë. Kjo duhet të përfshijë edhe modifikimin e cilësisë së kredisë që i korrespondon një vlerësimit të kredisë.

NËNKREU IV
LLOGARITJA

Neni 108
Llogaritja e shumës së ekspozimeve të ponderuara me rrezikun

1. Bankat llogarisin shumën e ekspozimit të ponderuar me rrezikun të një pozicioni titullzimi, të vlerësuar nga një ECAI e pranuar, duke i aplikuar vlerës së ekspozimit peshën e rrezikut që i korrespondon shkallës së cilësisë së kredisë, siç përcaktohet në tabelat 13 dhe 14:

Tabela 13. Për pozicionet që nuk kanë vlerësim afatshkurtër të kredisë

Cilësia e kredisë	1	2	3	4	5 e poshtë
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	350%	1250%

Tabela 14. Për pozicionet që kanë vlerësim afatshkurtër të kredisë

Cilësia e kredisë	1	2	3	Të gjithë vlerësimet e tjera
Pesha e rrezikut	20%	50%	100%	1250

2. Bankat zbatojnë një peshë rreziku prej 1250% për shumën e ekspozimit në një

pozicion titullzimi të pavlerësuar. Përjashtimisht për këto pozicione, banka mund të aplikojë peshat e rrezikut të referuara në nenet 110-113 të kësaj rregulloreje, në qoftë se plotësohen kriteret e përcaktuara.

Neni 109
Përcaktimi i vlerës së *cap*-it

1. Shumat e ekspozimit, të ponderuara me rrezikun, të llogaritura për pozicionet në titullzim, për bankat origjinuese ose bankat sponsorizuese, kufizohen deri në nivelin e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun që do të llogaritej, nëse këto ekspozime nuk do të ishin titullzuar (*cap*), duke supozuar zbatimin e një peshe rreziku prej 150% për të gjitha ekspozimet e pakthyera në afat dhe për ekspozimet që u përkasin "kategorive me rrezik të lartë", ndërmjet ekspozimeve të titullzuara.

2. Kërkesa për kapital përkundrejt totalit të pozicioneve në një titullzim, do të jetë maksimalisht 12% e vlerës së *cap*-it.

Neni 110
Trajtimi i pozicioneve të pavlerësuara (metoda *Look-through*)

1. Bankat, të cilat mund të kenë pozicione titullzimi të pavlerësuara, mund të zbatojnë trajtimin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun për ato pozicione, me kusht që të njihet përbërja e grupit të ekspozimeve të titullzuara.

2. Bankat, në rast se njihet përbërja e grupit të ekspozimeve që bëjnë pjesë në një titullzim, zbatojnë mesataren e ponderuar të peshave të rrezikut që do të zbatohej për ekspozimet e titullzuara sipas kreut III të kësaj rregulloreje[15], të shumëzuar me një normë përqendrimi.

3. Bankat llogarisin normën e përqendrimit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni, si shumë e vlerave nominale të të gjitha segmenteve (transheve), pjesëtuar me shumën e vlerave nominale të segmenteve (transheve) me një nivel më të ulët (më *junior*) ose në të njëjtin nivel me segmentin (transhin), në të cilin mbahet pozicioni, përfshi edhe këtë të fundit (segmentin që mbahet pozicioni).

4. Pesha e rrezikut që rezulton sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk duhet të jetë më e lartë se 1250% ose më e ulët se çdo peshë rreziku, që i aplikohet një segmenti (transhi) të vlerësuar me përparësi më të lartë (*more senior*).

5. Bankat, në rastet kur nuk janë në gjendje të përcaktojnë peshat e rrezikut që do të zbatoheshin ndaj ekspozimeve të titullzuara, sipas kreut III të kësaj rregulloreje, aplikojnë për këto pozicione peshën e rrezikut prej 1250%.

Neni 111
Trajtimi i pozicioneve të titullzuara në një segment (*tranche*) që mbulon humbjet i dyti ose më lart, në një program ABCP (metoda *Look Through* për transaksionet ABCP)

1. Bankat, për pozicionet e titullzimit që përmbushin kushtet e vendosura sipas paragrafit 2 të këtij neni, zbatojnë një peshë rreziku që përcaktohet si më e larta midis 100% dhe peshës më të lartë të rrezikut që do të zbatohej për secilin pozicion të titullzuar.

2. Pozicioni i titullzuar, për qëllim të zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të jetë në një segment (*tranche*), i cili ekonomikisht përballon i dyti humbjet në

[15]Në zbatim të formulës: (E1*P1+E2*P2+...+En*Pn)/(E1+E2+...+En), ku: E përfaqëson vlerën e ekspozimit; P përfaqëson peshën përkatëse të rrezikut për çdo ekspozim; n përfaqëson numrin e ekspozimeve në një titullzim.

titullzim, ose në një segment (*tranche*) me pozicion më të mirë, dhe segmenti (*tranche*) që përballon i pari humbjen duhet të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e kredisë për segmentin (*transhin*) që përballon i dyti humbjen;

b) të jetë i një cilësie ekuivalente me cilësinë/shkallën e investimit, ose i një cilësie më të mirë;

c) të jetë i mbajtur nga një bankë, e cila nuk mban një pozicion në segmentin që përballon i pari humbjen.

3. Bankat, përveç sa më sipër, për pozicionet e titullzuara në një segment (*tranche*), që mbulon i dyti humbjet ose më lart, në një program ABCP që janë në formën e lehtësive të likuiditetit, mund të zbatojë trajtimin e përcaktuar në nenet 112 dhe 113, në rast se është më e favorshme për to (bankat).

Neni 112

Trajtimi i lehtësirave të likuiditetit të pranueshme për transaksionet e titullzimit, të pavlerësuara nga një ECAI e pranuar

1. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të një lehtësie likuiditeti, duke zbatuar një koeficient prej 50% mbi vlerën nominale të saj, në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) marrëveshja e lidhur për lehtësinë e likuiditetit përmban klauzola, të cilat identifikojnë dhe përcaktojnë qartë kushtet kur mund të tërhiqet lehtësia;

b) lehtësia nuk është e mundur të përdoret për mbulimin e humbjeve të ndodhura tashmë në kohën e tërheqjes së saj (për shembull, të mundësohet likuiditet për ekspozime të dështuara (*default*) në kohën e tërheqjes së lehtësisë ose për të blerë aktive me një vlerë më të lartë se sa vlera e drejtë e tyre (*fairvalue*);

c) lehtësia duhet të përdoret vetëm për mbulimin e përkohshëm të diferencave ndërmjet flukseve hyrëse dhe atyre dalëse, dhe nuk duhet të përdoret për të siguruar financim të përhershëm apo të rregullt për titullzimin;

d) shlyerja/ripagimi i tërheqjes së lehtësisë nuk duhet të jetë në prioritet më të ulët se pretendimet e investitorëve, përveç pretendimeve që rrjedhin nga kontratat derivative të normave të interesit dhe të këmbimeve valutore, komisioneve apo pagesave të tjera të ngjashme me to, si dhe ripagimi i lehtësisë nuk mund të shtyhet në kohë apo të shmanget;

e) lehtësia e likuiditetit nuk mund të përdoret/tërhiqet nëse nuk janë ezauruar të gjitha përmirësimet e cilësisë së kredisë prej së cilës kjo lehtësi mund të përfitonte;

f) lehtësia e likuiditetit duhet të përfshijë një klauzolë, e cila parashikon reduktimin automatik në shumën që mund të tërhiqet me aq sa është shuma e ekspozimeve të dështuara (*default*), ose për rastet kur grupi i ekspozimeve të titullzuara përbëhet nga instrumente të vlerësuara nga një ECAI e pranuar, kjo klauzolë të ndalojë përdorimin e lehtësisë, nëse cilësia mesatare e këtyre ekspozimeve bie nën ekuivalentin e investment grade të ECAI-së të emëruar (“ekspozime të dështuara” (*default*) do të konsiderohen ekspozimet me vonesë me më shumë se 90 ditë).

2. Bankat zbatojnë, për lehtësirat e likuiditetit, peshën më të lartë të rrezikut që do të zbatohej te secili prej ekspozimeve të titullzuara, sipas kreut III të kësaj rregulloreje, nga banka që mban ekspozimet.

Neni 113

Lehtësitë e likuiditetit në formën e paradhënieve në *cash*

Bankat, për vlerën e ekspozimit në një lehtësi likuiditeti, e cila është e anulueshme pa kushte, zbatojnë një koeficient 0% mbi vlerën nominale të lehtësisë, me kusht që të plotësohen kërkesat e përcaktuara në nenin 112, dhe që ripagimi i shumave të përdorura nga lehtësia e akorduar të jetë me përparësi të lartë (*senior*) krahasuar me çdo të

drejtë/pretendim tjetër ndaj flukseve të parasë që vijnë nga ekspozimet e titullzuara.

Neni 114

Kërkesat për kapital shtesë për titullzimin e ekspozimeve qarkulluese me të drejtë amortizimi të hershëm

1. Bankat origjinuese, përveç shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, të llogaritura për pozicionet e tyre të mbajtura në titullzim, llogarisin edhe shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun sipas metodës së përcaktuar në këtë nen, paragrafët 2 dhe 3, deri në nenin 121, kur shesin ekspozimet qarkulluese në një titullzim që përmban klauzola të amortizimit të hershëm (kushti i amortizimit të hershëm paraqet një klauzolë kontraktuale që kërkon mbylljen e pozicionit të investitorit përpara maturitetit fillestar të caktuar për titullzimin e lëshuar, në rastin e ndodhjes së ngjarjeve të paracaktuara).

2. Bankat llogarisin shumën/at e ekspozimit/eve të ponderuara me rrezikun, duke konsideruar interesat e origjinuesit dhe të investitorit.

3. Bankat origjinuese, në rastet kur strukturat e titullzuara përmbajnë njëkohësisht ekspozime qarkulluese dhe joqarkulluese, zbatojnë trajtimin e tyre, sipas neneve 115-121, ndaj asaj pjese të grupit të ekspozimeve të titullzuara që përmban ekspozime qarkulluese.

Neni 115

Interesi i origjinuesit dhe i investitorit

1. Bankat konsiderojnë si “interes të origjinuesit”, vlerën e ekspozimit të asaj pjese të vlerës nominale të grupit të shumave të përdorura (*pool of drawn amounts*) të shitura në titullzim, raporti i së cilës me shumën e të gjithë grupit (*pool*) të shitur në strukturë, përcakton pjesën e flukseve të parasë të gjeneruara nga mbledhja e kryegjësë dhe interesit dhe shumave të tjera, të cilat nuk janë të disponueshme për t’iu paguar mbajtësit të pozicioneve të titullzimit (interesat e origjinuesit nuk mund të shlyhen pas interesave të investitorëve).

2. Bankat konsiderojnë si “interes të investitorit”, vlerën e ekspozimit të pjesës nominale të mbetur të grupit të shumave të përdorura (*pool of drawn amounts*).

3. Ekspozimi i bankës origjinuese, i lidhur me të drejtat e saj, për sa i përket interesit të origjinuesit, nuk do të konsiderohet si pozicion në titullzim, por si ekspozim përpjesëtimor (*pro rata*) përkundrejt ekspozimeve të titullzuara, sikur këto të fundit të mos ishin të titullzuara.

Neni 116

Përjashtimet nga trajtimi i amortizimit të hershëm

1. Bankat origjinuese janë të përjashtuara nga kërkesat për kapital shtesë të paragrafit 1 të nenit 114, për llojet e mëposhtme të titullzmit:

a) titullzimet e ekspozimeve qarkulluese, në të cilat investitori mbetet plotësisht i ekspozuar ndaj tërheqjeve të ardhshme të huamarrësve, në mënyrë të tillë që rreziku i ekspozimeve (lehtësisë) bazë nuk i kthehet bankës origjinuese edhe në rast të ndodhjes së një ngjarje të amortizimit të hershëm; dhe

b) titullzimet, në të cilat çdo klauzolë për amortizimin e hershëm ndodh vetëm në rast të ndodhjes së ngjarjeve që nuk lidhen me performancën e aktiveve të titullzuara ose performancën e bankës origjinuese, të tilla si ndryshime të rëndësishme në rregullore të ndryshme ose në ligjet e taksave.

Neni 117

Kërkesat maksimale për kapital

1. Për bankën origjinuese që është subjekt i kërkesave për kapital sipas nenit 114, totali i shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun në lidhje me pozicionet në interesat e investitorëve dhe shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, të llogaritura sipas nenit 114, nuk duhet të jetë më i madh se shuma më e madhe midis:

a) shumës së ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, të llogaritura për pozicionet e saj në interesat e investitorëve; dhe

b) shumës së ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, të cilat do llogariten bazuar në ekspozimet e titullzuara nga ana e bankës që i mban këto ekspozime, sikur të mos ishin të titullzuara, në një shumë të barabartë me nivelin e interesave të investitorëve.

2. Zbritja e fitimeve neto, nëse ka, që vijnë nga kapitalizimi i të ardhurave të ardhshme, sipas kërkesave të udhëzimit "Për kapitalin rregullator", nuk duhet të përfshihet në shumën maksimale të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 118

Llogaritja e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për pozicionet në titullzimet e ekspozimeve qarkulluese me klauzola të amortizimit të hershëm

Bankat, llogarisin shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, të referuara sipas paragrafit 1 të nenit 114, duke shumëzuar shumën e interesave të investitorëve me produktin e faktorit konvertues të përshtatshëm, siç përcaktohet në nenin 121, dhe mesataren e ponderuar të peshave të rrezikut që do të zbatohej ndaj ekspozimeve të titulluara, sikur të mos ishin të titullzuara.

Neni 119

Tipat e klauzolave të amortizimit të hershëm

1. Bankat konsiderojnë klauzolat për amortizim të hershëm respektivisht:

a) "të kontrolluar", në rast se plotësohen kriteret në vijim:

i) banka origjinuese ka hartuar një plan të përshtatshëm për kapitalin dhe likuiditetin, për të siguruar se ka kapital dhe likuiditet të mjaftueshëm, nëse ndodh një amortizim i hershëm;

ii) gjatë kohës së zbatimit të transaksionit ndodh një ndarje proporcionale mes interesit të origjinuesit dhe interesit të investitorit për pagesat e interesit dhe kryegjësë, shpenzimeve, humbjeve dhe rimarrjeve, bazuar në balancën e llogarive të arkëtueshme në një ose disa data reference, përgjatë çdo muaji;

iii) periudha e amortizimit konsiderohet e mjaftueshme për 90% të tepricës së borxhit total (interesit të origjinuesit dhe investitorit), në fillimin e periudhës së amortizimit të hershëm, që duhej të ishin shlyer/ripaguar ose të ishin njohur si të dështuara (*default*) në fund të periudhës; dhe

iv) shpejtësia e shlyerjeve të shumave të detyrimit ndaj investitorit nga banka origjinuese nuk është më e lartë sesa do të ishte në rastin e shlyerjeve sipas amortizimit linear, për periudhën e caktuar sipas pikës "iii" më sipër.

b) "jo të kontrolluar" nëse nuk plotësohen kriteret/kushtet e shkronjës "a".

Neni 120

Marzhi i tejkaluar (*excess spread*)

1. Bankat, në rastet e titullzimit me klauzolë të amortizimit të hershëm të ekspozimeve me pakicë, të cilat janë të paangazhuara (*uncommitted*) dhe të anulueshme pa kushte, në të cilat amortizimi i hershëm aktivizohet në rast se marzhi i tejkaluar bie në një nivel specifik, krahasojnë nivelin mesatar 3-mujor (tremujor) të marzhit të tejkaluar me limitin

e vendosur të këtij marzhi në titullzimin në fjalë.

2. Në rast se titullzimi nuk përcakton limit për marzhin e tejkaluar, limiti do vendoset 4.5 pikë përqindje më lart sesa niveli i marzhit të tejkaluar, në të cilin fillon amortizimi i hershëm.

Neni 121

Faktorët e konvertimit në titullzimet qarkulluese me klauzola të amortizimit të hershëm

1. Faktori i konvertimit që do të zbatohet, duhet të përcaktohet sipas nivelit aktual të mesatares tremujore të marzhit të tejkaluar, në përputhje me tabelën 15.

Tabela 15. Faktorët e konvertimit

	Titullzimet subjekt i klauzolës së amortizimit të hershëm, të kontrolluar	**Titullzimet subjekt i klauzolës të amortizimit të hershëm, jo të kontrolluar**
Mesatarja 3-mujore e marzhit të tejkaluar	**Faktori i konvertimit**	**Faktori i konvertimit**
Mbi nivelin A	0%	0%
Niveli A	1%	5%
Niveli B	2%	15%
Niveli C	10%	50%
Niveli D	20%	100%
Niveli E	40%	100%

2. Në tabelën 15:

- “Niveli A” do të thotë nivel i marzhit i tejkaluar prej më pak se 133,33% të nivelit të vendosur të marzhit të tejkaluar, por jo më pak se 100% e atij të vendosur;
- “Niveli B” do të thotë nivel i marzhit i tejkaluar prej më pak se 100% të nivelit të vendosur të marzhit të tejkaluar, por jo më pak se 75% e atij të vendosur;
- “Niveli C” do të thotë nivel i marzhit i tejkaluar prej më pak se 75% të nivelit të vendosur të marzhit të tejkaluar, por jo më pak se 50% e atij të vendosur;
- “Niveli D” do të thotë nivel i marzhit i tejkaluar prej më pak se 50% të nivelit të vendosur të marzhit të tejkaluar, por jo më pak se 25% e atij të vendosur; dhe
- “Niveli E” do të thotë nivel i marzhit i tejkaluar më pak se 25% të nivelit të vendosur të marzhit të tejkaluar.

3. Të gjitha titullzimet e tjera që i nënshtrohen klauzolës për amortizimin të hershëm të kontrolluar të ekspozimeve qarkulluese, do të jenë subjekt i një faktori konvertimi prej 90%.

4. Të gjitha titullzimet e tjera, që i nënshtrohen një klauzole për amortizim të hershëm jo të kontrolluar të ekspozimeve qarkulluese, do të jenë subjekt i një faktori konvertimi 100%.

Neni 122

Njohja e zbutjes së rrezikut në pozicionet e titullzimit

Bankat, në llogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, në rastet kur për një pozicion titullzimi është siguruar një mbrojtje kredie, modifikojnë shumën/vlerën e ekspozimit, në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje.

Neni 123

Reduktimet në shumat e ekspozimit të ponderuara me rrezikun

1. Bankat kanë opsionin që pozicionet e titullzimit për të cilat është caktuar një peshë

rreziku 1250%, në vend që t'i përfshijnë në llogaritjen e shumave të ekspozimit të ponderuara me rrezikun, mund t'i zbresin ato nga kapitali rregullator. Për këto qëllime, llogaritja e vlerës së ekspozimit pasqyron mbrojtjen e financuar të kredisë, në përputhje me nenin 122.

2. Bankat, në rastin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, zbresin nga shuma maksimale e ekspozimeve të ponderuara me rrezik (*cap*), e përcaktuar sipas nenit 109 të kësaj rregulloreje, në një vlerë të barabartë me 12.5 herë shumën e zbritur nga kapitali rregullator.

Neni 124

Llogaritja nga ana e bankës origjinuese të shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun për ekspozimet në një titullzim sintetik

Bankat origjinuese të një titullzimi sintetik, për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun për ekspozimet e titullzuara, kur plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 104, zbatojnë metodologjitë llogaritëse dhe kërkesat e përcaktuara në nenet 108-123 të kësaj rregulloreje.

Neni 125

Trajtimet e mospërputhjeve në maturitet për titullzimet sintetike

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun për titullzimet sintetike, konsiderojnë çdo mospërputhje në maturitetet midis mbrojtjes së kredisë, me anë të së cilës është arritur ndarja në segmente (*tranches*) dhe ekspozimeve të titullzuara.

2. Bankat konsiderojnë si maturitet të ekspozimeve të titullzuara maturitetin më të gjatë ndër ekspozimet individuale (maksimalisht prej 5 vitesh). Maturiteti i mbrojtjes së kredisë duhet të përcaktohet në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje.

3. Bankat origjinuese nuk konsiderojnë mospërputhjet në maturitet për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, për segmente (transhet), që sipas këtij nënkreu ponderohen me 1250%. Për të gjitha segmentet (transhet) e tjera, trajtimi i mospërputhjeve në maturitet të përcaktuara në kreun IV, bëhet sipas formulës së mëposhtme:

RWW* = [RW (SP) x (t-t*)/(T-t*)] + [RW (Ass) x (T-t)/(T-t*)],

ku:

RWW* - janë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun;

RW (SP) - janë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në qoftë se nuk ka mospërputhje në maturitete;

RW (Ass) - janë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, në rast se nuk do të titullzoheshin, të llogaritura në baza proporcionale;

T- është maturiteti i ekspozimeve themeltare, pjesë e titullzimit të shprehur në vite;

t - është maturiteti i mbrojtjes së kredisë i shprehur në vite;

t* - është 0,25.

KREU VI

RREZIKU I KREDISË SË KUNDËRPARTISË

NËNKREU I

METODAT PËR LLOGARITJEN E VLERËS SË EKSPOZIMEVE

Neni 126

Kërkesa të përgjithshme për zgjedhjen e metodës

1. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e kredisë së kundërpartisë, për të gjitha ekspozimet e tyre në librat e bankës dhe në librin e tregtueshëm.

2. Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë së kundërpartisë është 12% e totalit të ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut, të llogaritura në përputhje me paragrafin 7 të nenit 127.

3. Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë së kundërpartisë, llogarisin vlerën e ekspozimeve në lidhje me elementet e mëposhtme, respektivisht në librat e bankës dhe në librin e tregtueshëm:

a) instrumentet derivative mbi banak (OTC) të përcaktuar në aneksin 4 të kësaj rregulloreje;

b) derivativët e kredisë (vetëm në librin e tregtueshëm);

c) marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjella të riblerjes së titujve dhe të mallrave (*commodities*), transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes së titujve dhe të mallrave (*commodities*);

d) transaksionet e huadhënies me marzhe të titujve;

e) transaksionet me afat të gjatë shlyerje.

4. Bankat përdorin një nga metodat e mëposhtme për të llogaritur vlerën e ekspozimeve për instrumentet derivativë të listuara në aneksin 4 të kësaj rregulloreje:

a) metodën e ekspozimit origjinal;

b) metodën e *mark-to-market*;

c) metodën standarde.

5. Bankat, të cilat nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 144 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje nuk mund të përdorin metodën e ekspozimit origjinal, për llogaritjen e vlerës së ekspozimit të instrumenteve derivative.

6. Bankat nuk mund të përdorin metodën e ekspozimit origjinal për të përcaktuar vlerën e ekspozimit të kontratave të listuara në paragrafin 3 të aneksit 4 të kësaj rregulloreje.

7. Përdorimi i kombinuar i metodave të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni për llogaritjen e vlerës së ekspozimit të kontratave të derivativëve mund të bëhet në baza të përhershme vetëm brenda një grupi bankar, por jo brenda bankës. Përdorimi i kombinuar i metodave në fjalë lejohet brenda bankës vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 133 paragrafi 2 të këtij kreu.

8. Bankat llogarisin ekspozimet, që u referohen zërave që përfshihen në shkronjën “b” të paragrafit 3 të këtij neni, duke përdorur metodën *mark-to-market* ose metodën standarde.

9. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimeve të përcaktuara në shkronjën “c” dhe “d” të paragrafit 3 të këtij neni, në përputhje me përdorimin e një prej metodave të përcaktuara në kreun IV të kësaj rregulloreje:

a) metoda e thjeshtë;

b) metoda gjithëpërfshirëse e rregullimit të luhatshmërisë të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë;

c) metoda gjithëpërfshirëse e rregullimeve të brendshme të luhatshmërisë.

10. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimeve që rrjedhin nga transaksionet me afat të gjatë shlyerje, me një prej metodave të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, pavarësisht metodës së zgjedhur për të trajtuar derivativët mbi banak, marrëveshjet e riblerjes, transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së titujve apo mallrave (*commodities*), dhe transaksionet e huadhënies me marzhe.

11. Bankat, që llogarisin ekspozimet sipas metodës *mark-to-market* dhe metodës standarde, nuk lejohen që të përdorin metodën e ekspozimit origjinal në periudhën pasuese raportuese.

12. Bankat, pavarësisht metodës së zgjedhur, llogarisin vlerën e ekspozimit ndaj një

kundërpartie të dhënë, si shumën e vlerave të ekspozimeve, të përllogaritura për çdo grup netimi (kompensimi) me atë kundërparti.

13. Marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjella të riblerjes me Bankën e Shqipërisë, janë të përjashtuara nga dispozitat e këtij kreu.

Neni 127

Kërkesa të veçanta për përcaktimin e vlerës së ekspozimeve

1. Bankat, në rastin kur blejnë instrumente derivativë kredie për mbrojtje ndaj një ekspozimi në librin e bankës ose ndaj një ekspozimi të rrezikut të kredisë së kundërpartisë, mund të përllogarisin kërkesën për kapital për aktivin e mbrojtur (*hedged*) në përputhje me kreun IV të kësaj rregulloreje, nenet 90, 93, 94, 95 dhe 96.

Në këto raste, vlera e ekspozimit për llogaritjen e rrezikut të kredisë së kundërpartisë për këto derivativë kredie vendoset zero.

2. Vlera e ekspozimit për rrezikun e kredisë së kundërpartisë, nga kontratat *credit default swap* të shitura, që përfshihen në librin e bankës, është zero, në rastet kur këto kontrata trajtohen si mbrojtje e kredisë, e ofruar nga banka dhe janë subjekt i kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë, për të gjithë vlerën nominale të tyre, si garanci të lëshuara.

3. Bankat nuk llogarisin vlerë ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë së një kundërpartie qendrore, që rrjedh nga instrumentet derivativë, marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjella të riblerjes, transaksionet e huadhënies apo huamarrjes së titujve apo mallrave (*commodities*), transaksionet me afat të gjatë shlyerje dhe transaksionet e huadhënies me marzhe, nëse këto janë pranuar nga kundërpartia qendrore.

4. Bankat nuk llogarisin vlerë ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë së një kundërpartie qendrore, që rrjedh nga instrumentet financiare të dhënë si garanci një kundërpartie qendrore, për transaksionet e përcaktuara në paragrafin 3.

5. Bankat, për qëllime të zbatimit të përjashtimeve në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, sigurojnë që ekspozimet ndaj kundërpartisë qendrore duke përfshirë të gjithë pjesëmarrësit në marrëveshjet e tyre, të jenë plotësisht të mbuluara me kolateral në baza ditore.

6. Banka e Shqipërisë, në rastet kur bankat përdorin metodën *mark-to-market* dhe metodën e ekspozimit origjinal, siguron që vlera nominale që do të konsiderohet, të jetë një *benchmark* i përshtatshëm për rrezikun e vetë kontratës. Në rastet kur kontrata mundëson shumëfishim të flukseve të parasë, vlera nominale duhet të korrigjohet në mënyrë që të marrë parasysh, efektet e shumëfishimit në strukturën e rrezikut të asaj kontrate.

7. Bankat, për qëllime të llogaritjes së ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, trajtojnë ekspozimet e llogaritura me metodën e ekspozimit origjinal, metodën *mark-to-market* dhe metodën standarde, sipas peshave të rrezikut të përcaktuara në kreun III të kësaj rregulloreje.

Neni 128

Metoda e ekspozimit origjinal

1. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të një kontrate individuale sipas kësaj metode, duke shumëzuar vlerën nominale të kontratës me përqindjet e përcaktuara sipas tabelës 16.

Tabela 16

Maturiteti fillestar	**Kontrata të normës së interesit**	**Kontrata të kursit të këmbimit dhe arit**
Deri në 1 vit (≤ 1 vit)	0.5%	2%

Më shumë se një vit, jo më tepër se dy vjet (1 vit < Maturiteti fillestar ≤ 2 vjet)	1%	5%
Përqindje për çdo vit shtesë	1%	3%

2. Bankat, në rastin e kontratave të normës së interesit, mund të përdorin maturitetin e mbetur ose atë fillestar, vetëm me miratim paraprak të Bankës së Shqipërisë.

Neni 129
Metoda *mark-to-market*

1. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit të një kontrate individuale sipas metodës *mark-to-market*, si shumë të:

a) kostos aktuale të zëvendësimit të kontratës, e cila përfaqëson vlerën aktuale të tregut, në rast se është pozitive; dhe

b) ekspozimit të mundshëm të ardhshëm të kredisë (me përjashtim të *single currency floating/floating interest rate swaps*, për të cilat llogaritet vetëm kostoja aktuale e zëvendësimit të kontratës), i cili llogaritet si vlera nominale (*notional*) e një kontrate individuale, e shumëzuar me përqindjet e përcaktuara sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 17

Maturiteti i mbetur	**Kontrata të normës së interesit**	**Kontrata të kursit të këmbimit dhe arit**	**Kontrata të titujve të kapitalit**	**Kontrata të metaleve të çmuar, përveç arit**	**Kontrata të mallrave (*commodities*) të tjera, përveç atyre për metalet e çmuara**
≤ 1 vit	0%	1%	6%	7%	10%
1 vit < maturiteti i mbetur ≤ 5 vjet	1.5 %	5%	8%	7%	12 %
>5 vjet	1.5 %	7.5 %	10%	8 %	15 %

2. Bankat, në rastet e kontratave, të cilat nuk përfshihen në një nga pesë kategoritë e treguara në tabelën 17, përdorin përqindjet e përcaktuara për kategorinë e kontratave të mallrave (*commodities*) të tjera, të ndryshme nga ato për metalet e çmuara, në përputhje me maturitetin e tyre të mbetur.

3. Bankat, në rastet e kontratave me shkëmbime të shumëfishta të kryegjësë (principalit), shumëzojnë përqindjet e përcaktuara në tabelën e mësipërme me numrin e pagesave të mbetura për t'u kryer sipas kushteve të kontratës.

4. Bankat, në rastet e kontratave të strukturuara për shlyerjen e ekspozimit të mbetur sipas datave të përcaktuara paraprakisht dhe kur kushtet rivendosen të tilla, që vlera e tregut të kontratës të jetë zero në këto data, llogarisin maturitetin e mbetur, të barabartë me kohën deri në datën e ardhshme të rivendosjes së kushteve.

Në rastin e kontratave të normës së interesit, që plotësojnë këto kritere dhe kanë një maturim të mbetur mbi një vit, përqindja duhet të jetë jo më e vogël se 0.5%.

5. Bankat, për kontratat e kolateralizuara të derivativëve mbi banak (OTC) për njohjen e kolateralit, për efekt të metodës *mark-to-market* mund të përdorin vetëm "Metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar", sipas kreut IV të kësaj rregulloreje, duke konsideruar marrëveshjet e netimit (kompensimit) kur është e përshtatshme.

Neni 130
Metoda standarde

1. Bankat përdorin metodën standarde (MS) për llogaritjen e vlerës së ekspozimit për

derivativët mbi banak (OTC), derivativët e kredisë dhe transaksionet me afat të gjatë shlyerje.

2. Bankat llogarisin vlerën e ekspozimit për instrumentet dhe transaksionet e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, në mënyrë të veçantë për çdo grup netimi (kompensimi) dhe mbi baza neto, duke konsideruar zbritjen e kolateralit/eve të njohura, siç përcaktohet në formulën e mëposhtme:

vlera e ekspozimit =ß*max(CMV-CMC; $\sum_j|\sum_i RPT_{ij}-\sum_l RPC_{lj}|*CCRM_j$),

ku:

CMV = vlera korente e tregut e portofolit të transaksioneve brenda grupit të netimit (kompensimit) me një kundërparti,

pra ku:

$$CMV=\sum_i CMV_i$$

CMV_i = vlera korente e tregut të transaksionit i;

CMC = vlera korente e tregut të kolateralit të caktuar për grupin e netimit (kompensimit);

pra ku:

$$CMC=\sum_l CMC_l$$

CMCl = vlera korente e tregut të kolateralit l;

i = indeksi që përcakton transaksionin;

l = indeksi që përcakton kolateralin;

j = indeksi që përcakton kategorinë e grupit të mbrojtjes (*hedging set*). Këto grupe mbrojtjeje i korrespondojnë faktorëve të rrezikut, për të cilët pozicionet e rrezikut me shenjë të kundërt mund të kompensohen, për të dhënë një pozicion rreziku neto, mbi të cilin mbështetet masa e ekspozimit;

RPTij = pozicioni i rrezikut nga transaksioni i lidhur me grupin e mbrojtjes j;

RPClj = pozicioni i rrezikut nga kolaterali i lidhur me grupin e mbrojtjes j;

CCRMj = shumëzuesi i rrezikut të kredisë së kundërpartisë (SHRKK) i paraqitur në tabelën 19 lidhur me grupin e mbrojtjes j;

ß= 1.4

3. Bankat, për qëllime të llogaritjes së vlerës së ekspozimit, konsiderojnë kolateralin e marrë nga një kundërparti, me shenjë pozitive dhe kolateralin e dhënë një kundërpartie, me shenjë negative.

4. Bankat, për qëllime të njohjes së kolateralit sipas kësaj metode, sigurojnë që kolaterali të plotësojë të paktën kërkesat për njohjen e kolateralit, sipas nenit 50 të kreut IV të kësaj rregulloreje dhe sipas paragrafëve 5 deri në 8, të nenit 137 të këtij kreu.

Neni 131

Trajtimi i instrumenteve financiare sipas metodës standarde

1. Bankat, konsiderojnë pjesën e pagesës si pozicion në para (*payment leg*), kur një transaksion i derivativëve mbi banak (OTC), me profil linear rreziku, kërkon shkëmbimin e një instrumenti financiar përkundrejt një pagese.

2. Transaksionet që kërkojnë shkëmbimin e një pagese, përkundrejt një pagese tjetër, përbëhen nga dy pozicione në para (*payment legs*). Pozicionet në para (*payment legs*) konsistojnë në pagesat bruto të rëna dakord me marrëveshje, përfshirë vlerën nominale (*notional*) të transaksionit.

3. Bankat, në aplikimin e metodës standarde, mund të mos e konsiderojnë rrezikun e

normës së interesit nga pozicionet në para (*payment legs*) me një maturitet të mbetur prej më pak se një vit.

4. Bankat i trajtojnë transaksionet, që konsistojnë në dy pozicione në para (*payment legs*), të tilla si swap-et e normës së interesit, si një transaksion të vetëm agregat, kur janë të denominuara në të njëjtën monedhë. Transaksioni agregat trajtohet si një pozicion në para (*payment leg*).

5. Bankat u përcaktojnë transaksioneve të derivativëve mbi banak (OTC) me profil linear rreziku, të cilat kanë si instrument bazë një instrument kapitali (duke përfshirë indekset e aksioneve) ose mall (*commodity*) (duke përfshirë arin dhe metale të tjera të çmuara), një pozicion rreziku të titujve të kapitalit (ose indeksin e aksioneve) ose mallit/*commodity* (përfshirë arin dhe metalet e tjera të çmuara) përkatës dhe një pozicion rreziku të normës së interesit për pozicionin në para (*payment leg*). Nëse pozicioni në para (*payment leg*) është i denominuar në monedhë të huaj, ai përfshihet, gjithashtu, në një pozicion rreziku në monedhën përkatëse.

6. Transaksionet e derivativëve mbi banak (OTC), me profil linear rreziku me një instrument borxhi, si instrument bazë, lidhen me një pozicion rreziku të normës së interesit për instrumentin e borxhit dhe me një pozicion tjetër të rrezikut të normës së interesit për pozicionin në para (*payment leg*).

7. Transaksionet e derivativëve mbi banak (OTC), me profil linear rreziku, që kërkojnë këmbimin e një pagese, kundrejt një pagese tjetër, përfshirë kontratat *forward* për monedhat e huaja, lidhen me një pozicion të rrezikut të normës së interesit për secilin nga pozicionet në para (*payment leg*). Nëse instrumenti i borxhit, mbi të cilin bazohet transaksioni, është i denominuar në monedhë të huaj, ai lidhet me një pozicion rreziku në këtë monedhë. Nëse një pozicion në para (*payment leg*), është i denominuar në monedhë të huaj, ai lidhet sërish me një pozicion rreziku në këtë monedhë.

Vlera e ekspozimit që i caktohet një *swap*-i të kursit të këmbimit (*foreign exchange basis swap*), është zero.

8. Bankat përcaktojnë masën e një pozicioni rreziku nga një transaksion i derivativëve mbi banak (OTC) me profil linear rreziku, si vlerën nominale efektive (çmimi i tregut shumëzuar me sasinë) të instrumenteve financiare, mbi të cilat mbështetet transaksioni (përfshirë mallrat (*commodities*)), konvertuar në monedhën vendase të bankës, përveç instrumenteve të borxhit.

9. Bankat, për instrumentet e borxhit dhe për pozicionet në para (*payment legs*), përcaktojnë masën e pozicionit të rrezikut si vlerën nominale efektive të pagesave bruto për t'u kryer (përfshirë vlerën nominale) konvertuar në lekë, shumëzuar përkatësisht me kohëzgjatjen e modifikuar të instrumentit të borxhit ose me pozicionin në para (*payment leg*).

10. Bankat përcaktojnë masën e pozicionit të rrezikut nga një kredit *default swap* (CDS), si vlerën nominale të instrumentit të borxhit referencë, shumëzuar me maturitetin e mbetur të *credit default swap*.

11. Bankat përcaktojnë masën e pozicionit të rrezikut nga një derivativ mbi banak (OTC) me profil jolinear rreziku, përfshirë opsionet dhe opsionet mbi *swap*-et (*swaptions*), si të barabartë me vlerën nominale efektive delta ekuivalente të instrumentit financiar mbi të cilin mbështetet transaksioni, përveç rastit kur transaksioni mbështetet mbi një instrument borxhi.

12. Bankat përcaktojnë masën e pozicionit të rrezikut nga një derivativ mbi banak (OTC), me profil jolinear rreziku, përfshirë opsionet dhe opsionet mbi swap-et (*swaptions*), ku si instrument bazë, merret një instrument borxhi ose një pozicion në para (*payment leg*), si të barabartë me vlerën nominale efektive delta, ekuivalente të instrumentit financiar, ose të barabartë me pozicionin në para (*payment leg*), shumëzuar përkatësisht me kohëzgjatjen e modifikuar të instrumentit të borxhit, ose të pozicionit në para (*payment leg*).

13. Bankat, për përcaktimin e pozicioneve të rrezikut, kolateralin e marrë nga një kundërparti e trajtojnë si pretendim ndaj kundërpartisë nën një kontratë derivative (pozicion në blerje) që maturohet sot, ndërkohë që kolateralin e dhënë e trajtojnë si detyrim ndaj kundërpartisë (pozicion në shitje), që maturohet sot.

Neni 132

Përcaktimi i pozicioneve të rrezikut sipas metodës standarde

1. Bankat grupojnë pozicionet e rrezikut sipas kategorive të grupeve mbrojtëse (*hedging sets categories*) dhe llogarisin pozicionin neto të rrezikut, për çdo grup mbrojtës. Pozicioni neto i rrezikut përfaqëson vlerën absolute të shumës së pozicioneve individuale të rrezikut (që rrjedh nga transaksionet dhe kolaterali në një grup netimi (kompensimi)), që përfshihen në të.

Pozicioni neto i rrezikut, në formulat e paraqitura në paragrafin 2, neni 130, do të llogaritet si më poshtë:

$$\left|\sum_{i} RPT_{ij} - \sum_{l} RPC_{lj}\right|$$

2. Bankat, për të llogaritur pozicionin neto të rrezikut, u referohen kategorive të mëposhtme të grupeve të mbrojtjes:

a) pozicionet e rrezikut, të ndjeshme ndaj faktorit të rrezikut “normë e interesit”: emetues të kualifikuar (“emetues të kualifikuar” do të konsiderohet çdo emetues, për të cilin aplikohet një kërkesë për kapital, për rrezikun specifik të portofolit të tregtueshëm, e barabartë ose më e ulët se 1.6%, sipas tabelës 21 të kreut VII të kësaj rregulloreje);

i) bankat përfshijnë pozicionet e rrezikut të emetuesve të kualifikuar, të lidhura me depozitat në para të marra si kolateral nga kundërpartia, me pozicionet në para (*payment legs*) dhe me instrumentet bazë të borxhit, në një prej gjashtë grupeve mbrojtëse për çdo monedhë si në tabelën 18. Grupet mbrojtëse janë të përcaktuar nga një kombinim i kritereve të “maturitetit” dhe të “normave të interesit referuese”;

ii) bankat, për pozicionet e rrezikut të normave të interesit, të lidhura me instrumentet bazë të borxhit, ose me pozicionet në para (*payment legs*), për të cilat norma e interesit është e lidhur me një normë interesi referuese, që përfaqëson nivelin e përgjithshëm të interesit në treg (për shembull Libor, Euribor etj.), konsiderojnë maturitet të mbetur gjatësinë e intervalit kohor, deri në rregullimin tjetër të normës së interesit. Në të gjitha rastet e tjera, konsiderohet maturitet i mbetur, maturiteti i mbetur i instrumentit të borxhit, ose në rastin e pozicionit në para (*payment leg*), koha e mbetur e transaksionit.

Tabela 18

Maturiteti i mbetur/periudha deri në rregullimin e ardhshëm të normës së interesit	**Norma interesi referuese qeveritare**	**Norma interesi referuese joqeveritare**

Maturiteti Maturiteti Maturiteti	Nën 1 vit 1 deri në 5 vjet Mbi 5 vjet	Nën 1 vit 1 deri në 5 vjet Mbi 5 vjet

b) pozicionet e rrezikut, të ndjeshme ndaj faktorit të rrezikut “normë e interesit”: *credit default swap*, emetues të kualifikuar.

Bankat krijojnë grupe mbrojtëse të veçanta për çdo emetues të kualifikuar të një instrumenti borxhi referencë, që qëndron në bazë të një *credit default swap*.

Bankat trajtojnë shportën “*nth-to-default*” e *credit default swap*, si më poshtë:

i) bankat përcaktojnë madhësinë e pozicionit të rrezikut në një instrument borxhi referencë, të shportës që qëndron në bazë të një “*nth-to-default*” *credit default swap*, e cila është e barabartë me vlerën nominale efektive të instrumentit të borxhit referencë, shumëzuar me kohëzgjatjen e modifikuar të derivatit “*nth-to-default*”, në lidhje me një ndryshim në marzhin e kredisë (*credit spread*) të instrumentit të borxhit referencë;

ii) bankat, për çdo instrument borxhi referencë të një shporte që qëndron në bazë të një “i” *credit default swap*, përcaktojnë një grup mbrojtës. Pozicionet e rrezikut nga “*nth-to-default*” *credit default swaps* të ndryshme nuk përfshihen në të njëjtin grup mbrojtës.

c) pozicionet e rrezikut, të ndjeshëm ndaj faktorit të rrezikut “normë e interesit”: emetues jo të kualifikuar (bankat konsiderojnë si emetues jo të kualifikuar çdo emetues, për të cilin aplikohet një kërkesë për kapital për rrezikun specifik të portofolit të tregtueshëm, prej më shumë se 1.6%, sipas tabelës 21 të kreut VII të kësaj rregulloreje).

i) bankat, për pozicionet e rrezikut të normave të interesit të lidhura me instrumentet bazë të borxhit që u referohen emetuesve jo të kualifikuar, për pozicionet në para (*payment legs*) të lidhur me të tillë emetues, si edhe për pozicionet e rrezikut nga depozitat në para, që janë vendosur me kundërpartinë si kolateral, përcaktojnë një grup mbrojtës të veçantë për çdo emetues;

ii) bankat mund të përfshijnë në të njëjtin grup mbrojtës, pozicionet e rrezikut që lindin nga instrumentet e borxhit të një emetuesi jo të kualifikuar, pozicionet në para (*payment legs*) të lidhura me të tillë emetues ose nga instrumentet e borxhit referencë të të njëjtit emetues që qëndrojnë në bazë të kredit *default swap*.

d) Pozicionet e rrezikut, të ndjeshme ndaj faktorëve të tjerë të rrezikut.

Bankat përfshijnë në të njëjtin grup mbrojtës instrumentet financiare të ndryshme nga instrumentet e borxhit, vetëm në rast se ato janë instrumente të ngjashme ose identike, ndërsa në rastet e tjera ato përfshihen në grupe mbrojtëse të veçanta.

Ngjashmëria e instrumenteve përcaktohet si më poshtë:

i) për titujt e kapitalit, instrumente të ngjashme janë ato që emetohen nga i njëjti emetues. Indekset e kapitalit (*equity index*) trajtohen si të emetuara nga emetues të veçantë;

ii) për metalet e çmuara, instrumente të ngjashme janë ato të të njëjtit metal. Indekset e metaleve të çmuara trajtohen si metale të çmuara të veçanta;

iii) për energjinë elektrike, instrumente të ngjashme janë ato të drejta dhe detyrime shpërndarjeje, që i referohen të njëjtit interval kohor piku apo jashtë pikut të ngarkesës brenda 24 orëve;

iv) për mallrat (*commodities*), instrumente të ngjashme janë ato të të njëjtit mall (*commodity*). Indekset e mallrave (*commodities*) trajtohen si mallra (*commodities*) të veçantë.

Neni 133

Shumëzuesit e rrezikut të kredisë së kundërpartisë sipas metodës standarde

1. Bankat aplikojnë shumëzuesit e rrezikut të kredisë së kundërpartisë (SHRKK) të përcaktuara në tabelën 19 mbi pozicionet neto të rrezikut që i referohen çdo kategorie të

grupeve të mbrojtjes.

Tabela 19

	Kategoritë e grupeve të mbrojtjes	**SHRKK**
1	Normat e interesit, për pozicionet e rrezikut të lidhura me instrumentet e borxhit të emetuesve të kualifikuar	0.2%
2	Normat e interesit, për pozicionet e rrezikut, të lidhura me një instrument borxhi referencë, të emetuesve të kualifikuar që qëndron në bazë të një *credit default swap*	0.3%
3	Normat e interesit për pozicionet e rrezikut, të lidhura me një instrument borxhi ose instrument borxhi referencë, të emetuesve jo të kualifikuar	0.6%
4	Kursi i këmbimit	2.5 %
5	Energjia elektrike	4 %
6	Ari	5 %
7	Tituj të kapitalit	7 %
8	Metale të çmuara (përveç arit)	8.5%
9	Mallra (*commodities*) të tjera (pa përfshirë metalet e çmuara dhe elektricitetin)	10%
10	Instrumentet bazë të derivativëve mbi banak, të cilat nuk përfshihen në asnjë nga kategoritë e mësipërme	10%

2. Bankat, për transaksionet me profil jolinear rreziku ose për pozicionet në para (*payment legs*) dhe transaksionet me instrumente të borxhit si instrument bazë, për të cilat ato (bankat) nuk mund të përcaktojnë deltën ose kohëzgjatjen e modifikuar, përdorin metodën *mark-to-market*, të përcaktuar në nenin 129 të këtij kreu.

3. Bankat nuk njohin netimin (kompensimin) e transaksioneve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, që nënkupton se vlera e ekspozimit duhet të përcaktohet me supozimin sikur një grup netimi (kompensimi) të përfshinte vetëm një transaksion (domethënë çdo transaksion do të konsiderohet si një grup netimi/kompensimi i veçantë).

4. Bankat hartojnë dhe miratojnë procedura të brendshme për të verifikuar se përpara përfshirjes së një transaksioni në një grup mbrojtjeje, transaksioni është i mbuluar nga një kontratë netimi (kompensimi) ligjërisht e detyrueshme, që përmbush kërkesat e vendosura në nënkreun II të këtij kreu.

NËNKREU II
NETIMI (KOMPENSIMI) KONTRAKTUAL

Neni 134
Llojet e netimit (kompensimit) që njihen nga Banka e Shqipërisë

1. Bankat, për qëllime të këtij nënkreu, me “kundërparti” do të kuptojnë çdo person fizik dhe juridik, që ka fuqinë për të përfunduar marrëveshje netimi (kompensimi) kontraktuale, që nënkupton një marrëveshje të shkruar bilaterale me një kundërparti e cila krijon një detyrim të vetëm ligjor, që mbulon të gjitha marrëveshjet tip dypalëshe.

2. Bankat, për qëllime të zbutjes/zvogëlimit të rrezikut të kredisë së kundërpartisë, konsiderojnë si teknika zbutje tipat e mëposhtëm të netimit (kompensimit):

a) marrëveshjet dypalëshe të zëvendësimit midis bankës dhe kundërpartisë së saj, sipas së cilës të drejtat dhe detyrimet e dyanshme grupohen (shkrihen) automatikisht, në mënyrë të tillë që ky zëvendësim të fiksojë një vlerë neto të vetme sa herë që aplikohet, dhe

krijon kështu një marrëveshje të re ligjore që sjell përfundimin e asaj të mëparshmes;

b) marrëveshje të tjera dypalëshe midis bankës dhe kundërpartisë.

Neni 135

Kërkesat për njohjen e netimit (kompensimit) kontraktual për zvogëlimin e rrezikut të kundërpartisë

1. Banka e Shqipërisë njeh netimin (kompensimin) kontraktual si teknikë që zvogëlon rrezikun e kundërpartisë, vetëm nëse plotësohen kriteret/kushtet e mëposhtme:

a) bankat kanë një marrëveshje netimi (kompensimi) kontraktuale me kundërpartinë e tyre, e cila përfshin edhe dispozitën e kompensimit (*close-out*), ku detyrimet respektive duhet të jenë të vlerësuara sipas vlerës së tregut (*mark-to-market*) të transaksioneve individuale të përfshira;

b) bankat vënë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, opinione të shkruara dhe të argumentuara ligjore, që, në rast të një pretendimi në rastet e parashikuara në shkronjën "a" të këtij paragrafi, gjykatat përkatëse dhe autoritetet administrative do të mund të përfundojnë se të drejtat dhe detyrimet e bankave, do të ishin të kufizuara në shumën neto, siç përshkruhet në këtë shkronjë, sipas:

i) ligjit të juridiksionit, nën të cilin kundërpartia ka drejtorinë qendrore dhe nëse është përfshirë dega e një banke të huaj edhe nën ligjin e juridiksionit në të cilin operon kjo degë;

ii) ligjit që rregullon transaksionet individuale të përfshira; dhe

iii) ligjit që rregullon çdo kontratë, apo marrëveshje të nevojshme për të zbatuar netimin (kompensimin) kontraktual;

c) bankat disponojnë procedurat e nevojshme për të siguruar që vlefshmëria ligjore e netimeve (kompensimeve) kontraktuale është në proces shqyrtimi të vazhdueshëm, duke konsideruar ndryshimet e mundshme të ligjeve, të aplikueshme mbi to;

d) bankat disponojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dosjet e tyre;

e) bankat faktorizojnë efektet e netimit (kompensimit), në matjen e ekspozimit agregat ndaj rrezikut të kredisë për çdo kundërparti dhe administrojnë rrezikun e kredisë së kundërpartisë në këto baza; si dhe

f) bankat agregojnë rrezikun e kredisë për çdo kundërparti, në mënyrë që të përftohet një ekspozim ligjor i vetëm midis transaksioneve. Ky agregim konsideron përcaktimin e kufijve të qëllimit të kredisë, si dhe llogaritjen e kapitalit të brendshëm.

2. Banka e Shqipërisë siguron, duke u konsultuar edhe me autoritetet kompetente të vendeve të tjera në rastet kur shihet e nevojshme, që netimi (kompensimi) kontraktual të jetë ligjërisht i ekzekutueshëm sipas ligjit të secilit prej juridiksioneve përkatëse. Në rast se (Banka e Shqipërisë) nuk krijon bindjen për këtë, marrëveshjet e netimit (kompensimit) kontraktuale nuk do të njihen për asnjërën nga kundërpartitë për qëllime të zvogëlimit të rrezikut.

Neni 136

Efektet e njohjes së netimit (kompensimit) kontraktual

1. Bankat, për qëllime të zbatimit të metodës standarde, njohin netimin (kompesimin) kontraktual, siç përcaktohet në nenet 130-132 të kësaj rregulloreje.

2. Bankat, për qëllime të zbatimit të metodës *mark-to-market* dhe metodës origjinale, njohin netimin (kompensimin) kontraktual, respektivisht siç përcaktohet më poshtë:

a) për kontratat e zëvendësimit:

i) metoda *mark-to-market*: bankat llogarisin koston aktuale të zëvendësimit dhe vlerën nominale, duke konsideruar vlerën neto të kontratave të zëvendësimit;

ii) metoda e ekspozimit origjinal: bankat llogarisin vlerën nominale, duke konsideruar

vlerën neto të kontratave të zëvendësimit dhe aplikojnë përqindjet e tabelës 16 të këtij kreu.

b) për marrëveshjet e tjera të kompensimit:

i) metoda *mark-to-market*: bankat llogarisin koston aktuale të zëvendësimit për kontratat e përfshira në një marrëveshje netimi (kompensimi), duke marrë në konsideratë koston hipotetike aktuale neto të zëvendësimit, që rezulton nga marrëveshja (në rastin kur netimi/kompensimi rezulton në një detyrim neto për bankën që përllogarit koston e zëvendësimit neto; kosto aktuale e zëvendësimit llogaritet si "zero") dhe reduktojnë vlerën e ekspozimeve të mundshme të ardhshme të kredisë, për të gjitha kontratat e përfshira në marrëveshje, sipas formulës së mëposhtme:

EMAK red = 0,4 * EMAK bruto + 0,6 * RNB * EMAK bruto,

ku:

EMAK red = vlera e reduktuar e ekspozimeve të mundshme të ardhshme të kredisë, për të gjitha kontratat me një kundërparti të caktuar, të përfshirë në një marrëveshje netimi (kompensimi) dypalëshe të vlefshme ligjërisht;

EMAK bruto = shuma e vlerave e ekspozimeve të mundshme të ardhshme të kredisë, për të gjitha kontratat me një kundërparti të caktuar, të përfshira në një marrëveshje netimi (kompensimi) dypalëshe, të vlefshme ligjërisht dhe që përllogaritet duke shumëzuar vlerat nominale me përqindjet e caktuara në tabelën 17 të këtij kreu.

RNB = raporti i kostos neto të zëvendësimit për të gjitha kontratat e përfshira në një marrëveshje kompensimi dypalëshe, të vlefshme ligjërisht, me një kundërparti të caktuar (numërues) me koston e zëvendësimit bruto për të gjitha kontratat e përfshira në një marrëveshje kompensimi dypalëshe, të vlefshme ligjërisht me atë kundërparti (emëruesi).

Për të përllogaritur ekspozimet e mundshme të ardhshme të kredisë sipas formulës së mësipërme, kontratat plotësisht të ngjashme të përfshira në marrëveshjet e netimit (kompensimit), mund të konsiderohen si një kontratë e vetme me vlerë nominale ekuivalente me vlerën neto (*net receipt*).

ii) metoda e ekspozimit origjinal: bankat, për qëllime të zbatimit të kësaj metode, konsiderojnë kontratat plotësisht të ngjashme, të përfshira në marrëveshjen e kompensimit, si një kontratë të vetme me vlerë nominale ekuivalente me *net receipt*, ku vlerat nominale shumëzohen me përqindjet e dhëna në tabelën 17, si dhe aplikojnë për të gjitha kontratat e tjera të përfshira në një marrëveshje kompensimi, përqindjet që përcaktohen në tabelën 20.

Tabela 20

Maturiteti fillestar*	**Kontrata të normave të interesit**	**Kontrata të këmbimit valutor**
Më pak se një vit	0.35 %	1.50%
Më shumë se një vit, por jo më shumë se dy vjet	0.75 %	3.75 %
Pagesë shtesë për çdo vit shtesë	0.75 %	2.25 %

*Bankat, në rastin e kontratave të normave të interesit, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të zgjedhin mes maturitetit fillestar dhe maturitetit të mbetur.

NËNKREU III
TRAJTIME TË VEÇANTA TË RREZIKUT TË KUNDËRPARTISË

Neni 137
Rregulla të veçanta për ekspozimet në librin e tregtueshëm

1. Bankat, për qëllime të metodës *mark-to-market*, llogarisin ekspozimin e mundshëm

të ardhshëm të kredisë në rastin e *total return swaps* dhe credit *default swaps*, të përfshirë në librin e tregtueshëm duke shumëzuar vlerën nominale të instrumentit me përqindjet e mëposhtme:

a) 5%, nëse detyrimi referencë do të konsiderohej si pozicion i një emetuesi të kualifikuar sipas nenit 132 të kësaj rregulloreje, në rast se do të përbënte një ekspozim direkt;

b) 10%, nëse detyrimi referencë nuk përmbush kriteret për t'u konsideruar si pozicion i një emetuesi të kualifikuar sipas nenit 132, në rast se do të përbënte një ekspozim direkt.

2. Bankat, në rastet e *credit default swaps* që i krijojnë bankës një pozicion në blerje në detyrimin bazë (ofrues i mbrojtjes), për llogaritjen e ekspozimeve të mundshme të ardhshme të kredisë (për qëllime të metodës *mark-to-market*) përdorin vlerën prej 0%, me kushtin që kontrata e derivativit të kredisë të mos përmbajë klauzolë për mbyllje të kontratës, në rast të paaftësisë paguese të blerësit të mbrojtjes, edhe pse subjekti emetues i detyrimit bazë nuk ka dështuar ende.

3. Bankat përcaktojnë përqindjen për llogaritjen e ekspozimit të mundshëm të ardhshëm për derivatet e kredisë "*nth to default*", si më poshtë:

a) rendisin detyrimet bazë sipas radhës zbritëse të cilësisë së kredisë, duke filluar nga ato jo të kualifikuara sipas rrezikut specifik të pozicionit, sipas kreut VII të kësaj rregulloreje;

b) marrin në konsideratë detyrimin bazë që zë vendin e n-të dhe konsideron faktorin e ponderimit të lidhur me të (për shembull: në rast të kontratës *first-to-default*, faktori i ponderimit përcaktohet duke iu referuar detyrimit referencë që ka cilësi më të ulët në shportë).

4. Bankat, në llogaritjen e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut, për ekspozimet në librin e tregtueshëm, nuk mund të përdorin metodën e thjeshtë, të përcaktuar në nenet 52 deri në 58 të kreut IV të kësaj rregulloreje, për njohjen e efekteve të kolateralit financiar.

5. Bankat, në rastet e marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes së titujve dhe të mallrave (*commodities*), transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes së titujve dhe të mallrave (*commodities*), të regjistruara në librin e tregtueshëm, mund të njohin si kolateral të pranueshëm, të gjitha instrumentet financiare dhe mallrat (*commodities*), të cilat janë të pranueshëm për t'u përfshirë në librin e tregtueshëm.

6. Bankat, për ekspozimet që lidhen me derivativët mbi banak, të regjistruara në librin e tregtueshëm, mund të njohin si kolateral të pranueshëm edhe mallrat (*commodities*) që janë të pranueshme për t'u përfshirë në librin e tregtueshëm.

7. Bankat, për qëllime të llogaritjes së rregullimeve të luhatshmërisë, instrumentet financiare apo mallrat (*commodities*), të cilat nuk janë të zgjedhshme sipas kreut IV, që jepen hua, shiten, apo ofrohen, ose merren hua, blihen, apo pranohen si kolateral në transaksione të tilla dhe bankat përdorin rregullimet mbikëqyrëse të luhatshmërisë sipas kreut IV, i trajtojnë si tituj të kapitalit që nuk përfshihen në një indeks kryesor, të listuara në një bursë të njohur.

8. Bankat, në rastet kur përdorin metodën e brendshme të rregullimit të luhatshmërisë, të përcaktuar në kreun IV të kësaj rregulloreje, për instrumentet financiare dhe mallrat (*commodities*) që nuk janë të pranueshëm sipas kërkesave të këtij kreu (kreut IV), i llogarisin rregullimet e luhatshmërisë për çdo zë më vete.

9. Bankat, për llogaritjen e ekspozimeve, në lidhje me njohjen e marrëveshjeve tip të netimit (kompensimit), që mbulojnë transaksionet e riblerjes dhe/ose transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së titujve dhe/ose të mallrave (*commodities*) dhe/ose transaksione të tjera në tregjet e kapitalit, e njohin netimin (kompensimin) ndërmjet pozicioneve në librin e tregtueshëm dhe jo të tregtueshëm, në rastet kur transaksionet që netohen përmbushin kushtet e mëposhtme:

a) të gjitha transaksionet janë të vlerësuara çdo ditë me vlerë tregu;

b) çdo instrument apo mall (*commodity*) i marrë borxh, i blerë apo i marrë sipas këtyre transaksioneve, njihet si kolateral financiar i pranueshëm.

10. Bankat, në rastet kur një derivativ kredie, i përfshirë në librat e bankës siguron një mbrojtje të brendshme dhe mbrojtja e kredisë është e njohur sipas kreut IV të kësaj rregulloreje, konsiderojnë pozicionin në derivatin e kredisë si pozicion që nuk sjell rrezik të kundërpartisë.

11. Bankat, në mënyrë alternative, mund të përfshijnë në baza konsistente, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital të rrezikut të kredisë së kundërpartisë, të gjithë derivativët e kredisë të regjistruar në librin e tregtueshëm, që formojnë një mbrojtje të brendshme ose të blera si mbrojtje kundrejt rrezikut të kredisë së kundërpartisë, kur mbrojtja njihet si teknikë zbutjeje sipas kërkesave të kreut IV.

KREU VII
RREZIKU I TREGUT

NËNKREU I
LIBRI I TREGTUESHËM

Neni 138
Karakteristika të përgjithshme të librit të tregtueshëm

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, përfshijnë në “librin e tregtueshëm” të gjitha pozicionet në instrumentet financiare e në mallra (*commodities*), të mbajtura me qëllim tregtimin e tyre ose mbrojtjen e elementeve të tjera të librit të tregtueshëm. Këto instrumente duhet të jenë të çliruara nga çdo lloj klauzole/dispozite kufizuese, për sa i përket tregtueshmërisë së tyre ose aftësisë së tyre për t’u mbrojtur tërësisht.

2. Bankat konsiderojnë “pozicione të mbajtura me qëllim tregtimi” ato pozicione, të cilat janë të destinuara për t’u mbyllur brenda një kohe të shkurtër dhe/ose janë pozicione të ndërmarra me qëllim përfitimi brenda një kohe të shkurtër, si rezultat i diferencës midis çmimit të blerjes dhe të shitjes ose i luhatshmërive të tjera në çmim ose në normën e interesit (me “pozicione” nënkuptohen pozicionet e vetë bankës dhe pozicionet e hapura nga shërbimet e bëra klientelës ose duke vepruar si bërës tregu/*market maker*).

3. Bankat konsiderojnë “pozicione të mbajtura me qëllim mbrojtjen e elementeve të tjera të librit të tregtueshëm” ato pozicione, të cilat janë ndërmarrë me qëllim kompensimin tërësisht ose pjesërisht të faktorëve të rrezikut të lidhur me këto elemente.

Neni 139
Politikat dhe procedurat e brendshme për administrimin e pozicioneve të tregtueshëm dhe të librit të tregtueshëm

1. Bankat hartojnë dhe miratojnë politika dhe proceduara të brendshme për administrimin e pozicioneve ose portofolave të tyre të tregtueshme, të cilat përcaktojnë qëllimin për t’u tregtuar dhe përfshijnë minimalisht:

a) një politikë tregtimi qartësisht të dokumentuar, të miratuar nga këshilli drejtues i bankës për pozicionet, instrumentet ose portofolat, e cila duhet të përfshijë edhe periudhën e pritshme të mbajtjes së tyre;

b) procedura të përcaktuara qartë për një administrim aktiv të pozicioneve, të ndërmarra nga njësia e veçantë e tregtimit (*trading desk*), të cilat përfshijnë:

i) përcaktimin e kufijve dhe monitorimin e përshtatshmërisë së tyre;

ii) autonominë/pavarësinë e punonjësve (*dealers*) në krijimin dhe administrimin e

pozicioneve brenda kufijve të miratuar të tyre dhe në përputhje me strategjinë e miratuar;

iii) raportimin e pozicioneve te drejtuesit e lartë të bankës, si pjesë integrale e procesit të administrimit të rrezikut të institucionit;

iv) monitorimin aktiv të pozicioneve në bazë të informacioneve të siguruara nga tregu;

v) vlerësimin mbi tregtueshmërinë ose aftësinë mbrojtëse të pozicionit dhe të komponentëve të rrezikut, si dhe vlerësimin mbi cilësinë dhe disponueshmërinë e të dhënave të tregut, në procesin e përcaktimit të vlerës së instrumentit, nivelin e qarkullimit në treg, madhësinë e pozicionit të tregtuar në treg.

2. Bankat, në përputhje me politikën e tyre të tregtimit, hartojnë procedura të brendshme të përcaktuara qartë për monitorimin e pozicioneve qarkulluese dhe të pozicioneve të pandryshuara/statike në librin e tregtueshëm.

3. Bankat disponojnë procedura të qarta për përcaktimin e pozicioneve, që do të përfshihen në librin e tregtueshëm për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital. Këto procedura duhet të jenë pjesë e sistemit të administrimit të rrezikut nga ana e bankave. Përputhja me këto proceduara është subjekt i kontrollit (auditit) të brendshëm.

4. Bankat hartojnë dhe miratojnë procedura të qarta për administrimin e përgjithshëm të librit të tregtueshëm, të cilat përcaktojnë minimalisht:

a) aktivitetet që ajo (banka) konsideron si të tregtueshëm dhe që përfshihen në librin e tregtueshëm për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital;

b) shkallën në të cilën një pozicion mund të rivlerësohet në baza ditore, duke iu referuar një tregu aktiv dhe likuid, si në blerje ashtu edhe në shitje; dhe

c) për ekspozimet e vlerësuara nëpërmjet modeleve të veçanta (*mark-to-model*), shkallën në të cilën ajo (banka) është në gjendje:

i) të identifikojë të gjitha rreziqet materiale të ekspozimit;

ii) të mbrojë (*hedge*) të gjitha rreziqet materiale të ekspozimit me instrumente, për të cilat ekziston një treg aktiv dhe likuid, si në blerje ashtu edhe në shitje;

iii) të japë vlerësime të besueshme për hipotezat dhe parametrat kryesorë të përdorura në model;

d) shkallën në të cilën, ajo (banka) mund të prodhojë vlerësime të pozicioneve, që mund të vlerësohen nga jashtë në baza të vazhdueshme;

e) shkallën në të cilën, kufizimet ligjore ose kërkesa të tjera operacionale pengojnë aftësinë e bankës për të likuiduar apo mbrojtur një pozicion për një periudhë afatshkurtër;

f) shkallën në të cilën banka mund të administrojë aktivisht rrezikun e pozicionit në kuadrin e aktivitetit të saj të tregtimit;

g) shkallën në të cilën, ajo (banka) mund të transferojë rrezikun ose pozicionet ndërmjet librit të tregtueshëm dhe librit të bankës, si dhe kriteret për të tilla transferime.

Neni 140

Kërkesa specifike të Bankës së Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë përjashtimin nga libri i tregtueshëm, e atyre zërave, të cilët aktualisht ose prej kohësh, nuk kanë tregtueshmëri të dukshme (për shembull, mungesa e likuiditetit dhe e tregtimit të tyre), veçanërisht nëse periudha e mbajtjes së këtyre instrumenteve është më e gjatë se ajo që i korrespondon qëllimit afatshkurtër për tregtim.

2. Banka e Shqipërisë mund të ndalojë përfshirjen në librin e tregtueshëm të atyre zërave, për të cilët bankat nuk kanë burimet, përvojën e nevojshme apo sistemet e duhura të kontrollit për t'i administruar aktivisht.

Neni 141

Mbrojtja e brendshme (*internal hedging*)

1. Bankat përkufizojnë “mbrojtjen e brendshme” si pozicionin që, tërësisht ose në pjesën më të madhe, kompenson rrezikun e një pozicioni ose të një grupi pozicionesh në librat e bankës.

2. Bankat përfshijnë pozicionet e krijuara nga mbrojtjet e brendshme në librin e tregtueshëm, nëse këto pozicione mbahen për qëllime tregtimi dhe nëse plotësohen kriteret e përgjithshme sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 139, dhe vlerësimit të kujdesshëm (*prudencial*) sipas nenit 142. Bankat, në veçanti:

a) sigurojnë që mbrojtjet e brendshme të mos kenë qëllim kryesor zvogëlimin e kërkesës për kapital rregullator, por të jenë të dokumentuara në mënyrën e duhur dhe të jenë subjekt i miratimeve të brendshme dhe i procedurave të kontrollit të brendshëm;

b) trajtojnë transaksionet e brendshme në përputhje me kushtet e tregut dhe administrojnë në mënyrë dinamike, brenda kufijve të lejuar për rrezikun e tregut, që buron nga mbrojtja e brendshme në librin e tregtueshëm;

c) monitorojnë transaksionet e brendshme në mënyrë të kujdesshme, duke përdorur procedurat e duhura dhe të përshtatshme.

3. Trajtimi sipas paragrafit 2 të këtij neni, aplikohet pavarësisht kërkesave për kapital rregullator të aplikueshme ndaj kahut të mbrojtjes së brendshme, që kalon në librat e bankës (*banking bosk leg of the internal hedge*).

4. Bankat, në rastet kur përdorin një derivativ kredie që përfshihet në librin e tregtueshëm për mbulimin e rrezikut të një ekspozimi në librat e bankës dhe një mbulim i tillë sigurohet nëpërmjet mbrojtjes së brendshme, mund të konsiderojnë ekspozimin që përfshihet në librat e bankës si të mbrojtur për qëllime të përcaktimit të kërkesës për kapital të rrezikut të kredisë, me kushtin që banka të blejë nga një palë e tretë, një derivativ kredie që plotëson kriteret e vendosura në kreun IV të kësaj rregulloreje, për të mbrojtur ekspozimin në librat e bankës.

5. Bankat, në rastet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, për qëllime të llogaritjes së kërkesave për kapital, nuk përfshijnë në librin e tregtueshëm derivativin e brendshëm dhe atë të jashtëm.

Neni 142

Kërkesa për vlerësimin e zërave të librit të tregtueshëm

1. Bankat sigurojnë, që vlera e aplikuar mbi secilin nga pozicionet që përfshihet në librin e tregtueshëm pasqyron vlerën e saktë të tregut, i cili duhet të reflektojë natyrën dinamike të pozicioneve të librit të tregtueshëm dhe kërkesat për saktësi, të lidhura me librin e tregtueshëm.

2. Bankat rivlerësojnë pozicionet në librin e tregtueshëm në baza ditore. Në rastet kur një çmim tregu nuk është i disponueshëm ose kur për disa produkte të konvertueshme, çmimi i tregut nuk pasqyron vlerën e brendshme (*intrinsicvalue*) të pozicionit, ato (bankat) përdorin një metodë alternative vlerësimi (*mark-to-model*), pasi kanë njoftuar paraprakisht Bankën e Shqipërisë, me kushtin që kjo metodë të jetë e kujdesshme (*prudente*).

3. Bankat regjistrojnë pozicionet që nga data e tregtimit të transaksionit.

4. Bankat krijojnë dhe zhvillojnë sisteme dhe kontroll të mjaftueshëm për të siguruar vlerësime të besueshme dhe të kujdesshme të rrezikut në librat e tregtueshëm, të cilat duhet të përmbajnë minimalisht elementet e mëposhtme:

a) procedura të dokumentuara (të shkruara) për procesin e vlerësimit, të cilat përcaktojnë qartë:

i) përgjegjësitë sipas strukturave/njësive organizative të përfshira në kryerjen e vlerësimit;

ii) burimet e informacionit të tregut, si dhe rishikim e përshtatshmërisë së tyre;

iii) frekuencën e vlerësimeve të pavarura;

iv) kohën e dhënies së çmimit të mbylljes;

v) proceduarat për rregullimin e vlerësimit, procedurat e verifikimit *ad-hoc* dhe ato të fundit të muajit;

b) linjat e raportimit për njësinë që është përgjegjëse në këtë proces, të cilat duhet të jenë të qarta dhe të pavarura nga njësia operuese (*front-office*).

Linjat e raportimit duhet të shtrihen deri te këshilli drejtues i bankës.

5. Bankat përdorin vlerësimin e zërave/pozicioneve të librit të tregtueshëm të bazuar në vlerën e tregut (*mark-to-market*), i cili nënkupton një vlerësim, të paktën, në baza ditore të pozicioneve në bazë të çmimeve të mbylljes, të publikuara nga burime të pavarura. (Këtu përfshihen çmimet e bursës, çmimet në ekran ose çmimet e dhëna nga ndërmjetës/*broker* të ndryshëm, të pavarur dhe me reputacion të mirë).

6. Bankat, gjatë vlerësimit me çmim tregu (*mark-to-market*), përdorin kuotimin më të kujdesshëm (*prudent*) midis çmimit të ofruar dhe atij të kërkuar (*bid/ask*), me përjashtim të rasteve kur ajo (banka) është bërës tregu (*market maker*) i rëndësishëm për instrumentin financiar dhe mallin (*commodity*) në fjalë, dhe mund të kuotojë një çmim, që përfaqëson mesataren midis çmimit të ofruar dhe atij të kërkuar.

7. Bankat, në rastet kur nuk është i mundur vlerësimi me çmim tregu, vlerësojnë pozicionet/portofolat e tyre bazuar në modele (*mark-to-model*), para aplikimit të kërkesave për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut ("Vlerësim i bazuar në model" nënkupton çdo lloj vlerësimi, që ka për *bench mark* tregun, ekstrapolohet apo llogaritet nga të dhënat e tij (tregut)).

8. Bankat, në rastet që përdorin vlerësimin e bazuar në model (*mark-to-model*), plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) drejtimi i lartë duhet të jenë i informuar mbi instrumentet e librit të tregtueshëm që vlerësohen në bazë të një modeli, si dhe mbi materialitetin e pasaktësive (aftësinë shpjeguese të modelit) që krijohen në raportimin e rrezikut/performancës së bankës;

b) të dhënat e tregut (*market input*), kur është e mundur, të jenë në linjë me çmimet e tregut;

c) përshtatshmëria e të dhënave të tregut për vlerësimin e një pozicioni të veçantë dhe parametrat e modelit, të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme;

d) në rastet kur është e mundur, për instrumente të caktuara financiare ose mallra (*commodities*), të përdoren metodologji vlerësimi, të cilat janë të pranuara gjerësisht nga tregu;

e) në rastet kur modeli është ndërtuar nga vetë banka, ai (modeli) duhet të jetë i bazuar mbi supozime të përshtatshme, të vlerësuara dhe të verifikuara nga palë të kualifikuara, që nuk kanë marrë pjesë në ndërtimin e tij, si dhe në veçanti, modeli të ndërtohet dhe të miratohet në mënyrë të pavarur nga *front-office*;

f) modelet të testohen në mënyrë të pavarur, duke përfshirë vlefshmërinë e strukturës matematikore të hipotezave të ngritura dhe të programimit/*software*-it që është aplikuar;

g) të ekzistojnë procedura formale kontrolli për modifikimet që i bëhen modelit dhe një kopje e modelit të ruhet dhe të përdoret periodikisht për kontrollin e vlerësimeve;

h) strukturat e administrimit të rrezikut të jenë të informuara mbi dobësitë e modelit, të cilat duhet t'i konsiderojnë në vlerësimin e rezultateve të tij;

i) modeli të rishikohet periodikisht për të vlerësuar saktësinë e rezultateve (për shembull duke rivlerësuar përshtatshmërinë e supozimeve, analizat e humbjes dhe fitimit përkundrejt faktorëve të rrezikut, krahasimin e çmimit efektiv të mbylljes me atë që prodhon modeli).

9. Bankat, përveç vlerësimit ditor me vlerë tregu (*mark-to-market*) ose vlerësimit të bazuar në modele (*mark-to-model*), realizojnë edhe një verifikim të pavarur të çmimeve, proces ky me anë të të cilit verifikohen periodikisht për saktësi dhe pavarësi çmimet e tregut ose *input*-et e modelit.

10. Bankat sigurojnë që verifikimi i çmimeve të tregut dhe i *input*-eve të modelit të kryhet nga një njësi e pavarur nga *dealing room*, të paktën me frekuencë mujore, ose më shpesh, sipas natyrës së aktivitetit tregtar.

11. Bankat, në rastet kur nuk mund të sigurojnë verifikime të pavarura të çmimeve dhe burimeve të tregut, konsiderojnë mundësinë e rregullimeve në vlerësimin ose krijimin e rezervave të vlerësimit.

Neni 143

Rregullimet e vlerësimit (*valuation adjustment*) të pozicioneve në librin e tregtueshëm

1. Bankat hartojnë dhe miratojnë procedura të brendshme, që lidhen me rregullimet e vlerësimit apo krijimin e rezervave të vlerësimit.

2. Bankat vlerësojnë mundësinë e kryerjes së rregullimeve të vlerësimit apo të krijimit të rezervave si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:

a) marzheve të parealizuara të kredisë;

b) kostove të mbylljes të pozicioneve;

c) rreziqeve operacionale;

d) mbylljes përpara kohe të pozicioneve;

e) kostove të investimit dhe të financimit;

f) kostove administrative të ardhshme;

g) rrezikut të modelit (nëse konsiderohet e rëndësishme).

3. Bankat krijojnë rezerva të vlerësimit për pozicionet më pak likuide, të cilat mund të jenë rezultat i ngjarjeve në treg dhe/ose i situatave të lidhura me vetë bankën (për shembull, pozicionet e përqendruara dhe/ose pozicionet e pandryshuara/statike).

4. Bankat vendosin për krijimin e rezervave, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, bazuar në faktorët e mëposhtëm:

a) kohën e nevojshme për të mbrojtur pozicionin ose rreziqet brenda pozicionit;

b) luhatshmërinë dhe mesataren e marzheve të ofruara/të kërkuara;

c) gatishmërinë e kuotimeve në treg (numrin dhe identitetin e *market maker*);

d) luhatshmërinë dhe mesataren e vëllimeve të tregtuara;

e) përqendrimet në treg;

f) vjetërsinë e pozicionit;

g) masën, në të cilën vlerësimet mbështeten në vlerësimet sipas modelit (*marking to model*);

h) efektin e rreziqeve të tjera të modelit.

5. Bankat, në rastet kur përdorin vlerësimin e palëve të treta ose vlerësimin e bazuar në modele, marrin në konsideratë nëse duhet të kryejnë rregullim të vlerësimit ose të krijojnë rezerva për pozicionet më pak likuide, si dhe duhet të rishikojnë përshtatshmërinë në baza të vazhdueshme.

6. Bankat zbresin rezervat e vlerësimit nga kapitali rregullator, siç përcaktohet në rregulloren “Për kapitalin rregullator”.

NËNKREU II
KËRKESA PËR KAPITAL PËR RREZIKUN E TREGUT

Neni 144

Llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut

1. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm, siç

specifikohet në kreun III të kësaj rregulloreje, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;

b) gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë euro.

2. Bankat për llogaritjen e aktivitetit në librin e tregtueshëm, vlerësojnë titujt e borxhit me vlerën e tyre të tregut ose vlerën nominale, titujt e kapitalit me vlerën e tyre të tregut dhe derivativët, sipas vlerës nominale ose të tregut të instrumenteve bazë të tyre. Pozicionet në shitje mblidhen me pozicionet në blerje, pavarësisht shenjës së tyre.

3. Bankat janë subjekt i detyrimeve të këtij kreu, nëse tejkalohet një nga kufijtë e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e tregut si shumë e:

a) kërkesës për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm, e cila përfshin:

i) kërkesën për kapital për rreziqet e pozicionit;

ii) kërkesën për kapital për rrezikun e përqendrimit.

b) kërkesës për kapital rregullator për të gjitha pozicionet e bankës (pozicione në librin e tregtueshëm dhe pozicione në librat e bankës), e cila përfshin:

i) kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit;

ii) kërkesën për kapital për rrezikun e pozicioneve në mallra (*commodities*);

iii) kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes.

5. Trajtimi rregullator i opsioneve paraqitet në nenet 175-181 të këtij nënkreu.

Neni 145

Rreziku i pozicionit

1. Rreziku i pozicionit shpreh rrezikun që rrjedh nga luhatshmëria e çmimit të titujve nga faktorë që lidhen me ecurinë e tregjeve, si edhe me situatën e emetuesit.

2. Rreziku i pozicionit, i llogaritur për librin e tregtueshëm të një banke, përfshin dy elemente të dallueshme:

a) rrezikun e përgjithshëm, që përfaqëson rrezikun e humbjeve të shkaktuara nga një prirje e përgjithshme dhe jo e favorshme e çmimeve të titujve në treg (për shembull, për titujt e borxhit ky rrezik është i lidhur me ndryshimet e pafavorshme të normave të interesit, ndërkohë që për titujt e kapitalit është i lidhur me një lëvizje të pafavorshme të vetë tregut); dhe

b) rrezikun specifik, i cili përfaqëson rrezikun e humbjeve të shkaktuara nga luhatshmëritë jo të favorshme të çmimit të instrumenteve financiare, të shkaktuar nga faktorë të lidhur me situatën e emetuesit.

3. Rreziku i pozicionit dhe kërkesa për kapital e lidhur me të përcaktohet, në mënyrë të veçantë, për:

a) titujt e borxhit dhe instrumente të tjera, që varen nga norma e interesit dhe nga aftësia paguese e emetuesit, duke përfshirë derivativët e kredisë;

b) titujt e kapitalit dhe instrumente të tjera financiare, që varen nga ecuria e tregjeve të kapitalit;

c) kuotat/njësitë e pjesëmarrjes në sipërmarrjet e investimit kolektiv dhe në instrumente të tjera financiare, vlera e të cilëve varet nga vlera e sipërmarrjeve të investimit kolektiv (SIK).

Neni 146

Netimi (kompensimi)

1. Diferenca midis pozicioneve në blerje dhe në shitje për të njëjtin titull të kapitalit, titull borxhi, titull të konvertueshëm, kontrata identike të së ardhmes, opsione, garanci apo garanci me mbulesë, përbën pozicionin neto në secilën prej këtyre instrumenteve financiare.

2. Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun specifik, mund të netojnë pozicionet në instrumente borxhi, që rrjedhin nga instrumentet derivateve, përkundrejt pozicioneve kompensuese në këto instrumente borxhi.

3. Bankat konvertojnë në baza ditore të gjitha pozicionet, pavarësisht nga shenja, përpara agregimit të tyre, në monedhën e raportimit të bankës me kursin spot të ditës.

Neni 147

Trajtimi i instrumenteve derivative dhe instrumenteve të tjera për efekt të llogaritjes së rrezikut të pozicionit

1. Bankat, në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit, trajtojnë instrumentet derivative (përveç opsioneve) si kombinime të pozicioneve hipotetike, si më poshtë:

a) kontratat e së ardhmes të normës së interesit në blerje (*long interest-rate futures*) trajtohen si kombinim i një pozicioni në shitje të një titulli të borxhit pa rrezik, me kupon zero, me datë maturiteti atë të kontratës së ardhme të normës së interesit dhe një pozicioni hipotetik në blerje në një titull të borxhit pa rrezik, me kupon zero, me datë maturiteti atë të kontratës së ardhme të normës së interesit, plus periudhën e kontratës (të normës e interesit). Kontratat e së ardhmes së normave të interesit në shitje trajtohen në mënyrë të ngjashme, por duke këmbyer pozicionet në shitje dhe në blerje (për qëllime të llogaritjes së rrezikut specifik, të dyja pozicionet vendosen në kategorinë e parë të tabelës 21);

b) kontratat *forward* të normës së interesit në shitje (*forward-rate agreements*) trajtohen si kombinim i një pozicioni në blerje të një titulli të borxhit pa rrezik, me kupon zero, me datë maturiteti atë të kontratës *forward* të normës së interesit, plus periudhën e kontratës (për normën e interesit) dhe një pozicion hipotetik në shitje të një titulli të borxhit pa rrezik, me kupon zero me datë maturiteti atë të kontratës *forward* të normës së interesit. Kontratat *forward* të normave të interesit për pozicionin në blerje trajtohen në mënyrë të ngjashme, por duke këmbyer pozicionet në shitje dhe në blerje (për qëllime të llogaritjes së rrezikut specifik, të dyja pozicionet vendosen në kategorinë e parë të tabelës 21);

c) kontratat *forward* për të blerë një titull të borxhit do të trajtohen si kombinim i një pozicioni në shitje në një titull borxhi, pa rrezik, me kupon zero, me datë maturiteti atë të kontratës *forward* dhe një pozicioni në blerje në vetë titullin e borxhit. I njëjti trajtim, por duke këmbyer pozicionet në blerje dhe në shitje, bëhet për kontratat *forward* për të shitur një titull të borxhit (për qëllime të llogaritjes së rrezikut specifik, pozicioni në titullin e borxhit pa rrezik vendoset në kategorinë e parë të tabelës 21, ndërsa pozicioni në letrën e borxhit në kolonën që u përgjigjet karakteristikave të saj);

d) kontratat *forward* të monedhës dhe kontratat e së ardhmes të monedhës trajtohen si pozicione hipotetike në blerje/shitje në tituj të borxhit pa rrezik, me kupon zero, në monedhën e blerë/shitur me maturitet të barabartë me atë të kontratës;

e) kontratat *swaps* të normave të interesit dhe të monedhës do të trajtohen si dy pozicione hipotetike në tituj pa rrezik, me maturitet të njëjtë;

i) kontratat *swaps* të normave të interesit trajtohen si kombinim i një pozicioni hipotetik në blerje dhe një pozicioni hipotetik në shitje në instrumente borxhi pa rrezik, me normë fikse ose normë të ndryshueshme dhe maturitete të njëjta;

ii) kontratat *swaps* të monedhave trajtohen si kombinime të pozicioneve hipotetike në shitje dhe në blerje, në një titull të borxhit me rrezik zero, në një monedhë të caktuar, me

normë interesi fikse ose normë interesi të ndryshueshme (në varësi në kontratës) dhe me maturitete të njëjta.

2. Bankat trajtojnë opsionet sipas neneve 175-181.

3. Bankat trajtojnë derivativët e titujve të kapitalit sipas nenit 160.

4. Bankat trajtojnë garancitë e lidhura me instrumentet e borxhit dhe titujt, në të njëjtën mënyrë si instrumentet në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Bankat mund të përfshijnë në librin e tregtueshëm për qëllime të llogaritjes së kapitalit për rrezikun e tregut, pozicionet e krijuara nga marrëveshjet e riblerjes, marrëveshjet e anasjella të riblerjes, transaksionet e huadhënies ose huamarrjes së titujve apo të mallrave (*commodities*), me kusht që këto transaksione të përmbushin kushtet për t'u përfshirë në librin e tregtueshëm dhe përfshirja e tyre në këtë libër do të bëhet në baza të vazhdueshme (konsistente). Pavarësisht se ku janë regjistruar transaksione të tilla, këto janë subjekt i kërkesës për kapital, për rrezikun e kredisë së kundërpartisë.

Bankat trajtojnë:

a) marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e huadhënies si kombinim i një pozicioni në blerje, në instrumentin bazë me maturitet të barasvlershëm me të dhe një pozicioni në shitje në një instrument borxhi pa rrezik, me maturitet dhe normë interesi atë të marrëveshjes përkatëse;

b) marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe për marrëveshjet e huamarrjes, si kombinim i një pozicioni në shitje, në instrumentin bazë me maturitet të barasvlershëm me të dhe një pozicioni hipotetik në blerje në një instrument borxhi pa rrezik, me maturitet dhe normë interesi atë të marrëveshjes përkatëse.

6. Bankat, për trajtimin e obligacioneve të konvertueshme, mund të zgjedhin midis dy metodologjive të ndryshme, respektivisht:

a) e para, bankat përfshijnë obligacionin e konvertueshëm në tituj të borxhit; dhe

b) e dyta, bankat përfshijnë të tilla obligacione në tituj të borxhit ose në tituj të kapitalit, bazuar mbi probabilitetin e konvertimit (nëpërmjet *delta equivalent value*).

Bankat, në rastet kur zgjedhin/përdorin metodologjinë e dytë, duhet të përdorin këtë metodologji për të gjithë portofolin e obligacioneve të konvertueshme.

7. Bankat nuk mund të bëjnë netim midis titullit të konvertueshëm dhe një pozicioni me shenjë të kundërt në instrumentin bazë të saj.

8. Bankat, që nuk përdorin modelet e ndjeshmërisë (*sensibilitetit*), sipas nenit 15, mund të trajtojnë si plotësisht të kompensueshëm çdo pozicion në derivativë të normave të interesit (*forward rate agreements, interest-rate swaps, swap options* etj.) që plotëson, të paktën, kushtet e mëposhtme:

a) pozicionet janë të kompensueshme deri në të njëjtën vlerë nominale (*notional*) dhe janë të denominuara në të njëjtën monedhë dhe të lidhura me të njëjtin instrument bazë;

b) normat e referencës për pozicionet me normë të ndryshueshme janë identike dhe diferenca midis kuponëve, për pozicionet me normë fikse, është jo më shumë se 20 pikë bazë;

c) data e ardhshme e caktimit të normës së interesit ose në rast të pozicioneve me kupon fiks, maturiteti i mbetur, plotëson kushtet e mëposhtme:

i) më pak se një muaj: në të njëjtën ditë;

ii) ndërmjet 1 muaji dhe një viti: brenda 30 ditësh.

Neni 148

Trajtimi i shitësit të mbrojtjes (*protection seller*)

1. Bankat, për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, përveç se kur përcaktohet ndryshe në këtë nënkre, në rastin e shitësit të mbrojtjes (i cili merr përsipër rrezikun e kredisë) trajtojnë pozicionet e krijuara nga derivativët e kredisë si instrumente

borxhi me vlerën e tyre nominale (*notional*).

Bankat, për qëllime të llogaritjes të kërkesës për kapital për rrezikun specifik, me përjashtim të *totalreturn swaps*, përcaktojnë maturitetin e pozicioneve sipas maturitetit të kontratës së derivativit të kredisë, në vend të maturitetit të detyrimit referencë. Në mënyrë të veçantë:

a) *total return swap* trajtohet:

i) për rrezikun e përgjithshëm, si kombinim i një pozicioni në blerje të detyrimit referencë, me maturitet të njëjtë me atë të total *return swaps* dhe një pozicioni në shitje në një instrument borxhi pa rrezik, me maturitet ekuivalent me periudhën deri sa të përcaktohet norma tjetër e interesit;

ii) për rrezikun specifik, si pozicion në blerje në detyrimin referencë.

b) *credit defaults swap* trajtohet:

i) për rrezikun e përgjithshëm, nuk krijohet pozicion;

ii) për rrezikun specifik, si kombinim i një pozicioni sintetik në blerje, në një detyrim të njësisë referencë.

Kur një *credit defaults swap* ka një vlerësim të jashtëm dhe plotëson kushtet për t'u kualifikuar si instrument borxhi, sipas paragrafit 7 të nenit 153, ai trajtohet si një pozicion në blerje në derivativin e dhënë.

Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital, në rastet kur sipas instrumentit në fjalë duhet të paguhet *prim* dhe interesa, trajtojnë këto flukse si pozicione në një instrument borxhi pa rrezik, me normë interesi dhe datë maturiteti të njëjtë me ato të kontratës.

c) *single name credit linked note* trajtohet:

i) për rrezikun e përgjithshëm, si pozicion në blerje në vetë këtë notë, të trajtuar si një produkt i normës së interesit;

ii) për rrezikun specifik, si pozicion sintetik në blerje në detyrimin e subjektit referencë dhe si pozicion në blerje përkundrejt emetuesit të notes.

Bankat, për qëllime të llogaritjes të kërkesës për kapital për rrezikun specifik, në rastet kur një *single namecredit linked note* ka një vlerësim të jashtëm dhe plotëson kushtet për t'u kualifikuar si instrument borxhi, sipas paragrafit 7 të nenit 153, do t'i trajtojnë ato vetëm si pozicione në instrument borxhi (vetë notën).

d) *multiple name credit linked note* trajtohet:

i) për rrezikun e përgjithshëm, si pozicion në blerje në një instrument borxhi (vetë nota);

ii) për rrezikun specifik, ky instrument, duke siguruar mbrojtje proporcionale, krijon disa pozicione në blerje, në secilën prej njësive referencë, në një vlerë ekuivalente të peshës që zë çdo njësi referencë ndaj vlerës nominale (*notional*) të vetë notës.

Bankat, për efekt të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun specifik, në rast se ekziston më shumë se sa një detyrim për një njësi referencë, do të konsiderojnë si faktor ponderimi, atë më të lartin ndër faktorët e ponderimit të këtyre detyrimeve.

Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun specifik, në rastet kur një *multiple name credit linked note* ka një vlerësim të jashtëm dhe plotëson kushtet për t'u trajtuar si instrument borxhi, i kualifikuar sipas paragrafit 7 të nenit 153, do t'i trajtojnë ato vetëm si pozicion në blerje në një instrument borxhi (në vetë notën);

e) derivativi i kredisë *first-asset-to-default* trajtohet:

i) për rrezikun specifik, si pozicion në blerje, në secilën prej detyrimeve referencë të kontratës të derivativit të kredisë.

Në qoftë se vlera maksimale e pagesës, në rastin e një kredie, është më e vogël se kërkesa për kapital për pozicionet e krijuara si më sipër, vlera maksimale e pagesës do të

merret si kërkesë për kapital për rrezikun specifik;

ii) për rrezikun e përgjithshëm, në rast se sipas kontratës së instrumentit në fjalë duhet të paguhet prim dhe interesa, këto flukse duhet të trajtohen si pozicione në një instrument borxhi pa rrezik, me normë interesi dhe datë maturiteti të njëjtë me ato të kontratës.

Bankat, për qëllime të llogaritjes të kërkesës për kapital për rrezikun specifik, në rastet kur një derivativ i kredisë *first-asset-to-default* ka një vlerësim të jashtëm dhe plotëson kushtet për t'u trajtuar si instrument borxhi, i kualifikuar sipas paragrafit 7 të nenit 153, do të trajtojnë atë si pozicion në një instrument borxhi, që pasqyron vlerësimin e vetë derivativit;

f) derivativi i kredisë *n-th asset-to-default* trajtohet:

i) për rrezikun specifik të pozicionit, krijon pozicion në blerje në detyrimin e secilës prej njësive referencë minus *nth*-1 pozicione (ato që kanë kërkesën më të ulët për kapital për rrezikun specifik).

Në qoftë se vlera maksimale e pagesës, në rastin e një kredie, është më e vogël se kërkesa për kapitalin e përllogaritur për pozicionet e krijuara si më sipër, vlera maksimale e pagesës do të merret si kërkesë për kapital;

ii) për rrezikun e përgjithshëm, në rast se, sipas kontratës së instrumentit në fjalë, duhet të paguhet prim dhe interesa, këto flukse duhet të trajtohen si pozicione në një instrument borxhi pa rrezik, me normë interesi dhe datë maturiteti të njëjtë me ato të kontratës.

Bankat, për qëllime të llogaritjes të kërkesës për kapital për rrezikun specifik, në rastet kur një derivat i kredisë *nth-asset-to-default* ka një vlerësim të jashtëm dhe plotëson kushtet për t'u trajtuar si instrument borxhi i kualifikuar sipas paragrafit 7 të nenit 153, do të trajtojnë atë si pozicion në një instrument borxhi, që pasqyron vlerësimin e derivativit.

Neni 149

Trajtimi i blerësit të mbrojtjes (*protection buyer*)

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit, në rastin e blerësit të mbrojtjes, trajtojnë pozicionet e krijuara në kontratat e derivativëve të kredisë, në të njëjtën mënyrë, si edhe shitësi i mbrojtjes, por me shenjë të kundërt, me përjashtim të *credit linked notes*, të cilat nuk krijojnë pozicion në shitje në vetë instrumentin e borxhit.

2. Bankat, në rastet kur, në një datë të caktuar, ekziston një opsion *call*, i kombinuar me një *step-up*, konsiderojnë këtë datë si maturitet të mbrojtjes.

3. Bankat, në rast të derivateve të kredisë *first-to-default dhe nth-to-default*, bëjnë trajtimet e mëposhtme:

a) derivatet e kredisë *first-to-default*: kur një bankë blen mbrojtje kredie për një numër njësish referencë, sipas kushteve/termave që aktivi i parë që dështon çon në kryerjen e pagesës dhe kjo ngjarje kredie sjell përfundimin e kontratës, mund të kompensojë (*offset*) rrezikun specifik për njësinë referencë, ndaj të cilës aplikohet kërkesë më e ulët për kapital ndër njësitë e tjera referencë, sipas tabelës 21 të këtij kreu;

b) derivatet e kredisë *nth-to-default*: kur falimentimi i n-të midis ekspozimeve çon në kryerjen e pagesës, blerësi i mbrojtjes së kredisë mund të kompensojë (*offset*) rrezikun specifik, në rast së mbrojtja është përfituar edhe për dështimet 1 deri në n-1, ose kur n-1 *defaults* kanë ndodhur tashmë. Në të tilla raste, metodologjia e përcaktuar për *first to default credit derivative* aplikohet edhe për produktet *n-th to default*.

Neni 150

Modelet e ndjeshmërisë

1. Bankat të cilat vlerësojnë dhe administrojnë rrezikun e normës së interesit që rrjedh nga instrumentet derivativë, duke u mbështetur në aktualizimin e flukseve të ardhshme të parasë, mund të përdorin modelet e ndjeshmërisë, për të llogaritur pozicionet në këto instrumente.

2. Bankat mund t'i përdorin modele të tilla edhe për llogaritjen e pozicioneve në obligacione, por vetëm në rast se këto obligacione gjenerojnë fluks parash përgjatë maturitetit të mbetur të obligacionit. Pozicionet e llogaritura në këtë mënyrë përfshihen në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e përgjithshëm të normave të interesit, sipas njërës prej metodave të përcaktuara në nenet 155 dhe 156.

3. Bankat përdorin modelet e ndjeshmërisë (sensibilitetit), të referuara më sipër, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë, me kushtin që të plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) pozicionet e përfituara nga ky model të kenë të njëjtën ndjeshmëri (sensibilitet) ndaj ndryshimit të normave të interesit, ashtu si edhe instrumentet bazë; dhe

b) ndjeshmëria (sensibiliteti) e pozicioneve ndaj ndryshimit të normave të interesit të vlerësohet, duke pasur si referencë, një kampion normash interesi përgjatë kurbës së normave të kthimit, me të paktën një pikë sensibiliteti në secilën prej segmenteve të maturitetit, të përcaktuara në metodën e bazuar në maturitet (tabela 22).

4. Bankat plotësojnë, në baza të vazhdueshme, kushtet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, duke filluar që nga dita që është marrë miratimi nga Banka e Shqipërisë.

5. Bankat që aplikojnë për marrjen e miratimit paraprak për përdorimin e modelit, paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm, që evidenton:

a) llojet e instrumenteve financiare, ndaj të cilave do të aplikohet modeli i ndjeshmërisë (sensibilitetit);

b) supozimet bazë, mbi të cilat mbështetet modeli; dhe

c) plotësimin e kritereve, të përcaktuara në paragrafin 3, të këtij neni.

6. Banka e Shqipërisë, në rastet kur banka nuk respekton (plotëson) gjatë veprimtarisë së saj kriteret/kushte në bazë të cilave ajo (Banka e Shqipërisë) ka dhënë miratimin paraprak, duhet të paraqesë një plan masash, me afate të përcaktuara, për plotësimin e kritereve/kushteve ose të vërtetojë/argumentojë që efekti i mosplotësimit të këtyre kushteve, nuk është i rëndësishëm për përdorimin e modelit.

7. Banka e Shqipërisë revokon miratimin e dhënë për përdorimin e modelit të ndjeshmërisë (*sensitivity model*), në rastet kur:

a) bankat nuk plotësojnë rekomandimet/masat mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë për mënjanimin/shmangien e parregullsive; si dhe

b) mosplotësimi i kritereve/kushteve të bankës me ato të përcaktuara në këtë kre janë të rëndësishme për përdorimin e modelit.

Neni 151

Rreziku specifik për pozicionet në librin e tregtueshëm të mbrojtur nga derivativët e kredisë

1. Bankat, mund të zbusin rrezikun specifik për pozicionet në librin e tregtueshëm të mbrojtur nga derivativët e kredisë, në përputhje me kërkesat e këtij neni.

2. Bankat, në rastet kur vlera e një pozicioni në blerje/shitje në librin e tregtueshëm dhe ajo e një pozicioni shitje/blerje të krijuar nga derivativi i kredisë, lëvizin gjithmonë në drejtime të kundërta dhe kanë afërsisht të njëjtën madhësi, i përjashtojnë të dy pozicionet nga llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun specifik.

3. Bankat aplikojnë një përjashtim të tillë (siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni) në situatat/rastet e mëposhtme:

a) pozicionet e krijuara i referohen instrumenteve tërësisht të njëjta (identike); ose

b) një pozicion *cash* në blerje mbrohet nga një *total rate of return swap* dhe ekziston

një përputhje e plotë ndërmjet detyrimit referencë dhe ekspozimit në librin e tregtueshëm (pozicioni *cash*). Me përputhje të plotë nuk nënkuptohet maturiteti i vetë *total return swap*-it, i cili mund të jetë i ndryshëm nga ai i ekspozimit në librin e tregtueshëm.

4. Bankat, në rastet kur vlera e një pozicioni në blerje/shitje në librin e tregtueshëm dhe ajo e një pozicioni shitje/blerje të krijuar nga derivativi i kredisë, lëvizin gjithmonë në drejtime të kundërta, por jo në të njëjtën shkallë, zvogëlojnë kërkesën për kapital për rrezikun specifik në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) ekziston një përputhje e plotë në termat e detyrimit referencë, maturitetit të detyrimit referencë dhe derivativit të kredisë dhe të monedhës të ekspozimit në librin e tregtueshëm; dhe

b) karakteristikat kryesore të kontratës së derivativit të kredisë (përcaktimi i ngjarjes së kredisë, sistemi i shlyerjes) nuk shkaktojnë devijime materiale të vlerës së tregut të derivativit, nga vlera e tregut e pozicionit në librin e tregtueshëm.

5. Bankat, në rastet kur një transaksion që plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni transferon rrezikun, reduktojnë (*offset*) kërkesën për kapital për rrezikun specifik me 80%, për kahun e transaksionit që ponderohet me peshë më të madhe (sipas rrezikut specifik), ndërsa kërkesa për kapital për kahun tjetër do të jetë 0%.

6. Bankat, në rastet kur vlera e një pozicioni në blerje/shitje në librin e tregtueshëm dhe ajo e një pozicioni shitje/blerje të krijuar nga derivativi i kredisë, zakonisht lëvizin në drejtime të kundërta, mund të aplikojnë reduktime të pjesshme të kërkesës për kapital për rrezikun specifik, në rastet kur:

a) pozicionet e krijuara nga mbrojtja e kredisë plotësojnë kushtet e shkronjës “b”, të paragrafit 4, të këtij neni, por ekziston një mospërputhje midis llojit të detyrimit referencë dhe ekspozimit të krijuar nga pozicioni në librat e bankës. Megjithatë, këto pozicione plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

i) detyrimi referencë radhitet në të njëjtin nivel (*pari passu*) ose në një nivel më të ulët (*junior*) përparësie, krahasuar me ekspozimin e krijuar në librin e tregtueshëm (ekspozimin/detyrimin që mbrohet); dhe

ii) detyrimi referencë dhe ekspozimi i krijuar nga pozicioni në librat e bankës kanë të njëjtin subjekt referencë (*obligor*) dhe kanë klauzola ligjërisht të detyrueshme *cross-defaulf* dhe *cross-acceleration default*;

b) pozicionet e krijuara plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 3 shkronja “a”, ose në paragrafin 4 të këtij neni, por ekziston një mospërputhje në monedhë ose në maturitet midis mbrojtjes së kredisë dhe pozicionit në librin e tregtueshëm;

c) pozicionet e krijuara plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, por ekziston një mospërputhje në llojin e instrumentit ndërmjet pozicionit në librin e tregtueshëm (pozicionit *cash*) dhe derivativit të kredisë (ekspozimi në dokumentacionin e derivatit të kredisë përcaktohet si një nga detyrimet e mundshme të dorëzueshme).

7. Bankat, në rastet e situatave sipas paragrafit 6 të këtij neni, llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun specifik, vetëm për atë anë të transaksionit (derivativit të kredisë ose pozicionit të mbrojtur), për të cilin përllogaritet kërkesë më e lartë për kapital për rrezikun specifik.

8. Bankat, në të gjitha rastet e tjera, të cilat nuk përfshihen në paragrafët e mësipërm të këtij neni, llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun specifik për derivativin e kredisë dhe për pozicionin e mbrojtur.

Neni 152

Rreziku i pozicionit për titujt e borxhit

1. Bankat klasifikojnë pozicionet neto në instrumente borxhi, sipas monedhave në të cilat janë denominuar.

2. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun specifik dhe atë të përgjithshëm, për secilën monedhë në mënyrë të veçantë.

Neni 153

Rreziku specifik për titujt e borxhit

1. Bankat përfshijnë pozicionet neto në instrumentet e borxhit, të llogaritura sipas nenit 146, në një nga kategoritë sipas tabelës 21, në bazë të emetuesit, të vlerësimeve të brendshme apo të jashtme të kredisë dhe të maturitetit të mbetur dhe, më pas i shumëzojnë ato me peshat e specifikuara po në këtë tabelë.

2. Bankat, për qëllime të llogaritjes së kapitalit rregullator për rrezikun specifik, mbledhin vlerën absolute të pozicioneve të ponderuara, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni.

Tabela 21

Kategoritë	**Kërkesa për kapital**
a) Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveritë qendrore, të emetuar nga bankat qendrore, nga organizata ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose nga autoritetet lokale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe të Republikës së Shqipërisë, që do të kualifikoheshin sipas shkallës 1 të cilësisë së kredisë ose do të ponderoheshin me 0%, sipas kreut III të kësaj rregulloreje.	0%
b) - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveritë qendrore, të emetuar nga bankat qendrore, nga organizata ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose nga autoritetet lokale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe të Republikës së Shqipërisë, që do të kualifikoheshin në shkallën 2 ose 3 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje. - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga institucione që do të kualifikoheshin në shkallën 1 ose 2 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje. - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga shoqëri tregtare (korporata), që do të kualifikoheshin në shkallën 1, 2 ose 3 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje. - Pozicione të tjera, të kualifikuara sipas paragrafit 7 të këtij neni.	0.25 % (maturitet i mbetur më pak ose i barabartë me 6 muaj) 1% (maturitet i mbetur më i madh se 6 muaj, më i vogël ose i barabartë me 24 muaj) 1.6 % (maturitet i mbetur më i madh se 24 muaj)

c) - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveritë qendrore, të emetuar nga bankat qendrore, nga organizata ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose nga autoritetet lokale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe të Republikës së Shqipërisë ose që do të kualifikoheshin në shkallën 4 ose 5 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje. - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga institucione, që do të kualifikoheshin në shkallën 3 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje. - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga shoqëri tregtare (korporata), që do të kualifikoheshin në shkallën 4 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje. -Ekspozimet, për të cilat nuk ka një vlerësim të cilësisë së kredisë nga ECAI-të e emëruara.	8%
d) - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveritë qendrore, të emetuar nga bankat qendrore, nga organizata ndërkombëtare, nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit, ose nga qeveritë rajonale ose nga autoritetet lokale të shteteve anëtare të Bashkimit Europian ose të Republikës së Shqipërisë ,që do të kualifikoheshin në shkallën 6 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje. - Tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga shoqëri tregtare (korporata), që përmbushin kriteret për dhënien e një grade të shkallës së vlerësimit të cilësisë së kredisë të barabartë me 5 ose 6, sipas kreut III të kësaj rregulloreje.	12%

3. Bankat nuk llogarisin rrezik specifik për instrumentet e veta të borxhit, të përfshira në librin e tregtueshëm.

4. Bankat përdorin peshën maksimale sipas tabelës 21 (12%) për instrumentet e borxhit, për të cilët rreziku është në rritje, si rezultat i paaftësisë paguese të emetuesit ose likuiditetit në rënie të instrumentit.

5. Bankat ponderojnë me 8% ose 12 % instrumentet e borxhit, të cilat emetohen nga emetues të pakualifikuar, sipas tabelës 21. Banka e Shqipërisë mund t'u kërkojë bankave të aplikojnë një peshë më të lartë rreziku për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun specifik për këto instrumente dhe/ose të mos lejojë mundësinë e kompensimit (*offsetting*), me çdo lloj tjetër instrumenti borxhi, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e përgjithshëm.

6. Ekspozimet në titullzime, që janë elemente zbritëse në llogaritjen e kapitalit rregullator ose ponderohen me një peshë rreziku prej 1250%, siç përcaktohet në kreun V të kësaj rregulloreje, janë subjekt i mbulimit me kapital, jo më të vogël se ai i vendosur sipas këtyre trajtimeve. Bankat, për instrumentet e likuiditetit jo subjekt i klasifikimit (*rating*), parashikojnë një mbulim kapitali jo më të vogël se ai i vendosur në nënkreun IV të kreut III të kësaj rregulloreje.

7. Bankat, për qëllime të përdorimit të tabelës 21, do të përfshijnë në termin "pozicione të tjera të kualifikuara", pozicionet e mëposhtme:

a) pozicionet në shitje dhe në blerje në instrumente borxhi, që plotësojnë kërkesat për t'u caktuar në një nga klasat e aftësisë paguese me cilësi të lartë (*investment grade*), në kuadër të metodës të standardizuar të rrezikut të kredisë;

b) pozicionet në shitje dhe në blerje në instrumente borxhi, për të cilat nuk janë të disponueshme vlerësime të aftësisë paguese nga ECAI-të e emëruara dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i) konsiderohen nga banka si mjaft likuide;

ii) sipas gjykimit të bankës, cilësia e investimeve është, të paktën, e barasvlershme me pozicionet e shkronjës "a" të këtij paragrafi; dhe

iii) janë të listuara, të paktën, në një treg të rregulluar të një vendi të BE-së dhe në Republikën e Shqipërisë, ose në një bursë të një vendi të tretë, në rast se kjo e fundit është e njohur nga autoritetet kompetente të vendit të BE-së dhe nga Republika e Shqipërisë;

c) pozicione në shitje dhe në blerje në instrumente borxhi, të emetuara nga banka (institucione) të tjera, të cilat sipas gjykimit të vetë bankës janë mjaftueshëm likuide dhe cilësia e kredisë së tyre është të paktën sa ajo e titujve të borxhit sipas shkronjës "a" të këtij paragrafi;

d) pozicionet në tituj të lëshuar nga banka të tjera (institucione) që kanë një cilësi kredie ekuivalente ose më të lartë se sa ato që janë të lidhura me shkallën 2 të cilësisë së kredisë, sipas kreut III të kësaj rregulloreje, për ekspozimet ndaj institucioneve, dhe janë subjekt i një regjimi mbikëqyrës të ngjashëm me atë që aplikohet ndaj vetë bankave.

Neni 154

Metodat për llogaritjen e rrezikut të përgjithshëm për titujt e borxhit

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së rrezikut të përgjithshëm të titujve të borxhit, mund të përdorin dy metoda alternative:

a) metodën e bazuar mbi maturitetin e titujve;

b) metodën e bazuar mbi kohëzgjatjen financiare (*duration*).

2. Bankat, të cilat për qëllime të llogaritjes së rrezikut të përgjithshëm përdorin metodën e bazuar mbi kohëzgjatjen financiare (*duration*), nuk mund të revokojnë (të tërheqin) përdorimin e saj, vetëm me përjashtim të rasteve të veçanta.

Neni 155

Metoda e bazuar mbi maturitetin

1. Bankat, që përdorin metodën e bazuar mbi maturitetin, ndjekin tre hapat e përcaktuar në vijim në shkronjat "a", "b" dhe "c":

a) ponderojnë pozicionet neto të përcaktuar më parë (instrument pas instrumenti dhe sipas maturitetit të mbetur):

i) shpërndajnë pozicionet neto në secilën prej segmenteve të përshtatshme të maturitetit sipas tabelës 22, në bazë të maturitetit të mbetur në rastin e titujve të borxhit me norma fikse dhe në bazë të periudhës së mbetur deri në vendosjen e normës së re të interesit, në rastin e titujve të borxhit me normë interesi të ndryshueshme, duke bërë dallimin midis titujve me kupon 3% dhe atyre me kupon më të lartë se 3%;

ii) shumëzojnë (ponderojnë) çdo pozicion neto me peshat e rrezikut sipas kolonës 4 të tabelës 22 (peshat e ponderimit janë të përcaktuara në mënyrë të tillë, që të pasqyrojnë ndjeshmërinë e tyre ndaj lëvizjeve të përgjithshme të normave të interesit);

iii) llogarisin shumën e të gjitha pozicioneve të ponderuara në blerje dhe atyre në shitje, duke përcaktuar pozicionet e ponderuara në blerje dhe në shitje për çdo segment maturiteti;

Tabela 22

Zonat	Segmentet e maturitetit		Peshat e ponderimit	Ndryshimi i supozuar në normat e interesit në (%)
	Kuponi më i madh ose i barabartë me 3%	Kuponi më i vogël se 3%		
Zona 1	0 ≤ 1 muaj	0 ≤ 1 muaj	0%	-
	>1 ≤ 3 muaj	>1 ≤ 3 muaj	0.2%	1%
	> 3 ≤ 6 muaj	> 3 ≤ 6 muaj	0.4%	1%
	> 6 ≤ 12 muaj	> 6 ≤ 12 muaj	0.7%	1%
Zona 2	> 1 ≤ 2 vjet	> 1.0 ≤ 1.9 vjet	1.25%	0.9%
	> 2 ≤ 3 vjet	> 1.9 ≤ 2.8 vjet	1.75%	0.8%
	> 3 ≤ 4 vjet	> 2.8 ≤ 3.6 vjet	2.25%	0.75%
Zona 3		> 3.6 ≤ 4.3 vjet	2.75%	0.75%
	>4 ≤ 5 vjet	> 4.3 ≤ 5.7 vjet	3.25%	0.7%
	> 5 ≤ 7 vjet	> 5.7 ≤ 7.3 vjet	3.75%	0.65%
	> 7 ≤ 10 vjet	> 7.3 ≤ 9.3 vjet	4.5%	0.6%
	> 10 ≤ 15 vjet	> 9.3 ≤ 10.6 vjet	5.25%	0.6%
	> 15 ≤ 20 vjet	> 10.6 ≤ 12.0 vjet	6%	0.6%
	> 20 vjet	> 12.0 ≤ 20.0 vjet	8%	0.6%
		> 20 vjet	12.5%	0.6%

b) kompensojnë pozicionet neto të ponderuara si më poshtë:

i) referuar çdo segmenti maturiteti: kompensojnë pozicionin e ponderuar në blerje me pozicionin e ponderuar në shitje, për çdo segment maturitetit (pozicioni i ponderuar në shitje ose në blerje, që ka vlerë më të vogël përbën pozicionin e ponderuar të kompensuar të segmentit të maturitetit, ndërkohë diferenca midis dy pozicioneve përfaqëson pozicionin e ponderuar, të pakompensuar në shitje/blerje të segmentit të maturitetit);

ii) referuar çdo zone: llogarisin pozicionin e ponderuar në shitje dhe në blerje të pakompensuar të çdo zone, si shumë e pozicioneve të ponderuara, të pakompensuara në blerje dhe në shitje, të gjitha segmenteve të maturitetit brenda secilës zonës përkatëse, dhe kompensojnë pozicionin e ponderuar të pakompensuar në blerje me atë në shitje, brenda secilës zonë (pozicioni, që ka vlerën më të vogël midis tyre përbën pozicionin e kompensuar të ponderuar të zonës në fjalë, ndërkohë diferenca midis dy pozicioneve përbën pozicionin e ponderuar të pakompensuar të zonës);

iii) ndërmjet zonave: llogarisin vlerën e pozicionit të ponderuar në blerje (shitje) të pakompensuar në zonën një, që kompensohet nga pozicioni i ponderuar i pakompensuar në shitje (blerje) në zonën dy, e cila përbën pozicionin e kompensuar të ponderuar midis zonave 1 dhe 2 (pjesa e mbetur e pozicionit të ponderuar të pakompensuar të zonës dy, që kompensohet nga pozicioni i ponderuar i pakompensuar i zonës 3 përbën pozicionin e kompensuar midis zonës 1 dhe 3).

Bankat mund të kryejnë llogaritjet e mësipërme edhe në të kundërt. Pra, fillimisht llogaritet pozicioni i ponderuar i kompensuar midis zonës dy dhe tre e më pas midis zonës dy dhe një.

Pozicioni i ponderuar i pakompensuar i mbetur në zonën 1 pas kompensimit me zonën 2, që kompenson pozicionin e pakompensuar që mbetet në zonën 3, pas kompensimit me zonën 2, përbën pozicionin e kompensuar midis zonës 1 dhe 3. Shuma e të gjitha pozicioneve të ponderuara, të pakompensuara, të mbetura në të gjitha zonat, përbën pozicionin total të ponderuar, të pakompensuar;

c) llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e përgjithshëm të titujve të borxhit si shumë të komponentëve të mëposhtëm:

i) 10% të totalit të pozicioneve të ponderuara, të kompensuara në të gjitha segmentet e maturitetit;

ii) 40% të pozicionit të ponderuar, të kompensuar në zonën 1;

iii) 30% të pozicionit të ponderuar, të kompensuar të zonës 2;

iv) 30% të pozicionit të ponderuar, të kompensuar të zonës 3;

v) 40% të pozicionit të ponderuar, të kompensuar midis zonës 1 dhe 2 dhe midis zonës 2 dhe 3;

vi) 150% të pozicionit të ponderuar, të kompensuar midis zonave 1 dhe 3;

vii) 100% të pozicionit total të ponderuar, të pakompensuar.

Neni 156

Metoda e bazuar mbi kohëzgjatjen financiare (*duration*)

1. Bankat që përdorin metodën e bazuar mbi kohëzgjatjen financiare ndjekin hapat e përcaktuar sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “d”, në vijim:

a) llogarisin kohëzgjatjen e modifikuar për çdo titull të borxhit.

Bankat, llogarisin fillimisht për instrumentet e borxhit me normë fikse interesi, normën e kthimit deri në maturitet (norma e zbritjes për këtë instrument), bazuar në vlerën e tregut dhe për instrumentet me normë të ndryshueshme interesi, llogarisin normën e tyre të kthimit, bazuar në vlerën e tregut, duke supozuar se vlera nominale paguhet në momentin kur ndryshon norma e ardhshme e interesit).

Metodat e llogaritjes së normës së kthimit deri në maturitet aplikohen në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha pozicionet e librit të tregtueshëm, për të cilat bankat llogarisin rrezikun e përgjithshëm për titujt e borxhit.

Kohëzgjatja financiare e modifikuar për çdo instrument borxhi përllogaritet në bazë të formulës së mëposhtme:

Dmod= D/1+r,

ku:

Dmod = kohëzgjatja e modifikuar;

D = duration:

$$D = \frac{\sum_{t=1}^{m} \frac{tC_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^{m} \frac{C_t}{(1+r)^t}}$$

r = norma e kthimit deri në maturitet;

Ct = pagesat *cash* në kohën t;

m = maturiteti;

t = koha;

b) shpërndajnë pozicionet sipas zonave të kohëzgjatjes.

Bankat vendosin secilin prej instrumenteve të borxhit në zonën e duhur sipas tabelës 23, duke u bazuar në kohëzgjatjen e modifikuar të secilit instrument. Bankat llogarisin pozicionin e kohëzgjatjes së ponderuar për çdo instrument, duke shumëzuar çmimin e tregut të instrumentit me kohëzgjatjen e modifikuar dhe me ndryshimet e supozuara të normave të interesit.

Tabela 23

Zonat	Kohëzgjatja e modifikuar	Ndryshimi i supozuar në normat e interesit në (%)
1	> 0.0 ≤ 1.0	1.00
2	> 1.0 ≤ 3.6	0.85
3	> 3.6	0.70

c) kompensojnë pozicionet brenda zonave dhe ndërmjet zonave.

Bankat, për të llogaritur pozicionet e kompensuar, aplikojnë mënyrën e përshkruar në metodën e maturitetit, duke përllogaritur pozicionet e kompensuara dhe të pakompensuara;

d) llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e përgjithshëm si shumë të:

i) 2% të pozicioneve të kohëzgjatjes së ponderuar për secilën zonë;

ii) 40% të pozicioneve të kohëzgjatjes së ponderuar të kompensuar midis zonës 1 dhe zonës 2;

iii) 40% të pozicioneve të kohëzgjatjes së ponderuar të kompensuar midis zonës 2 dhe zonës 3;

iv) 150% të pozicionit të kohëzgjatjes së ponderuar të kompensuar midis zonës 1 dhe zonës 3; dhe

v) 100% të pozicioneve të kohëzgjatjes së ponderuar të pakompensuar të mbetur.

Neni 157

Kërkesa të përgjithshme për pozicionet në titujt e kapitalit

1. Bankat mbledhin të gjitha pozicionet e tyre neto në shitje dhe të gjitha pozicionet e tyre neto në blerje për një titull të kapitalit, të llogaritura në përputhje me nenin 146.

2. Shuma e dy shifrave, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përbën pozicionin e përgjithshëm bruto.

3. Diferenca midis dy shifrave, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përbën pozicionin e përgjithshëm neto.

Neni 158

Rreziku specifik për titujt e kapitalit

1. Bankat shumëzojnë pozicionin e përgjithshëm bruto, të përcaktuar sipas paragrafit 2 të nenit 157, me 4%, për të llogaritur kërkesat për kapital për rrezikun specifik.

2. Bankat, pavarësisht sa përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, mund të llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun specifik, duke shumëzuar pozicionin e përgjithshëm bruto me 2% për ato portofola aksionesh që përmbushin kushtet e mëposhtme:

a) aksionet nuk janë lëshuar nga emetues që kanë emetuar vetëm instrumente borxhi të tregtueshëm, që aktualisht trajtohen me një kërkesë për kapital prej 8% ose 12% sipas tabelës 21 ose që trajtohen me një kërkesë më të ulët për kapital, sepse janë të garantuara ose të siguruara;

b) aksionet gjykohen si shumë likuide nga ana e Bankës së Shqipërisë sipas kritereve objektive; dhe

c) asnjë pozicion individual nuk përbën më shumë se 5% të vlerës së portofolit total të aksioneve të bankës. Përjashtimisht, një pozicion individual mund të përbëjë deri në 10% të vlerës së portofolit të titujve të kapitalit, me kushtin që totali i të tilla pozicioneve të mos kalojë 50% të vlerës totale të portofolit të titujve të kapitalit.

Neni 159
Rreziku i përgjithshëm i titujve të kapitalit

Bankat llogarisin kërkesën për kapital ndaj rrezikut të përgjithshëm, duke shumëzuar pozicionin e përgjithshëm neto, të përcaktuar sipas paragrafit 3 të nenit 157, me 8%.

Neni 160
Trajtimi i derivativëve mbi titujt e kapitalit

1. Bankat trajtojnë kontratat e së ardhmes dhe kontratat *forward* mbi titujt individualë të kapitalit, mbi portofola të titujve të kapitalit, ose mbi portofola të treguesit të kapitalit (*stock indices*), si kombinim të një pozicioni në blerje ose në shitje në instrumentin bazë të kapitalit dhe një pozicioni në shitje ose në blerje në një titull të borxhit pa rrezik, pa kupon dhe me maturitet atë të kontratës.

2. Bankat trajtojnë *equity swaps* si kombinim të një pozicioni në blerje në një instrument të kapitalit, ose në një portofol të titujve të kapitalit ose të indekseve të kapitalit, në bazë të të cilave ato (bankat) do të përfitojnë një shumë bazuar në ndryshimin e çmimit të këtij instrumenti të kapitalit, ose të portofolit të titujve ose të treguesit të aksioneve dhe një pozicioni në shitje në një instrument kapitali ose në një portofol të titujve të kapitalit ose në indekse të kapitalit, në bazë të të cilit ato (bankat) paguajnë një shumë, bazuar në ndryshimin e vlerës së këtij instrumenti kapitali ose portofoli të titujve të kapitalit ose të indekseve të kapitalit.

3. Bankat trajtojnë kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve, ekuivalentet e ponderuara me koeficientin delta të opsioneve në kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve (*share indices*) dhe indekset e aksioneve (*share index*), të cilat më poshtë cilësohen së bashku si kontrata të së ardhmes mbi indekset e aksioneve, si kombinim i një pozicioni në shitje/blerje për secilin nga aksionet përbërëse dhe i një pozicioni në blerje/shitje në një titull të borxhit pa rrezik, pa kupon dhe me maturitet atë të kontratës.

Bankat, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të netojnë pozicionet e krijuara në aksione si më sipër me pozicionet e kundërta në të njëjtin titull kapitali.

4. Bankat, në rastet kur netojnë pozicionet në aksione, që krijohen nga një derivativ mbi titujt e kapitalit sipas paragrafit 3 të këtij neni, me një pozicion të kundërt në të njëjtin titull të kapitalit, sigurojnë që kanë kapital të mjaftueshëm për të mbuluar rrezikun e humbjes së shkaktuar nga lëvizja e vlerave të kontratës të derivativit jo plotësisht në linjë me vlerën e aksioneve përbërëse të saj. Bankat, në rastet që mbajnë pozicione të kundërta në kontrata derivative mbi titujt e kapitalit, sigurojnë që kanë kapitalin e mjaftueshëm për të mbuluar humbjet si rezultat i mospërputhjes në maturitet dhe/ose të përbërjes së indekseve, apo të dy faktorëve njëkohësisht.

5. Bankat trajtojnë kontratat e së ardhmes mbi indekset e aksioneve, të cilat tregtohen në bursë dhe që përfaqësojnë indekse gjerësisht të diversifikuara, me një kërkesë për kapital për rrezikun e përgjithshëm prej 8%, ndërkohë që në këtë rast nuk do të aplikohet kërkesë për kapital për rrezikun specifik. Kontrata të tilla të së ardhmes mbi indekset e aksioneve, do të përfshihen në përllogaritjen e pozicionit të përgjithshëm neto, sipas paragrafit 3 të nenit 157, por nuk do të merren parasysh në përllogaritjen e pozicionit të përgjithshëm bruto sipas paragrafit 2 të nenit 157.

6. Bankat, në rastin që një kontratë e së ardhmes mbi indekset e aksioneve nuk zbërthehet në disa pozicione sipas aksioneve përbërëse, e trajtojnë atë si një pozicion në një aksion individual. Rreziku specifik i këtij aksioni individual mund të mos merret parasysh, nëse kontrata e së ardhmes mbi indekset e aksioneve në fjalë tregtohet në bursë dhe përfaqëson një indeks gjerësisht të diversifikuar.

Neni 161

Rreziku i pozicionit për kuotat e investimeve në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK)

1. Bankat, për kuotat e pjesëmarrjes në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK), të cilat përmbushin kushtet për t'u përfshirë në librin e tregtueshëm, llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun specifik dhe të përgjithshëm të pozicionit prej 32% (*residual method*).

2. Bankat, për pozicionet për kuotat në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK), llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit (specifik dhe të përgjithshëm) dhe rrezikun e kursit të këmbimit jo më shumë se 40%.

3. Bankat, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, nuk mund të bëjnë netim midis investimeve bazë të një sipërmarrjeje të investimeve kolektive (SIK) në të cilën zotëron kuota dhe pozicioneve të tjera të njëjta të ndërmarra nga banka.

4. Bankat, përveçse sa më sipër, mund të përdorin metodat e përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni për llogaritjen e kërkesës për kapital, për pozicionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK) të mbikëqyrura ose me seli qendrore në vendet e BE-së ose në Republikën e Shqipërisë, nëse plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) prospekti i shoqërive të investimeve kolektive ose dokumenti ekuivalent me të përcakton:

i) kategoritë e aktiveve në të cilat shoqëritë e investimit kolektiv janë të autorizuara të investojnë;

ii) nëse janë parashtruar kufij për investimet - kufijtë relativë dhe metodat për t'i përllogaritur këta kufij;

iii) nëse pranohet huamarrja - nivelin maksimal të lejueshëm;

iv) nëse pranohen investimet në derivativet financiare të tregtuara jashtë bursës ose operacione të llojit repo një politikë për të kufizuar rrezikun e kundërpartisë që rrjedh nga këto operacione;

b) aktiviteti i shoqërive të investimeve kolektive raportohet në raporte gjashtëmujore dhe vjetore, që lejojnë vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurat dhe operacionet e këtyre shoqërive gjatë periudhës së raportimit;

c) kuotat/aksionet e shoqërive të investimeve kolektive janë të kthyeshme/likuidueshme me *cash*, mbi baza ditore dhe me kërkesë të mbajtësit;

d) investimet e shoqërive të investimeve kolektive janë të ndashme nga aktivet e administruesit/menaxhuesit të kësaj shoqërie;

e) bankat investuese duhet të realizojnë një vlerësim të përshtatshëm të rrezikut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

5. Bankat, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të njohin si të pranueshme për zbatimin e trajtimeve specifike të përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni, kuotat në sipërmarrjet të investimeve kolektive (SIK) të vendeve të treta, nëse janë plotësuar kriteret sipas shkronjave "a" deri në "e" të paragrafit 4 të këtij neni.

6. Bankat zgjedhin midis tri metodave specifike, bazuar në natyrën e kuotave të tregtueshme të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) dhe në llojin e informacionit të disponueshëm prej tyre (bankave), për sa u përket investimeve të bëra nga sipërmarrjet e investimeve kolektive e (SIK) në bazë të mandatit të saj, siç përcaktohet më poshtë.

a) Metoda 1. Bankat, të cilat janë në dijeni të investimeve bazë të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) në baza ditore, llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit (rreziku i përgjithshëm dhe rreziku specifik), duke i trajtuar pozicionet nga investimet në këto sipërmarrje, si pozicione ndaj instrumenteve bazë dhe i përfshijnë ato në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit (specifik dhe të përgjithshëm),

sipas llojit të instrumentit (tituj të borxhit apo tituj të kapitalit).

Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital të rrezikut të pozicionit (specifik dhe të përgjithshëm), mund të bëjnë netimin midis instrumenteve, në të cilat investon sipërmarrja kolektive e investimit dhe pozicioneve të tjera identike të mbajtura nga ato (bankat), në librin e tregtueshëm, për sa kohë që bankat mbajnë një sasi kuotash, të mjaftueshme që e lejojnë këmbimin për investimet bazë.

b) Metoda 2. Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik), mund t'i trajtojnë kuotat në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK) si pozicione në një indeks aksionesh ose në një shportë titujsh të kapitalit apo të borxhit dhe i përfshijnë ato në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit (specifik dhe të përgjithshëm), sipas llojit të instrumentit (tituj të borxhit apo tituj të kapitalit), vetëm në rast se përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) sipas mandatit të administrimit, sipërmarrja e investimeve kolektive (SIK) ka qëllim të ndjekë (*replicate*) përbërjen dhe tendencën e një indeksi aksionesh ose të një shporte fikse të instrumenteve të kapitalit ose të borxhit;

ii) korrelacioni midis ndryshimeve ditore të çmimit të kuotave/njësive në shoqërinë kolektive të investimit dhe indeksit të aksioneve ose shportës fikse të instrumenteve të kapitalit ose të borxhit, të jetë minimalisht 0.9, për një kohëzgjatje minimale gjashtë mujore (me "lidhje/korrelacion" kuptohet në këtë kontekst koeficienti i korrelacionit midis normës së kthimit ditor të kuotave në sipërmarrjen e investimeve kolektive (SIK) dhe të treguesit të aksioneve ose shportës fikse të instrumenteve të kapitalit ose të borxhit që kjo shoqëri kolektive e investimit ndjek).

c) Metoda 3. Bankat, në rastet kur nuk janë në dijeni të investimeve bazë të mësipërme në mënyrë të përditësuar, llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik), sipas llojit të instrumentit (tituj të borxhit apo tituj të kapitalit), me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) supozohet që sipërmarrja e investimeve kolektive (SIK) investon fillimisht në masën maksimale të lejueshme sipas mandatit të administrimit, në kategoritë e aktiveve, subjekt i kërkesave më të larta për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik) dhe vazhdon të investojë në një radhë zbritëse, derisa arrin kufirin maksimal të përgjithshëm për investimet. Pozicioni në kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) do të trajtohet si kuota direkte në pozicionet e supozuara si më sipër;

ii) bankat konsiderojnë ekspozimin jo të drejtpërdrejtë maksimal që mund të arrijnë në investimet në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK), nëpërmjet marrjes së borxhit, kur llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit, duke rritur proporcionalisht pozicionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK) deri në ekspozimin maksimal të investimeve bazë që rezultojnë prej mandatit të shoqërisë;

Bankat, në rastet kur kërkesa për kapital sipas kësaj metode, për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik) të marrë, është më e madhe se kufiri sipas paragrafit 1 dhe/ose 2 të këtij neni, kufizojnë/reduktojnë këtë kërkesë deri në atë nivel.

7. Bankat mund t'i besojnë një pale të tretë llogaritjen dhe raportimin e kërkesave për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik), në lidhje me pozicionet në kuotat e pjesëmarrjes në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK), sipas metodave të përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni, me kushtin që të garantohet saktësia e llogaritjes dhe e raportimit.

Neni 162

Rreziku i shlyerjes

1. Bankat që kryejnë transaksione në tituj të borxhit, tituj të kapitalit, kontrata

derivative, valuta dhe mallra (*commodities*), mund të ekspozohen ndaj rrezikut të humbjeve që buron nga mos shlyerja e transaksionit në datën e shlyerjes.

2. Bankat kategorizojnë humbjet, që rrjedhin nga mos shlyerja e transaksionit, si humbje që lidhen, respektivisht:

a) në rastin e transaksioneve, për të cilat parashikohet shlyerja e tipit 'dorëzim kundrejt pagesës" (DVP – *delivery vs. payment*) ose anasjellas, me diferencën midis çmimit të fiksuar në kontratë dhe vlerës korente/aktuale të instrumenteve financiare, të valutave ose mallrave (*commodities*) për të marrë (dorëzuar);

b) në rastin e transaksioneve, për të cilat nuk parashikohet shlyerja e tipit 'dorëzim kundrejt pagesës', por për të cilat pagesa mund të kryhet përpara marrjes së vlerës korresponduese nga pala tjetër ose vlera korresponduese që duhet t'i dorëzohet palës tjetër lëshohet përpara marrjes së pagesës (operacionet joDVP ose me dorëzim të lirë), me vlerën aktuale të instrumenteve financiare, valutave ose mallrave (*commodities*) të transferuara kundërpartisë, për të cilat nuk është marrë vlera korresponduese ose me pagesën e kryer pa marrë vlerën korresponduese nga pala tjetër.

3. Bankat llogarisin kërkesat për kapital siç parashikohet në nenet 163 dhe 164, për të mbuluar rreziqet që burojnë nga të gjitha transaksionet e pashlyera të instrumenteve financiare (përfshirë kontratat derivative), valutave dhe mallrave (*commodities*).

4. Bankat nuk llogarisin kërkesë për kapital për marrëveshjet e riblerjes aktive dhe pasive, si dhe operacionet e huamarrjes apo huadhënies së titujve ose mallrave (*commodities*), si dhe kontratat derivative pa shkëmbim kapitali.

5. Banka e Shqipërisë, në rastet e mosfunksionimit me natyrë sistemike të një sistemi shlyerje ose kompensimi, mund të pezullojë aplikimin plotësisht ose pjesërisht të kërkesave për kapital për rrezikun e operacioneve të pashlyera, deri në kthimin në normalitet të funksionit të këtij sistemi. Në raste të tilla, mosshlyerja e një transaksioni nga ana e një subjekti nuk konsiderohet si ekspozim në *default*, në terma të rrezikut të kredisë.

Neni 163

Rreziku i shlyerjes për transaksionet DVP

Bankat llogarisin kërkesën për kapital, duke aplikuar faktorët e ponderimit, të diferencuar në breza kohorë, siç përcaktohet në tabelën 24 mbi diferencën, kur është pozitive (domethënë përbën humbje për bankën), midis çmimit kontraktual dhe vlerës korente të instrumenteve financiare, valutave dhe mallrave (*commodities*), për të marrë ose dorëzuar.

Tabela 24

Numri i ditëve të punës pas datës së shlyerjes	**Faktorët e ponderimit (%)**
Nga dita 5-15	8
Nga dita 16-30	50
Nga dita 31-45	75
Nga dita 46 e më tej	100

Neni 164

Rreziku i shlyerjes për transaksionet joDVP

1. Bankat, që kanë kryer pagesën ose dorëzimin e instrumenteve financiare, valutave ose mallrave (*commodities*) dhe nuk kanë marrë vlerën korresponduese brenda së njëjtës ditë ose në rastin e operacioneve ndërkombëtare, brenda ditës së nesërme të punës, trajtojnë vlerën e transferuar si kredi dhënë kundërpartisë dhe përdorin të njëjtën metodologji llogaritjeje për kërkesat për kapital të përdorur për ekspozimet jashtë librit të tregtueshëm.

2. Bankat, pavarësisht metodologjisë së përdorur, në rastin kur shuma e ekspozimeve që burojnë nga transaksionet e pashlyera nëpërmjet sistemeve DVP është e papërfillshme, përdorin një faktor ponderimi 100%.

3. Bankat që kanë kryer pagesën ose dorëzimin dhe nuk kanë marrë vlerën korresponduese brenda ditës së katërt të punës, pas datës së parashikuar për shlyerjen e detyrimit[16] nga ana e kundërpartisë, zbresin nga kapitali rregullator shumën më të madhe, midis shumës monetare të transferuar dhe vlerës korente të instrumenteve korresponduese të pritshme ose midis shumës monetare që pritet të marrë dhe vlerës korente të instrumenteve korresponduese transferuar kundërpartisë, siç përcaktohet në rregulloren për kapitalin rregullator.

Neni 165

Rreziku i përqendrimit në librin e tregtueshëm

1. Bankat, të cilat si rezultat i pozicioneve të rrezikut në librat e tyre të tregtueshëm, tejkalojnë ekspozimin maksimal të lejueshëm, të përcaktuar në nenin 64 paragrafi 1 të ligjit për bankat, detyrohen të respektojnë një kërkesë të veçantë për kapital.

2. Bankat mund të tejkalojnë ekspozimin maksimal të lejueshëm, me kusht që të përmbushin kushtet/kriteret e mëposhtme:

i) ekspozimi në librin e bankës, ndaj personave ose grup personave të lidhur, nuk e tejkalon ekspozimin maksimal të lejueshëm, të përcaktuar në ligjin për bankat dhe ekspozimi maksimal i lejueshëm tejkalohet nga ekspozimi në librin e tregtueshëm;

ii) bankat plotësojnë kërkesat për kapital lidhur me tejkalimin e ekspozimit maksimal të lejueshëm;

iii) në rastet kur nuk kanë kaluar më shumë se 10 ditë nga momenti i tejkalimit të ekspozimit maksimal të lejueshëm, ekspozimi ndaj personave ose grup personave të lidhur në librin e tregtueshëm nuk është më i madh se pesëfishi i kapitalit rregullator të bankës;

iv) në rastet kur kanë kaluar më shumë se 10 ditë nga momenti i tejkalimit të ekspozimit maksimal të lejueshëm, shuma që tejkalon këtë ekspozim nuk është më e madhe se gjashtëfishi i kapitalit rregullator të bankës.

3. Bankat, lidhur me librin e tregtueshëm, llogarisin ekspozimin ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, si shumë e pozicioneve neto në blerje, të përllogaritura për çdo instrument financiar, të lëshuar nga personi ose grupi i personave të lidhur, dhe ekspozimeve ndaj rrezikut të shlyerjes dhe rrezikut të kundërpartisë, në lidhje me të njëjtin person, siç përcaktohet në këtë kre. Pozicionet e rrezikut, në lidhje me librin e tregtueshëm, llogariten duke ponderuar ekspozimin në përputhje me peshat e përcaktuara në rregulloren për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave.

Neni 166

Kërkesa për kapital për rrezikun e përqendrimit

1. Bankat llogarisin kërkesat për kapital për rrezikun e përqendrimit, siç përcaktohet në hapat e mëposhtëm:

a) llogarisin pozicionin total të rrezikut për çdo kredimarrës, si shumë e pozicionit të rrezikut, lidhur me librin e tregtueshëm dhe të gjitha pozicionet e tjera të rrezikut;

b) llogarisin ekspozimin maksimal të lejueshëm për çdo kredimarrës, si diferencë midis pozicionit total të rrezikut lidhur me një kredimarrës dhe ekspozimit maksimal të lejueshëm;

c) klasifikojnë pozicionet e rrezikut në librin e tregtueshëm për kredimarrësit, për të

---

[16] E përcaktuar si “data e dytë” në transaksionet jo DVP.

cilët evidentohet tejkalim i ekspozimit maksimal të lejueshëm sipas shkronjës “b” të këtij paragrafi, me qëllim identifikimin e atyre me rrezik më të lartë, që u atribuohet shuma që tejkalon ekspozimin maksimal të lejueshëm.

Bankat rendisin pozicionet në librin e tregtueshëm, duke filluar nga ato që i nënshtrohen kërkesave për kapital për rrezikun specifik, duke vijuar me ato që u nënshtrohen kërkesave për kapital për rrezikun e shlyerjes dhe të kundërpartisë. Bankat, në çdo profil rreziku, shpërndajnë nevojat/kërkesën për kapital, për shumë/at që tejkalon/jnë ekspozimin maksimal të lejueshëm, duke filluar nga komponenti me kërkesën më të lartë për kapital;

d) mbledhin pozicionet e renditura në këtë mënyrë, deri sa të arrihet vlera e shumës që tejkalon ekspozimin maksimal të lejueshëm, siç përcaktohet në shkronjën “b” të këtij paragrafi;

e) në rastin kur nuk kanë kaluar më shumë se 10 ditë, nga momenti i tejkalimit të ekspozimit maksimal të lejueshëm, kërkesa shtesë për kapital do të jetë sa dyfishi i asaj të kërkuar për rrezikun specifik, rrezikun e shlyerjes dhe rrezikun e kundërpartisë për pozicionet e identifikuara, siç përcaktohet në shkronjën “d” të këtij neni;

f) në rastin kur kanë kaluar më shumë se 10 ditë nga momenti i tejkalimit të kufirit, kërkesa shtesë për kapital do të përllogaritet duke:

i) mbledhur pozicionet e identifikuara, siç përcaktohet në shkronjën “d” të këtij paragrafi, sipas intervaleve të dhëna në tabelën 25 kolona 2, duke filluar me pozicionin me kërkesën më të ulët për kapital, deri sa të arrihet kufiri i sipërm për çdo interval;

ii) shumëzuar kërkesat për kapital për pozicionet e klasifikuara në këtë mënyrë, me përqindjet përkatëse, të dhëna në tabelën 25, kolona 3;

iii) mbledhur rezultatin e shumëzimit të kërkesave për kapital me përqindjet përkatëse.

Tabela 25

Pozicioni i rrezikut (në % ndaj kapitalit rregullator)	**Shuma që kalon kufijtë maksimalë të lejueshëm (në % ndaj kapitalit rregullator)**	**Peshat e ponderimit**
Kolona 1	**Kolona 2**	**Kolona 3**
Nga 20%-40%	Nga 0% në 20%	200%
Nga 40%-60%	Nga 20% në 40%	300%
Nga 60%-80%	Nga 40% në 60%	400%
Nga 80% në 100%	Nga 60% në 80%	500%
Nga 110% në 250%	Nga 80% në 230%	600%
mbi 250%	Mbi 230%	900%

Neni 167

Trajtimi i pozicioneve nga nënshkrimi i titujve

1. Bankat përfshijnë pozicionet e krijuara si rezultat i nënshkrimeve të titujve të borxhit dhe të kapitalit, në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit, siç përcaktohet në këtë nen.

2. Bankat llogarisin pozicionin neto, duke zbritur shumën e titujve që ajo është angazhuar të pranojë, në mënyrë të pakushtëzuar, me një çmim të caktuar, sipas pozicioneve që janë nënshkruar nga palët e treta, në bazë të marrëveshjeve formale.

3. Bankat reduktojnë pozicionin neto të përfituar, siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni, me faktorët sipas tabelës më poshtë:

Tabela 26

Ditë pune	**Faktori i reduktimit (%)**
Ditë pune 0*:	100
Ditë pune 1:	90
Ditë pune 2 dhe 3:	75
Ditë pune 4:	50
Ditë pune 5:	25
Pas 5 ditë pune	0%

* Ditë pune 0, nënkupton ditën e punës kur bankat, në mënyrë të pakushtëzuar, angazhohen për të pranuar një sasi të caktuar letrash me vlerë me një çmim të rënë dakord.

4. Bankat përfshijnë pozicionet neto të reduktuara, në llogaritjen e kërkesës për kapital, në përputhje me kërkesat e përcaktuara për rrezikun e pozicionit për instrumentet e borxhit dhe rrezikun e pozicionit për titujt e kapitalit.

5. Bankat sigurojnë kapital të mjaftueshëm për mbulimin e rrezikut të humbjeve që ekziston ndërmjet kohës kur merret angazhimi fillestar dhe ditës 1 të punës.

Neni 168

Pozicionet në mallra (*commodities*)

1. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për mbulimin e rrezikut të humbjeve potenciale nga pozicionet në mallra (*commodities*).

2. Bankat përfshijnë në llogaritjen e kërkesës për kapital të pozicionit në mallra (*commodities*), të gjitha aktivet dhe pasivet në bilanc e jashtë bilancit në mallra (*commodities*), duke përjashtuar pozicionet në mallra (*commodities*) që mbahen me qëllim financimin e *stock*-ut.

3. Bankat shprehin në terma të njësisë standarde matëse, çdo pozicion në mall (*commodity*) ose në derivative mbi mallra (*commodities*). Këto pozicione konvertohen në monedhën raportuese, duke përdorur çmimin spot për çdo mall (*commodity*).

4. Bankat, në rastet kur detyrimi për një pozicion në shitje duhet të shlyhet përpara pozicionit në blerje, për të njëjtin mall (*commodity*), ato (bankat) duhet të mbrohen edhe nga rreziku i mungesës së likuiditetit, që mund të ekzistojë në disa tregje.

5. Bankat, për qëllime të metodës së thjeshtë, sipas nenit 171, do të konsiderojnë “pozicion neto për secilin mall (*commodity*)”, tepricën e pozicionit në blerje (në shitje) kundrejt pozicionit në shitje (blerje) në të njëjtin mall (*commodity*), në kontrata identike future në mallra (*commodities*), në opsione identike në mallra (*commodities*) dhe në garancitë identike në mallra (*commodities*).

6. Bankat konsiderojnë “pozicione në të njëjtin mall (*commodity*)” pozicionet e mëposhtme:

a) pozicionet në nënkategori të ndryshme të mallrave (*commodities*) ku nënkategoritë janë të këmbyeshme kundrejt njëra-tjetrës; dhe

b) pozicionet në mallra (*commodities*) të ngjashme, në rast se ata janë zëvendësues të afërt të njëri-tjetrit dhe në rast se koeficienti i korrelacionit midis çmimeve të tyre, për një periudhë minimalisht 1-vjeçare, është jo më i vogël se 0.9.

Neni 169

Trajtimi i derivativëve mbi mallrat (*commodities*) dhe i instrumenteve të tjera

1. Bankat trajtojnë kontratat e së ardhmes (*future*) dhe kontratat *forward* në mallra (*commodities*), si kombinime të një pozicioni në blerje/në shitje, në mallin (*commodity*) bazë dhe një pozicion në shitje/blerje, në një obligacion pa rrezik, pa kupon dhe raportohen si vlera nominale në terma të njësisë standarde matëse dhe maturitet të njëjtë me atë të kontratës.

2. Bankat trajtojnë *swap*-et e mallrave (*commodities*), si kombinime të pozicioneve në blerje në mallra (*commodities*), në bazë të të cilit ato (bankat) paguajnë çmim fiks dhe marrin/përfitojnë një çmim të ndryshueshëm dhe pozicione në shitje në mallra (*commodities*), në bazë të të cilave ato (bankat) përfitojnë një çmim fiks dhe paguajnë një çmim të ndryshueshëm.

Bankat, në rastet kur përdorin metodën e bazuar mbi segmentet e maturitetit sipas nenit 172, trajtojnë *swap*-in mbi mallrat (*commodities*), si një seri pozicionesh, të barabartë me shumën nominale të kontratës, ku çdo pozicioni i përgjigjet një pagesë e *swap*-it, të cilat vendosen sipas tabelës 27.

Bankat, në rastet kur *swap*-et e mallrave (*commodities*), në të cilat të dyja anët e transaksionit janë në mallrat (*commodities*) të ndryshme, i përfshijnë ato në segmentin e maturitetit që i përgjigjet mallit (*comimodity*) përkatës, sipas tabelës 27.

3. Bankat trajtojnë pozicionet që krijohen nga marrëveshjet e riblerjes të mallrave (*commodities*), marrëveshjet e anasjella të riblerjes në mallra (*commodities*) dhe nga marrëveshjet e huadhënies dhe huamarrjes si më poshtë:

a) për marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e huadhënies, si pozicion në blerje në mallin (*commodity*) bazë, me maturitet të barasvlershëm me të dhe pozicion në shitje në një instrument borxhi pa rrezik, me maturitet dhe normë interesi atë të marrëveshjes përkatëse;

b) për marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe për marrëveshjet e huamarrjes, si pozicion në shitje në instrumentin bazë, me maturitet të barasvlershëm me të dhe pozicion në blerje në një instrument borxhi pa rrezik, me maturitet dhe normë interesi atë të marrëveshjes përkatëse.

Neni 170

Metodat e llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun në mallra (*commodities*)

Bankat mund të llogarisin kërkesën për kapital, respektivisht sipas:

a) metodës së thjeshtë;

b) metodës së bazuar mbi segmentet e maturitetit.

Neni 171

Metoda e thjeshtë

1. Bankat që përdorin metodën e thjeshtë llogarisin për çdo mall (*commodity*) kërkesën për kapital rregullator, e cila është e barabartë me shumën e elementeve të mëposhtme:

a) 15% e pozicionit neto në shitje ose në blerje shumëzuar me çmimin spot të mallit (*commodity*);

b) 3% e pozicionit bruto, të përllogaritur si shuma e pozicionit në shitje dhe atij në blerje, shumëzuar me çmimin spot (shuma e vlerave absolute).

2. Bankat llogarisin kërkesën e përgjithshme për kapital, për mbulimin e rreziqeve të lidhura me mallrat (*commodities*), si shumë të kërkesës për kapital për çdo mall (*commodity*).

Neni 172

Metoda e bazuar mbi segmentet e maturitetit

1. Bankat që kërkojnë të përdorin këtë metodë, njoftojnë paraprakisht Bankën e Shqipërisë dhe në çdo rast duhet të përdorin metodën e zgjedhur prej tyre në mënyrë të vazhdueshme.

2. Bankat përdorin segmentet e maturitetit për çdo mall (*commodity*) në përputhje me tabelën 27, si më poshtë:

Tabela 27

Segmentet e maturitetit	**Norma e marzhit (në %)**
≤ 1 muaj	1.5 %
> 1 ≤ 3 muaj	1.5 %
> 3 ≤ 6 muaj	1.5 %
> 6 ≤ 12 muaj	1.5 %
> 1 ≤ 2 vjet	1.5 %
> 2 ≤ 3 vjet	1.5 %
> 3 vjet |	1.5 %

3. Bankat mund të kompensojnë midis tyre pozicionet në të njëjtin mall (*commodity*) ose të konsideruara të tilla sipas paragrafit 6 të nenit 168 dhe i radhisin ato në segmentet përkatës të maturitetit mbi baza neto, në rast se plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) pozicionet në kontrata kanë të njëjtën datë skadence;

b) pozicionet në kontrata maturohen brenda 10 ditësh nga njëra-tjetra, në rast se kontratat nga rrjedhin nga këto pozicione negociohen në tregje me data dorëzimi ditore.

4. Pozicionet në stok i ngarkohen segmentit të parë.

5. Bankat llogarisin shumën e pozicioneve në blerje dhe të atyre në shitje në secilin segment maturiteti. Shuma e pozicioneve në blerje (shitje), që kompensohet nga shuma e pozicioneve në shitje (blerje) në një segment maturiteti të caktuar, përbën pozicionin e kompensuar në atë segment, ndërsa pozicioni i mbetur në shitje ose në blerje përbën pozicionin jo të kompensuar për atë segment.

6. Pjesa e pozicionit në shitje (në blerje) jo e kompensuar e një segmenti maturiteti, që kompensohet nga pozicioni në blerje (në shitje) jo i kompensuar, i një segmenti maturiteti pasardhës përbën pozicionin e kompensuar midis dy zonave të afërta. Pjesa e pozicionit të mbetur përbën pozicionin jo të kompensuar midis dy segmenteve të maturitetit.

7. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për çdo mall (*commodity*), si shumë të elementeve të mëposhtme:

a) shuma e vlerave absolute të pozicioneve të kompensuar (në blerje ose në shitje) për çdo segment maturiteti shumëzuar me normën e marzhit sipas tabelës 27 dhe me çmimin spot për atë mall (*commodity*);

b) vlera absolute e pozicionit të pakompensuar në një segment maturiteti ose midis dy segmentesh maturiteti, i cili është mbartur në segmentin e maturitetit vijues, shumëzuar me 0.6% (*carryrate*) dhe nga çmimi spot për atë mall (*commodity*);

c) pozicioni i mbetur i pa kompensuar, i shumëzuar me 15% (*outright rate*) dhe nga çmimi spot për atë mall (*commodity*).

8. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun në mallra (*commodities*), si shumë e kërkesave për kapital për çdo mall (*commodity*) të llogaritur, sipas paragrafit 7 të këtij neni.

Neni 173

Kërkesa për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit

Bankat, në rastet kur pozicioni total neto i hapur valutor i saj, i përcaktuar në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, është më i lartë se 2% e kapitalit rregullator, shumëzojnë me 8% vlerën e këtij pozicioni, për llogaritjen e kërkesës për kapital rregullator për rrezikun e kursit të këmbimit.

Neni 174

Pozicionet valutore në sipërmarrjet e investimit kolektiv, si pjesë e llogaritjes së pozicionit total neto të hapur

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së pozicionit të hapur neto, sipas rregullores “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, marrin në konsideratë edhe pozicionet valutore aktuale në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK), duke dalluar ndërmjet:

a) pozicioneve në kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK), për të cilat pozicionet (investimet) aktuale bazë, në monedhë të huaj janë të njohura për bankën; dhe

b) pozicioneve të tjera në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK).

2. Bankat, për pozicionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK) të referuara në shkronjën “a” të paragrafit 1 të këtij neni, konsiderojnë vlerën kontabël të aktiveve në monedhë të huaj në të cilat është investuar, në proporcion me peshën që çdo aset i tillë zë në totalin e investimeve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK). Pozicionet në monedhë të huaja të përllogaritura në këtë mënyrë përfshihen në llogaritjen e pozicionit neto për çdo monedhë.

3. Bankat, për pozicionet e referuara në shkronjën “b” të paragrafit 1 të këtij neni (bankat nuk kanë dijeni për pozicionet valutore në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK)), supozojnë që investohet deri në maksimumin e lejueshëm në monedhë të huaj, sipas mandatit të saj (SIK).

4. Bankat, për pozicionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive (SIK), të cilat përfshihen në librin e tregtueshëm dhe për të cilat lejohet huadhënia, konsiderojnë ekspozimet indirekte maksimale, që shoqëria kolektive e investimit mund të krijojë, në rast se ndërmerr pozicione duke përdorur borxhin. Për këtë qëllim, vlera kontabël e një pozicioni në sipërmarrjet kolektive të investimit do të rritet në mënyrë proporcionale me rritjen maksimale, që mund të arrijnë investimet bazë të sipërmarrjes së investimit kolektiv, sipas mandatit të saj.

5. Banka, në rastet kur është në dijeni të drejtimit (shenjës) së investimit, të pozicioneve në valutë të huaj, të krijuara sipas paragrafit 3, do t’i konsiderojë ato (pozicionet), si pozicione të tjera në SIK- monedha jo të veçanta.

Në të gjitha rastet e tjera, bankat konsiderojnë pozicionet e sipërpërmendura si pozicione në monedhë të veçantë.

6. Bankat nuk mund të bëjnë netimin ndërmjet pozicioneve në blerje dhe në shitje në të njëjtën sipërmarrje ose në sipërmarrje kolektive investimi, të ndryshme.

7. Bankat llogarisin (për sa referohet më sipër) pozicionin total të hapur neto si shumë të:

a) vlerës më të lartë midis: i) shumës së pozicionit neto në blerje, plus pozicione të tjera në SIK- monedha jo të veçanta (nëse pozicioni i tyre është në blerje); dhe ii) shumës së pozicionit neto në shitje plus pozicione të tjera në SIK - monedha jo të veçanta (nëse pozicioni i tyre është në shitje);

b) pozicione të tjera në SIK - monedha të veçanta.

Neni 175
Kërkesa për kapital për opsionet

1. Bankat mund të përdorin një nga metodat e mëposhtme për të llogaritur kërkesën për kapital në lidhje me portofolin e opsioneve:

a) metodën e thjeshtë;

b) metodën delta plus.

Neni 176
Metoda e thjeshtë

1. Bankat, të cilat janë të përfshira në mënyrë të kufizuar në blerjen e opsioneve, mund të përdorin metodën e thjeshtë, të përshkruar më poshtë për kombinime specifike.

2. Bankat, për opsionet *call* ose *put* të blera, llogarisin kërkesën për kapital si vlerën më të vogël ndërmjet:

a) vlerës së tregut të instrumentit bazë të opsionit, shumëzuar me shumën e peshave të rrezikut specifik dhe atij të përgjithshëm; dhe

b) vlerës së opsionit (për opsionet që nuk janë të vlerësuar me vlerë tregu mund të përdoret vlera në bilanc).

3. Bankat, për pozicionet në blerje në instrumentin bazë (*cash* ose *forward*), të shoqëruar me një opsion *put* të blerë, ose për pozicione në shitje në instrumentin bazë (*cash* ose *forward*), të shoqëruar me një opsion *call* në blerje, llogarisin kërkesën për kapital, duke shumëzuar vlerën e tregut të instrumentit bazë me shumën e peshave të rrezikut specifik dhe atij të përgjithshëm për atë instrument, minus vlerën e brendshme të opsionit me një minimum 0.

4. Bankat llogarisin vlerën e brendshme të opsionit respektivisht:

a) për opsionin *call*, si diferencë midis vlerës së tregut të instrumentit bazë dhe çmimit *strike*; dhe

b) për opsionin *put*, si diferencë midis çmimit *strike* dhe vlerës së tregut të instrumentit bazë.

5. Bankat, në rastet e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, për pozicionet në opsione dhe atje ku është e përshtatshme, nuk i konsiderojnë pozicionet e lidhura me instrumentin bazë në llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit, për rrezikun e kursit të këmbimit dhe për rrezikun në mallra (*commodities*).

6. Kërkesa për kapital e opsioneve e llogaritur sipas kësaj metode, do t'i shtohet kërkesës për kapital të llogaritur për rrezikun e pozicionit, rrezikun e kursit të këmbimit dhe rrezikun e mallrave (*commodities*).

Neni 177
Kërkesa të përgjithshme për metodën delta plus

1. Metoda delta plus merr në konsideratë parametrat e ndjeshmërisë të lidhura me opsionet.

2. Bankat që përdorin metodën delta plus, njohin opsionet si pozicione të barasvlershme me vlerën e tregut të instrumentit bazë, të shumëzuar me parametrin delta, për vlerësimin e rrezikut të pozicionit në librin e tregtueshëm, të rrezikut të kursit të këmbimit dhe të rrezikut në mallra/*commodities* (vlera ekuivalente delta).

3. Bankat, me qëllim llogaritjen e kërkesës totale për kapital, llogarisin kërkesën për kapital për parametrin gama (norma e ndryshimit të deltës) dhe për parametrin vega (ndjeshmëria e vlerës së një opsioni ndaj ndryshimit në luhatshmërinë e çmimeve), pasi parametri delta nuk i mbulon në mënyrë të mjaftueshme rreziqet e lidhura me pozicionin e opsioneve.

4. Bankat, për opsionet që tregtohen në bursë, përdorin parametrat e ndjeshmërisë delta, *gama* dhe *vega*, të llogaritura nga bursa, ndërsa për opsionet mbi banak, i llogarisin këta parametra në përputhje me modelet standarde të tregut ose sipas modeleve të brendshme të bankës, duke njoftuar paraprakisht Bankën e Shqipërisë.

Neni 178

Rreziku specifik sipas metodës delta plus

Bankat, llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun specifik në veçanti për çdo opsion, duke shumëzuar vlerën ekuivalente delta të çdo opsioni me peshat e rrezikut për rrezikun specifik të përcaktuar sipas nenit 153 për titujt e borxhit, nenit 158 për titujt e kapitalit dhe nenit 161 për kuotat në SIK.

Neni 179

Rreziku i përgjithshëm sipas metodës delta plus

1. Bankat përfshijnë vlerën ekuivalente delta të çdo opsioni mbi tituj të borxhit, në llogaritjen e kërkesës për kapital, në përputhje me një nga metodat e përcaktuara në nenin 155 ose nenin 156.

2. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për opsionet në kuota të SIK në bazë të vlerës ekuivalente delta, në përputhje me metodat e llogaritjes të aplikuara, të përcaktuara në nenin 161.

3. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për opsionet mbi titujt e kapitalit, në bazë të pozicioneve ekuivalente delta, në përputhje me nenin 159.

4. Bankat përfshijnë pozicionet ekuivalente delta për opsionet mbi monedhat, në llogaritjen e pozicionit total neto të hapur valutor të bankës dhe aplikohet kërkesë për kapital sipas nenit 173.

5. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për opsionet mbi mallrat (*commodities*), në bazë të pozicioneve ekuivalente delta, në përputhje me një nga metodat e përcaktuara në nenet 171 ose 172.

6. Bankat, për opsionet mbi instrumente që nuk përfshihen në pikat më sipër, përdorin metodën (përqasjen) e dy kaheve, me një kah në kohën që kontrata e instrumentit bazë bëhet efektive dhe me një kah në kohën që kontrata e instrumentit bazë maturohet.

7. Bankat, për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit dhe për rrezikun në mallra (*commodities*), kompensojnë vlerën ekuivalente delta kundrejt pozicioneve në të njëjtin instrument bazë ose derivativ financiar, ku opsionet e blera *call*/të shitura *put* trajtohen si pozicione në blerje dhe opsionet e shitura *call*/të blera put trajtohen si pozicione në shitje.

Neni 180

Rreziku gama dhe vega

1. Bankat llogarisin rrezikun gama dhe vega për çdo opsion të veçantë dhe i grupojnë

sipas instrumentit bazë.

2. Bankat konsiderojnë si një instrument të vetëm bazë respektivisht:

- për titujt e kapitalit dhe treguesit e aksioneve (*stock indices*), çdo treg kombëtar;
- për instrumentet që varen nga norma e interesit, segmentet e maturitetit siç janë përcaktuar në tabelën 22;
- për monedhat dhe për arin, çdo çift monedhash dhe arin;
- për mallrat (*commodities*), pozicionet në një produkt të veçantë.

3. Bankat llogarisin rrezikun gama si më poshtë për çdo opsion:

Rreziku gama = 1/2 gama * N * (luhatshmëria e instrumentit bazë) 2, ku N është numri i instrumenteve bazë të opsionit.

4. Bankat përcaktojnë luhatshmërinë e instrumentit bazë në të njëjtën mënyrë që llogaritet rreziku i përgjithshëm, siç përcaktohet më poshtë:

a) për opsionet në tituj të kapitalit dhe të treguesve të aksioneve, është e barabartë me 8% të vlerës së tregut të instrumentit bazë;

b) për opsionet e normave të interesit, nëse instrumenti bazë është një titull i borxhit, vlera e tregut e instrumentit bazë shumëzohet me peshat sipas tabelës 21 ose me ndryshimin e normave të interesit, sipas tabelës 22 (në varësi të metodës së zgjedhur). Në rast se instrumenti bazë është norma e interesit, si ndryshim i vlerës së instrumentit bazë do të konsiderohet ndryshimi i normave të interesit sipas tabelës 21;

c) për opsionet e monedhave, do të jetë e barabartë me 8% të kursit të këmbimit midis dy monedhave në fjalë;

d) për mallrat (*commodities*), do të jetë e barabartë me 15% të vlerës së tregut të mallit (*commodity*) në fjalë;

e) për opsionet mbi pozicionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive, vlera e tregut e instrumentit bazë do të shumëzohet me 32%, në rast se banka përdor metodën e mbetur (*residual method*) për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e pozicionit në SIK.

5. Bankat llogarisin rrezikun vega për çdo opsion individual si:

Rreziku vega = Vega * N * luhatshmëria e instrumentit bazë/4, ku N është numri i instrumenteve bazë.

6. Çdo opsion mbi të njëjtin instrument bazë mund të ketë ndikim pozitiv ose negativ mbi faktorin gama. Bankat mbledhin këto efekte individuale, të cilat japin një efekt neto negativ ose pozitiv mbi gamën e çdo instrumenti bazë. Për qëllime të llogaritjes së kërkesës për kapital do të konsiderohet vetëm efekti neto negativ mbi gamën.

Neni 181

Kërkesa për kapital sipas metodës delta plus

1. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e opsioneve si shumë të:

a) kërkesës për kapital për rrezikun specifik (neni 178);

b) kërkesës për kapital për rrezikun e përgjithshëm për rrezikun delta (neni 179), duke i shtuar shumën e vlerave absolute të rreziqeve vega dhe rreziqeve neto gama negative.

2. Bankat që zgjedhin këtë metodë për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e opsioneve, i shtojnë kërkesës për kapital për rrezikun e tregut të llogaritur, sipas paragrafit 3 të nenit 144, kërkesën për kapital, të llogaritur sipas paragrafit 1 të këtij neni.

KREU VIII

RREZIKU OPERACIONAL

NËNKREU I

METODA E TREGUESIT TË THJESHTË

Neni 182
Kërkesa për kapital

Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tri vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient α prej 15%.

Neni 183
Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare

1. Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për çdo vit, llogaritet si shumë e të ardhurave neto nga interesi dhe të ardhurave neto jo nga interesi për atë vit.

2. Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për çdo vit, llogaritet në bazë të të dhënave 12-mujore të vitit fiskal dhe, në rastet kur nuk janë ende të disponueshme të dhënat e kontrolluara (audituara), përdoren vlerësimet e vetë bankës për këtë tregues.

3. Në llogaritjen e mesatares së tri viteve, nuk do të konsiderohet treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare, nëse në ndonjë prej viteve, ky tregues rezulton negativ ose i barabartë me zero.

4. Treguesi mesatar i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare do të llogaritet si shuma e vlerave pozitive të treguesve të të ardhurës neto nga veprimtaria bankare, pjesëtuar me numrin e viteve, në të cilat treguesi është pozitiv.

Neni 184
Kualifikimet

1. Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për secilin prej tri viteve, që jepet si shumë e të ardhurave neto nga interesi dhe të ardhurave neto jo nga interesi, do të përfshijë konkretisht elementet e mëposhtme:

a) të ardhura neto nga interesat;

b) të ardhura neto nga operacionet e qirasë financiare dhe *faktoring*-ut;

c) të ardhura neto nga komisionet;

d) të ardhura neto nga veprimet me tituj dhe veprimet e tjera financiare;

e) fitimi neto nga veprimet me valutat;

f) të ardhura të tjera neto nga veprimtaria bankare.

2. Treguesi i të ardhurës neto do të llogaritet përpara zbritjes së shpenzimeve për provigjione dhe shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarisë (përfshirë dhe komisionet/shpenzimet e kryera për shërbimet nga të tretët) dhe përjashton, në çdo rast, zërat e mëposhtëm:

a) të ardhurën e jashtëzakonshme;

b) të ardhurat nga sigurimi prej dëmtimeve;

c) të ardhurat nga interesa pjesëmarrëse në filiale apo palë të lidhura;

d) fitim/humbjet e realizuara nga shitja e zërave të librit të bankës.

3. Bankat, në rastet që nuk disponojnë të dhëna të plota për tri vite (rastet e bankave që nuk kanë më shumë se një vit aktivitet), do të përdorin të dhënat e parashikuara në planet e tyre të biznesit.

4. Bankat përdorin formulën e mëposhtme në llogaritjen e kërkesës për kapital për mbulimin e rrezikut operacional:

Kërkesa për kapital për rrezikun operacional = {(treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-1) * (15%) + (Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-2) * (15%) + (treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-3)

* (15%)} / 3

Me kusht që:

- treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-1> 0; dhe
- treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-2 > 0; dhe
- treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare e vitit T-3 > 0,

ku T është viti i raportimit.

NËNKREU II
METODA STANDARDE

Neni 185
Kërkesa për kapital

1. Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës standarde, e cila konsideron treguesin e të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për tri vitet e fundit, sipas linjave të biznesit dhe koeficientëve respektivë ß, siç përcaktohet në tabelën 30. Në çdo vit të dhënë, kërkesa negative për kapitalin e një linje biznesi, që rezulton nga vlera negative e treguesit të të ardhurës neto nga veprimtaria bankare, konsiderohet në vlerën e saj negative në treguesin total të llogaritur për atë vit. Megjithatë, në rastet kur kërkesa në total për kapital (treguesi i së ardhurës neto nga veprimtaria bankare) për të gjitha linjat e biznesit është negative për një vit të caktuar, shtesa në llogaritjen e mesatares në këtë vit do të jetë zero.

2. Treguesi i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare për çdo vit, llogaritet në bazë të të dhënave të fundit të vitit fiskal, dhe në rastet kur nuk janë ende të disponueshme të dhënat e kontrolluara (audituara), mund të përdoren vlerësimet e vetë bankës për këtë tregues.

Tabela 30. Linjat e biznesit, veprimtaritë dhe koeficienti përkatës ß

Nr.	**Linjat e biznesit**	**Lista e veprimtarive**	**Koeficienti ß**
1.	Financat e korporatave	- nënshkrimin e instrumenteve financiare dhe/ose vendosjen e instrumenteve financiare në baza të një angazhimi të pakthyeshëm; - shërbime të lidhura me nënshkrimin; - shërbime këshilluese në fushën e investimeve; - shërbime për vlerësimin e korporatave (shoqërive tregtare); - shërbime për operacione titullzimi për të tretë; - shërbime këshilluese mbi strukturën e kapitalit, strategjinë e biznesit dhe aspekte të lidhura me to, si edhe shërbime këshilluese dhe shërbime të lidhura me shkrirjen dhe blerjen e shoqërive (ndërmarrjeve); - analiza kërkimore dhe financiare mbi investimet dhe forma të tjera të përgjithshme të këshillimit, lidhur me transaksionet me instrumente financiare	18%

2.	Veprime me thesarin	- tregtimi për llogari të vet; - ndërmjetësimi në tregjet ndërbankare; - titullzime për llogari të vet; - marrje dhe transmetim i urdhrave lidhur me një ose më shumë instrumente financiare; - ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve; - vendosje e instrumenteve financiare jo në baza të një angazhimi të pakthyeshëm; - administrimi i një sistemi shumëpalësh transaksionesh (*Operation of Multilateral Trading Facilities*)	18%
3.	Ndërmjetësim me pakicë	- marrja dhe transmetimi i urdhrave lidhur me një ose më shumë instrumente financiare; - ekzekutimi i urdhrave për llogari të klientëve; - vendosje e instrumenteve financiare jo në baza të një angazhimi të pakthyeshëm (produkte sigurimi, aksione, tituj, derivativë etj.)	12%
4.	Veprimtari bankare dhe financiare	- pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme; - kredidhënie; - qira financiare dhe *faktoring*; - financime për eksportin dhe tregtinë; - ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve; - veprime me valutat	15%
5.	Veprimtari bankare me pakicë (*retail*)	- pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme; - kredidhënie; - qira financiare dhe *faktoring*; - ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve; - veprime me valutat	12%
6.	Pagesa dhe shlyerje	- shërbimet dhe sistemet e pagesave, transferimit dhe klerimit (SWIFT, AECH, Master Card, Visa, Amex, e-banking etj.); - lëshimi dhe administrimi i mjeteve të pagesave	18%
7.	Shërbime si agjent	- ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare për llogari të klientëve, duke përfshirë marrjen në kujdestari dhe shërbime të lidhura me to, të tilla si: administrimi i *cash*-it ose i garancive reale (kolateralit)	15%
8.	Administrim aktivesh	- administrimi i portofolit; - administrimi i titujve të sipërmarrjeve kolektive të investimit (*Managing of UCITS*); - forma të tjera të administrimit të aktiveve.	12%

3. Bankat, me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të llogarisin kërkesën e kapitalit për rrezikun operacional, duke përdorur metodën standarde me tregues alternativë, siç përcaktohet në nënkreun III të këtij kreu.

Neni 186

Kërkesat për kategorizimin e linjave të biznesit

Bankat hartojnë politika dhe kritere të veçanta për kategorizimin e treguesve respektivë, për linjat dhe veprimtaritë e biznesit në një kuadër të standardizuar. Kriteret duhet të rishikohen dhe të përshtaten për aktivitetet e reja apo/dhe për çdo ndryshim të biznesit

dhe të rreziqeve, që ndërmerr banka[17].

NËNKREU III
TREGUES ALTERNATIVË PËR LINJA TË CAKTUARA BIZNESI

Neni 187
Modalitetet

1. Banka e Shqipërisë mund të japë miratim paraprak për bankën, në rast se ajo (banka) kërkon të përdorë tregues të ndryshëm (alternativë) nga ai i të ardhurës neto nga veprimtaria bankare, të përdorur për linjat e biznesit respektivisht për:

a) veprimtarinë bankare me pakicë; dhe

b) veprimtarinë bankare e financiare.

2. Banka, për këto linja biznesi, mund të përdorë treguesin mesatar për tri vitet e fundit të shumës totale bruto të kredive të akorduara klientëve të shumëzuar me një koeficient 0,035.

3. Në rastet e linjave të biznesit të veprimtarive bankare me pakicë dhe/ose veprimtarive bankare e financiare, kreditë e akorduara të konsideruara në tregues do të përfshijnë kreditë, që u korrespondojnë këtyre portofolave dhe në rastet e linjës së biznesit të veprimtarive bankare e financiare, përfshihen edhe titujt që mbahen në librat e bankës.

4. Bankat përdorin treguesit alternativë, nëse ato (bankat) i kanë të përqendruara veprimtaritë e tyre në veprimtaritë bankare me pakicë dhe/ose veprimtaritë bankare e financiare, dhe të ardhurat nga këto veprimtari përbëjnë jo më pak se 90% të të ardhurave të bankës.

5. Bankat llogarisin kërkesën totale për kapital sipas metodës standarde me tregues alternativë, njësoj si me metodën standarde.

6. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për përdorimin e treguesve alternativë, vetëm në rast se banka vërteton se një pjesë e rëndësishme e veprimtarive bankare me pakicë dhe/ose veprimtarive bankare e financiare, përfshijnë kredi që shoqërohen me një mundësi dështimi të lartë dhe se metoda standarde që përdor tregues të ndryshëm (alternativë), ofron një bazë të përmirësuar për vlerësimin e rrezikut operacional.

Neni 188
Kritere kualifikuese

1. Bankat plotësojnë kriteret kualifikuese të listuara në paragrafin 2 të këtij neni, krahas standardeve të përgjithshme të administrimit të rrezikut, të përcaktuara në aneksin 3 të kësaj rregulloreje, mbi kriteret teknike të organizimit dhe trajtimit të rreziqeve dhe të rregullores “Për administrimin e rrezikut operacional”.

2. Bankat, në përputhje me natyrën, vëllimin, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e përgjithshëm të rrezikut, sigurojnë:

a) sistem/e të mira të dokumentuara të administrimit dhe vlerësimit të rrezikut operacional, me përgjegjësi të qarta dhe të mirëpërcaktuara. Këto sisteme duhet të identifikojnë ekspozimet e bankës ndaj rrezikut operacional dhe duhet të mbledhin të dhënat përkatëse për këtë lloj rreziku, duke përfshirë edhe të dhënat për humbjet materiale. Sistemi/et duhet të jenë subjekt i rishikimeve të rregullta dhe të pavarura nga banka;

b) sistem/e të vlerësimit të rrezikut operacional të integruara ngushtësisht në proceset e administrimit të rrezikut të bankës. Rezultatet e këtij/këtyre sistemi/eve, duhet të jenë pjesë

---

[17]Parimet për kategorizimin e linjave të biznesit përcaktohen në aneksin 5 të rregullores nr. 3, datë 19.1.2011 “Për administrimin e rrezikut operacional”.

integrale e procesit të monitorimit dhe kontrollit të profilit të rrezikut operacional të saj;

c) sistem/e raportimi efikas/e për drejtorinë, i cili/të cilët siguron/jnë raporte/të dhëna mbi rrezikun operacional për funksionet e rëndësishme brenda bankës. Bankat hartojnë dhe miratojnë procedura për të ndërmarrë veprimet e duhura, bazuar në informacionin që përmbajnë raportet e drejtorisë.

3. Bankat që përdorin metodën standarde nuk mund të kalojnë në metodën e treguesit të thjeshtë, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë dhe vetëm nëse:

a) banka argumenton se përdorimi i metodës së treguesit të thjeshtë nuk ka si qëllim reduktimin e kërkesës për kapital për rrezikun operacional, por diktohet (është i domosdoshëm) për nga natyra dhe kompleksiteti i veprimtarisë së saj; si dhe

b) ky ndryshim nuk do të ketë efekt të ndjeshëm negativ, në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës ose aftësinë e saj për të administruar në mënyrë efektive rrezikun operacional.

4. Bankat që përdorin metodën standarde paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë dokumentet e mëposhtme:

a) organigramën që përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e funksioneve të administrimit dhe kontrollit të rrezikut operacional në bankë;

b) vendimin e Këshillit Drejtues për përdorimin e metodës standarde;

c) një dokument që përshkruan procesin e vlerësimit të rrezikut operacional dhe konkluzionet e vlerësimit;

d) një raport të posaçëm të kontrollit të brendshëm të bankës; si dhe

e) çdo vit, një relacion nga strukturat drejtuese të bankës mbi respektimin e kërkesave rregullative për përdorimin e metodës standarde dhe një raport nga kontrolli i brendshëm mbi cilësinë e sistemit të administrimit të rrezikut operacional në bankë.

KREU IX
PROCESI I VLERËSIMIT TË BANKAVE

Neni 189
Kërkesa të përgjithshme

1. Bankat hartojnë dhe miratojnë strategji dhe procese të plota, efektive dhe të bazuara, për të vlerësuar dhe mbajtur në mënyrë të vazhdueshme shumat, tipat dhe shpërndarjen e kapitalit të brendshëm, që ato konsiderojnë të përshtatshëm për të mbuluar natyrën dhe nivelin e rrezikut, ndaj të cilit janë ose mund të jenë të ekspozuara.

2. Strategjitë dhe proceset e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë subjekt i rishikimeve të rregullta të brendshme nga bankat, për t'u siguruar nëse ato janë gjithëpërfshirëse dhe proporcionale me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktivitetit të bankës.

NËNKREU I
PROCESI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT (ICAAP)[18]

Neni 190
Të përgjithshme

1. Banka krijon një proces të përshtatshëm vlerësimi të brendshëm të

[18] *Internal Capital Adequacy Assessment Process.*

mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në strategjitë për administrimin e rreziqeve.

2. Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit do të konsiderohet i përshtatshëm për bankën, nëse:

a) është i bazuar në identifikimin, matjen ose vlerësimin e rreziqeve, në formimin e një vlerësimi total të rreziqeve dhe në monitorimin e rreziqeve kryesore, ku banka është e ekspozuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;

b) siguron kapitalin e mjaftueshëm për mbulimin e profilit të rrezikut të bankës; dhe

c) ky proces është përfshirë në mënyrë të përshtatshme në sistemin e administrimit.

3. Banka, nëpërmjet një procesi të plotë të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, siguron që niveli i rreziqeve ndaj të cilave është ekspozuar banka, të jetë brenda kapacitetit të rrezikut të saj.

4. Banka krijon një proces vlerësimi të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, në mënyrë proporcionale me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj.

Neni 191

Identifikimi, matja, vlerësimi i rreziqeve dhe hartimi i një vlerësimi të përgjithshëm të rreziqeve, dhe monitorimi i tyre

1. Banka, bazuar në profilin e saj të rrezikut, përcakton dhe kategoritë e rreziqeve të rëndësishme për t'u konsideruar në procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.

2. Banka argumenton dhe dokumenton vendimet e saj lidhur me marrjen ose jo në konsideratë të rreziqeve specifike dhe supozimet e përdorura në procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit.

3. Banka harton dhe/ose përgatit metodologji të përshtatshme të matjes, apo vlerësimit të rreziqeve, me qëllim hartimin e masave apo vlerësimeve të rreziqeve të veçanta.

4. Metodologjitë e matjes apo vlerësimit të rreziqeve do të konsiderohen të përshtatshme, nëse ato përfshijnë:

a) përdorimin e metodave për llogaritjen e kërkesave kapitale në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

b) metodologjitë e dokumentuara të brendshme të bankës; dhe/ose

c) metodologji të tjera, të përshtatshme për matjen ose vlerësimin e rreziqeve.

5. Banka, nëse konstaton se masa apo vlerësimi i një rreziku të veçantë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nuk pasqyron ekspozimin aktual të bankës në atë rrezik, mund të rregullojë vlerësimin duke bërë një vlerësim më lart ose më poshtë.

6. Banka argumenton dhe dokumenton përdorimin e metodave individuale të përdorura për matjen ose vlerësimin e rreziqeve, vlerësimet jo të matshme të rreziqeve, si dhe rregullimet e vlerësimit të rrezikut të përmendura në paragrafin 5 të këtij neni.

7. Banka përcakton pozicionin e përgjithshëm të rrezikut të bazuar në matjen apo vlerësimin e rreziqeve individuale.

8. Banka përcakton metodologjinë e duhur të brendshme për përcaktimin e pozicionit/profilit të përgjithshëm të rrezikut.

9. Metodologjia për përcaktimin e pozicionit/profilit të përgjithshëm të rrezikut do të konsiderohet e përshtatshme, në qoftë se ajo mundëson një tërësi masash të krahasueshme apo vlerësimesh të rrezikut dhe, kur është e përshtatshme, një rregullim të profilit të përgjithshëm të rrezikut.

Neni 192

Sigurimi i mbulimit të mjaftueshëm me kapital i profilit të rrezikut

1. Banka përcakton objektivat e duhur të brendshëm për të siguruar kapitalin e duhur të brendshëm.

2. Objektivat e brendshëm do të konsiderohen të përshtatshme, në qoftë se ato sigurojnë mbulimin me kapital të rrezikut/qeve të paktën:

a) gjatë operacioneve/veprimtarisë normale të bankës; dhe

b) në rrethana të jashtëzakonshme.

3. Banka, në përcaktimin e objektivave të brendshëm, për të siguruar mbulimin e mjaftueshëm të rrezikut me kapital, konsideron kapacitetin e saj në lidhje me mundësinë për të disponuar/siguruar kapital.

Neni 193

Llojet e kapitalit të brendshëm

1. Banka përcakton llojin e kapitalit, me të cilin ajo siguron mbulimin e duhur të rrezikut me kapital.

2. Banka siguron që totali i kapitalit për të mbuluar rrezikun është në përputhje me kapacitetin e saj për të marrë rreziqe në çdo kohë. Totali i kapitalit për mbulimin e rrezikut mund të ndryshojë nga shuma e kapitalit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

3. Banka, në rastet kur totali i kapitalit për mbulimin e rrezikut është më i vogël se shuma e kapitalit të përcaktuar në nenin 7 të kësaj rregulloreje, injekton kapital (ose paraqet pranë Bankës së Shqipërisë një plan për rritjen e kapitalit), deri në shumën e llogaritur sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

4. Banka siguron një vlerësim të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe një shpërndarje, të paktën një herë në vit të tij, si dhe çdo ndryshim të rëndësishëm të ekspozimit ndaj rreziqeve.

Neni 194

Përfshirja e procesit të brendshëm të vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit në sistemin e administrimit të rrezikut/qeve

Banka siguron përfshirjen e procesit të brendshëm të vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit në sistemin e administrimit të rrezikut/qeve, bazuar në përdorimin e rezultateve të këtij procesi, në monitorimin e vendimeve mbi veprimtarinë e saj (biznesin), të atyre (vendimeve) që lidhen me administrimin e rrezikut/qeve dhe të vendimeve që lidhen me shpërndarjen e brendshme të kapitalit të brendshëm të vlerësuar si të përshtatshëm për mbulimin e rrezikut/qeve.

KREU X

MBIKËQYRJA DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE NGA BANKAT

Neni 195

Mbikëqyrja

1. Banka e Shqipërisë, duke konsideruar kriteret teknike, të përcaktuara në aneksin 3, bën rishikimin e strategjive, proceseve dhe mekanizmave të zbatuar nga bankat në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe vlerësimin e rreziqeve, ndaj të cilave banka është apo mund të jetë e ekspozuar.

2. Banka e Shqipërisë, bazuar në rishikimin dhe vlerësimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, përcakton nëse strategjitë, proceset dhe mekanizmat e zbatuar nga

bankat, si dhe kapitali i mbajtur nga ana e tyre, siguron administrim dhe monitorim të qëndrueshëm të rreziqeve.

3. Banka e Shqipërisë, në varësi të natyrës, madhësisë, rëndësisë sistemike dhe kompleksitetit të veprimtarisë së bankave, përcakton frekuencën dhe intensitetin e rishikimeve dhe vlerësimeve të referuara në paragrafin 1.

Neni 196
Publikimi nga bankat

Bankat për qëllime të zbatimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, publikojnë informacionin e kërkuar sipas kërkesave të rregullores “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 197
Kërkesa raportuese

Bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë të dhënat mbi raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas sistemit raportues të unifikuar.

Neni 198
Masat mbikëqyrëse dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

Neni 199
Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

ANEKS 1
KËRKESAT MINIMALE PËR NJOHJEN DHE VLERËSIMIN E KOLATERALIT PASURI E PALUAJTSHME

PJESA 1
KËRKESAT MINIMALE PËR NJOHJEN E KOLATERALIT PASURI E PALUAJTSHME

1. Bankat, për njohjen e kolateralit pasuri e paluajtshme për qëllime të kreut III të kësaj rregulloreje, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme.

a) Siguria ligjore:

i) kolaterali i ngarkuar me barrë hipotekare duhet të jetë i ekzekutueshëm dhe pasuria e paluajtshme duhet të dokumentohet në mënyrën e duhur (e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) dhe brenda afatit;

ii) marrëveshja e hipotekimit duhet të pasqyrojë një hipotekë/peng të saktë (domethënë të jenë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për vendosjen e hipotekës/pengut);

iii) marrëveshja e kolateralit dhe procesi ligjor që e mbështet atë duhet t’u mundësojë bankave që të përftojnë vlerën e mbrojtjes, brenda një afati kohor të arsyeshëm.

b) Monitorimi i vlerave të pasurisë së paluajtshme:

i) bankat monitorojnë në baza të shpeshta, minimalisht një herë në vit, vlerën e pasurive të paluajtshme tregtare dhe një herë në çdo tre vjet, pasuritë e paluajtshme rezidenciale;

ii) bankat, në rastin kur kushtet e tregut u nënshtrohen ndryshimeve të rëndësishme, kryejnë monitorime më të shpeshta të kolateraleve të përcaktuar në pikën "i" të kësaj shkronje;

iii) bankat përdorin metodat statistikore për monitorimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme dhe për identifikimin e saj, në rastet kur ajo (pasuria e paluajtshme) ka nevojë për rivlerësim;

iv) bankat bëjnë vlerësimin e pasurisë së paluajtshme me një vlerësues të pavarur, në rastet kur informacioni mbi vlerën e pasurisë se paluajtshme evidenton se vlera e saj ka rënë në mënyrë të ndjeshme në krahasim me çmimet e përgjithshme të tregut;

v) bankat, për kreditë që kalojnë vlerën 420 milionë lekë ose 5% të kapitalit rregullator të bankës, bëjnë vlerësimin e saj me një vlerësues të pavarur, të paktën çdo tre vjet.

"Vlerësues i pavarur" është personi, i cili ka kualifikimet e nevojshme, aftësinë, përvojën, si dhe zotëron licencën për ushtrimin e profesionit, dhe është i pavarur nga procesi i vendimmarrjes për dhënien e kredive.

c) Dokumentacioni:

i) bankat dokumentojnë në mënyrë të qartë llojet e pasurisë së paluajtshme rezidenciale dhe tregtare të pranuara/njohura prej tyre, si dhe politikat e tyre të kreditimit, lidhur me to.

d) Sigurimi:

i) bankat hartojnë dhe miratojnë procedura për monitorimin e duhur të sigurimit nga dëmtimi, të pasurisë së paluajtshme të lënë në hipotekë.

PJESA 2
KËRKESAT MINIMALE PËR VLERËSIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME

1. Vlerësuesi i pavarur i bankës vlerëson pasurinë e paluajtshme me një vlerë jo më të madhe se vlera e tregut. Kjo e fundit duhet të dokumentohet në mënyrë të qartë dhe transparente.

2. "Vlera e tregut" është vlera me të cilën mund të shkëmbehet pasuria e paluajtshme në datën e vlerësimit midis një shitësi dhe një blerësi të mundshëm, nëpërmjet një transaksioni ku palët veprojnë në mënyrë të kujdesshme dhe jo të detyrueshme dhe janë të mirinformuar.

3. Vlera e kolateralit duhet të jetë vlera e tregut ose vlera e kredisë hipotekare, e reduktuar siç duhet, në mënyrë që të pasqyrojë rezultatet e monitorimit të kërkuar në pjesën 1 të këtij aneksi dhe të marrë në konsideratë çdo të drejtë paraprake mbi të (pasurinë e paluajtshme).

ANEKS 2
KLASIFIKIMI I ZËRAVE JASHTË BILANCIT
(ndryshuar me vendimin nr. 7, datë 5.2.2020)

Zërat jashtë bilancit klasifikohen në kategoritë e mëposhtme.

Zëra me rrezik të lartë, që përfshijnë:

a) garanci pa mbulesë/me karakteristikat e zëvendësuesve të kredisë (me fondet e bankës), ku përfshihen letërkreditë, garancitë e aprovuara me linjë kredie etj.;

b) derivativët e kredisë (forward-et ose opsionet);

c) pranimet, të cilat janë elemente të formës së garancisë, ku banka nuk livron fonde, por premton pagesë apo financim të ardhshëm, siç përcaktohet në kontratën respektive;

d) çeqe, kambiale apo dëftesa me xhirim në llogari, që nuk mbajnë emrin e një banke tjetër;

e) transaksionet me rekurs, të cilat parashikojnë të drejtën për të kërkuar shlyerjen e detyrimit, ku përfshihet faktoringu, lehtësitë e skontimit të faturës etj.;

f) letra kredie në pritje/të gatshme (standby) të parevokueshme me karakteristikat e garancive pa mbulesë/zëvendësuesve të kredisë;

g) aktive të blera nëpërmjet marrëveshjeve të blerjes me të drejta të plota "forward";

h) depozitat "forward", të cilat përfaqësojnë depozitimin fizik të fondeve të parashikuar për një datë të përcaktuar në të ardhmen, sipas kontratës/ave respektive;

i) pjesa e papaguar e aksioneve dhe titujve të paguar pjesërisht;

j) marrëveshjet e shitjes dhe të riblerjes së aktiveve, siç përcaktohet në ligjin/rregulloren për REPO-t;

k) zëra të tjerë me rrezik të lartë, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga Banka e Shqipërisë.

Zëra me rrezik të mesëm, që përfshijnë:

a) zërat jashtë bilancit të financimit tregtar, në formën e kredive dokumentare të emetuara dhe të konfirmuara;

b) zëra të tjerë jashtë bilancit:

i. garanci transporti dhe garanci doganore dhe tatimore, ku garancia shërben për të siguruar pagesën e detyrimeve doganore dhe tatimore;

ii. angazhime kredie të patërhequra, të cilat përfaqësojnë marrëveshjet e huas, blerjet e titujve, ofrimin e garancive apo të lehtësirave të pranimit me një maturim fillestar më shumë se një vit;

iii. lehtësira/shërbime për lëshimin e vlerënotave, të cilat përfaqësojnë marrëveshjet midis disa bankave për të blerë çdo vlerënotë afatshkurtër apo afatgjatë, të cilën kredimarrësi nuk ka mundësi që ta shesë në tregun e Eurozonës, si dhe angazhimet qarkulluese të nënshkruara, të cilat përfaqësojnë një formë të kredisë qarkulluese, ku një grup bankash bien dakord të akordojnë kredi, në rastet kur një kredimarrës nuk ka mundësi të shesë në tregun e Eurozonës;

iv. zëra të tjerë me rrezik të mesëm, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga Banka e Shqipërisë.

Zëra me rrezik të ulët, që përfshijnë:

a) zërat jashtë bilancit të financimit tregtar:

i. kredi dokumentare, në të cilat dërgesa ose malli (commodity) shërben si kolateral, si dhe transaksione të tjera të vetëlikuidueshme;

ii. garancitë ku përfshihen kryesisht garancitë për tendera dhe për garantimin e përfundimit të punimeve (performance bonds), si dhe garancitë e lidhura me to për pagesat në avancë (advance payment) apo garancitë e mbajtjes (retention guarantees), si dhe garancitë që nuk kanë karakteristikat e garancive pa mbulesë/zëvendësuesve të kredisë;

iii. letra kredie në pritje/të gatshme (standby) të parevokueshme që nuk kanë karakteristikat e garancive pa mbulesë/zëvendësuesve të kredisë;

b) zëra të tjerë jashtë bilancit:

i. angazhime kredie të patërhequra, të cilat përfaqësojnë marrëveshjet e huas, blerjet e titujve, ofrimin e garancive apo të lehtësirave të pranimit, me një maturim fillestar deri në një vit (përfshirë edhe ato me maturim njëvjeçar), të cilat nuk mund të anulohen pa kushte, në çdo kohë dhe pa njoftuar, apo të cilat nuk parashikojnë, efektivisht, anulimin në mënyrë automatike, si pasojë e përkeqësimit të aftësisë paguese të kredimarrësit;

ii. zëra të tjerë me rrezik të ulët, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga Banka e Shqipërisë.

Zëra pa rrezik, që përfshijnë:

a) angazhime kredie të patërhequra, të cilat përfaqësojnë marrëveshjet e huas, blerjet e titujve, ofrimin e garancive apo të lehtësirave të pranimit, që mund të anulohen pa kushte, në çdo kohë dhe pa njoftuar apo që parashikojnë efektivisht anulimin në mënyrë automatike, si pasojë e përkeqësimit të aftësisë paguese të kredimarrësit. Linjat e kredisë me pakicë (retail) mund të konsiderohen si të anulueshme pa kushte, nëse kushtet e punës i lejojnë bankës të anulojë këto linja kredie, duke konsideruar në çdo rast dispozitat e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe aktet nënligjore e rregullative në zbatim të tij;

b) angazhime kredie të patërhequra për tendera dhe për garantimin e përfundimit të punimeve (performance guarantees), që mund të anulohen pa kushte, në çdo kohë dhe pa njoftuar apo që parashikojnë efektivisht anulimin në mënyrë automatike, si pasojë e përkeqësimit të aftësisë paguese të kredimarrësit;

c) zëra të tjerë pa rrezik, të klasifikuar nga vetë banka dhe të vlerësuar nga Banka Shqipërisë.

ANEKS 3
KRITERET TEKNIKE MBI ORGANIZIMIN DHE TRAJTIMIN E RREZIQEVE

Qeverisja/drejtimi i përgjegjshëm dhe efektiv i bankës

1. Këshilli Drejtues i Bankës, në përputhje me kuadrin ligjor[19] dhe rregullativ[20] në fuqi, mbi qeverisjen efektive dhe të përgjegjshme të Bankës, si dhe duke konsideruar madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së saj, siguron ekzistencën e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe në veçanti, ndarjen e detyrave në organizimin, parandalimin dhe monitorimin e konflikteve të interesit.

Trajtimi i rreziqeve

1. Këshilli Drejtues i Bankës miraton dhe rishikon periodikisht strategjitë dhe politikat e administrimit, monitorimit dhe zbutjes së rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet apo mund të jetë e ekspozuar banka, duke përfshirë edhe ato që vijnë nga mjedisi makroekonomik, në të cilin vepron banka.

Rreziku i kredisë dhe i kundërpartisë

1. Banka mbështet procesin e kredidhënies, në kritere të mirëpërcaktuara, si dhe përcakton qartë procesin e miratimit, ndryshimit, rinovimit, dhe rifinancimit të kredive.

2. Banka siguron sisteme efektive për administrimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të portofolave që mbartin rrezik dhe për ekspozimet, të cilët kërkojnë identifikim dhe administrim të kredive me probleme, rregullimet e duhura të vlerave të tyre dhe krijimit të provigjoneve.

3. Banka siguron diversifikimin e portofolit të kredive, duke konsideruar objektivat afatgjatë për kredidhënien të përcaktuar në strategjinë e saj dhe synimet për t'u shtrirë në tregun e kredidhënies.

Rreziku i mbetur

1. Banka harton dhe miraton politika dhe procedura për trajtimin dhe kontrollin e rrezikut të mbetur, që lind/rrjedh në rastet kur teknikat e njohura të zbutjes së rrezikut të kredisë, të përdorura nga banka rezultojnë të jenë më pak efektive nga sa parashikohej.

Rreziku i përqendrimit

---

[19]Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

[20]Rregullorja nr. 24, datë 26.3.2008 "Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe në degët e bankave të huaja" dhe rregullorja nr. 63, datë 14. 11. 2012 "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre".

1. Banka harton dhe miraton politika dhe procedura për administrimin e rrezikut të përqendrimit që rrjedh nga ekspozimet e bankës ndaj një personi ose pale të tretë, grup personash të lidhur, dhe personave/palëve të të njëjtit sektor ekonomik, rajon gjeografik apo nga e njëjta veprimtari, zbatimin e teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë dhe trajtimin në veçanti të rreziqeve që lidhen me ekspozime jo të drejtpërdrejta të mëdha kredie, si për shembull rastet e një emetuesi të vetëm kolaterali etj.

Rreziku i titullzimit

1. Banka siguron vlerësimin dhe trajtimin, nëpërmjet politikave dhe procedurave të duhura, të rreziqeve që rrjedhin nga transaksionet e titullzimit në të cilat ajo (banka) është investitore, origjinuese apo financuese e transaksionit, përfshirë këtu dhe rrezikun e reputacionit, siç janë rreziqet që rrjedhin nga produkte apo struktura komplekse duke synuar në veçanti, që thelbi ekonomik i transaksionit të pasqyrohet plotësisht në vlerësimin e rrezikut dhe në vendimet e Këshillit Drejtues (ose menaxhimit të bankës).

2. Banka, të cilat janë origjinuese të transaksioneve të ripërsëritshme të titullzimit, që përfshijnë dispozita të amortizimit/shlyerjes së parakohshme, duhet të disponojnë plane likuiditeti për trajtimin e pasojave që rrjedhin, si nga amortizimi i planifikuar, ashtu edhe nga ai i parakohshëm (i paplanifikuar).

Rreziku i tregut

1. Bankat hartojnë dhe zbatojnë politikat dhe procedurat e duhura dhe të nevojshme për matjen dhe administrimin e të gjitha burimeve të rëndësishme dhe efekteve të rreziqeve të tregut.

Rreziku i normave të interesit në librat e bankës

1. Banka siguron sisteme për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut që rrjedh nga ndryshimet e mundshme të normave të interesit në librat e bankës.

Rreziku operacional

1. Banka harton dhe zbaton politika dhe procese për vlerësimin dhe administrimin e ekspozimit ndaj rrezikut operacional, duke përfshirë edhe ngjarjet e rënda, madje dhe ato me frekuencë të ulët.

2. Banka, siç përcaktohet dhe në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut operacional[21], për qëllime të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut operacional, mund të përcaktojë përkufizim/e më të specifikuara të këtij rreziku, me kusht që ato të përmbajnë minimalisht elementet e përkufizimit të dhënë në këtë rregullore.

3. Banka siguron planet e emergjencës/kontigjencës dhe të vazhdimësisë së biznesit me qëllim që ajo (banka) të jetë e aftë të vazhdojë aktivitetin dhe të kufizojë humbjet në rast të situatave të rënda (çrregullimeve) të biznesit.

Rreziku i likuiditetit

1. Banka harton dhe zbaton strategji të qëndrueshme, politika, procese dhe sisteme për identifikimin, matjen, administrimin dhe monitorimin e rrezikut të likuiditetit, të cilat përfshijnë minimalisht elementet e përcaktuara në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut të likuiditetit[22].

2. Banka siguron që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e bankës, tipologjinë e aktivitetit dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

3. Banka zhvillon metodologji për identifikimin, matjen, administrimin dhe monitorimin e pozicioneve të financimit. Këto metodologji duhet të përfshijnë të dhënat faktike dhe të pritshme të flukseve të parasë që rrjedhin nga aktivet, pasivet, zërat (angazhimet) jashtë bilancit, duke përfshirë fondet e mundshme (potenciale) të emergjencës dhe ndikimin e mundshëm nga rreziku i reputacionit.

---

[21]Rregullorja nr. 3, datë 19.1.2011 "Për administrimin e rrezikut operacional" dhe anekset e saj.

[22]Rregullorja nr. 71, datë 14.10.2009 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" dhe anekset e saj.

4. Banka bën dallimin ndërmjet aktiveve të premtuara (për t'u investuar/akorduar/etj.) dhe atyre ndaj të cilave nuk ekziston ndonjë pretendim, të cilat janë në dispozicion në çdo kohë, në veçanti gjatë situatave të emergjencës. Banka konsideron, gjithashtu, edhe personin, të cilit i përkasin këto aktive, vendin në të cilin është regjistruar ligjërisht aktivi/et në një regjistër apo llogari, faktin nëse janë të pranueshme apo jo si aktive likuide dhe monitorimin e tyre (aktiveve), me qëllim mobilizimin në çdo kohë.

5. Banka konsideron aktet ligjore dhe rregullative në fuqi, si dhe kufizimet për mundësitë reale të transferimit të likuiditeteve dhe të aktiveve ndaj të cilave nuk ekziston ndonjë pretendim ndërmjet bankave/palëve.

6. Banka siguron teknika të ndryshme të zbutjes së rrezikut të likuiditetit, duke përfshirë një sistem të kufijve dhe mbulimin e nevojave për likuiditet në mënyrë që ajo (banka) të jetë në gjendje të përballojë situata të ndryshme stresi dhe një strukturë të diversifikuar financimi efikase për të pasur akses në burimet e fondeve, të cilat rishikohen mbi baza periodike të rregullta.

7. Banka administron likuiditetin jo vetëm në kushte/rrethana normale, por përgatitet për administrimin e tij dhe në kushte/rrethana të jashtëzakonshme. Në funksion të kësaj të fundit, banka kryen në mënyrë periodike *stress test*-e, me qëllim identifikimin dhe matjen e ekspozimit të saj ndaj rrezikut të likuiditetit, si në kushte/situata normale të aktivitetit të përditshëm, ashtu dhe në situata jo të zakonshme.

8. Banka zhvillon një plan emergjence për administrimin e rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme, i cili është pjesë e sistemit të administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe përmban minimalisht elementet e përcaktuara në kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë për administrimin e rrezikut të likuiditetit[23].

ANEKS 4
LLOJET E DERIVATIVËVE

1. Kontrata për normat e interesit:
a) *Swap*-e të normave të interesit mbi një monedhë të vetme;
b) *Swap*-et bazë;
c) Marrëveshje "*forward*" të normave të interesit;
d) Kontratat e së ardhmes për normat e interesit;
e) Opsione të blera mbi normat e interesit; dhe
f) Kontrata të tjera të një natyre të ngjashme.
2. Kontrata të këmbimeve valutore dhe kontrata që kanë lidhje me arin:
a) *Swap*-e të normave të interesit ndërmjet monedhave;
b) Kontrata "*forward*" të kursit të këmbimit;
c) Kontrata të së ardhmes ndërmjet monedhave;
d) Opsione të blera mbi monedhat;
e) Kontrata të tjera të një natyre të ngjashme; dhe
f) Kontrata që kanë lidhje me arin, me natyrë të ngjashme nga pika "a" deri në "e".

3. Kontrata me natyrë të ngjashme me ato të përmendura në paragrafin e parë, nga shkronja "a" deri në shkronjën "e", dhe nga shkronja "a" deri në shkronjën "d" të paragrafit të dytë, që kanë lidhje me tregues ose indekse të tjerë reference.

Kështu, do të përfshihen, minimalisht, të gjitha instrumentet e specifikuara më poshtë:

a) opsionet, kontratat e së ardhmes, *Swap*-et, marrëveshjet *forward* të normave të interesit dhe çdo kontratë tjetër derivative, që ka të bëjë me titujt, monedhat, normat e

[23]Rregullorja nr. 71, datë 14.10.2009 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" dhe anekset e saj.

interesit apo *yield*-t, ose instrumente të tjera derivative, tregues apo masa financiare, të cilat mund të shlyhen fizikisht ose në *cash*;

b) opsionet, kontratat e së ardhmes, *Swap*-et, marrëveshjet *forward* të normave të interesit, dhe çdo kontratë tjetër derivative, që ka të bëjë me mallrat (*commodities*), të cilat duhet të shlyhen në *cash*, ose mund të shlyhen në *cash* me opsionin e pagesës së njërës prej palëve (në rast mospagese apo prishjes së kontratës nga njëra palë);

c) opsionet, kontratat e së ardhmes, *Swap*-et dhe çdo kontratë tjetër derivative, që ka të bëjë me mallrat (*commodities*) që mund të shlyhen fizikisht, duke siguruar që ato do të tregtohen në një treg të rregulluar apo nëpërmjet lehtësirave/marrëveshjeve tregtare shumëpalëshe;

d) opsionet, kontratat e së ardhmes, *Swap*-et, *forward*-et dhe çdo kontratë tjetër derivative, që ka të bëjë me mallrat (*commodities*) që mund të shlyhen fizikisht, ndryshe nga sa përmendet në shkronjën "c" të këtij paragrafi, dhe që nuk përdoren për qëllime tregtare, që kanë karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative, duke konsideruar që ato shlyhen nëpërmjet shtëpive të njohura të klerimit apo janë subjekt i opsioneve *call* të rregullta marxhinale (të kryera nga brokerat/ndërmjetësit kur llogaritë bien poshtë kufirit të kërkesave marxhinale);

e) kontrata financiare të diferencave;

f) opsionet, kontratat e së ardhmes, *Swap*-et, *forward*-et dhe çdo kontratë tjetër derivative, që ka të bëjë me variablat klimaterik, normat e interesit për transportin e mallrave (*commodities*), pagesat e emisioneve, normat e inflacionit apo të dhëna të tjera statistikore ekonomike, të cilat duhet të shlyhen në *cash*, ose mund të shlyhen në *cash* me opsionin që njëra prej palëve (në rast mospagese apo prishjes së kontratës nga njëra palë), si dhe çdo kontratë tjetër derivative që ka të bëjë me aktivet, të drejtat, detyrimet, si dhe treguesit dhe njësitë matëse që nuk përmenden në këtë paragraf, që kanë karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative, duke konsideruar që ato tregtohen në një treg të rregulluar, apo nëpërmjet një angazhimi/lehtësie tregtare shumëpalëshe, të cilat do të shlyhen nëpërmjet shtëpive të njohura të klerimit, apo janë subjekt i opsioneve *call* të rregullta marxhinale.

ANEKS 5
KRITERET TEKNIKE QË PËRDOR BANKA E SHQIPËRISË, GJATË PROCESIT TË RISHIKIMIT/SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT MBIKËQYRËS

1. Banka e Shqipërisë, në procesin e saj mbikëqyrës, përveç rrezikut të kredisë, rreziqeve të tregut dhe rrezikut operacional, shqyrton dhe vlerëson:

a) rezultatet e *stress-test*-eve të realizuara nga bankat, të cilat mund të përdorin një model të brendshëm vlerësimi;

b) ekspozimet dhe administrimin e rrezikut të përqendrimit, duke përfshirë kërkesat e rregullores nr. 31, datë 30.4.2008 "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", e ndryshuar;

c) masën e shtrëngimit, përshtatshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave dhe procedurave të bankës për administrimin e rrezikut të mbetur që rezulton/është rrjedhojë e përdorimit të teknikave të njohura të zbutjes së rrezikut;

d) nivelin, në të cilin fondet e vetë (kapitali rregullator) bankës përballojnë aktivet të cilat sigurojnë (mbrojnë), duke konsideruar qëllimin ekonomik të transaksionit, përfshirë këtu edhe shkallën e transferimit të përftuar të rrezikut;

e) ekspozimin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit nga banka;

f) efektet e diversifikimit të rreziqeve dhe mënyrën se si ky diversifikim është përfshirë në metodat e matjes së rrezikut;

g) rezultatet e *stress-test*-eve të realizuara nga bankat, të cilat përdorin modele të brendshme për llogaritjen e kapitalit të nevojshëm për mbulimin/monitorimin e rreziqeve të tregut.

2. Banka e Shqipërisë siguron nëse bankat mbështesin/përdorin procesin/et e titullzimit. Në rastet që Banka e Shqipërisë evidenton se një bankë ka mbështetur/përdorur titullzimet më shumë se një herë, duhet të konsiderojë mjetet e duhura (si për shembull rishikim i kuadrit rregullativ, i metodologjisë së mbikëqyrjes etj.), të cilat pasqyrojnë një pritshmëri më të madhe për të mbështetur në të ardhmen titullzimin, me qëllim shmangien e një transferimi të konsiderueshëm/të madh të rrezikut.

3. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse korrigjimet/rregullimet e vlerave dhe të provigjoneve për pozicionet/portofolat në librin e tregtueshëm, i mundësojnë bankës shitjen ose sigurimin e mbrojtjes së pozicioneve brenda një periudhe të shkurtër dhe pa pësuar humbje të mëdha, duke supozuar se ndodhemi në kushte normale tregu.

ANEKS 6
KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR NJOHJEN E ECAI-ve

A. Informacion i përgjithshëm

1. Lloji i vlerësimit të kredisë: i kërkuar (*solicited*) ose/dhe i dhënë (*unsolicited*), me një shpjegim të shkurtër mbi logjikën e politikës së vlerësimit.

2. Vendet ku ECAI-ja ushtron aktivitetin e tij.

3. Një vështrim i strukturës ligjore të ECAI-së dhe grupit të cilit i takon: pronësia, degët (filialet) kryesore, shërbimet ndihmëse ose të tjera të ofruara etj. Informacioni mbi pronësinë duhet të përfshijë një listë të aksionarëve që zotërojnë më shumë se për shembull 10% të kapitalit të ECAI-së;

4. Numri i përgjithshëm i punonjësve.

5. Numri i përgjithshëm dhe përqindja e të ardhurave nga klientët kryesorë dhe/ose abonentët (për shembull, klientët dhe abonentët që zënë 5% ose më shumë të totalit të të ardhurave).

6. Informacioni financiar që tregon qëndrueshmërinë financiare të ECAI-s: pasqyrat financiare të ECAI-së për tri vitet e fundit dhe parashikimet për tri vitet e ardhshme nëse janë të disponueshme ose një letër mbështetëse nga subjekti mëmë.

7. Informacion mbi kodin e sjelljes, nëse ky kod është në përputhje me standardet e pranuara të tregut ose me parimet e njohura ndërkombëtare.

B. Informacioni që evidenton se plotësohen kriteret e njohjes si të pranueshme të ECAI-ve

Objektiviteti i metodologjisë

1. Një përshkrim i detajuar i metodologjisë dhe proceseve të vlerësimit të kredisë dhe se si është përcaktuar, zbatuar dhe ndryshuar kjo metodologji. Ky përshkrim duhet të përfshijë një përshkrim të proceseve në vend, për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të metodologjive të vlerësimit, në mënyrë të vazhdueshme, për të gjitha vlerësimet e kredisë, në mënyrë të veçantë rolin e komisioneve vlerësuese dhe udhëzimeve që ato u përmbahen, masën e përfshirjes së të dhënave nga subjektet vlerësuese, aksesin ndaj informacionit jopublik etj.

2. Një përshkrim i detajuar i të dhënave sasiore: variablat kyçë, burimet e të dhënave, supozimet dhe teknikat sasiore të përdorura, shtrirja e të dhënave nga subjektet e vlerësuara etj., për secilin segment brenda të cilit është aplikuar, në mënyrë të veçantë, një metodologji e mirëfilltë (për shembull, për segmentin e financave të strukturuara, financave publike apo subjekteve tregtare).

3. Një përshkrim i detajuar i të dhënave cilësore: në veçanti objekti i gjykimit cilësor, si për shembull në lidhje me strategjinë, planet e biznesit të subjekteve të klasifikuara etj., për secilin segment brenda të cilit është aplikuar, në mënyrë të veçantë, një metodologji e mirëfilltë (për shembull, për segmentin e financave të strukturuara, financave publike apo

subjekteve tregtare).

4. Një përmbledhje, sipas zonave gjeografike, të ndryshimeve të konsiderueshme në metodologjitë bazë të përdorura.

5. Një përshkrim të metodologjisë së përdorur për të verifikuar saktësinë, qëndrueshmërinë dhe fuqinë dalluese të sistemeve të klasifikimit, me detaje mbi rezultatet dhe konkluzionet e përftuara nga një analizë e tillë.

Pavarësia e metodologjisë

1. Një përshkrim i procedurave që synojnë sigurimin e vlerësimeve të drejta dhe objektive të kredisë: mekanizmat për të identifikuar, parandaluar, administruar dhe eliminuar konfliktet, aktuale apo të mundshme të interesit.

2. Një përshkrim i masave mbrojtëse në fuqi në rastet kur aksionerët ose palët e tjera në grupin e palëve të lidhura janë të vlerësuar (*rated*).

3. Deklaratë mbi ekzistencën e një funksioni të kontrollit të brendshëm dhe/ose që ekzistojnë mjete për të siguruar që procedurat e brendshme të hartimit, rishikimit dhe tërheqjes së vlerësimeve të kredisë zbatohen në mënyrë efektive.

4. Deklaratë mbi aftësitë profesionale të duhura dhe të nevojshme të anëtarëve të grupeve dhe komiteteve të vlerësimit, duke përfshirë ekspertizën dhe përvojën në vlerësimin e kredisë, si dhe përsosjen e tyre nëpërmjet programeve të mjaftueshme të trajnimit.

5. Një përshkrim i karakteristikave kryesore të kodit të brendshëm të sjelljes së ECAI-së.

6. Deklaratë mbi politikën e shpërblimit të stafit të përfshirë në vlerësimin e kredisë, e cila nuk do të ndikojë në prodhimin e vlerësimeve të kredisë të pavarura dhe objektive (për shembull, vërtetim se shpërblimi i analistëve nuk është i lidhur me vendimet e vlerësimit të kredisë, pagesat nga subjektet vlerësuara, ose të ardhurat nga klientët apo abonentët).

7. Informacion i detajuar i politikës së komisioneve të ECAI-së.

8. Deklaratë që personeli i përfshirë në procesin e vlerësimit të kredisë nuk është angazhuar në marrëdhënie biznesi me subjektet e vlerësuara, që mund të pengojnë lëshimin e vlerësimeve të pavarura dhe me cilësi të lartë të kredisë.

Rishikimi i vazhdueshëm i metodologjisë

1. Informacion i përgjithshëm mbi shqyrtimin e vlerësimeve të kredisë (për shembull, procesi në vend, karakteristikat kryesore, fusha e veprimit, frekuenca dhe ekipet/grupet e stafit të përfshirë, mjetet e përdorura, trajtimi, fazat kryesore të procesit të monitorimit, rifreskimi i të dhënave, informacioni nga subjektet e vlerësuara të marra në shqyrtim, sistemet automatike paralajmëruese, mekanizmat që lejojnë gabime sistematike në vlerësimet e kredisë, të cilat reflektohen në ndryshime të mundshme në metodën e vlerësimeve etj.).

2. Një përmbledhje e rezultateve të rishikimeve të kryera.

3. Informacion mbi ekzistencën e një sistemi "*back-testing*" të instaluar në vend dhe që funksionon prej të paktën një viti.

4. Lista e kontakteve me drejtimin e lartë, të subjekteve të vlerësuara.

Transparenca e metodologjisë

1. Vërtetim se janë publikuar parimet e metodologjisë së përdorur nga ECAI-ja për formulimin e vlerësimeve të saj të kredisë.

2. Përshkrim i mënyrave të përdorura për të bërë publike metodologjitë dhe të termave të marrjes së vlerësimeve të kredisë nga ana e të gjithë përdoruesve të mundshëm.

3. Një përshkrim të politikave të transparencës, lidhur me tipin e vlerësimeve të kredisë: të dhëna (*unsolicited*) dhe të kërkuara (*solicited*).

Besueshmëria

1. Çdo evidencë që vërteton/demonstron mbështetjen e tregut në vlerësimet e kredisë, të tilla si: pjesa e tregut;numri i subjekteve të vlerësuara; sa gjatë ka qenë aktive në treg ECAI-ja; të ardhurat e përftuara nga aktiviteti i vlerësimeve.

Transparenca e vlerësimeve të kredisë

1. Një përshkrim i detajuar i procedurave në fuqi të publikimit (*disclosures*).

C. Informacioni i nevojshëm për *mapping* e vlerësimit të kredisë

Informacion i nevojshëm për *mapping* e vlerësimit afatgjatë të kredisë

1. Përkufizimi i dështimit (*default*).

2. Norma e akumuluar e dështimit (*Cumulative Default Rate* - CDR) e më shumë se tri viteve për secilën kategori (për t'u ofruar çdo vit nëse ECAI-ja do të njihet) dhe të paktën dy CDR-t më të fundit.

3. Mesatarja 10-vjeçare e CDR-së 3-vjeçare dhe nëse kjo nuk është e disponueshme, një tregues i pritshmërisë së ECAI-s lidhur me mesataren 10-vjeçare të CDR-së 3-vjeçare.

4. Një informacion mbi probabilitetin e synuar të dështimit për çdo kategori të vlerësimit të kredisë, nëse është përdorur një probabilitet i synuar i dështimit.

5. Përshkrimi i metodologjisë për llogaritjen e CDR-s: përzgjedhja e grupit/*pool* (statike kundrejt dinamike/e rregulluar, përkufizimi i dështimit, mbledhja (agregimi) e dështimeve (mekanizmi i ponderimit).

6. Rëndësia statistikore e normave të dështimit.

7. Karakteristikat dinamike të metodologjisë së vlerësimit.

8. Kuptimi i kategorive të vlerësimit të kredisë.

9. Gama e vlerësimit të kredisë që përcakton ECAI-ja.

10. Afati kohor i vlerësimeve të kredisë.

11. Matricat transitore.

12. Mbulimi gjeografik.

Informacion i nevojshëm për *mapping* e vlerësimit afatshkurtër të kredisë

1. Lidhja mes vlerësimeve thelbësore afatshkurtra të kredisë dhe vlerësimeve thelbësore afatgjata të kredisë.

2. Lidhja mes vlerësimeve afatshkurtra të kredisë së financave të strukturuara dhe vlerësimeve afatgjata të kredisë së financave të strukturuara.

ANEKSI 7
Formularët raportues të kërkesave për kapital (COREP) dhe udhëzuesi metodologjik për plotësimin e tyre

CR SA Rreziku i kredisë, rreziku i kredisë së kundërpartisë dhe rreziku i shlyerjes :

Klasa e ekspozimit

Ecai të nominuara

		Ekspozimi origjinal përpara faktorëve të konvertimit		(-) Rregullime të vlerës dhe provigjonet e lidhura ekspozimeve origjinale	Ekspozimi origjinal para faktorëve të konvertimit (neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjonet)	Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë me efekte zëvendësimi të ekspozimit						Ekspozimi neto pas efekti zëvendësues të teknikave të zbutjes së kredisë, përpara aplikimit të faktorëve të konvertimit	Metodat e zbutjes së rrezikut të kredisë që përkin vlerën e ekspozimit. Mbrojtja e kredisë e financuar, metoda e kolateralit financiar, metoda			Vlera e ekspozimit të rregulluar plotësisht (E*)	Ndarja e ekspozimeve të rregulluara plotësisht të zëra jashtë bilancit sipas faktorëve të konvertimit			
						Mbrojtja e pafinancuar e kredisë: Vlera e rregulluar (Ga)		Mbrojtja e financuar e kredisë		Zëvendësimi i ekspozimeve si rezultati teknikave të zbutjes			Rregullimi i luhatshmërisë së ekspozimit	(-) Kolaterali financiar: Vlera e rregulluar (Cvam)	(-) Rregullimet e luhatshmërisë dhe maturitetit		0%	20%	50%	100
		010	020	030	040	050	060	070	080	090	100	110=040-090+100	120	130	140	150 = 110 + 120 - 130	160	170	180	190
010	**Totali i ekspozimeve**																			
011	Nga të cilat SME																			
012																				
013																				
014																				
												Ndarja sipas llojit të ekspozimit								
020	Zërat e bilancit subjekti i rrezikut të kredisë																			
030	Zërat jashtë bilancit subjekti i rrezikut të kredisë																			
	Ekspozime të/ transaksionet subjekti i rrezikut të kundërpartisë																			
040	Transaksionet e financimit të letrave me vlerë																			
050																				
060	Derivativet dhe transaksionet e shlyerjes në aftatë gjatë kohë																			
070																				
080																				
												Ndarja e ekspozimeve totale sipas peshës së ponderimit								
090	0%																			
100	10%																			
110	20%																			
120	35%																			
130	50%																			
140	75%																			
150	85%																			
160	100%																			
170	125%																			
180	150%																			
190	200%																			
200	1250%																			
210	Pesha të tjera																			
												Zëra të vecantë								
220																				
230																				
240																				
250																				

CRSEC SA Titullizimi

Formulari 2

Lloji i titullizimit:

OCAI-shi e nominuara:

	Shuma totale e ekspozimeve të titullizuara të origjinës	Titullizimi vetëm: Mbrojtje krediti ekspozimeve të titullizuara			Pozicionet në titullizim	(-) Rregullimet e vlerës dhe provigjionet	Vlera neto e ekspozimeve (dikur debitur rregullimet e vlerës dhe provigjionet)	Teknikat e zbutjes së kreditit (TZK) me efekt zhvendosues				Ekspozimet neto pas efektave të zhvendosjeve të rezultit të TZK, para faktorëve të konvertimit.	(-) Teknikat e zbutjes së kreditit që pasqyrojnë efektet e ekspozimit: Mbrojtja e kreditit financiar, metoda gjithëpërfshirëse	Vlerat e ekspozimit e regulluar pas kredisë (E*)	Ndarje ekspozimeve të regulluara pas kredisë të klasifikuara sipas faktorëve të konvertimit:				Vlera e ekspozimit			Ndarje ekspozimeve subjekt i pozicionimeve metë sipas					
		(-) Mbrojtje kreditoi financiar (Da)	(-) Totali i fshirjeve dikur Vlera e regulluar e mbrojtjes së kreditoi pafinancuar (G*)	Vlera nominale (notional) e mbrojtjeve e ndërtuara e mbrojtjes së kreditit	Ekspozimi origjinal para faktorëve të konvertimit			Mbrojtja e kreditoi pafinancuar: Vlera e regulluar (Ga)	Mbrojtje financiare kreditit	Zvendosjet e ekspozimeve në rezultat i TZK: (-) Totali i fshirjeve dikur	Totali i fshirjeve hyrëse				0%	>0% deri në =20 %	>20% deri në =50%	>50% deri në =100 %		(-) shtesa me kapitalin regullator	Subjekt i pozicionimeve metë	Ponderimi i rrezikut (sipas)				Të shkëlqyera (sipas)	Të pashkëlqyera (sipas)
	010	020	030	040	050	060	070=080-060	080	090	100	110	120	130	140	150	160	170	180	190	200	210=190-200	220	230	240	250	260	270
Ekspozimi total																											
Origjinuni: Ekspozimi total																											
Dëra në bilanc																											
sektor (Segmenti me pikpamjen të lartë)																											
mezzanine (Segmenti me pikpamjen mesatare)																											
First loss (Segmenti që mbulon humbjet e para)																											
Dërat jashtë bilancit dhe derivatet																											
Amortizimi para kohe (early amortization)																											
Investitori: Ekspozimi total																											
Dëra në bilanc																											
sektor (Segmenti me pikpamjen të lartë)																											
mezzanine (Segmenti me pikpamjen mesatare)																											
First loss (segmenti që mbulon humbjet e para)																											
Dërat jashtë bilancit dhe derivatet																											
Sponsori: Ekspozimi Total																											
Dëra në bilanc																											
Dëra jashtë bilancit dhe derivatet																											

Formulari 3

MKR SA TDI **Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit**

Monedha:

		Pozicionet					Kërkesë për kapital (në %)	Kërkesa për kapital	Ekspozimi ponderuar me rrezik
		Të gjitha pozicionet		Pozicionet neto		Pozicionet subjekti kapitalit rregullator			
		Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje				
		010	020	030	040	050		060	070
010	Titujt e borxhit në librin e tregtueshëm								
011	Rreziku i përgjithshëm								
012	Derivatet								
013	Mjete të tjera dhe detyrime								
020	Metoda e bazuar në maturitet								
030	Zona 1								
040	0 ≤ 1 muaj								
050	> 1 ≤ 3 muaj								
060	> 3 ≤ 6 muaj								
070	> 6 ≤ 12 muaj								
080	Zona 2								
090	> 1 ≤ 2 (1,9 për kupon më të ulët se 3%) vite								
100	> 2 ≤ 3 (> 1,9 ≤ 2,8 për kupon më të ulët se 3%) vite								
110	> 3 ≤ 4 (> 2,8 ≤ 3,6 për kupon më të ulët se 3%) vite								
120	Zona 3								
130	> 4 ≤ 5 (> 3,6 ≤ 4,3 për kupon më të ulët se 3%) vite								
140	> 5 ≤ 7 (> 4,3 ≤ 5,7 për kupon më të ulët se 3%) vite								
150	> 7 ≤ 10 (> 5,7 ≤ 7,3 për kupon më të ulët se 3%) vite								
160	> 10 ≤ 15 (> 7,3 ≤ 9,3 për kupon më të ulët se 3%) vite								
170	> 15 ≤ 20 (> 9,3 ≤ 10,6 për kupon më të ulët se 3%) vite								
180	> 20 (> 10,6 ≤ 12,0 për kupon më të ulët se 3%) vite								
190	(> 12,0 ≤ 20,0 për kupon më të ulët se 3%) vite								
200	(> 20 për kupon më të ulët se 3%) vite								

Formulari 4

MKR SA EQU **Rreziku i pozicionit në tituj të kapitalit**

		Pozicionet					Kërkesa për kapital në % (%)	Kërkesa për kapital	Totali i ekspozimeve të ponderuara me rrezik
		Pozicionet		Pozicioni neto		Pozicioni neto subjekt i kërkesës për kapital			
		Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje				
		010	020	030	040	050		060	070
010	Tituj të kapitalit në librin e tregtueshëm								
020	Rreziku i përgjithshëm						8.00		
021	Derivativet								
022	Asete të tjera dhe detyrime								
030	Kontrata të së ardhmes që bazohen në indekset e aksioneve të tregtueshme në bursë, gjerësisht të diversifikueshme, subjekte tënjë përqasje të vecantë								
040	Aksione të tjera përvec atyre të përcaktuara në rrjeshtin 030								
050	Rreziku specifik						4.00		
080	Përqasje e vecantë për pozicionet në SKI								
090	Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jo delta)								
100	Metoda e thjeshtë								
110	Përqasja delta plus - rreziku gama								
120	Përqasja delta plus - rreziku vega								

Formulari 5

CR TB SETT

Rreziku i shlyerjes

		Transaksione të pashlyera me cmimin e shlyerjes	Ekspozimi si rezultat i differences në cmim për transaksionet e pashlyera	Kërkesa për kapital	Totali i ekspozimeve i ponderuar me rrezik
		010	*020*	*030*	*040*
010	***Totali I transaksioneve të pashlyera në librin e bankës***				
020	Transaksione të pashlyera deri në 4 ditë (factor 0 %)				
030	Transaksione të pashlyera ndërmjet 5 dhe 15 ditësh (faktor 8%)				
040	Transaksione të pashlyera ndërmjet 16 dhe 30 ditësh (faktor 50%)				
050	Transaksione të pashlyera ndërmjet 31 dhe 45 ditësh (faktor 75%)				
060	Transaksione të pashlyera mbi 46 ditë e më tepër (faktor 100%)				
070	Totali I transaksioneve të pashlyera në librin e tregtueshëm				
080	Transaksione të pashlyera deri në 4 ditë (factor 0 %)				
090	Transaksione të pashlyera ndërmjet 5 dhe 15 ditësh (faktor 8%)				
100	Transaksione të pashlyera ndërmjet 16 dhe 30 ditësh (faktor 50%)				
110	Transaksione të pashlyera ndërmjet 31 dhe 45 ditësh (faktor 75%)				
120	Transaksione të pashlyera mbi 46 ditë e më tepër (faktor 100%)				

Formulari 6

MKR SA COM ***(Commodities)*** **Rreziku i investimeve në mallra**

		Të gjitha pozicionet		Pozicioni Neto		Pozicione subjekti kërkesës përkapital	**Kërkesa përkapital (%)**	Kërkesa për kapital	Pozicionet e ponderuara me rrezik
		Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje				
		010	020	030	040	050		060	070
010	Pozicionet totale në mallra								
020	Metale të cmuara (përvec arit)								
030	Metale bazë (zink, bakër, etj)								
040	Produkte bujqësore (softs)								
050	Të tjera								
060	Nga të cilat produkte energjitike (naftë, benzinë)								
070	Metoda e bazuar në segmentet e maturitetit								
080	**Extended maturity ladder approach**								
090	Metoda e thjeshtë: Të gjitha pozicionet								
100	Kërkesë shtesë për opcionet s (rreziqe jo delta)								
110	Metoda e thjeshtë								
120	Metoda delta plus - kërkesa shtesë për rrezikun gamma								
130	Metoda delta plus - kërkesa shtesë për rrezikun vega								
140	**Scenario matrix approach**								

Formulari 7

MKR SA FX

Rreziku i kursit të këmbimit

		Kodi i monedhës	Të gjitha pozicionet		Pozicionet neto		Pozicione me trajtim preferencial			Kërkesa përkapital (%)			Kërkesa për kapital	Eksponimet e ponderuara me rrezik
			Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje		Në blerje	Në shitje			
		010	020	030	040	050	060	070	080				090	100
010	Pozicionet totale në monedhë të huaj													
020	**Monedhat me korrelacion të fortë**													
030	Të gjitha monedhat (duke përfshirë investimet në SKI të trajtuara si monedhë e vecantë)									8.00	8.00			
040	Ari									8.00	8.00			
050	Kërkesë shtesë për opcionet s (rreziqe jo delta)													
060	Metoda e thjeshtë													
070	Metoda delta plus - kerkesa shtesë për rrezikun gamma													
080	Metoda delta plus - kërkesa shtesë për rrezikun vega													
090	**Scenario matrix approach**													
	Ndarja e pozicioneve sipas llojit të instrumentit													
100	Instrumenta financiare													
110	Zëra jashtë bilancit													
120	Derivative													
	Pozicionet në valuta të ndryshme													
130	Euro	EUR												
140	**Lek**	**ALL**												
150	**Peso Argjentinas**	**ARS**												
160	Dollar Australian	AUD												
170	**Real Brazilian**	**BRL**												
180	**Lev Bullgar**	**BGN**												
190	Dollar Kanadez	CAD												
200	**Koruna Ceke**	**CZK**												
210	Krona Daneze	DKK												
220	**Paundi Egjiptian**	**EGP**												
230	Paundi Britanik	GBP												
240	**Forint Hungarez**	**HUF**												
250	Yen Japonez	JPY												
260	**Lata Letoneze**	**LVL**												
270	**Lita Lituaniane**	**LTL**												
280	**Denar Maqedonas**	**MKD**												
290	**Peso Meksikan**	**MXN**												
300	**Zloti Polak**	**PLN**												
310	**Leu Rumun**	**RON**												
320	**Rubla Ruse**	**RUB**												
330	**Dinar Serb**	**RSD**												
340	Krona Suedeze	SEK												
350	Franga Zvicerane	CHF												
360	Lira Turke	TRY												
370	**Hrynia Ukrainase**	**UAH**												
380	Dollar Amerikan	USD												
390	**Krona Islandeze**	**ISK**												
400	Krone Norvegjeze	NOK												
410	Të tjera													

Formulari 8

OPR **Rreziku operacional**

	Aktiviteti bankar	Treguesi			Kredi dhe paradhenie (N të metodes standarte	
		VITI-3	VITI-2	VITI I FUNDIT	VITI-3	VITI-2
		010	020	030	040	050
010	1. TOTALI I AKTIVITETEVE BANKARE SUBJEKT I METODËS SË TREGUESIT BAZIK (BIA)					
020	2. TOTALI I AKTIVITETEVE BANKARE SUBJEKT I METODAVE STANDARTE (STA) / STANDARTE ALTERNATIVE (ASA)					
	Subjekt i metodes standarte:					
030	FINANCAT E KORPORATAVE (CF)					
040	TREGTIMI DHE SHITJET (TS)					
050	Broker me Pakice (RBr)					
060	BANKINGU TREGTAR(CB)					
070	BANKINGU ME PAKICE (RB)					
080	PAGESAT DHE SHLYERJET (PS)					
090	SHERBIMET E AGJENCISE (AS)					
100	MENAXHIMI I ASETEVE (AM)					
	Subjekt i metodes standarte te avancuar:					
110	BANKINGU TREGTAR (CB)					
120	BANKINGU ME PAKICE (RB)					
130	**Përqasja AMA**					

Formulari 9

RMK – Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

(ndryshuar rreshti i fundit me vendimin nr. 91, datë 2.12.2015
në "Pakësimet për rritjen e portofolit brenda vendit për vitin 2016")

RMK - Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

1)

Treguesit	Vlera
Kapitali rregullator	(a)
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(b)
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (ne%)	(a)/(b)*100

2)

Treguesit	Vlera
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(d)=(a)+(b)+(c)
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	(a)
12.5*kërkesa për kapital për rrezikun e tregut	(b)
12.5*kërkesa për kapital për rrezikun operacional	(c)

UDHËZUES METODOLOGJIK

PËR PLOTËSIMIN E FORMULARËVE RAPORTUES TË KËRKESAVE PËR KAPITAL "COREP"

1 Përmbajtja

2 KËRKESA PËR KAPITAL PËR RREZIKUN E KREDISË 14

2.1 Formulari CR SA- Rreziku i kredisë, rreziku i kredise së kundërpartise dhe rreziku i shlyerjes se transaksioneve jo-DVP 14
2.1.1 Të përgjithshme 14
2.1.2 Përmbajtja e kolonave 14
2.1.3 Përmbajtja e rreshtave 19

2.2 Formulari CR SEC SA-Titullizimi 20
2.2.1 Të përgjithshme 20
2.2.2 Përmbajtja e kolonave 20
2.2.3 Përmbajtja e rreshtave 25

3 KËRKESA PËR KAPITAL PËR RREZIKUN E TREGUT 26

3.1 Formulari MKR SA TDI –Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit. 26
3.1.1 Të përgjithshme 26
3.1.2 Përmbajtja e kolonave 26
3.1.3 Përmbajtja e rreshtave 27

3.2 Formulari MKR SA ECU-Rreziku i pozicionit të titujve të kapitalit. 29
3.2.1 Të përgjithshme 29
3.2.2 Përbërja e kolonave 29
3.2.3 Përbërja e rreshtave 30

3.3 Formulari CR TB SETT – Rreziku i shlyerjes 31
3.3.1 Të përgjithshme 31
3.3.2 Përmbajtja e kolonave 32
3.3.3 Përmbajtja e rreshtave 32

3.4 Formulari MKR SA COM- Rreziku i investimeve në mallra (commodities). 33
3.4.1 Të përgjithshme 33
3.4.2 Përmbajtja e kolonave 33
3.4.3 Përmbajtja e rreshatve 34

3.5 Formulari MKR SA FX- Rreziku i kursit të këmbimit. 35
3.5.1 Të përgjithshme 35
3.5.2 Raportimi i pozicionit valutor neto 35
3.5.3 Raportimi i kërkesës për kapital për pozicionin neto të hapur valuator 36
3.5.4 Rreziqe të tjera 36
3.5.5 Kërkesa për kapital 37

4 KËRKESA PËR KAPITAL PËR RREZIKUN OPERACIONAL 37

4.1 Formulari OPR - Rreziku operacional 37

4.1.1 Të përgjithshme 37
4.1.2 Metoda e Thjeshtë 37
4.1.3 Metoda standarte 38
4.1.4 Metoda standarte e avancuar 38

5 FORMULARI RMK-RAPORTI I MJAFTUESHMERISË SE KAPITALIT 38

2. Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë

2.1 Formulari CR SA - Rreziku i kredisë, rreziku i kredisë së kundërpartisë dhe rreziku i shlyerjes së transaksioneve jo-DVP

2.1.1 Të përgjithshme

Fusha e zbatimit të këtij formulari mbulon kërkesat e mëposhtme për kapital:

- Rrezikun e kredisë në librin e bankës, i cili përfshin edhe rrezikun e kundërpartisë në librin e bankës;

- Rrezikun e kundërpartisë në librin e tregtueshëm;

- Rrezikun e shlyerjes për transaksionet jo-DVP (neni 164), si në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm.

Bankat duhet të plotësojnë këtë formular për çdo klasë ekspozimi të përcaktuar në nenin 10 të rregullores dhe në total për të gjitha klasat e ekspozimeve, duke përjashtuar ekspozimet e titullzuara.

Ekspozimet, të cilat sipas kuadrit rregullator në fuqi, konsiderohen të pambrojtura ndaj luhatshmërisë së kursit të këmbimit, do të pasqyrohen në atë klasë ekspozimi në të cilën do të përfshiheshin sikur të mos e kishin këtë veçori, pavarësisht se në rregullore, të tilla ekspozime trajtohen në klasën e ekspozimeve me rrezik të lartë.

Bankat nuk duhet të plotësojnë fushat me ngjyrë gri.

Në fushën ECAI të emëruara dhe/ose ECA, bankat paraqesin emrat e të gjithë ECAI-ve të emëruara nga banka dhe/ose të ECA-ve për t'u përdorur për të vlerësuar (*rating*) ekspozimet e përfshira në secilën prej klasave të ekspozimit.

Bankat, për plotësimin e kësaj tabele konsiderojnë të gjitha ato ekspozime të cilat nuk janë zbritur nga kapitali rregullator dhe për të cilat ato (bankat) nuk llogarisin kërkesë për kapital për rrezikun e tregut.

Ky formular raportohet çdo tremujor.

2.1.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular përmban 24 kolona, me përmbajtje si më poshtë:

Kolonat 010-030: Këto kolona janë të ngjyrosura me gri dhe nuk plotësohen nga bankat.

Kolona 040 - Ekspozimet origjinale përpara faktorëve të konvertimit (neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjonet).

Në kolonën 040, në rreshtin "Totali i ekspozimeve" bankat paraqesin totalin e vlerës të ekspozimeve neto, që i përkasin kategorisë të specifikuar në fushën "Klasa e ekspozimit", sipas rregullave të mëposhtme:

- Vlera e një ekspozimi individual, që është pjesë e bilancit të bankës, është e barabartë me vlerën neto, me të cilën paraqitet në bilanc ekspozimi në fjalë (pas zbritjes së provigjoneve);
- Vlera e një ekspozimi individual, që është pjesë e zërave jashtë bilancit, është e barabartë me vlerën që ka zëri jashtë bilancit, të cilit i referohet ekspozimi në fjalë (pas zbritjes së provigjoneve);
- Vlera e ekspozimeve individuale, që lindin nga marrëveshjet repo të letrave me vlerë apo të mallrave, marrëveshjet e huadhënies apo të huamarrjes së letrave me vlerë apo mallrave, të cilat nuk janë subjekt i marrëveshjeve kuadër të netimit dhe e transaksioneve të huadhënies me marzhe, është e barabartë me vlerën e transaksionit në fjalë;
- Në rast të marrëveshjeve kuadër të netimit që mbulojnë marrëveshjet repo të letrave me vlerë apo të mallrave, marrëveshjet e huadhënies apo të huamarrjes së letrave me vlerë apo mallrave, vlera e ekspozimit që rrjedh nga këto marrëveshje të netimit është e barabartë me vlerën e rregulluar plotësisht të ekspozimit (E*), të llogaritur në përputhje me nenin 75, paragrafi 6, të rregullores;
- Vlera e një ekspozimi individual, që rrjedh nga marrëveshjet e shlyerjes në afat të gjatë kohe, llogaritet sipas metodave të përcaktuara në kreun IV të rregullores;
- Vlera e ekspozimit, që rrjedh nga derivatet e specifikuara në aneksin IV të rregullores llogaritet siç është përcaktuar në kreun IV të rregullores.

Bankat ndajnë shumën që plotësohet në kolonën e parë, në rreshtin "Totali i ekspozimeve" sipas rreshtave individualë":

- Sipas tipit të ekspozimit (zë bilanci, zë jashtë bilancit, transaksione të financimit të letrave me vlerë[24] dhe derivative, dhe transaksionet e shlyerjes në afat të gjatë kohë)
- Sipas peshave të rrezikut (0%, 10%, 20%, 35%, 50%, 75%, 85%, 100%, 125%, 150%, 250%, 1250% dhe pesha të tjera).

Kolonat 050-100: Teknikat e zbutjes së kredisë me efekt zëvendësimi në ekspozim

Kolonat nga 050 deri në 100 i referohen mbrojtjes së kredisë së financuar dhe të pafinancuar që redukton rrezikun e kredisë për një ose disa ekspozime, me anë të efektit të zëvendësimit, sipas neneve 53-57 (*Mbrojtja e financuar - Metoda e thjeshtë për kolateralin) dhe neneve 94-96 (Mbrojtja e pafinancuar*), duke zëvendësuar peshat e rrezikut për pjesën e mbuluar të ekspozimit me peshën e rrezikut të kolateralit ose të ofruesit të kolateralit.

Kolonat 050 dhe 060 – Mbrojtja e pafinancuar e kredisë: Vlera e rregulluar (GA)

Bankat në këto kolona paraqesin vlerën e mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, të rregulluar për mospërputhjet në maturitet dhe në monedhë, të llogaritur sipas neneve 90-92 të rregullores. Vlerat e rregulluara të garancive dhe të derivativeve të kredisë jepen të ndara, përkatësisht në kolonat 050 dhe 060.

---

[24] Në transaksionet e financimit të titujve përfshihen marrëveshjet repo të titujve apo të mallrave, marrëveshjet e huadhënies apo të huamarrjes së titujve apo mallrave, dhe transaksionet e huadhënies me marzhe.

Kolonat 070 dhe 080 - Mbrojtja e financuar e kredisë

Kolonat 070 dhe 080 i referohen mbrojtjes së financuar të kredisë (pa marrë parasysh marrëveshjet kuadër të netimit, të cilat merren në konsideratë me vlerën origjinale të ekspozimit, në kolonën 1). *Credit linked notes* dhe netimi në bilanc trajtohen si kolaterali i tipit depozitë në *cash* (neni 49, paragrafi 1, pika a e rregullores).

Bankat, të cilat përdorin metodën e thjeshtë të kolateralit financiar të përcaktuar në nenet 53-56 të rregullores, paraqesin në kolonën 070 vlerat e kolateralit financiar, ndërkohë që kjo kolonë nuk plotësohet nga bankat që përdorin metodën gjithëpërfshirëse të kolateralit financiar. Vlera e mbrojtjeve të tjera të financuara të kredisë, të përcaktuar në nenet 77-78 të rregullores, plotësohet në kolonën 080.

Kolonat 090 dhe 100 - Zëvendësimi i ekspozimit, si rezultat i teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë

Kolona 090 - Totali i flukseve dalëse

Në këtë kolonë, banka paraqet shumën e flukseve dalëse, që do të thotë shumën e atyre pjesëve të ekspozimeve që përfshihen në kolonën 040, të cilat janë të siguruara nga mbrojtja e financuar dhe e pafinancuar e kredisë, sipas kolonave nga 050 në 080. Në qoftë se emetuesi i mbrojtjes së financuar të kredisë ose ofruesi i mbrojtjes së pafinancuar të kredisë është i klasifikuar në të njëjtën klasë si debitori, fluksi dalës individual për këtë ekspozim do të paraqitet si fluks hyrës në kolonën 100 të po së njëjtës tabelë, dukë marrë në konsideratë tipin e ekspozimit dhe peshën e rrezikut të kredisë të caktuar për mbrojtjen e financuar apo të pafinancuar, sipas neneve 54, 94 dhe 95 të rregullores. Në qoftë se emetuesi i mbrojtjes së financuar të kredisë ose ofruesi i mbrojtjes së pafinancuar të kredisë nuk klasifikohet në të njëjtën klasë ekspozimi si debitori, flukset hyrëse individuale do të paraqiten si flukse hyrëse në kolonën përkatëse të tabelës, që paraqet klasën e ekspozimeve në të cilën përfshihen ekspozimet e emetuesit të mbrojtjes së financuar të kredisë ose të ofruesit të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë.

Kolona 100 - Flukset hyrëse

Në kolonën 100, në rreshtin "Totali i ekspozimeve" paraqitet shuma e totalit të flukseve dalëse të kolonës 090 të po së njëjtës klase ekspozimesh dhe flukset dalëse të tabelave të klasave të tjera të ekspozimeve, si rezultat i marrjes në konsideratë të mbrojtjes së financuar dhe të pafinancuar të kredisë (sipas neneve 54, 94 dhe 95 të rregullores), emetuesi dhe ofruesi i të cilave klasifikohen në klasën e ekspozimit, që i përket formatit që po plotësohet.

Shuma e paraqitur në kolonën 100, në rreshtin total ndahet sipas rreshtave individualë, duke marrë parasysh:

- llojin e ekspozimit që sigurohet nga mbrojtja e financuar ose e pafinancuar, emetuesit dhe ofruesit e të cilave janë të klasifikuar në klasën e ekspozimit të formatit që po plotësohet;
- peshën e ponderimit të përcaktuar për mbrojtjen e kredisë së financuar dhe të pafinancuar.

Kolona 110 - Ekspozimi neto pas aplikimit të teknikave zbutëse me efekt zëvendësues në ekspozim, përpara aplikimit të faktorëve të konvertimit

Në këtë kolonë, banka paraqet shumën e ekspozimeve, pasi është marrë në konsideratë shuma e flukseve hyrëse dhe dalëse nga aplikimi i mbrojtjes së kredisë me efekt zëvendësues mbi ekspozimet, që llogaritet duke zbritur nga ekspozimet neto në kolonën 040, shumën e flukseve hyrëse në kolonën 090, dhe duke shtuar shumën e flukseve hyrëse në kolonën 100.

Kolonat 120 deri në 140 - Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë që kanë efekt në shumën e ekspozimit: Metoda gjithëpërfshirëse e kolateralit financiar.

Kolonat 120 deri në 140 i referohen llogaritjes së vlerës së rregulluar të ekspozimit dhe mbrojtjes së kredisë së financuar.

Kolona 120 - Rregullimet e luhatshmërisë të ekspozimit

Banka paraqet rregullimin e luhatshmërisë së ekspozimit të llogaritur sipas formulës (EVA – E) = E × HE

Kolona 130 - Kolaterali financiar: Vlera e rregulluar (CVAM)

Banka paraqet vlerën e kolateralit financiar të llogaritur sipas nenit 158, paragrafi 3, sipas formulës: CVAM = C × (1-HC-HFX)×(t-t*)/(T-t*).

Kolona 140 - Rregullimet e luhatshmërisë dhe të maturitetit

Banka paraqet rregullimet e luhatshmërisë dhe të mospërputhjes të maturitetit të llogaritur me anë të formulës (CVAM – C) = C × [(1-HCHFX)×(t-t*)/(T-t*) - 1], ku efekti i rregullimeve të luhatshmërisë llogaritet me formulën (CVAM – C) = C × [(1-HCHFX) ×(t-t*)/(T-t*) – 1 dhe efekti i rregullimeve për

mospërputhje të maturitetit me anë të formulës (CVAM – CVA) = C × [(1-HC-HFX)×(t-t*)/(T-t*) - 1].

Kolona 150 - Vlera e rregulluar plotësisht të ekspozimit (E)*

Banka paraqet vlerën e rregulluar plotësisht të ekspozimit, e cila merr në konsideratë luhatshmërinë e ekspozimit dhe efektet e kolateralit financiar, sipas nenit 158, paragrafi 4. Kjo vlerë llogaritet duke i shtuar shumës në kolonën 110 atë të kolonës 120, duke i zbritur shumën në kolonën 130.

Kolonat 160-190 – Ndarja e vlerës së rregulluar plotësisht të ekspozimeve të lidhura me zërat jashtë bilancit sipas faktorëve të ekspozimit

- Në kolonën 0% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 15 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si me rrezik të ulët sipas aneksit numër 2, "Klasifikimi i zërave jashtë bilancit" të rregullores.
- Në kolonën 20% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 15 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si me rrezik të ulët sipas aneksit numër 2, "Klasifikimi i zërave jashtë bilancit" të rregullores.
- Në kolonën 50% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 15 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si me rrezik të ulët sipas aneksit numër 2, "Klasifikimi i zërave jashtë bilancit" të rregullores.
- Në kolonën 100% paraqitet ajo pjesë e shumës nga kolona 15 që përfaqëson ekspozime të zërave jashtë bilancit, që klasifikohen si me rrezik të ulët sipas aneksit numër 2, "Klasifikimi i zërave jashtë bilancit" të rregullores.

Vlerat e përfshira në kolonat 160-190, në rreshtin ekspozimet totale duhet të jenë të barabarta me vlerat e përfshira në pikëprerjen e rreshtit 030 "Zërat jashtë bilancit", me këto kolona.

Kolona 200 - Vlera e ekspozimit

Në këtë kolonë, bankat paraqesin vlerën neto të ekspozimit, pasi kanë marrë në konsideratë efektet e mbrojtjes së kredisë dhe faktorët e konvertimit për zërat jashtë bilancit. Për llogaritjen e vlerës së ekspozimit për zërat jashtë bilancit, nga kolona 150 zbriten totali i kolonës 160, 80% e shumës së kolonës 170, 50% e shumës së kolonës 180. Për tipat e tjera të ekspozimit, shuma në kolonën 200 është e barabartë me shumën në kolonën 150.

Vlera e paraqitur në këtë kolonë, në pikëprerjen me rreshtin totali i ekspozimeve, është e barabartë me shumën e rreshtave 020, 030, 040, 060, të po kësaj kolone.

Kolona 210 - Nga të cilat: Të lidhura me rrezikun e kundërpartisë

Në këtë kolonë bankat plotësojnë një pjesë të shumës së reflektuar në kolonën 200, e cila është e lidhur me ekspozime të lindura nga derivativet, transaksionet repo të letrave me vlerë apo të mallrave, marrëveshjet e huadhënies apo të huamarrjes së letrave me vlerë apo mallrave, transaksionet e huadhënies me marzhe dhe marrëveshjet e shlyerjes në afat të gjatë.

Kolona 220 - Ekspozimet e klasifikuara sipas rrezikut

Bankat përcaktojnë për vlerat e ekspozimeve nga kolona 200 një peshë rreziku, mbështetur në cilësinë e kredisë. Vlera, që bankat plotësojnë në kolonën 210, rreshti "Totali i ekspozimeve", është e barabartë me shumatoren e vlerave të kolonës 210 për rreshtat 020-060, dhe shumatoren e vlerave të kolonës 210 për rreshtat 090-210.

Kolona 230:

Në këtë kolonë do të pasqyrohet ajo pjesë e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut, për llogaritjen e të cilave bankat kanë përdorur peshat e bazuara në vlerësimet e cilësisë së kredisë të kundërpartisë, të emetuara nga një ECAI e nominuar.

Kolona 240:

Në këtë kolonë do të pasqyrohet ajo pjesë e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut, për llogaritjen e të cilave bankat kanë përdorur peshat e bazuara në vlerësimet e cilësisë së kredisë të qeverisë qendrore (rasti i ekspozimeve ndaj institucioneve të mbikëqyrura).

2.1.3 Përmbajtja e rreshtave

Rreshti 010 "Totali i ekspozimeve"

Në rreshtin "Totali i ekspozimeve", bankat raportojnë vlerën totale sipas kolonave individuale, vlerë kjo e cila prezanton shumën e kolonave individuale përkundrejt llojit të ekspozimit ose të peshës së rrezikut.

Rreshti 011 - Nga të cilat SME

Ky rresht plotësohet për klasat "Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)", "Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)"; "Ekspozime ose

ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme dhe “Ekspozime ekspozime (kredi) me probleme”, si dhe në tabelën përmbledhëse të të gjitha klasave të ekspozimeve.

Rreshtat 020-060 - Ndarja e ekspozimeve totale sipas llojit të ekspozimit

Shuma e vlerës të ekspozimeve që paraqitet në kolonën 040, në rreshtin “Totali i ekspozimeve”, ndahet sipas tipit të ekpozimeve si në vijim:

- Zërat e bilancit: janë zërat që nuk përfshihen në asnjë nga tipat e tjerë të ekspozimit. Ekspozimet e lindura nga shlyerjet jo-DVP, edhe pse nuk janë zëra bilanci, pasqyrohen në këtë rresht. Ekspozimet që janë zëra bilanci dhe trajtohen si transaksione të financimit të letrave me vlerë dhe si derivative apo transaksione me afat të gjatë shlyerje nuk përfshihen në këtë rresht, por përkatësisht në rreshtat 040 dhe 060;
- Zërat jashtë bilancit: zërat e përcaktuar në aneksin numër 2 të rregullores. Ekspozimet që janë zëra jashtë bilancit dhe trajtohen si transaksione të financimit të letrave me vlerë dhe si derivative apo transaksione me afat të gjatë shlyerje nuk përfshihen në këtë rresht, por përkatësisht në rreshtat 040 dhe 060;
- Transaksionet e financimit të letrave me vlerë (këtu përfshihen transaksionet repo, transaksionet e huamarrjes dhe huadhënies të letrave me vlerë dhe mallrave, transaksionet e financimit me marzhe, si edhe vlera E* e marrëveshjeve kuadër të netimit të lidhura me të tilla transaksione);
- Derivativet dhe transaksionet e shlyerjes në afat të gjatë kohe: derivativet, si specifikohet në aneksin IV të rregullores, dhe transaksionet e shlyerjes në afat të gjatë kohe, siç specifikohet në kreun VI të rregullores.

Rreshtat 090-210 - Ndarja e ekspozimeve totale sipas peshave të rrezikut

Shuma e vlerës së ekspozimeve që paraqitet në qelizën që formohet nga prerja e kolonës 040 me rreshtin “Totali i ekspozimeve” ndahet sipas peshave të rrezikut të specifikuara në (0%, 10%, 20%, 35%, 50%, 75%, 85, 100%, 150%, 1,250%, pesha të tjera).

Rreshtat 220- 270 - Zëra të veçantë

Këta rreshta janë të pasqyruar me gri dhe do të plotësohen nga bankat, sipas kërkesave të autoritetit në periudhat në vazhdim.

2.2 Formulari CR SEC SA - Titullzimi

2.2.1 Të përgjithshme

Bankat duhet të plotësojnë formularin CR SEC SA për ekspozimet e lidhura me transaksionet e titullzimit, në mënyrë të veçantë për ekspozimet e lidhura me titullzimet tradicionale dhe ato sintetike, të cilat përcaktohen në fushën “Lloji i titullzmit”.

Raportimi varet nga roli që marrin bankat në procesin e titullzimit. Për këta arsye, raportimi i zërave ndryshon në varësi të faktit nëse banka është origjinuesi, investuesi dhe sponsori.

Në fushën ECAI e emëruar, bankat pasqyrojnë emrin e të gjitha ECAI-ve të emëruara për vlerësimin e të tilla ekspozimeve.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë gri.

Ky formular raportohet çdo tremujor.

2.2.2 Përmbajtja e kolonave

Formulari CR SEC SA përmban 34 kolona, përbërja e të cilave është si më poshtë:

Kolona 010 - Shuma totale e ekspozimeve të titullzuara të origjinuara

Kjo plotësohet vetëm nga bankat që kanë rolin e origjinuesit në një titullzim. Në këtë kolonë bankat plotësojnë vlerën aktuale të të gjithapozicioneve të titullzuara, të origjinuara gjatë transaksioneve të titullzimit, pavarësisht se kush mban pozicionet.

Kështu, si ekspozimet e titullzuara në bilanc (obligacionet, obligacionet e varura) ashtu edhe ekspozimet jashtë bilancit (linjat e varura të kredisë, lehtësirat e likuiditetit dhe derivativet financiare) që kanë origjinuar gjatë procesit të titullzimit duhet që të raportohen.

Në rast të pozicioneve të mbivendosura, vetëm pozicioni ose pjesa e pozicionit që prodhon ekspozimin më të lartë të ponderuar me rrezik duhet të raportohet. Në rreshtin “Totali në kolonën 1, pasqyrohet shuma aktuale e ekspozimeve të titullzuara (*underlying pool of exposures and reserve account*).

Zërat e aktivit dhe zërat e pasivit pasqyrohen në mënyrë të ndarë në kolonën 1, sipas rreshtave individualë, me vlerën e tyre kontabël, duke marrë parasysh faktin që:

a) zërat e bilancit nuk përfshijnë zhvlerësimin (impairment);

b) zërat jashtë bilancit nuk përfshijnë provigjonet e krijuara për të tilla angazhime;

c) zërat jashtë bilancit nuk përfshijnë faktorët e konvertimit;

d) zërat e bilancit dhe jashtë bilancit nuk përfshijnë efektet e mbrojtjes së kredisë, me përjashtim të marrëveshjeve kuadër të netimit (marrëveshjet kuadër të netimit që i referohen disa instrumenteve

financiare të ekzekutueshëm, të emetuar nga e njëjta SPV, merren në konsideratë).

Në rast të një ekspozimi qarkullues me të drejtë amortizimi të hershëm është e nevojshme të plotësohet shuma e "interesit të investitorit" në rreshtin përkatës sipas nenit 152, paragrafi 2.

Kolonat 020-040 - Titullzimi sintetik - Mbrojtja e kredisë së ekspozimeve të titullzuara

Kolonat 020-040 i referohen mbrojtjes së kredisë të një titullzimi sintetik, me anë të së cilës arrihet segmentimi (*transhing*) i ekspozimeve të titullzuara. Vetëm bankat origjinuese në një titullzim sintetik i plotësojnë këto kolona. Mbrojtja e kredisë nuk përfshin rregullimet si rezultat i mospërputhjeve në maturitet.

Kolona 020 dhe 030 i referohen mbrojtjes së financuar dhe të pafinancuar të kredisë.

Kolona 020 – Mbrojtja e kredisë e financuar (CVAm)

Banka plotëson vlerën e mbrojtjes së kredisë së financuar, siç përcaktohet në nenin 158 të rregullores. Për kolateralin financiar, bankat mund të përdorin vetëm metodën gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye, vlera e kolateralit në këtë kolonë paraqitet e rregulluar për luhatshmërinë dhe mospërputhjet në maturitet, siç përcaktohet në nenin 158, paragrafi 3. *Credit linked notes* trajtohen si mbrojtje e financuar e kredisë, sipas nenit 90, paragrafi 2.

Kolona 030 - Mbrojtja e pafinancuar e kredisë: Vlera e rregulluar (G)*

Banka plotëson vlerën e mbrojtjes së kredisë të pafinancuar, të rregulluar për çdo mos përputhje në monedhë (G*), sipas nenit 91, paragrafi 1.

Kolona 4 - Vlera e mbajtur ose e blerë e mbrojtjes së kredisë

Bankat plotësojnë vlerat e mbrojtjes së financuar të kredisë, të cilat origjinuesi, si blerës i kolateralit, mban ose riblen nga ofruesit e kolateralit. Efektet e rregullimeve të luhatshmërisë, siç përcaktohen në nenet 58 dhe 59 të rregullores, nuk merren në konsideratë për llogaritjen e vlerës së mbajtur apo të riblerë të mbrojtjes së kredisë.

Kolona 050 - Poziconet në titullzime: Ekspozimet origjinale para faktorëve të konvertimit

Bankat plotësojnë vlerën kontabël të pozicioneve individuale të titullzuara, pa zhvlerësim apo provigjone, dhe pa përdorur faktorët e konvertimit. Origjinuesi, i cili përdor titullzimin sintetik, e llogarit këtë vlerë sipas kolonave 010-020-030+040 (kolonat 020 dhe 030 kanë vlera negative). Kështu, vlera e ekspozimit plotësohet pasi janë marrë në konsideratë flukset hyrëse dhe dalëse, si rezultat i mbrojtjes së kredisë me anë të të cilave është arritur segmentimi (*transhing*).

Netimi është i rëndësishëm vetëm në rast të kontratave derivative të shumëfishta të ofruara tek e njëjta SPV.

Në rast të klauzolave të amortizimit të hershëm, bankat duhet të specifikojnë shumën e "interesit të investitorëve", sipas nenit 152 të rregullores.

Kolona 060 – Rregullimi i vlerës

Plotësohet shuma e zhvlerësimeve dhe provigjoneve për asetet dhe për zërat jashtë bilancit.

Kolona 070 - Ekspozimi neto nga rregullimet e vlerës

Plotësohet vlera neto e ekspozimeve, e cila llogaritet si diferencë e kolonës 050 dhe 060, pa përdorur faktorët e konvertimit.

Kolonat 080-013 plotësohen vetëm në rast të blerjes së kolateralit shtesë që nuk është marrë në konsideratë në kolonat 020-040.

Kolonat 080-110 - Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë me efekt zëvendësues në ekspozim

Kolonat nga 080-110 i referohen mbrojtjes së kredisë të financuar dhe të pafinancuar, e cila sjell një rënie në rrezikun e kredisë bazuar në zëvendësimin e ekspozimit, ku pesha e rrezikut për pjesën e mbrojtur zëvendësohet me peshën e rrezikut të kolateralit (që do të thotë ofruesi i kolateralit).

Kolona 080 - Mbrojtja e kredisë e pafinancuar - Vlera e rregulluar (Ga)

Bankat plotësojnë vlerën e mbrojtjes së kredisë të pafinancuar, e rregulluar për çdo mospërputhje në maturitet dhe në monedhë sipas neneve 90 dhe 92 të rregullores.

Kolona 090 - Mbrojtja e financuar e kredisë

Për kolateralin financiar, kjo kolonë plotësohet vetëm nga bankat që përdorin metodën e thjeshtë të kolateralit financiar, sipas neneve 53-56 të rregullores.

Kolonat 100 dhe 110 - Zëvendësimi i ekspozimit si rezultat i CRM

Kolona 100 - Totali i flukseve dalëse

Plotësohet shuma e kolateralizuar për secilin prej roleve që ka një bankë në titullzim (origjinues, investitor etj.) dhe është e barabartë me shumën e kolonave 8 dhe 9.

E njëjta shumë plotësohet edhe në kolonën 11 - Totali i flukseve hyrëse për të njëjtin rol

(origjinues, investues dhe sponsor).

Kolona 120 - Ekspozimi neto pas efektit zëvendësues të teknikave të zbutjes së kredisë para aplikimit të faktorëve të konvertimit

Plotësohet shuma e ekspozimit neto pasi janë marrë në konsideratë flukset hyrëse dhe dalëse si rezultat i efektit të zëvendësimit të ekspozimit, e cila llogaritet duke zbritur shumën totale në kolonën 100 nga kolona 070 dhe duke shtuar shumën nga kolona 110 (070-100+110).

Kolona 130 - Teknikat e zbutjes së kredisë që ndikojnë në shumën e ekspozimit: Metoda gjithëpërfshirëse e kolateralit financiar

Kolona 140 - Vlera e rregulluar plotësisht e ekspozimit (E): llogaritet si shumë e kolonave 120 dhe 130*

Kolonat 150-180 - Ndarja e vlerës së rregulluar plotësisht të zërave jashtë bilancit, duke konsideruar faktorët e konvertimit

Vlera e rregulluar plotësisht e zërave jashtë bilancit nga kolona 140 klasifikohet në një nga kolonat korresponduese 150-180, sipas faktorëve të konvertimit.

Kolona 190 - Vlera e ekspozimit

Plotësohet vlera e ekspozimit neto pasi është marrë në konsideratë efekti i mbrojtjes së kredisë dhe faktorët e konvertimit.

Për zërat jashtë bilancit, vlera në kolonën 190 është shuma e prodhimit të vlerës nominale të rregulluar plotësisht në kolonat 150-180 dhe i faktorëve të konvertimit korrespondues. Për zërat e bilancit plotësohet vlera nga kolona 140 (pasi janë zbritur zërat jashtë bilancit).

Kolona 200 - Zërat që zbriten nga kapitali rregullator

Plotësohet vlera e pozicioneve të titullzuara, të cilave u është caktuar një peshë rreziku 1250% dhe që banka e zbret nga kapitali rregullator, sipas udhëzimit të kapitalit rregullator.

Kolona 210 - Subjekt i peshave të rrezikut

Bankat plotësojnë në këtë kolonë shumën si diferencë e kolonave 190 dhe 200.

Kolona 220-290 - Ndarja e vlerës së ekspozimit sipas peshave të rrezikut

Kolonat 220-250 - Ekspozimet e vlerësuara (me cilësi kredie nga 1-4)

Plotësohen ekspozimet e titullzuara me vlerësim të cilësisë së kredisë nga një ECAI e emëruar, duke plotësuar kolonën përkatëse sipas peshave të rrezikut.

Kolona 260 - 1250% (Ekspozime të vlerësuara)

Plotësohen shumat e pozicioneve të titullzuara me një vlerësim kredie nga një ECAI e zgjedhur, të cilave u është caktuar një peshë rreziku 1250%.

Kolona 270 - 1250% (Ekspozime të pavlerësuara)

Plotësohet shuma e pozicioneve të titullzuara, të pavlerësuar nga një ECAI e emëruar.

Kolona 280-290 Pozicionet e pavlerësuara -"Metoda look through"

Plotësohen pozicionet pa vlerësim kredie nga një ECAI e emëruar, ku peshat e rrezikut përllogariten bazuar në grupin e ekspozimeve bazë, sipas nenit 110 të rregullores. Në rast të ekspozimeve qarkulluese me klauzola të amortizimit të hershëm, bankat duhet të konsiderojnë detyrimet që rrjedhin nga neni 110 i rregullores.

Kolona 290 - Nga të cilat: segmenti (transhi) i dytë që mbulon humbjet

Plotësohet pjesa e pavlerësuar e ekspozimeve nga kolona 28 që, sipas nenit 110 të rregullores, si pjesë e një programi ABCP, kanë trajtim të veçantë.

Kolona 300: Ekspozimet e ponderuara me rrezik

Plotësohet shuma e ponderuar me rrezik si shumë e prodhimeve të ekspozimeve individuale prej kolonave 220-290 dhe peshave të rrezikut korresponduese, pa marrë parasysh ekspozimet e trajtuara sipas nenit 109 dhe nenit 117, dhe duke përjashtuar çdo ekspozim të ponderuar me rrezik që i korrespondojnë ekspozimeve të rishpërndara me anë të flukseve dalëse (*outflow*) në formatet e tjera.

Për titullzimet sintetike me mospërputhje në maturitet, shuma që do të raportohet në këtë kolonë duhet të mos konsiderojë mospërputhjet në maturitet.

Kolona 300 bis - Rregullimet e ekspozimeve me rrezik si rezultat i mospërputhjeve në maturitet

Mospërputhjet në maturitet në titullzimin sintetik midis mbrojtjes së financuar me anë të së cilës është arritur segmentimi i ekspozimeve të titullzuara dhe ekspozimeve të titullzuara duhet të llogaritet në përputhje me nenin 125 të rregullores si RW*-RW(SP). Mospërputhjet në maturitet duhet të injorohen në rast të segmenteve (transheve) që janë subjekt i një peshe rreziku prej 1250%, ku shuma që duhet të raportohet është 0. Shuma e RW(SP) përfshin jo vetëm shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezik

të raportuara nën kolonën 30, por edhe shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezik që i korrespondojnë ekspozimeve të shpërndara nëpërmjet flukseve dalëse (*outflow*) në tabelat e tjera.

Kolona 310 - Kërkesa për kapital përpara përdorimit të CAP-it

CAP është kërkesa maksimale për kapital për totalin e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për pozicionet e titullzuara, e përcaktuar në nenet 109 dhe 117.

Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë të titullzimeve llogaritet si 12% e shumës nga kolona 300 dhe 300 bis.

Kolona 320 - Memorandum items: kërkesa për kapital që i korrespondon flukseve dalëse nga titullzimi te klasat e tjera të ekspozimit

Kjo kolonë plotësohet vetëm nga origjinuesi, i cili pasqyron kërkesën për kapital për ekspozimet nga kolona 300, të cilat si rezultat i përdorimit të mbrojtjes së kredisë, tejkalojnë kërkesën për kapital për ekspozimet bazë, sikur ato të mos ishin të titullzuara (CAP). Këto kërkesa për kapital i korrespondojnë flukseve dalëse të kërkesës për kapital për ekspozimet e titullzuara te klasat e ekspozimeve e tjera. Në llogaritjen e këtij zëri konsiderohen kufizimet e përcaktuara në nenet 109 dhe 117 të rregullores.

Kolona 330 - Kërkesa për kapital pas përdorimit të CAP

Plotësohet kërkesa për kapital pasi konsiderohen kufizimet në nenet 109 dhe 117. Kolona 330 llogaritet si shumë e vlerave në kolonat 310 dhe 320.

Bankat duhet të raportojnë ekspozimet në titullzime sipas kolonave dhe të analizojnë fushat që mbulohen nga një aktivitet i tillë nëpër rreshta, sipas rolit që merret përsipër në titullzim.

2.2.3 Përmbajtja e rreshtave

Formulari CR SEC SA përmban 17 rreshta.

Vlera në rreshtin 010 “Ekspozimi total” duhet të jetë e barabartë me shumën e ekspozimeve totale të bankës, sipas roleve të marra përsipër në një titullzim:

- origjinuesi;
- investuesi;
- sponsori.

Ekspozimet në titullzim sipas roleve individuale, ndahen më tej sipas:

- Aseteve dhe, brenda këtij grupi, ndahen sipas segmenteve të rrezikut të kredisë në lidhje me skedulin e pagesës (plotësohet nga origjinuesi dhe investitori);
- Zërat jashtë bilancit dhe instrumentet derivative (plotësohen nga bankat në të gjitha rolet) që kanë;
- Ekspozimet qarkulluese me të drejtë shlyerje të parakohshme (plotësohet vetëm nga origjinuesi).

Zërat e aktivit që i përkasin tri segmenteve të ndryshme të rrezikut të kredisë paraqiten sipas rreshtave të veçantë:

- Zërat me rrezikun më të lartë (segmenti (transhi) senior në një titullzim);
- Zërat me rrezik mesatar (segmenti (transhi) mezzanine në një titullzim);
- Zëri, i cili mbulon i pari humbjen, që përfshin pozicionet në ato segmente (transhe), të cilët mbulojnë të parët humbjet. Në qoftë se ky segment (transh) nuk garanton përmirësim të cilësisë së kredisë për segmentet e tjera në titullzim është e nevojshme që të merret në konsideratë segmenti tjetër në radhë si segment që mbulon humbjet. Vlerësimi i rritjes së cilësisë së kredisë (*credit enhancement*), e ofruar nga segmentet e ndryshme, vazhdon deri sa një rritje e konsiderueshme e cilësisë së kredisë arrihet nëpërmjet segmentit (transhit) që mbulon i pari humbjen.

Zërat jashtë bilancit përfshijnë ekspozimet për shumat e patërhequra që origjinuesi duhet të sigurojë për likuiditet dhe për lehtësira të tjera kredituese kur bën pagesa te shërbyesit e titullzimit (*servicer*) dhe për lehtësira kredie (*credit facilities*), në rast të kushteve të përgjithshme të përkeqësuara në treg kur kryen një transaksion titullzimi.

Bankat, të cilat kanë investime në titullzime, në këtë format do të plotësojnë vetëm qelizat e ngjyrosura me të verdhë.

3. Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut

3.1 Formulari MKR SA TDI –Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit

3.1.1 Të përgjithshme

Formulari MKR SA TDI përmban informacion mbi pozicionet dhe kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik) për titujt e borxhit në librin e tregtueshëm, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat plotësojnë këtë formular në mënyrë të veçantë për monedhat kryesore (lekë, euro, USD), për të gjitha monedhat e tjera (përveç atyre kryesore), për ato instrumente në të cilat kanë pozicione në

librin e tregtueshëm, si dhe në total (për monedhat kryesore dhe për monedhat e tjera).

Bankat plotësojnë shenjën e monedhës në fushën “Monedha”.

Në rreshtat e tabelës konsiderohen metodat e mëposhtme për llogaritjen e kërkesës për kapital.

- Rreziku i përgjithshëm: metoda e bazuar në maturitet;
- Rreziku i përgjithshëm: metoda e bazuar në kohëzgjatje;
- Rreziku specifik;
- Rreziku specifik për pozicionet në SIK;
- Rreziqet jodelta (gamma dhe vega) të lidhura me opsionet.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyr ë gri.

Ky formular raportohet çdo gjashtëmujor.

3.1.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular përmban nëntë kolona, me përmbajtje si më poshtë:

Kolona 010 dhe 020 - Të gjitha pozicionet (Në blerje dhe në shitje)

Në kolonat 010 dhe 020, bankat plotësojnë pozicionet bruto, pa marrë në konsideratë marrëveshjet e netimit dhe pa pozicionet e derivuara nga nënshkrimi i titujve të borxhit nga të tretët, sipas nenit 167 të rregullores.

Kolonat 030 dhe 040 –Pozicionet neto (në blerje, në shitje)

Kolona 030 (pozicioni neto në blerje) dhe kolona 040 (pozicioni neto në shitje) i referohen pozicionit neto (në blerje apo në shitje), sipas nenit 146. Bankat llogarisin pozicionin neto si diferenca midis pozicionit në blerje/shitje dhe atyre në shitje/blerje në instrumentet financiare të të njëjtit lloj. Bankat plotësojnë vlerën e pozicionit neto, domethënë pozicionin e kompensuar për çdo segment maturiteti.

Kolona 050 - Pozicione subjekte të kërkesës për kapital

Kjo kolonë i referohet pozicioneve të ponderuara, që janë subjekt i kërkesës për kapital, të llogaritura nën përqasjet e reflektuara në rreshtat e këtij formati. Për metodën e bazuar në maturitet, këto pozicione janë të pasqyruara në nenin 155, pika “c”, ndërkohë që për metodën e kohëzgjatjes, ato janë të pasqyruara në nenin 156, pika d.

Kolona 060 - Kërkesa për kapital

Bankat llogarisin kërkesën për kapital për secilën nga përqasjet e reflektuara nën rreshtat e këtij formati, si dhe totalin e kërkesës për kapital. Totali i kërkesës për kapital, i cili pasqyrohet në rreshtin 010 “Titujt e borxhit në librin e tregtueshëm”, është shuma e kërkesës për kapital për rrezikun e përgjithshëm (të pasqyruar në rreshtin 020 të po kësaj kolone, në rast se banka përdor metodën e bazuar në maturitet, ose në rreshtin 201, në rast se banka përdor metodën e bazuar në kohëzgjatje) dhe të kërkesës për kapital për rrezikun specifik (të pasqyruar në rreshtin 250, ku vlera në këtë rresht është shumë e rreshtave 251, 325, 340 dhe 350).

3.1.3 Përmbajtja e rreshtave

Në rreshtat e këtij formulari bankat raportojnë pozicionet në titujt e borxhit dhe kërkesat përkatëse për kapital, duke u bazuar në kategorinë e rrezikut, maturitetin dhe metodologjinë e përdorur.

Rreshtat 012-013

Këta rreshta plotësohen vetëm për dy kolonat e para të formatit dhe përmbajnë informacion mbi pozicionet fillestare bruto të krijuara nga derivativet mbi normat e interesit dhe mbi titujt e borxhit (sipas nenit 147 të rregullores) dhe nga mjetet dhe detyrimet e tjera, vlera e të cilave varet nga ecuria e normës së interesit.

Rreshtat 020-200 - Rreziku i përgjithshëm: Metoda e bazuar në maturitet

Në këta rreshta bankat plotësojnë pozicionet në tituj të borxhit në përputhje me nenin 155 paragrafi 1, pika “a”, e rregullores. Kështu, bankat shpërndajnë pozicionet neto në secilën prej segmenteve të përshtatshme të maturitetit (shih tabelën 22 të rregullores), në bazë të maturitetit të mbetur në rastin e titujve të borxhit me norma fikse dhe në bazë të periudhës së mbetur deri në vendosjen e normës së re të interesit, në rastin e titujve të borxhit me normë interesi të ndryshueshme, duke bërë dallimin midis titujve me kupon 3% dhe atyre me kupon më të lartë se 3%.

Rreshtat 210-240 - Rreziku i përgjithshëm: Metoda e bazuar në kohëzgjatjen financiare

Në këto rreshta bankat plotësojnë pozicionet në tituj të borxhit në përputhje me nenin 156, paragrafi 1, pika “a” dhe “b”, të rregullores, sipas kohëzgjatjes së çdo instrumenti.

Rreshti 250 - Rreziku specifik

Në këtë rresht, në kolonën 060, bankat plotësojnë kërkesën për kapital për rrezikun specifik (shih

shpjegimin për kolonën 060).

Në këtë rresht, në kolonat nga 010 deri në 040, bankat plotësojnë pozicionet në titujt e borxhit, subjekt i kërkesës për kapital të rrezikut specifik, si shumë e rreshtave 260-231.

Rreshti 251 - Kërkesa për kapital për instrumentet e borxhit jo të titullzuar

Në këtë rresht bankat plotësojnë kërkesën për kapital për rrezikun specifik për titujt e borxhit, si shumë e kërkesave për kapital të katër kategorive të titujve të borxhit, të përcaktuara në rreshtat nga 260-320, si dhe për derivatet e kredisë (*n-th to default*) të vlerësuar (*rated*), të përcaktuar në rreshtin 321.

Në llogaritjen e kërkesës për kapital, bankat konsiderojnë edhe reduktimet në kapital që rrjedhin si rezultat i mbrojtjes së pozicioneve me atë të derivateve të kredisë, sipas nenit 151 të rregullores.

Rreshti 325 - Kërkesa për kapital për pozicionet e titullzuara

Ky rresht i referohet nenit 153, paragrafi 6 të rregullores. Në këtë rresht banka plotëson ekspozimet e titullzuara në kolonat 010-040 dhe kërkesën për kapital në kolonën 060.

Rreshti 341- Qasje e veçantë për rrezikun e pozicionit për pozicionet në SKI

Ky rresht i referohet rrezikut të pozicionit për investimet në SIK, të cilat llogariten sipas nenit 161 të rregullores. Në këtë rresht bankat regjistrojnë pozicionet në SKI, sipas kolonave individuale 010-040, dhe kërkesën për kapital në kolonën 060.

Kërkesa për kapital për pozicionet në SKI llogaritet si 32% e pozicionit neto në investimet në SKI. Në qoftë se një bankë llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit për investimet në SKI, kërkesa për kapital do të jetë më e ulëta midis vlerës 32% të pozicionit neto dhe diferencës midis 40% të pozicionit neto dhe kërkesës për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit, të llogaritur për këto pozicione.

Rreshtat 350-380 – Kërkesë shtesë për opsionet, rreziqet jodelta

Rreshti 350 - Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jodelta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital, të reflektuar në rreshtat në vijim, 360:380.

Rreshti 360 - "Metoda e thjeshtë" përfaqëson kërkesë për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione të titujve të borxhit të specifikuara në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 370 - "Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun gamma" përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 3 i rregullores.

Rreshti 380 - "Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun vega" përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 5 i rregullores.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik, duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 070, rrjeshti 010.

3.2 Formulari MKR SA ECU - Rreziku i pozicionit të titujve të kapitalit

3.2.1 Të përgjithshme

Ky formular përmban informacion mbi rrezikun e pozicionit dhe kërkesën për kapital për rrezikun e pozicionit (të përgjithshëm dhe specifik) të lidhur me titujt e kapitalit në librin e tregtueshëm, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë gri.

Ky formular raportohet çdo gjashtëmujor.

3.2.2 Përbërja e kolonave

Ky formular përmban 7 kolona si më poshtë:

Kolonat 010 dhe 020 - Pozicionet individuale (në blerje dhe në shitje)

Në kolonat 100 dhe 200, bankat plotësojnë pozicionet bruto, pa marrë në konsideratë marrëveshjet e netimit dhe pa pozicionet e derivuara nga nënshkrimi i instrumenteve financiare.

Kolonat 030-040 - Pozicionet neto (në blerje dhe në shitje)

Pozicioni neto është diferenca midis pozicionit në blerje/shitje dhe atyre në shitje/blerje në instrumentet financiare të të njëjtit lloj. Bankat plotësojnë vlerën e pozicionit neto, pra pozicionin e kompensuar për çdo segment maturiteti. Gjatë plotësimit të këtyre kolonave, bankat marrin në konsideratë edhe kërkesat e nenit 167 - i cili përcakton faktorët e reduktimit – aty ku këto janë të aplikueshëm.

Kolona 050 – Pozicioni neto subjekt i kërkesës për kapital

Kjo kolonë i referohet pozicioneve neto që janë subjekt i kërkesës për kapital, që llogaritet nën përqasjet e reflektuara në rreshtat 010-120 të këtij formati. Pozicioni total neto llogaritet si shumë e pozicioneve nga rreshtat 010-120 të këtij formati, në rreshtin "Tituj të kapitalit në librin e tregtueshëm".

Kërkesa për kapital në %

Kjo kolonë përmban peshat me të cilat shumëzohen pozicionet neto, subjekt të kërkesës për

kapital, për të përllogaritur kërkesën përkatëse për kapital.

Kolona 060 - Kërkesa për kapital

Kolona 060 përmban kërkesën për kapital të llogaritur si prodhim i peshave në kolonën "pesha" dhe pozicioneve neto, subjekt i kërkesave për kapital nga kolona 6. Kërkesa totale për kapital është shuma e kërkesave për kapital nga rreshtat 1-6 të këtij formati dhe pasqyrohet në rreshtat "Tituj të kapitalit në librin e tregtueshëm".

3.2.3 Përbërja e rreshtave

Ky formular përmban rreshta me përmbajtjen e mëposhtme:

Rreshti 020 - Rreziku i përgjithshëm

Rreshti "Rreziku i përgjithshëm" përmban pozicionet në tituj të kapitalit, të përllogaritura në përputhje me nenet 159 dhe 160 të rregullores. Në rreshtat individualë 021 dhe 022, bankat plotësojnë pozicionet e treguara në kolonat 010-070. Në rreshtin 020 plotësohen shumat përkatëse të rreshtave 021dhe 022.

Rreshti 030 - Kontrata të së ardhmes që bazohen në indekset e aksioneve të tregtueshme në bursë, gjerësisht të diversifikueshme, subjekte të një përqasjeje të veçantë.

Bankat plotësojnë rreshtin 030 me pozicionet në tituj të kapitalit dhe kontrata të së ardhmes të indeksit të kapitalit që tregtohen në bursa të njohura, dhe që përfaqësojnë indekse gjerësisht të diversifikuara aksionesh, të cilat janë subjekt i një qasjeje të veçantë, të përllogaritura në përputhje me nenin 160 të rregullores.

Rreshti 040 - Aksione të tjera përveç atyre të përcaktuara në rreshtin 30

Bankat plotësojnë rreshtin 040 me pozicionet në tituj të tjerë të kapitalit, të ndryshëm nga kontratat e së ardhmes të indeksit të kapitalit që tregtohen në bursa të njohura dhe që përfaqësojnë indekse gjerësisht të diversifikuara aksionesh, të përllogaritura në përputhje me nenin 159 të rregullores.

Rreshti 050 - Rreziku specifik

Rreshti "Rreziku specifik" përmban pozicione në tituj të kapitalit që janë subjekt i përllogaritjes së rrezikut specifik, në përputhje me nenet 158 dhe 160 të rregullores.

Rreshti 080 - Qasje e veçantë për rrezikun e pozicionit për pozicionet në SKI

Ky rresht i referohet rrezikut të pozicionit për investimet në SKI, sipas nenit 161 të rregullores. Në këtë rresht, bankat regjistrojnë pozicionet në SKI sipas kolonave individuale 010-040 dhe kërkesën për kapital në kolonën 060.

Kërkesa për kapital për pozicionet në SKI llogaritet si 32% e pozicionit neto në investimet në SKI. Në qoftë se një bankë llogarit kërkesë për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit për investimet në SKI, kërkesa për kapital do të jetë më e ulëta midis vlerës 32% të pozicionit neto dhe diferencës midis 40% të pozicionit neto dhe kërkesës për kapital për rrezikun e kursit, të këmbimit të llogaritur për këto pozicione.

Rreshtat 090-120 – Kërkesë shtesë për opsionet, rreziqet jodelta

Rreshti 090 - Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jodelta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital të reflektuar në rreshtat në vijim, 100:120.

Rreshti 100 - "Metoda e thjeshtë" përfaqëson kërkesë për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione të titujve të borxhit, të specifikuara në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 110 - "Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun gamma" përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 3 i rregullores.

Rreshti 120 - "Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun vega" përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve të titujve të borxhit të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 5 i rregullores.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 070, rreshti 010.

3.3 Formulari CR TB SETT – Rreziku i shlyerjes

3.3.1 Të përgjithshme

Formulari CR SETT përmban informacion mbi transaksionet në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm, të cilat janë akoma të pashlyera pas datës së shlyerjes (datëvalutës) dhe kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes sipas nenit 368 të rregullores.

Bankat raportojnë në këtë format informacione mbi rrezikun e shlyerjes të lidhur me titujt e borxhit, titujt e kapitalit, monedhat dhe mallrat (*commodities*), të mbajtura në librin e tregtueshëm dhe në librin e bankës.

Në rast të transaksioneve të pashlyera pas datës së shlyerjes (datëvalutës), bankat llogarisin diferencën në çmim, ndaj të cilës janë ekspozuar. Kjo është diferenca midis çmimit të shlyerjes të rënë dakord për instrumentin dhe çmimit aktual të tij, kur kjo diferencë përbën humbje për bankën.

Bankat shumëzojnë këtë diferencë me faktorin përkatës, sipas tabelës 24 të rregullores. Për transaksionet të cilëve u ka kaluar data e valutës jo më shumë së katër ditë, faktori i ponderimit është 0%.

3.3.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular është i përbërë nga kolona me përmbajtjen e mëposhtme:

Kolona 010 - Transaksione të pashlyera me çmimin e shlyerjes

Në këtë kolonë do të paraqiten me çmimin e tyre të shlyerjes të gjitha transaksionet DVP, të cilat rezultojnë të pashlyera pas datës së valutës, pavarësisht nëse ato rezultojnë me humbje ose me fitim pas datës së shlyerjes.

Kolona 020 - Ekspozimi si rezultat i diferencës në çmim për transaksionet e pashlyera

Bazuar në nenin 368 të rregullores, bankat raportojnë në këtë kolonë diferencën midis çmimit të shlyerjes të rënë dakord për instrumentin dhe çmimin aktual të tij, kur kjo diferencë përbën humbje për bankën. Pra, bankat raportojnë në këtë kolonë vetëm transaksionet që rezultojnë me humbje pas datës së shlyerjes (datëvalutës).

Kolona 030 - Kërkesa për kapital

Në këtë kolonë bankat raportojnë kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes për transaksionet DVP, sipas nenit 368 të rregullores.

Kolona 040 - Ekspozimet e ponderuara me rrezik.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 040, rreshti 010.

3.3.3 Përmbajtja e rreshtave

Kjo tabelë përmban rreshta me përmbajtjen e mëposhtme:

Rreshti 010 - Totali i transaksioneve të pashlyera në librin e bankës

Bankat raportojnë në rreshtin 010 informacion të agreguar në lidhje me rrezikun e shlyerjes për transaksionet në librin e bankës.

Bankat raportojnë në qelizën 010/010 (rresht/kolonë) shumën e transaksioneve të pashlyera pas datës së shlyerjes (datëvalutës), me çmimin e shlyerjes.

Bankat raportojnë në qelizën 010/020 (rresht/kolonë) shumën e diferencave në çmim, si rezultat i transaksioneve të pashlyera që rezultojnë me humbje.

Bankat raportojnë në qelizën 010/030 kërkesën agregate për kapital për transaksionet në librin e bankës.

Rreshtat 020-060 - Transaksione të pashlyera

Në këta rreshta, bankat raportojnë transaksionet në librin e bankës, të cilat janë subjekt i rrezikut të shlyerjes sipas kategorive të përcaktuara në tabelën 24 të rregullores.

Për transaksionet të cilëve u ka kaluar data e valutës jo më shumë së katër ditë, faktori i ponderimit është 0%.

Në rreshtat në vijim, bankat raportojnë të njëjtin informacion si në rreshtat 010-060, por të lidhur me transaksionet në librin e tregtueshëm.

3.4 Formulari MKR SA COM - Rreziku i investimeve në mallra (*commodities*)

3.4.1 Të përgjithshme

Formulari MKR SA COM përmban informacion mbi pozicionet në mallra dhe kërkesën korresponduese për kapital për këto pozicione, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë gri.

Ky formular raportohet çdo gjashtëmujor.

3.4.2 Përmbajtja e kolonave

Ky formular përmban kolonat me përmbajtjen si më poshtë:

Kolonat 010-020 - Të gjitha pozicionet- në blerje dhe në shitje

Bankat plotësojnë pozicionet bruto në blerje/shitje duke konsideruar pozicionet në të njëjtin mall (*commodities*), sipas nenit 168, paragrafët 2 dhe 6 të rregullores.

Kolonat 030-040 - Pozicionet neto

Bankat plotësojnë pozicionin neto, sipas nenit 168, paragrafi 5.

Kolona 050 - Pozicionet subjekt i kërkesës për kapital

Bankat plotësojnë pozicionet që janë subjekt i kërkesës për kapital, sipas metodave të përcaktuara në nenin 168 të rregullores.

Kolona 060 - Kërkesa për kapital

Bankat raportojnë kërkesën për kapital për rrezikun në mallra, sipas nenit 168 të rregullores.

Kolona 070 - Ekspozimet e ponderuara me rrezik

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik, duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 070, rreshti 010.

3.4.3 Përmbajtja e rreshtave

Ky formular përmban rreshtat me përmbajtjen si më poshtë:

Rreshti 010 - Pozicionet totale në mallra (commodities)

Bankat plotësojnë pozicionet në mallra dhe kërkesën përkatëse për kapital.

Rreshtat - 020-060 - Pozicionet sipas klasave të mallrave (commodities)

Për qëllime raportimi, bankat grupojnë në katër klasat e mëposhtme mallrat në të cilat kanë investuar:

- Metale bazë (zink, bakër etj.);
- Metale të çmuara (përveç arit);
- Produkte bujqësore (softs);
- Të tjera.

Rreshti 070 – Metoda e bazuar në segmentet e maturitetit

Bankat plotësojnë pozicionet në mallra, subjekte të metodës së bazuar në segmentet e maturitetit, sipas nenit 172 të rregullores.

Rreshti 090 - Metoda e thjeshtë

Bankat plotësojnë pozicionet në mallra, subjekte të metodës së bazuar në segmentet e maturitetit, sipas nenit 171 të rregullores.

Rreshtat 100-130 – Kërkesë shtesë për opsionet, rreziqet jodelta

Rreshti 100 - Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jodelta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital të reflektuar në rreshtat në vijim, 060:080.

Rreshti 110 - “Metoda e thjeshtë” përfaqëson kërkesë për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione mbi mallra të specifikuara në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 120 - “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun gamma” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve mbi mallra, të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 3 i rregullores.

Rrjeshti 130 - “Metoda delta plus - kërkesë shtesë për rrezikun vega” përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve mbi mallra, të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 5 i rregullores.

3.5 Formulari MKR SA FX- Rreziku i kursit të këmbimit

3.5.1 Të përgjithshme

Llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit i referohet dispozitave të rregullores “Mbi administrimin e pozicioneve valutore” dhe neneve 173 dhe 174 të rregullores, si pjesë e kërkesës për kapital për rrezikun e tregut.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë gri.

Kjo tabelë raportohet çdo gjashtëmujor.

3.5.2 Raportimi i pozicionit valutor neto

Kjo tabelë është e përbërë nga 13 kolona (010-100), nga të cilat tri kolona nuk janë të hapura për plotësim të dhënash (060-090).

Bankat plotësojnë fillimisht kolonat 020 dhe 030, për rreshtat 130 - “Euro” deri te rreshti 410 – “monedha të tjera”.

Pozicionet që bankat plotësojnë në këto qeliza janë të lidhura me ekuivalentin në lekë të pozicioneve të raportuara në formularin 32 të SRU-së, pa pozicionet në Ar. Kështu, bankat plotësojnë pozicionin në blerje dhe shitje (kolona 020 dhe 030 e formatit), për rreshtat 130 – “Euro” deri rreshtin 400 – “Norwegian Corona”, bazuar në formularin 32 të SRU-së, si më poshtë:

- Pozicioni në blerje për çdo monedhë = shumë e pozicionit spot (në blerje) + pozicioni *forward* (në blerje) + pozicione në opsione në blerje;
- Pozicioni në shitje për çdo monedhë = shumë e pozicionit spot (në shitje) + pozicioni *forward* (në shitje) + pozicione në opsione në shitje.

Në qelizën 020/410 (kolonë/rresht) dhe 030/410 (kolonë/rresht), bankat raportojnë pozicionet e

krijuara nga investimet në SKI, të cilat, sipas nenit 174, trajtohen si monedhë e veçantë.

Shuma e rreshtave nga 130-410 në kolonën 020, që përfaqëson pozicione në blerje, plotësohet në qelizën 020/030 (kolonë/rresht) – "Të gjitha monedhat e tjera" (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Shuma e rreshtave nga 130-140 në kolonën 030, që përfaqëson pozicione në shitje, plotësohet në qelizën 030/030 (rresht/kolonë) – "Të gjitha monedhat e tjera" (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Bankat plotësojnë, gjithashtu, në qelizën 020/040 (kolonë/rresht) pozicionet në blerje dhe në shitje dhe qelizën 030/040, duke i'u referuar vlerës së raportuar në formularin 32 të SRU-së.

Bankat plotësojnë pozicionet neto për çdo monedhë (kolona 040 dhe 050), për rreshtat nga 130-140, si diferencë midis pozicionit në blerje dhe atij në shitje për çdo monedhë. Kjo diferencë i referohet kolonës 10 të formularit 32 të SRU-së.

Shuma e të gjitha pozicioneve neto në blerje për rreshtat 130-410, plotësohet në qelizën 040/030 (kolonë/rresht) – "Të gjitha monedhat e tjera" (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Shuma e të gjitha pozicioneve neto në shitje për rreshtat 130-410, plotësohet në qelizën e 050/030 (kolonë/rresht) – "Të gjitha monedhat e tjera" (duke përfshirë edhe pozicionet në SIK në monedha të veçanta).

Bankat plotësojnë në rreshtin 040, në kolonat 040 dhe 050, pozicionet neto (shitje ose blerje) në Ar.

3.5.3 Raportimi i kërkesës për kapital për pozicionin neto të hapur valutor

Bankat përllogarisin pozicionin valuator neto në blerje të bankës në të gjitha monedhat si shumë e rreshtave 030 dhe 040, në kolonën 040.

Bankat përllogarisin pozicionin valuator neto në shitje të bankës në të gjitha monedhat si shumë e rreshtave 030 dhe 040, në kolonën 050.

Vlera më e lartë midis pozicioneve të përcaktuar si më sipër përbën pozicionin valuator neto të bankës. Në rast se vlera e pozicionit valuator neto është më i lartë se 2 %, bankat llogarisin kërkesën për kapital, duke ponderuar këtë pozicion me 8%. Kërkesa për kapital plotësohet në kolonën 090, në rreshtat 030 dhe 040.

3.5.4 Rreziqe të tjera

Në llogaritjen e kërkesës totale për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit, bankat duhet të përfshijnë edhe kërkesën për kapital për rreziqet jodelta të lidhur me opsionet e këmbimeve valutore në librin e tregtueshëm.

Kjo kërkesë raportohet në rreshtat 050-080 të formatit, sipas kolonës 090.

Rreshti 050 - Kërkesë shtesë për opsionet (rreziqe jodelta) përfaqëson shumën e kërkesës për kapital të reflektuar në rreshtat në vijim, 060:080.

Rreshti 060 - "Metoda e thjeshtë" përfaqëson kërkesën për kapital të llogaritur për ato pozicione në opsione të kursit të këmbimit të specifikuara në nenin 176 të rregullores.

Rreshti 070 - "Metoda delta plus - kërkesa shtesë për rrezikun gamma" përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun gamma të opsioneve të këmbimit valutor të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 3 i rregullores.

Rreshti 080 - "Metoda delta plus - kërkesa shtesë për rrezikun vega" përfaqëson kërkesën për kapital për rrezikun vega të opsioneve të këmbimit valutor të llogaritur sipas nenit 180, paragrafi 5 i rregullores.

3.5.5 Kërkesa për kapital

Bankat llogarisin kërkesën totale për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit në kolonën 090, rreshti 010, si shumë e kërkesave për kapital për pozicionet valutore (rreshti 030+rreshti 040), si edhe kërkesës për kapital për opsionet-rreziqet jodelta (rreshti 050).

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për

kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në kolonën 100, rreshti 010.

4. Kërkesa për kapital për rrezikun operacional

4.1 Formulari OPR - Rreziku operacional

4.1.1 Të përgjithshme

Ky formular shërben për raportimin e kërkesës për kapital për rrezikun operacional

sipas Metodës së Thjeshtë, Metodës Standarde dhe Metodës Standarde të Avancuar.

Bankat plotësojnë vetëm atë pjesë të formatit që i referohet llogaritjeve për përqasjen e zgjedhur për llogaritjen e kërkesës për kapital.

Bankat nuk plotësojnë fushat me ngjyrë gri.

Ky formular raportohet çdo fundviti.

4.1.2 Metoda e Thjeshtë

Për raportim e kërkesës për kapital sipas kësaj metode, bankat raportojnë në kolonat 010-030 treguesin e së ardhurës neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit, të përllogaritur sipas nenit 184, paragrafët 1, 2 dhe 3. (Vitet: T-3, T-2, T-1, ku T është viti aktual).

Bankat raportojnë kërkesën për kapital në qelizën 070/010 (kolonë, rresht), të llogaritur bazuar në nenin 184, paragrafi 4.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezik për këtë rrezik duke shumëzuar kërkesën totale për kapital me 12.5 dhe kjo shumë reflektohet në qelizën 071/010.

4.1.3 Metoda standarde

Për raportimin e kërkesës për kapital sipas metodës standarde, bankat plotësojnë në rreshtat 030-100, në kolonat 010-030, treguesin e të ardhurave neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit sipas nenit 185 (tabela 30) e rregullores.

Bankat raportojnë kërkesën për kapital në qelizën 070/020, të llogaritur bazuar në nenin 185, paragrafi 1.

4.1.4 Metoda standarde e avancuar

Rreshtat 110 dhe 120, në kolonat 040-060, janë të lidhur me kërkesa specifike raportimi sipas metodës standarde të avancuar. Bankat raportojnë në këta rreshta treguesin alternativ për dy linjat e biznesit, Bankingu Tregtar dhe Bankingu me Pakicë, sipas nenit 185, paragrafët 2 dhe 3.

Bankat raportojnë kërkesën për kapital sipas kësaj metode në qelizën 070/020.

5. Formulari RMK - Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

Ky formular shërben për të pasqyruar llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit nga ana e bankave.

Formulari raportohet çdo tremujor.

FORMULARI 9

(shtuar me vendimin nr. 70, datë 18.12.2014)

RMK - Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

1)

Treguesit	Vlera
Kapitali rregullator	(a)
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(b)
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (në %)	(a)/(b)*100

2)

Treguesit	Vlera
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	(d)= (a) +(b) + (c) + (d) - (e)
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	(a)
12.5*kerkesa per kapital per rrezikun e tregut	(b)
12.5*kerkesa per kapital per rrezikun operacional	(c)
Shtesat per rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidenteve, në valutë	(d)
Pakësimet për rritjen e portofolit të kredisë brenda vendit për vitin 2015	(e)

(shtuar me vendimin nr. 70, datë 18.12.2014 dhe ndryshuar me vendimin nr. 91, datë 2.12.2015)

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 1

Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" jorezidente në valutë
(në mijë lekë)
Emri i bankës ....
Periudha raportuese .....
Data e raportimit .....
Përgatiti (emër, mbiemër, firmë)
Drejtuesi (emër, mbiemër, firmë)

Nr.	**Llogaritja e rritjes së totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik, bazuar në klasat "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë**	**Mënyra e llogaritjes**
1	Totali i zërave të aktivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve në valutë, mars 2013	(a)
2	Totali i zërave të aktivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë në periudhën raportuese	(b)
3	Rritja e zërave të aktivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë	(c) = (b) - (a)
4	Totali i zërave të pasivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë" të jorezidentëve në valutë, mars 2013	(d)
5	Totali i zërave të pasivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë në periudhën raportuese	(e)
6	Rritja e zërave të pasivit "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe i "Veprimeve me letrat me vlerë", të jorezidentëve në valutë	(f) = (e) - (d)
7	Shtesa e totalit të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik	(g) = 0 nëse (c) <= 0 ose (c) < (f); (g) = (c) nëse (f) < 0 (g) = (c) – (f) nëse (f) > 0

FORMULARI I RAPORTIMIT NR. 2

Nr.	**Llogaritja e pakësimit të totalit të aktiveve dhe të zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, bazuar në rritjen e portofolit të kredisë bruto brenda vendit**	**Mënyra e llogaritjes**
1	Portofoli i kredisë bruto, në dhjetor 2015	(a)
2	Portofoli i kredisë bruto, në periudhën raportuese 2016	(b)
3	Rritja e portofolit të kredisë, 2016	(c) = (b) - (a)
4	Rritja e portofolit të kredisë për 2016-n, me bazë vjetore, sipas periudhës raportuese: - nëse periudha raportuese është mars 2016 - nëse periudha raportuese është qershor 2016 - nëse periudha raportuese është shtator 2016 - nëse periudha raportuese është dhjetor 2016	(d) = (c) * 4; (d) = (c) * 2; (d) = (c) * 4/3 (d) = (c)

5.	4% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2015	(e) = (a) * 4%
6.	10% e portofolit të kredisë së dhjetorit 2015	(f) = (a) * 10%
7.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, vetëm mars 2016 dhe për qershorin 2016	(g) = 0 nëse (d) < (e); (g) = (c) nëse (e) < (d) < (f); (g) = (f) nëse (d) > (f)
8.	Pakësimi i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezik, vetëm shtator 2016 dhe për dhjetorin 2016	(g) = 0 nëse (d) < (e); (g) = 50%*(c) nëse (e) < (d) < (f); (g) = 50%*(f) nëse (d) > (f)